



RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA
DHE PUNËN E ENTIT
SHTETËROR PËR REVIZION

për vitin
2022



**PER VITIN
2022**

RAPORTI VJETOR
PËR REVIZIONET E KRYERA
DHE PUNËN E ENTIT
SHTETËROR PËR REVIZION

Titulli origjinal:

Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2022 година

Titulli i publikimit:

Raporti vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2022

Botues:

Enti Shtetëror i Revizionit – Shkup
Rruga Pavel Shatev nr. 2, Pallati Emanuel Çučkov, Shkup

Për botuesin:

mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

Redaktor:

mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

Албански јазик

Përkthim maqedonisht-shqip: Sefedin Rexhepi

Shtypi:

Shoqëria për aktivitetin e shtypjes grafike, tregtinë, prodhimin dhe shërbimet GETEO print Pero SHPKNJ eksport - import -Shkup

Përpunimi kompjuterik dhe teknik:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KOMA SHPKNJ eksport import Shkup

Vendi i botimit:

Shkup, 2023

Tirazhi:

100 kopje

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
„Св. Климент Охридски“, Скопје
657.6(497.7)“2022”(047.31)

RAPORTI vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit shtetëror për revizion për vitin 2022 / [redaktor Maksim Acevski] ; përkthim maqedonisht-shqip Sefedin Rexhepi]. - Shkup : Enti shtetëror i revizionit, 2023. - 264 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2022 година

ISBN 978-608-5006-04-5

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2022 -- Извештаи


COBISS.MK-ID 60750341



The graphic preparation of this product is prepared within the programme "Democracy Works" which is implemented by the Westminster Foundation for Democracy (WFD), with support from the British Embassy in North Macedonia. The content of this publication does not necessarily reflect the position or the opinions of the WFD and UK Government.

Графичката подготовка на овој производ е подготвен во рамки на проектот „Практикувај демократија“, кој го спроведува Фондацијата за демократија на Вестминстер (ВФД), со поддршка од Британската Амбасада во Северна Македонија. Мислењата и ставовите наведени во оваа содржина не ги одразуваат секогаш мислењата и ставовите на (ВФД) и на Британската Влада.

Përgatitja grafike e këtij produkti është përgatitur në kuadër të projektit "Praktiko demokraci", i cili zbatohet nga Fondacioni për Demokraci Westminster (WFD), me mështetjen e Ambasadës Britanike në Maqedoninë e Veriut. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar



PËRMBAJTJA

1	PËR ENTIN SHETËTOR TË REVIZIONIT	17
	1.1. Korniza juridike	20
	1.2. Dokumentet strategjike	22
	1.3. Dokumentet metodologjike	32
2	KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUAR	37
	2.1. Transparenca në punën e ESHR-së	37
	2.2. Bashkëpunimi me kuvendin, organet shtetërore, asociacionet dhe institucionet profesionale, organizatat qytetare dhe publikun e gjerë	45
	2.3. Bashkëpunimi me organet kompetente për revizionet dhe efektet e tyre	51
3	KAPACITETET ADMINISTRATIVE	55
	3.1. Struktura e organizimit dhe burimet njerzore	55
	3.2. Rritja e njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetëror	58
	3.3. Burimet e TI-së	60
	3.4. Mjetet financiare për punën e ESHR-së	62
	3.5. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit jetësor	67
4	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	69
	4.1. Aktivitetet e projekteve	82
	4.2. Integrimet në BE	88
5	REVIZIONET E KRYERA	91
	5.1. Vlera e shtuar e revizioneve	99
	5.2. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021	101
	5.2.1. Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021	101
	5.2.2. Procesi i marrjes dhe shfrytëzimi i mjeteve nëpërmjet Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF)	111
	5.2.3. Ministria e financave	117

5.2.4.	Drejtoria e doganave Republikës së Maqedonisë së Veriut	118
5.2.5.	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	120
5.3.	Regjistrimi	125
5.3.1.	Regjistrimi i popullatës, amvisërisë dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021	125
5.4.	Administrata publike	130
5.4.1.	Reforma në administratën publike	130
5.5.	Zhvillimi rajonal	134
5.5.1.	Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë të demografisë	134
5.6.	Zhvillimi ekonomik dhe teknologjik	138
5.6.1.	Zhvillimi dhe puna e zonave zhvillimore teknologjike industriale	138
5.6.2.	Mbështetje financiare (grante kofinanciare) për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për inovacion dhe zhvillim teknologjik	142
5.7.	Shëndetësia	145
5.7.1.	Fondi i sigurimit shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut	145
5.7.2.	Institucionet shëndetësore publike	150
5.8.	Energjetika	151
5.8.1.	SHA për transmetim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi shtetërore Shkup	151
5.8.2.	Gatishmëria e sistemit energjetik për tu ballafaquar me krizën energjetike	154
5.9.	Shoqërit informatike /sistemet informative	160
5.9.1.	Regjistrat bujqësore në MBPE dhe AUV, dhe përdorimi i tyre në funksion të realizimit efektiv të të drejtave dhe plotësimit të detyrave të ekonomisë bujqësore	160
5.9.2.	Efektiviteti i sistemit të informacionit në drejtorin për të ardhurat publike për administrimin e tatimeve publike	161
5.10.	Gjyqësori dhe sundimi i së drejtës	163
5.10.1.	Efektiviteti i zbatimit të strategjisë për reforma në sektorin e jurispondencës 2017- 2022 dhe zbatimin e planit të veprimit të strategjisë	163
5.11.	Rini dhe sport	167
5.11.1.	Agjencia për rini dhe sport	167
5.12.	Mjedisi jetësor	169
5.12.1.	Tatimet për mjedisin jetësor në funksion të zbatimit efektiv të politikave për mbrojtje të mjedisit jetësor	169

5.13.	Bujqësia, pylltaria dhe ekonomia e ujit	172
5.13.1.	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujit	172
5.13.2.	Sistem për menaxhim me kriza dhe mbrojtje nga zjarret	174
5.13.3.	Shfrytëzimi i ujrave për ujitje	178
5.14.	Furnizim me ujë dhe shërbime komunale	186
5.14.1.	NPK Komunalec Sveti Nikollë	186
5.14.2.	NP Ujësjellësi dhe kanalizim - Shkup	188
5.15.	Punë dhe sociale	194
5.15.1.	Ministria e punës dhe politikës sociale	194
5.15.2.	Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut	198
5.15.3.	Agjencioni për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut	204
5.15.4.	Institucioni komunal publik shtëpia për persona të moshuar Kiro Kërsteski Platnik Prilep	208
5.16.	Arsimi	210
5.16.1.	SHFK "Luben Lape"- Komuna e Aerodromit	210
5.17.	Kulturë dhe trashëgimi kulturore	211
5.17.1.	Agjencia e filmit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	211
5.17.2.	Efikasiteti i politikave dhe masave për mbrojtje, menaxhim dhe vlerësim të trashëgimisë kulturore të patundshmërisë	213
5.18.	Vetëqeverisja lokale	219
5.18.1.	Njësitë e vetëqeverisjes lokale	219
5.18.2.	Të ardhurat vetanake të komunave për sigurimin e shërbimeve cilësor të qytetarëve gjatë kohës së pandemisë	222
5.19.	Partitë politike dhe fushatat zgjedhore	227
5.19.1.	Komisioni shtetëror i zgjedhjeve - fondet e paguara për zgjedhjet lokale 2021	227
5.19.2.	Fushata zgjedhore - zgjedhjet lokale 2021	230
5.19.3.	Partitë politike- puna e rregullt	232

6	DOBËSITË SISTEMORE	235
7	RAPORTI FINANCIAR I ESHR-së DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR	245
8	SHKURTESAT E SHFRYTËZUARA	262

Të nderuar,

Raporti vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 është pasqyrë objektive e rezultateve të punës sonë dhe revizioneve të zbatuara në vitin 2022.

Në vitin 2022, Enti Shtetëror i Revizionit realizoi Programin Vjetor të Punës, me të cilin u përfshin 188 revizione. Janë konstatuar 1242 gjendje, janë dhënë 775 rekomandime të përfshira në 223 raporte të revizorit, përmes të cilit kemi prezantuar informacionet objektive për punën e subjekteve të reviduara. Thëks i veçantë, sikurse edhe në vitin e kaluar u është kushtuar revizioneve të suksesit, të cilat, për kënaqësinë time po marrin gjithnjë e më shumë rëndësi çdo vjet. Fokusohemi në çështjet aktuale, me interes për publikun dhe palët e tjera të interesuara, me theks të veçantë në vlerën e shtuar të tyre. Gjatë zgjedhjes dhe definimit të fushëveprimit të revizioneve, si deri më tani kemi udhëhequr nga qëllimet tona strategjike, por edhe parimet e transparencës, shpenzimi i mjeteve sipas dedikimit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve që qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut i meritojnë.

Me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, u rrumbullaksua edhe realizimi i Strategjisë për zhvillim i Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2018-2022, e cila ishte udhërrëfyese ynë në arritjen e objektivave tona strategjike, por i orientuar edhe drejt maksimizimit të kontributeve tona në forcimin e kontrollit dhe përgjegjësisë financiare në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në lidhje me treguesit e punës sonë, me revizionet në vitin 2022 kemi rritur fushëveprimin e shpenzimeve të reviduara në raport me mjetet e përgjithshme buxhetore, dhe në të njëjtën kohë është rritur vlera e shtuar nga revizionet e kryera, para se gjithash, në pjesën e lartësisë së përcaktuar më pak të llogaritura, më pak të kthyera, gjegjësisht mjete më pak të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në buxhetet e komunave që tregojnë faktin se kontributi i ESHR-së në forcimin e institucioneve dhe përgjegjësisë menaxheriale është gjithnjë e më i rëndësishëm në shoqërinë tonë.

Ne vazhdimisht theksojmë edhe dobësitë sistemore, gjegjësisht dobësitë dhe paqartësitë në rregullativën në fusha të caktuara, duke treguar nevojën për tejkalimin e tyre, kontribuojmë në forcimin e sistemit juridik dhe krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e mëtejshëm të subjekteve juridike.

Transparenca dhe llogaridhënia në funksionimin e ESHR-së është gjithashtu thelbësore për ndërtimin e besimit, përgjegjësisë dhe efikasitetit në kryerjen

e revizionit shtetëror. Në drejtim të realizimit të objektivave strategjike, ESHR-ja përpiket të bashkëpunojë dhe bashkëpunon me qytetarët dhe mediat, organizatat joqeveritare dhe institucionet dhe organizatat e tjera me qëllim të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në përdorimin e mjeteve të tatimpaguesve. Për këtë qëllim, vazhdimisht ndërmarrim aktivitete për të rritur numrin e palëve të interesuara që marrin informacione në kohë për punën e ESHR-së dhe me kënaqësi mund të theksoj se numri i palëve të interesuara në dhjetor 2022 është 1.100.

Punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit me profesionalizmin, përgjegjësinë, besueshmërinë, paanshmërinë, pavarësinë, ndërgjeshmërinë, etikën e tyre kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë e punës së institucionit tonë. Prandaj, roli i çdo punonjësi është i rëndësishëm për funksionimin e suksesshëm të Entit Shtetëror të Revizionit. Në këtë drejtim dhe në vitin 2022 kemi investuar në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit dhe përmirësimin e proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe në ngritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të revizorëve tanë.

Pikërisht këto vlera janë parakusht për përmbushjen e detyrimeve të Entit Shtetëror të Revizionit në mënyrë që do t'i sigurojë Kuvendit dhe palëve të tjera të interesuara besim dhe siguri se raportet për revizionet e kryera dhe raporti vjetor në tërësi, përmbajnë informacione të sakta dhe objektive të bazuara në fakte, gjetje dhe rekomandime.

Prioriteti ynë në periudhën e ardhshme do të jetë realizimi i aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë e re për zhvillim e ESHR-së për vitet 2023-2027, të orientuar drejt forcimit të pavarësisë dhe integritetit të institucionit, ngritjen profesionale të të punësuarve dhe zbatimin e dispozitave të Memorandumit të lidhur ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ESHR-së.

Gjithashtu, do të vazhdojmë me përpjekjet drejt realizimit të pavarësisë kushtetuese dhe të plotë financiare dhe operative të Entit Shtetëror të Revizionit, ruajtjen e cilësisë dhe besimit të lartë, të njohur për punën e ESHR-së, me qëllim mbrojtjen e mjeteve të tatimpaguesve.



**"TË MËSOHEMI T'I
MENAXHOJMË RREZIQET PËR
T'I PARANDALUAR PASOJAT"**

Kryerevizori Shtetëror
mr. Maksim Acevski

REZULTATET KYÇE

NGA PUNA E ENTIT

SHTETËROR TË REVIZIONIT

106.200.612

Totali i
aktivës/pasivës

1.464.468

Kompensimet/
detyrimet publike/të
papaguara/ më pak të
paguara/në Buxhetin
e shtetit

441.862

Kompensimet e
papaguara më
pak të paguara
në Buxhetin e
komunave të
reviduara

2.341.039

Përdorimi i
mjeteve në
kundërshtim
me ligjin

6.089.138

Shuma
totale e
prokurimeve
publike

2.953.311

Përfshirja e PP-
së me revizionet

986.970

Shuma e
përgjithshme
nga parregullsitë
e konstatuara
te PP

**VLERA E
SHTUAR E
REVIZIONEVE**

139.337

Furnizimet e kryera
për të cilat nuk
është zbatuar
procedura për PP

602.006

Evidencimet
korrektuese
në Bilancet e
gjendjes

9.716.228

Gjendjet e përcaktuara që
ndikojnë në veprimtarinë
e subjektit lëndë të
revizionit dhe investimet
kapitale

246.000

Grantet e
anuluara/
humbura

6.303.750

Anulimi/ ndërprerja
e granteve për
investime
(të miratuara, por
huat/kredit/grantet
të pa tërhequr)

32.700

Provizionet
e paguara
për fondet e
patërhequra të
kredisë/huasë

në 000 denarë

PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2021



OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET

188 REVIZIONE TË KRYERA

170 Revizione të rregullshmërisë

12 Revizione të suksesit
4 Revizione të mjedisit jetësor 2 revizione të TI-së

6 Revizione të pajtueshmërisë

TEMAT E PËRFSHIRA ME REVIZIONET



REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

223


RAPORTE TË REVIZIONIT

OPINIONE TË REVIZIONIT REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË

KONKLUZIONE


REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË/ REVIZIONI I SUKSESIT

205 opinione për raportet financiare



69 pa rezervë

26 me rezervë



35 opinione të pavoritshme


75 refuzim opinionioni

196 opinione për pajtueshmëri me rregulla dhe ligje



55 pa rezervë

35 me rezervë



33 opinione të pavoritshme

73 refuzim opinionioni

6 konkluzione për revizionin e pajtueshmërisë



12 konkluzione për revizionin e suksesit



2 konkluzione për revizionin e TI-së



4 konkluzione Revizione të mjedisit jetësor



145

Parti Politike dhe pjesëmarrës në fushatë zgjedhore - Zgjedhjet Lokale 2021

1.242 ⚠️

GJETJET DHE PYETJET TË DEDIKTUARA ME REVIZION

333

SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

- **903** Revizione të rregullshmërisë
- **215** Revizione të suksesit
- **98** Revizione të pajtueshmërisë
- **26** Revizione të TI-së

- **25** Revizione të rregullshmërisë
- **151** Revizione të suksesit
- **6** Revizione të pajtueshmërisë
- **6** Revizione të TI-së

86

DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET TE PROKURIMET PUBLIKE

VLERA E PËRGJITHSHME E KONTRATAVE TË NDARA PËR PROKURIMET PUBLIKE

6.089.138

(në 000 denarë)

PROKURIME PUBLIKE TË REVIDUARA

2.953.311

(në 000 denarë)

986.970 ⚠️

PARREGULLSI TË KONSTATUARA TE PROKURIMET PUBLIKE

(në 000 denarë)

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura në bazë të prokurimeve publike;
- procedura të pa zbatuara të prokurimeve publike
- dobësi në planifikimin e prokurimeve publike
- parregullsi gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit/specifikime teknike
- dobësi në miratimin e vendimeve për prokurimet publike
- elemente të kufizuara të përfshira në dokumentacionet e tenderit në lidhje me konkurrencën

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E REVIDUARA

Gjithsej **411.508 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **284.839 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022

	Të ardhurat e reviduara publike	Shpenzimet e reviduara publike
Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	227.343 217.686	79.847 12.693
Buxhetet e fondeve	123.039 121.805	115.742 115.718
Buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale	12.515 3.393	11.536 2.829
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së	1.045 782	1.014 773
Partitë politike	766 397	734 294
Ndërmarrjet publike	1.659 1.744	1.709 1.953
Institucionet tjera/Personat juridik në të cilat shteti është aksioner	8.134 13.939	7.958 15.220
Të përfshira me revizionin e pajtueshmërisë	35.322 94.878	63.063 79.558
Të përfshira me revizionin e suksesit	1.685 57.299	3.236 7.022

■ Programin Vjetor - 2022

■ Programin Vjetor -2021

(në milionë denarë)

REKOMANDIMET E DHËNË DHE MASAT E NDËRMARRA

2022

775
REKOMANDIMET
E DHËNA TOTALE


■ **390** REKOMANDIME PËR TË CILAT KA
SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR
DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE

■ **385** REKOMANDIME PËR TË CILAT NUK KA
SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR
DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE


■ **98** REKOMANDIME PËR TË CILAT KA SKADUAR AFATI PREJ
90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE
NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

80%
ËSHTË
VEPRUAR SIPAS
REKOMANDIMEVE

292
REKOMANDIME
ME STATUS TË
PËRCAKTUAR



234 REKOMANDIME PËR TË CILAT
JANË NDËRMARRË MASA




44 nuk janë zbatuar




14 të pazbatueshme


2021



2020



PROCESI I REVIZIONIT





**PËR ENTIN
SHTETËROR TË
REVIZIONIT**

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Pavarur i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili më shumë se 20 vjet i informon institucionet kompetente dhe publikun në mënyrë transparente, në kohë dhe në mënyrë objektive për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera.

ESHR-ja revizionet i kryen në përputhje me udhëzimet, standardet dhe parimet e revizionit të përmbajtura në kornizën e njoftimeve profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI).

Pavarësia e institucionit është përcaktuar me Ligjin për revizion shtetëror, në të cilin janë rregulluar kompetencat e ESHR-së, është përcaktuar mandati i gjerë në kryerjen e revizioneve, me qasje në të gjitha informacionet, dokumentacionet dhe evidencat e nevojshme për zbatimin e revizionit shtetëror. ESHR-ja në mënyrë të pavarur e përcakton Programin Vjetor të Punës, në mënyrë objektive vendos për subjektet që janë lëndë e revizionit dhe mënyrën, përmbajtjen e njoftimit nga revizionet e kryera, në mënyrë të paanshme dhe i pa ndikuar nga pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.



MISIONI

KUSH JEMI DHE ÇFARË PUNOJMË?



Enti Shtetëror i Revizionit është Institucion Suprem i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili ka mandatin për të kryer punën e revizionit shtetëror. Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizionin shtetëror të raporteve financiare, të pajtueshmërisë me rregullat dhe rregullativat ligjore dhe revizionin e suksesit në përputhje me kërkesat e standardeve të INTOSAI.

Detyra jonë është të **zbatojmë kontrollime, të japim vlerësime dhe të shprehim opinione** sipas revizioneve të kryera të cilat do të kenë vlerë të shtuar për mirëqenien e qytetareve.

Rezultatet nga puna jonë dhe mandati ynë janë në funksion të plotësimin të nevojave dhe pritshmërisë së përdoruesve tanë, për shkak të promovimit dhe sigurimit të llogaridhënies, objektivitetit dhe transparencës në mbështetjen e shtetit, në drejtim të menaxhimit me mençuri dhe ndershmëri me mjetet publike.

VIZIONI ÇFARË SYNOJMË?



Në synimet për plotësimin e misionit tonë, besojmë se edhe më tej do ta mbajmë pavarësinë, profesionalizmin, etikën dhe ndershmërinë tonë, duke i zbatuar detyrat tona në përputhje me mandatin dhe ligjin, do të sigurojmë promovimin e vazhdueshëm të objektivitetit dhe transparencës, do të jemi frymëzues dhe inovativë dhe do të japim shembullin më të mirë për mbrojtjen e interesit publik në funksion të arritjes së nivelit të lartë të besimit nga publiku.

Në drejtim të realizimit të vlerave tona, të gjithë punonjësit tanë punojnë me përkushtim si profesionistë mjaft të mirë, duke i mbrojtur dhe respektuar interesat e profesionit të revizorit.



1.1

KORNIZA JURIDIKE

PAVARËSIA DHE KOMPETENCAT LIGJORE

Me Ligjin për revizion shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/2021) janë rregulluar kushtet dhe mënyra e kryerjes së revizionit shtetëror, si dhe organizimi dhe kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit.

Me qëllim të përmirësimit të kornizës juridike për revizionin shtetëror për shkak të arritjes së pavarësisë kushtetuese të ESHR-së dhe forcimit të pavarësisë operative dhe financiare në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së që është edhe orientimi strategjik i Entit Shtetëror të Revizionit, por edhe një nga kërkesat e:

- INTOSAI P-10 Deklarata e Meksikës për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Revizionit;
- Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) 2021-2025 për Kapitullin 3.32. Kontrolli financiar i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Programit për reforma të menaxhimit me financat publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022-2025 dhe Draft-Plani i Veprimit për Zbatim për vitin 2022, për shtyllën 7 – Kontrolli i jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare,

në kuadër të Tvinging Projektit "**Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare**", është përgatitur vlerësimi i kornizës juridike për revizionin shtetëror dhe janë dhënë rekomandimet për arritjen e pavarësisë kushtetuese dhe forcimin e pavarësisë operative dhe financiare të ESHR-së.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, me ndihmën e projektit të theksuar në periudhën 2021-2022 janë përgatitur:

Propozim-amendamentet për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e ESHR-së si kategori kushtetuese

Propozim-tekstin e amendamenteve kushtetuese, Enti Shtetëror i Revizionit e dorëzoi në Ministrinë e Drejtësisë si ministri kompetente, në Kuvend dhe Qeveri. Nga ana e organeve kompetente, ESHR-ja është informuar se iniciativa e tillë është në drejtim të forcimit të pavarësisë së ESHR-së dhe do të merret parasysh, por për shkak se ato përfaqësojnë sugjerime dhe kërkojnë trajtimin e veçantë në legjislacionin tonë dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në këtë proces, ESHR-ja do të njoftohet me kohë për të gjitha aktivitetet e ndërmarra. Në këtë drejtim presim që ministria kompetente në koordinim me të gjitha palët e interesuara në proces, të dorëzojë iniciativë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e pavarësisë së Entit Shtetëror të Revizionit në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Propozim-ligji i ri për revizion shtetëror

Propozim-ligji i ri për revizion shtetëror parasheh përforcimin e pavarësisë operative dhe financiare të Entit Shtetëror të Revizionit, veprim sipas rekomandimeve nga ana e subjekteve që janë lëndë e revizionit dhe krijon mundësi për shqyrtimin e raporteve përfundimtare të revizorit nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto janë përmirësime të rëndësishme të legjislacionit për revizion shtetëror në pajtim me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare për revizionin shtetëror të institucioneve supreme të revizionit. Për këtë Propozim-ligj janë siguruar edhe mendimet e:

- Drejtorisë së Përgjithshme për Buxhet të Komisionit Evropian (DG Budget),
- Iniciativës zhvillimore të INTOSAI (INTOSAI Development Initiative) dhe
- Tvinging Partnerëve të ISR-së së Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Bullgarisë.

Enti Shtetëror i Revizionit në bashkëpunim me Fondacionin për Demokraci Westminster në mars të 2022, organizoi ngjarje / debat publik në lidhje me draft-versionin e Ligjit të ri për revizion shtetëror në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Ve-

riut, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, Delegacionit të BE-së në Shkup, institucionet profesionale, komuniteti akademik, organizatat qytetare dhe punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit.

Propozim-ligji për revizion shtetëror nga ana e kryerevizorit shtetëror në prill të vitit 2022 iu dorëzua Ministrisë së Financave, për të vepruar në vazhdim si organ kompetent për rregullimin e politikave në fushën e financave publike. Në shkurt të vitit 2023, filluan procesin e konsultimeve publike për ligjin e ri për revizion shtetëror në platformën e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.ener.gov.mk).

Në periudhën e ardhshme pritet iniciimi i procedurës për miratimin e Ligjit të ri për revizion shtetëror dhe miratimi i amendamenteve kushtetuese.

Në mënyrë plotësuese, me qëllim të qasjes së sinkronizuar dhe të njëtrajtshme në rregullimin e fushës së financave publike, u përgatitën vlerësimet dhe u dhanë propozimet për përmirësimin sistematik të rregullave të reja në këtë fushë, veçanërisht në Ligjin e ri për buxhete me të cilat është rregulluar revizioni i financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe prokurimeve publike.

1.2 DOKUMENTET STRATEGJIKE

Zhvillimi strategjik i çdo organizate kërkon vizion për të ardhmen e dëshiruar dhe hartimin e planit, se si të bëhet realitet ai vizion. Prandaj zhvillimi i dokumenteve strategjike është një nga hapat kryesorë në zhvillimin e ISR-së dhe realizimin e vizionit, misionit dhe qëllimeve të tij. Në Raportet Vjetore të Progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të Komisionit Evropian në lidhje me fushën e revizionit të jashtëm, dhe i cili është në kompetencë të ESHR-së, janë treguar aspektet për të cilat nevojitet ndërmarrja e aktiviteteve nga organet kompetente në lidhje me:

- pavarësinë e Entit Shtetëror të Revizionit që të garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- kornizën juridike të sigurohet pavarësia e ESHR-së në pajtim me standardet INTOSAI;
- rekomandimet e përmbajtura në raportet e revizorit që të zbatohen në kohë dhe në mënyrë sistematike;
- diskutimin në Kuvend për raportet e revizorit.

Qasja strategjike në funksionimin e Entit Shtetëror të Revizionit rezultoi me miratimin e disa dokumenteve strategjike të cilat janë në drejtim të veprimtarisë dhe përcaktimit të aktiviteteve për qëllimet që duhet të realizohen në periudhën aktuale dhe të ardhshme, ndërsa janë në funksion të realizimit të tyre dhe hartimit të planeve përkatëse për implementim.

Në Entin Shtetëror të Revizionit janë miratuar më shumë dokumente strategjike, si në vijim:

Strategjia për zhvillim të Entit Shtetëror të Revizionit 2018 – 2022


Strategjia për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit për 2018-2022 i përmban përpjekjet për forcimin e pavarësisë dhe integritetit si parakusht për arritjen e profesionalizmit dhe kredibilitetit në funksionim, për të promovuar dhe përmirësuar zbatimin e parimeve, standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare të përmbajtura në Kornizën për publikimet profesionale të INTOSAI, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të efekteve të revizioneve të kryera dhe shkallës së përmbushjes së rekomandimeve të përmbajtura në raportet e revizionit. Enti Shtetëror i Revizionit në tërësi e ka realizuar këtë Strategji.

Strategjia e re për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2023 – 2027

Me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve në kohë për të përcaktuar qëllimet strategjike për periudhën e ardhshme 2023-2027, iu qas punës drejt miratimit të dokumentit të ri strategjik. Miratimi i Strategjisë së re për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2023-2027 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, paraqesin pjesë të aktiviteteve të realizuara me Tvinging Projektin "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare".

Në Strategji, ESHR-ja përpara vetes i vendosi qëllimet dhe prioritetet kryesore, të identifikuara përmes qëllimeve strategjike:

QËLLIMET STRATEGJIK



Strategjia e TI-së së ESHR-së 2018 – 2022

Në vitin 2022 janë realizuar aktivitetet për zbatimin e Strategjisë ekzistuese të TI-së së Entit Shtetëror të Revizionit 2018-2022, me qëllim që të rritet efikasiteti i sistemit të informacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit. Strategjia e theksuar i përkufizon katër qëllimet strategjike si në vijim:

- sigurimi dhe mirëmbajtja e burimeve të nevojshme për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të TI-së së ESHR-së (burimet njerëzore dhe politikat dhe procedurat për menaxhimin me proceset e punës),
- zhvillimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e arkitekturës së TIK-së në pajtim me zhvillimin e standardeve dhe teknologjive të reja,
- zhvillimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e zgjidhjeve aplikative dhe mbështetjes së TIK-së së revizionit,
- prezantimi i rezultateve nga puna e ESHR-së.

Implementimi i strategjisë së theksuar, aktivitetet e vazhdueshme të ndërmarra për mbrojtjen e sistemeve të informacioneve dhe investimet në zgjidhjet e reja moderne teknologjike (harduer dhe softuer), paraqet një nga parakushtet themelore për sigurinë e të dhënave të ESHR-së dhe mbrojtjen nga sulmet sajber.

Por, duke pasur parasysh se strategjia e theksuar e ka përfshirë periudhën që ka kaluar tashmë, nga ESHR-ja janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë së re të TI-së së ESHR-së për vitet 2023-2027.

Strategjia e komunikimit e ESHR-së 2020 – 2023

Qëllimi kryesor i Strategjisë së komunikimit është rritja e shkallës së informimit të publikut për rolin dhe detyrën e ESHR-së dhe të forcohet roli i ESHR-së si institucion në shërbim të publikut. Në strategji janë përkufizuar qëllimet e veçanta që orientohen drejt realizimit të rezultateve konkrete, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetet strategjike të ESHR-së, ndër të cilat janë:

- të promovohet roli i ESHR-së si promotor i parimit të transparencës dhe llogaridhënies së parave publike;
- të zhvillohet dhe forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi me të gjitha grupet e interesuara;
- të vendoset mbështetja publike për punën e ESHR-së dhe të sigurohet pjesëmarrja e publikut;
- nëpërmjet angazhimit të madh të publikut, të nxiten institucionet të veprojnë sipas raporteve të ESHR-së.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punë, si dhe për të mundësuar disponueshmërinë e informacioneve për punën e ESHR-së dhe për gjendjet e përmbytura në Raportet Përfundimtare të Revizorit, ESHR-ja vendosi regjistër të palëve të interesuara që përfshin 1.110 palë të interesuara. Vendosi përgatitjen e abstraktëve të revizorit dhe njoftime për publikun, ku në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme jepen gjendjet / informacionet kryesore të përmbytura në Raportet Përfundimtare të Revizorit. Me publikimin e Raportit Përfundimtar të Revizorit, informacioni u dorëzohet të gjithë palëve të interesuara. Informacionet për

punën e ESHR-së dhe për Raportet Përfundimtare të Revizorit me rregull publikohen në faqen e internetit të ESHR-së (www.dzr.mk) dhe Facebook¹.

Strategjia për menaxhimin me rreziqet e Entit Shtetëror të Revizionit 2020-2023

Me Strategjinë e miratuar për menaxhimin me rreziqet 2020-2023 rregullohen procedurat dhe aktivitetet për menaxhimin me rreziqet e konstatuara që mund të ndikojnë në arritjen e qëllimeve dhe punën e suksesshme të ESHR-së.

Strategjia për menaxhimin me rreziqet 2020-2023, i përkufizon qëllimet dhe përfitimet nga menaxhimi me rreziqet, përgjegjësitë për menaxhimin me rreziqet dhe jep pasqyrë të kornizës e cila do të vendoset, nëpërmjet së cilës me sukses do të menaxhohet me to.

Suksesi i procesit të menaxhimit me rreziqet monitorohet nëpërmjet zbatimit të:

- përditësimi të Regjistrimit të rreziqeve në nivel vjetor;
- zbatimit të aktiviteteve në pajtim me afatet e caktuara dhe sigurimit të ndjekjes së vazhdueshme të shkallës së realizimit të aktiviteteve të parapara kontrolluese;
- parashikimit të trajnimit për menaxhimin me rreziqet;
- monitorimit të përhershëm të shkallës së implementimit të aktiviteteve kontrolluese për menaxhimin me rreziqet.

Revidimi vjetor i procesit të menaxhimit me rreziqet, analiza dhe përditësimi i kryer i kontrollimeve në të gjitha nivelet, i japin rezultatet e pritura në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve, nëpërmjet vendosjes së kontrollëve të brendshme me çka ekspozimi i rrezikut mbahet në nivel të pranueshëm që është evidentuar në Regjistrin e përditësuar të rreziqeve.

Strategjia për menaxhimin me burimet njerëzore 2020 - 2023

Strategjia për menaxhimin me burimet njerëzore në ESHR 2020-2023, paraqet bazën për vendosjen dhe avancimin e funksionit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ESHR, nëpërmjet ndërtimit të sistemit efikas dhe funksional dhe sigurimit të kushteve për punësimin e personave profesionalë dhe të kualifikuar me shkallë të lartë të integritetit, të cilët janë të gatshëm të kryejnë në mënyrë efektive funksionet dhe përgjegjësitë e caktuara.

ESHR-ja promovon zhvillimin e cilësive profesionale të punonjësve, nëpërmjet vendosjes së sistemit real të vlerësimit të suksesshëm në punë, nëpërmjet procedurave të drejta dhe transparente për zhvillimin profesional dhe kreativ të punonjësve, si dhe vendosjen e materialeve plotësuese dhe stimulimeve të tjera për punonjësit.

Rritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve në ESHR paraqet angazhim themelor të institucionit, dhe këto përpjekje janë përfshirë në Planin Vjetor për zhvillim të vazhdueshëm profesional për vitin 2022.

Sipas Raportit për shkallën e realizimit të Strategjisë për menaxhimin me burimet njerëzore për vitin 2022, në bazë të treguesve të përcaktuar për monitorimin e shkallës së realizimit, mund të konk-

1 <https://www.facebook.com/EntiShtetëroriRevizionit>.

ludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit të Strategjisë deri në dhjetor 2022, realizoi pjesën më të madhe aktiviteteve të paraparë.

Plani strategjik për revizion i ESHR-së për vitet 2021 – 2023

Plani strategjik për revizion i ESHR-së për vitet 2021-2023 është miratuar në bazë të Udhëzimit të miratuar për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve dhe në pajtim me Vendimin për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2021-2023 dhe për fushat prioritare për revizionet sipas sektorëve që kryejnë revizion. Në këtë plan të ESHR-së, janë përcaktuar qëllimet strategjike për revizionet, fushat prioritare dhe nënfushat sipas sektorëve që kryejnë revizion.

Përveç dokumenteve strategjike të Entit Shtetëror të Revizionit ekzistojnë edhe dokumente të tjera strategjike të miratuara nga organet e tjera kompetente në të cilat përcaktohen qëllimet strategjike ose fushat që ndikojnë në funksionimin e Entit Shtetëror të Revizionit dhe në të njëjtën kohë u ndërmorën aktivitetet për formimin e më shumë grupeve të punës sektoriale. Pra, organet kompetente në drejtim të përmirësimit të menaxhimit me financat publike, që është një nga prioritetet kryesore, pas përfundimit të programit për reformën e menaxhimit me financat publike për vitet 2018-2021, në qershor 2022 miratuan Programin e ri për reformën e menaxhimit me financat publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022-2025.



QËLLIMET STRATEGJIKE

- Mbikqyrja mbi shpenzimin e mjeteve publike;
- Lufta kundër korrupsionit;
- Raportimi financiar cilësor;
- Duke kontribuar për përmirësimin e shërbimeve publike;
- Rritja e vazhdueshme e përgjegjësisë, llogaridhënies dhe transparencës;
- Rritja e përgjegjësisë dhe transparencës në përdorimin e mjeteve publike;
- Përmirësimi i punës së përdoruesve të mjeteve publike;
- Përmirësimi i cilësisë së punës së sektorëve nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm profesional të revizorëve;
- Përmirësimi i cilësisë së funksionimit të sektorëve duke forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve;
- Sigurimi i ambientit adekuat të punës;
- Përmirësimi i kulturës dhe etikës korporative në kryerjen e revizionit.



FUSHAT PRIORITARE

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Sigurimi dhe mbrojtja shtetërore;
- Gjendja e jashtëzakonshme dhe gjendja e krizës;
- Efektet nga pandemia;
- Partitë politike dhe procesi zgjedhor;
- Vetëqeverisja Lokale dhe Zhvillimi i Barabartë Rajonal;
- Puna dhe politika sociale;
- Arsimi;
- Kultura dhe sporti;
- Sistemi shëndetësor;
- Mjedisi jetësor;
- Bujqësia, pylltaria dhe ekonomia e ujërave;
- Gjyqësori dhe sundimi i së drejtës;
- Ekonomia;
- Trafiku, transporti dhe komunikimi;
- Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së;
- Sistemet e TI-së, mbrojtja dhe siguria e të dhënave, fondet nga BE-ja dhe nga institucionet tjera ndërkombëtare.

Programi për reformën e menaxhimit me financat publike "FINANCAT PUBLIKE SMART" 2022 – 2025

Në Programin e ri po bëhen përpjekje për të forcuar sistemin e financave publike, të promovohet transparenca, llogaridhënia, efikasiteti dhe disiplina fiskale në menaxhimin dhe përdorimin e resurseve publike, nëpërmjet masave, prioritetëve dhe shtyllave të përcaktuara.

Në kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit është përcaktuar shtylla 7 – Kontrolli i jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare.

Plani i veprimit për zbatimin e Programit për reformën e menaxhimit me financat publike për vitin 2022, paraqet plan të detajuar të aktiviteteve për zbatimin e masave dhe matjen e arritjes së indikatorëve të synuar, përfshirë edhe prioritetet për

revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare që janë në kompetencë të ESHR-së.

Grupi i punës sektoriale për menaxhimin me financat publike

Enti Shtetëror i Revizionit në mënyrë aktive merr pjesë në grupin e punës sektoriale për menaxhimin me financat publike me të cilën kryeson Ministria e Financave, qëllimi i të cilit është krijimi dhe ruajtja e qasjes funksionale sektoriale në fushën e menaxhimit me financat publike. Gjithashtu, Kryerevizori Shtetëror si anëtar mori pjesë në punën e Këshillit për menaxhimin me financat publike, që është trup koordinues për monitorimin e zbatimit të reformave në menaxhimin me financat publike.

Realizimi i qëllimeve strategjike të Entit Shtetëror të Revizionit të përcaktuara në dokumentet më të veçanta strategjike, realizimi i kompetencave të përcaktuara në dokumentet e tjera strategjike,



PROGRAMI VJETOR 2021

Subjektet që kanë dorëzuar kërkesë;

	NJVL	Kërkesat e arritura	2	Kërkesat e pranuar	1
	Institucione	Kërkesat e arritura	6	Kërkesat e pranuar	2
	OJQ dhe shoqata	Kërkesat e arritura	5	Kërkesat e pranuar	3
	Qytetarë	Kërkesat e arritura	5	Kërkesat e pranuar	0
		Gjithsej kërkesat e arritura	18	Gjithsej kërkesat e pranuar	6

si dhe pjesëmarrja në grupet e punës sektoriale, kërkon miratimin e akteve në nivel vjetor me të cilat do të lehtësohet realizimi i tyre. Për këtë qëllim janë miratuar më shumë akte në nivel vjetor dhe në të njëjtën kohë është vendosur sistemi i monitorimit të vazhdueshëm të realizimit të dokumenteve strategjike dhe vjetore, për të cilat përgatiten raportet përkatëse në nivel gjashtëmuor dhe vjetor.

Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2022

Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2022 është përgatitur në bazë të Planit Strategjik për Revizion të ESHR-së për vitet 2021-2023 dhe në përputhje me Udhëzimet e miratuara për planifikimet strategjike dhe vjetore të revizioneve dhe Vendimit për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizion të Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën

2021-2023 dhe fushat prioritare për revizionet sipas sektorëve që kryen revizionet. Ai është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e përcaktuar me ligj.

Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 është zbatuar në tërësi dhe ka përfshirë: 188 revizione, nga të cilat 171 janë revizione të rregullshmërisë (revizione financiare dhe revizione të pajtueshmërisë), 12 revizione të suksesit dhe 5 revizione të pajtueshmërisë. Janë realizuar 47 revizione që u referohen subjekteve dhe temave të revizionit në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror dhe 141 revizione që u referohen subjekteve të cilat morën pjesë në Zgjedhjet Lokale 2021. Nga gjithsej 12 revizione të parapara të suksesit, 8 janë zbatuar në bashkëpunim me Tvinging Partnerët e ISR-së së Kroacisë, Bullgarisë dhe Estonisë, 1 revizion kooperativ i suksesit në bashkëpunim me grupin e punës TFMA, me temë "Të ardhurat personale të komunave në kushtet e pandemisë për sigurimin



PROGRAMI VJETOR 2022

Subjektet që kanë dorëzuar kërkesë;

	NJVL	Kërkesat e arritura	8	Kërkesat e pranuar	5
	Institucione	Kërkesat e arritura	7	Kërkesat e pranuar	2
	OJQ dhe shoqata	Kërkesat e arritura	5	Kërkesat e pranuar	2
	Qytetarë	Kërkesat e arritura	18	Kërkesat e pranuar	6
Gjithsej kërkesat e arritura			38	Gjithsej kërkesat e pranuar	15

e shërbimeve cilësore për qytetarët”, në të cilin morën pjesë 7 Institucione Supreme të Revizionit: ISR e Shqipërisë, Malit të Zi, Rumanisë, Sllovakisë, Polonisë, Turqisë dhe ESHR-ja në rolin e koordinatorit dhe 1 revizion kooperativ me ISR-në e Serbisë me temë “Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë të demografisë”, në pajtim me memorandumin e nënshkruar dypalësh të bashkëpunimit.

Zbatimi i parimeve të transparencës gjatë përgatitjes së Programit Vjetor të Punës për vitin 2022, ESHR-ja mundësoi dhe vendosi në faqen e saj të internetit skedë “formulari i kërkesës për revizion”. Deri në ditën e hartimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, janë pranuar gjithsej 38 kërkesa për revizion, prej të cilave pjesa më e madhe janë kërkesat e qytetarëve ose 47% dhe kërkesat nga njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) ose 21%. Në Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, janë pranuar gjithsej 15 kërkesa për kryerjen e revizionit, gjegjësisht 39%. Kjo praktikë vazhdoi edhe gjatë përgatitjes së Programit Vjetor të Punës të ESHR-së për vitin 2023.

Plani Vjetor për parandalimin e korrupsionit i ESHR-së për vitin 2022

Duke vepruar në përputhje me kërkesat për miratimin e Planit Vjetor të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit për vitin 2022, gjatë muajit dhjetor 2021, Enti Shtetëror i Revizionit miratoi dhe publikoi planin e theksuar në faqen e internetit të ESHR-së² ESHR-ja ka zbatuar Planin Vjetor për parandalimin e korrupsionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, me të cilën parashihen masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në nivel

të institucionit. Në dhjetor 2022, u miratua Plani i ri Vjetor për parandalimin e korrupsionit për vitin 2023, i cili u publikua në faqen e internetit të ESHR-së³.

Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2022

Ritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit është një nga qëllimet strategjike dhe aktivitet dhe angazhim i vazhdueshëm i menaxhmentit të ESHR-së, për këtë arsye është përgatitur dhe miratuar Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2022⁴.

Plani i theksuar paraqet pasqyrim të kërkesave dhe nevojave të punonjësve dhe në të janë paraparë aktivitetet dhe fushat e orientuara drejt rritjes së njohurive dhe aftësive të punonjësve me çka është siguruar efekti i shumëfishtë i shprehur përmes rritjes së cilësisë së detyrave të kryera të punës dhe përparimit në menaxhimin me mjetet publike, të shpjeguar detajisht në pikën 3.2. të këtij raporti. Në dhjetor 2022, u miratua plani i ri vjetor për përsosjen e vazhdueshme profesionale për vitin 2023, i cili është publikuar në faqen e internetit të ESHR-së.

Raporti Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2021

Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2021 është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë

2 https://dzt.mk/sites/default/files/2021-12/Plani_vjetor_për_parandalim_të_korrupsionit_ESHR_viti_2022.pdf

3 https://dzt.mk/sites/default/files/2022-12/Plani_vjetor_për_parandalim_të_korrupsionit_ESHR_2023.pdf

4 https://dzt.mk/sites/default/files/2022-01/Plani_vjetor_për_Përsosjen_e_Vazhdueshme_Profesionale_për_vitin_2022.pdf

së Veriut në afatin e përcaktuar me ligj deri në fund të qershorit 2022 dhe gjithashtu është i disponueshëm në faqen e internetit të ESHR-së në tri gjuhë: maqedonase, shqipe dhe angleze.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e 79-të e shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021 dhe sipas tij, Konkluzionet e miratuara bashkë me Raportin e Komisionit për Financim dhe Buxhet i janë dorëzuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit.

Është vendosur praktikë për disponueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave që përmbahen në Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për institucionet supreme të revizionit, Gjykatës Evropiane të Revizionit, INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, misionet e organizatave ndërkombëtare, si dhe për zyrat përfaqësuese diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



1.3 DOKUMENTET METODOLOGJIKE DHE ZBATIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Në vitin 2022 si pjesë e aktivitetit të rregullt të harmonizimit të vazhdueshëm të metodologjisë së revizionit shtetëror me kërkesat e kornizës së publikimeve profesionale të INTOSAI-t, u miratuan aktet e


reja metodologjike dhe të përditësuara me të cilat sigurohet cilësia e lartë e revizioneve të kryera, si në vijim:

Doracaku për revizionin e pajtueshmërisë⁵




Është përgatitur me qëllim të implementimit të ISSAI 4000 – Standardi i revizionit të pajtueshmërisë dhe siguron zbatim të lehtësuar të revizionit të pajtueshmërisë, ofron udhëzime praktike për qasje të barabartë në kryerjen e revizioneve të pajtueshmërisë.

Doracaku për revizionin e suksesit⁶



Në qershor 2022, është miratuar doracaku i ri me qëllim që të kryet harmonizimi i kërkesave dhe implementimi i standardeve ISSAI 3000 për revizionin e suksesit.

Doracaku për revizionin e TI-s⁷



Ofron shpjegim gjithëpërfshirës të fushave kryesore të cilat revizorët duhet t'i marrin parasysh gjatë kryerjes së revizionit të sistemeve të informacioneve ose revizionit në kushtet e fushës së TI-së. Ky doracak është përgatitur në pajtim me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit (ISSAI), Doracaku për revizionin e TI-së të grupit të punës për revizionin e TI-së të INTOSAI-t dhe nismës zhvillimore të INTOSAI-t, standardet e njohura ndërkombëtarisht të TI-së dhe trendet bashkëkohore dhe praktikatat e mira në këtë fushë.

5 nr.01-1068/1 nga 06.06.2022.

6 nr.01-1069/1 nga 06.06.2022.

7 Në zbatim janë ende edhe: Doracaku për revizionin e rregullshmërisë; Doracaku për revizion të rregullshmërisë për njësitë e vetëqeverisjes lokale; Doracaku për revizion të TI-së; Doracak për monitorim të rekomandimeve;

Kodi i Etikës



Me qëllim që të përkufizohen vlerat, parimet dhe rregullat etike në bazë të të cilave bazohet sjellja profesionale e menaxhmentit dhe punonjësve të ESHR-së, dhe në këtë mënyrë ndihmon për të ndërtuar dhe ruajtur besimin e palëve të interesuara në aktivitetet e institucioneve. Ky kod është harmonizuar me kërkesat e ISSAI130 – Kodi i Etikës së INTOSAI-t.

Udhëzime për revizionin e fondeve të BE-së dhe ndihmës paraaderuese⁸



Është miratuar në qershor të vitit 2022, sigurojnë udhëzime praktike për revizionin e fondeve të BE-së dhe ndihmës paraaderuese.

Udhëzime në lidhje me zbulimin e parregullsisve, mashtrimit dhe korrupsionit⁹



qëllimi i këtyre udhëzimeve është të ndihmojë revizorët të kuptojnë dallimin midis mashtrimit, korrupsionit dhe parregullsisve. Gjithashtu, ky dokument ka për qëllim të ndihmojë revizorët të zbulojnë disa fusha që janë më të ekspozuara ndaj parregullsisve, mashtrimit dhe korrupsionit (analiza e rrezikut) dhe të marrin provat e nevojshme për të qenë në gjendje të raportojnë për raste të tilla.

Udhëzime për revizionin e barazisë gjinore



i përgatitur si rezultat i punës së përbashkët ndërmjet ESHR-së dhe Trupit të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe forcimin e gruas – UN Women, të cilat ofruan mbështetje profesionale dhe logjistike për botimin e saj.

8 numri 01-1070/1 nga 6.06.2022.

9 numri 01-1071/1 nga 06.06.2022.

Udhëzimi për kontrollin e cilësisë dhe Udhëzimi për sigurimin e cilësisë



Në funksion të sigurimit të cilësisë së lartë, por edhe sigurimit të cilësisë së revizioneve të kryera, ESHR-ja konstatoi procedura të detajuara të cilat duhet të monitorohen në të gjitha fazat e procesit të revizionit të përkufizuara me këto udhëzime.

Procedura për përgatitjen, dorëzimin dhe publikimin e raporteve përmbljedhëse



është miratuar në shtator 2022, me të cilat është rregulluar mënyra e përgatitjes, dorëzimit dhe publikimit të raporteve përmbljedhëse për një grup subjektsh të ngjashme që janë lëndë e revizionit.

Me qëllim të prezantimit më të mirë të rezultateve nga kryerja e revizionit shtetëror dhe të përmirësimit komunikimi me publikun, por edhe komunikimi i brendshëm në ESHR, dhe me qëllim të sigurimit të raportimit në kohë dhe cilësor të rezultateve nga revizionet, janë miratuar:

- Politikat për njoftimin dhe komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm për rezultatet e revizioneve të kryera,
- Procedura për organizimin dhe lëvizjen e dokumenteve në formën elektronike, veprimtaria e arkivit qendror dhe përdorimi dhe ruajtja e vulave dhe vulave katrorë në ESHR,
- Procedura për publikimin e raporteve të revizorit, dokumenteve dhe informacioneve të tjera në faqen e internetit të ESHR-së,
- Procedura për komunikimin e ESHR-së me palët e interesuara dhe

- Udhëzimi për paraqitjen grafike në raportet e revizorit.

Në mënyrë plotësuese, në kuadër të Tvinging Projektit, është përgatitur përmbajtja e re dhe struktura e raporteve të revizorit, në pajtim me standardet ndërkombëtare për revizionin, si dhe abstrakt i ri i revizionit për ta përmirësuar prezantimin e rezultateve nga revizionet. Kjo bëhet me qëllim që të rritet transparenca dhe llogaridhënia në promovimin e rezultateve të revizionit shtetëror.

Me qëllim të forcimit të integritetit si aspekt i rëndësishëm në procesin e parandalimit të korrupsionit, në ESHR në vitin 2022 janë miratuar:

- Politika e integritetit të Entit Shtetëror të Revizionit (shkurt 2022);
- Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit i Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022;
- Kodi i ri i Etikës për punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit, në pajtim me Kodin

e Etikës së INTOSAI-t dhe janë nënshkruar deklaratat nga punonjësit për njohjen me Kodin e Etikës së Entit Shtetëror të Revizionit;

- Vendimi për formimin e Komisionit për Etikë Profesionale;
- Rregullat për punën e Komisionit për Etikë Profesionale;

- Janë emëruar personat përgjegjës për: integritet, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe informacioneve me karakter publik, të dhënave personale dhe pranimin e fletëparaqitjeve, parashtrësive, informacioneve dhe kërkesave për veprim;

Certifikimi ISO

Në maj 2022, ESHR-ja me sukses kreu kontrollimin e ricertifikimit nga trupi i certifikimit, me ç'rast vazhdoi vlefshmëria e certifikimit për zbatimin e Sistemit për menaxhim në pajtim me ISO standardet MKC EN ISO 9001:2015 nga 30.05.2024.

ESHR-ja i filloi aktivitetet për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare për vendosjen e sistemit për luftën kundër korrupsionit ISO 37001 dhe Standardet Ndërkombëtare për sistemin për menaxhim me sigurinë e informacioneve ISO 27001. Certifikimi i këtyre standardeve do të zbatohet kur në shtet do të krijohen kushtet, gjegjësisht ekzistimi i trupit akreditues që do ta kryejë certifikimin.



**KOMUNIKIMI DHE
BASHKËPUNIMI
ME PALET E
INTERESUARA**

2.1 KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË

Komunikimi me palët e interesuara është mjet i rëndësishëm për secilën organizatë. Të udhëhequr nga caktimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Komunikimit të ESHR 2020-2023, gjegjësisht të nxisë komunikim në të cilin mediat, qytetarët dhe organizatat civile do të jenë aleatë në arritjen e qëllimit për rritjen e nivelit të informimit të publikut të gjerë për rolin dhe detyrën e ESHR-së dhe forcimin e rolit të ESHR-së si institucion në shërbim të publikut.

Transparenca në punën e ESHR-së është me rëndësi thelbësore për ndërtimin e besueshmërisë, përgjegjësisë dhe efikasitetit në kryerjen e revizionit. ESHR-ja, si institucion i pavarur vendosi kanale të dyanshme efikase të komunikimit me palët e interesuara, të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimeve organizative dhe strategjike, por ndikojnë edhe në efektivitetin, transparencën, llogaridhënien në sistemin e menaxhimit me financat publike.

Efikasiteti i punës transparente i ESHR-së është mundësuar edhe nëpërmjet faqes së internetit në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të mund të shikojnë dhe analizojnë raportet e revizorit, si dhe metodologjitë dhe procedurat e përdorura gjatë kryerjes së revizioneve. Kjo kontribuon në ndërtimin e besimit dhe kredibilitetit të punës së ESHR-së, dhe mundëson dialog dhe diskutim publik ndërmjet ESHR-së dhe palëve të interesuara. Dialogu i hapur me palët e interesuara i përfshin qytetarët, mediat, organizatat dhe institucionet tjera. ESHR-ja, të gjithë këtë e ka arritur përmes komunikimit të rregullt siç janë ngjarjet publike, seancat informative dhe publikimi i raporteve të revizorit dhe informacioneve të tjera përmes kanaleve të komunikimit publik.

Në të njëjtën kohë nëpërmjet informimit me kohë dhe në vazhdimësi të më shumë se 1.110 palëve të interesuara, publiku merr informacione në kohë për raportet përfundimtare të revizionit të publikuara në faqen e internetit të ESHR-së, si dhe njoftime për shtyp dhe abstrakte nga raportet e revizorit në të cilat janë përfshirë gjendjet e konstatuara kryesore, janë siguruar "kuptimi" i thjeshtuar i raporteve të revizorit dhe gjendjet e përcaktuar të përfshira në të.


ESHR-ja i publikon rregullisht raportet e veta vjetore, të cilat përmbajnë informacione për rezultatet e revizioneve të kryera, aktivitetet e institucionit, raportet financiare dhe aspektet e tjera të punës së tij. Këto raporte gjithashtu publikohen në faqen e internetit dhe janë në dispozicion për publikun, që mundëson transparencë dhe përgjegjësi në punën e ESHR-së.

Llogaridhënia, transparenca dhe përgjegjësia në funksionimin e ESHR-së është proces i vazhdueshëm dhe i pandashëm në funksionimin aktual të ESHR-së e cila arrihet me angazhimin e punonjësve dhe menaxhmentit të ESHR-së përmes përditësimit të vazhdueshëm të mejling listës së palëve të interesuara, paraqitjen në mediat kombëtare dhe deklaratat në lidhje me gjendjen e përcaktuar në raportet përfundimtare të revizorit, njoftimet në media për punën e ESHR-së dhe raportet përfundimtare të revizorit të publikuara, si dhe aktivitetet rrjedhëse për përditësimin e rregullt të faqes së internetit të ESHR-së dhe faqes së Facebook të ESHR-së.

Rezultatet dhe aktivitetet janë paraqitur në grafikonet e mëposhtëm:



LISTA-MEJLING
E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI
ME PALË TË JASHTME TË
INTERESUARA





**LISTA-MEJLING
E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI
ME 1,110 PALË TË JASHTME
TË INTERESUARA**

përfundim me janarin 2023

	Agjenci lajmesh	11
	Gazetarë	92
	Gazeta ditore	7
	Gazeta javore	3
	Radiodifuzione	38
	Televizione	51
	Operatorë kablovikë	25
	Portale të internetit	96
	Organizata qytetare	157
	Institucione	9
	Komuna	81
	Oda edhe asociacione	11
	Ndërmarrje publike në nivel lokal	122
	Ndërmarrje publike në nivel qendror	34
	Institucione Shëndetësore Publike	117
	Subjekti lëndë i revizionit	256










per vitin 2021

**380 PALË TË
JASHTME TË
INTERESUARA**

per vitin 2020


**190 PALË TË
JASHTME TË
INTERESUARA**



		2021	2020
	Agjenci lajmesh	11	11
	Gazetarë	91	62
	Gazeta ditore	7	7
	Gazeta javore	3	3
	Radiodifuzione	38	38
	Televizione	51	20
	Portale të internetit	95	30
	Organizata qytetare	50	50
	Institucione	9	5




**VIZITA NË
WWW. DZR.MK
2022**



Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor Korrik Gusht Shtator Tetor Nëntor Dhjetor



**PËRMBAJTJET
E VIZITUAR
WWW. DZR.MK
2022**



**ENTI SHTETËROR
I REVIZIONIT DHE
marrëdhëniet me
MEDIUMET**

01.01.2022 | 31.12.2022

512

NJOFTIME TË
MEDIUMEVE
PËR RAPORTET
PËRFUNDIMTARE TË
REVIZIONIT

92

NJOFTIME JANË
TRANSMETUAR
NGA ANA E
TELEVIZIONEVE

420

NJOFTIME JANË
PUBLIKUAR NGA ANA
E PORTALEVE TË
INTERNETIT

8

INTERVISTA DHE
DEKLARATA PËR
MEDIUMET

Mediat sociale

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së saj, duke ndjekur trendet botërore të rritjes së përdorimit të mediave sociale, ESHR-ja në mënyrë aktive vazhdoi të rrisë praninë e saj në to duke i përdorur si mjet promovimi të aktiviteteve dhe rezultateve të saj të arritura nga kryerja e revizionit shtetëror. Nëpërmjet tyre qytetarët dhe të gjithë palët e prekura / të interesuara kanë mundësinë të informohen për aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga kryerja e revizionit shtetëror. Këto mjete të reja komunikimi të ESHR-së paraqesin hapësirë diskutimi dhe shkëmbimi të mendimeve kreative dhe konstruktive.

Në vitin 2022, ESHR-ja në faqen e vet në Facebook gjithsej ka realizuar 170 publikime / postime, ndërsa në përqindje ditore janë evidentuar 2.232 vizita që në krahasim me vitin 2021 paraqet rritje për 427%.

ESHR-ja, në mënyrë aktive i përdor edhe faqet YouTube dhe LinkedIn si kanale për komunikim me palët e interesuara.



31.12.2021

31.12.2022




8.000 | 62.869

Arritjet totale për 3 përmbajtjet e publikuara më të frekuentuara



22.808 | 705.301

Njumri i përgjithshëm i vizituesve



8.982 | 104.908

Profile të ndryshme të cilat kanë shikuar një përmbajtje



8.363 | 25.021

Arritjet totale për 10 publikimet e fundit



762 | 6.967

Ndjekës të faqes



518 | 2.232

Është numri mesatar i vizituesve ditorë



17.11.2021






ËSHTË HAPUR MË

ANKETA PUBLIKE – SHKALLA E KËNAQËSISË

Enti Shtetëror i Revizionit zbaton anketën publike në vazhdimësi si një mjet kërkimor duke analizuar mendimin e palëve të interesuara rreth punës së ESHR-së, në bazë të rregullt t'i dorëzohen edhe grupit të subjekteve, si palë të interesuara në varësi të fushës së lëndës së revizionit (NJVL, ISHP, NP në nivel lokal dhe qendror dhe SHA në pronësi të shtetit etj.), me qëllim që gjendjet e konstatuara të përmbajtura në raportet përfundimtare të revizorit, njohuritë dhe informacionet të ndahen dhe parregullsitë/gjendjet e konstatuara të mos përsëriten në funksionimin e tyre.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe dukshmërisë në punën e saj, ESHR-ja ka dorëzuar pyetësor / anketë për shkallën e kënaqësisë nga bashkëpunimi me ESHR-në dhe për punën e institucionit tonë deri tek 1.110 palët e interesuara, duke përfshirë: 620 institucione, 323 medime dhe 157 organizata qytetare dhe e shpërndau në Facebook dhe faqen e tij të internetit. Sipas strukturës së përgjigjeve të marra lidhur me pyetjen e kënaqësisë nga bashkëpunimi me ESHR-në, veçanërisht nëpërmjet informimit në kohë për raportet e revizorit të publikuara, për aktivitetet e ESHR-së, është rritur transparenca ndaj mediave dhe organizatave qytetare. Është shprehur edhe besimi i madh për punën e ESHR-së, dhe duke e vlerësuar atë si institucion të paanshëm, të pavarur, ligjor, objektiv, transparent dhe profesional. Nuk mungon as kënaqësia nga cilësia e raporteve përfundimtare të publikuara të cilat vlerësohen si aktuale, të kuptueshme, të sakta dhe objektive.

STRUKTURA E PËRGJIGJEVE TË MARRA

	Institucionet nga sektori publik	54%
	Sektori privat	3%
	Organizatave qytetare	14%
	Mediat	13%
	Personat fizikë	17%

Raportet Përfundimtare të Revizorit janë:

Aktuale	75%
Të kuptueshme	77%
Të sakta	77%
Objektive	75%

Ndarja e njohurisë






Me qëllim të ndarjes së njohurisë dhe mësimëve të mësuara nga revizionet e kryera, përfaqësuesit e ESHR-së në mënyrë aktive marrin pjesë në konferenca të shumta, panel-diskutime, debate, tryeza të rrumbullakëta, të organizuara nga institucionet përkatëse / palët e interesuara në fushën e lëndës së diskutimit.

ESHR-ja vendosi praktikë, raportet përfundimtare të revizorit nga revizionet e kryera publikohen në faqen e internetit të ESHR-së, në bazë të rregullt t'i dorëzohen edhe grupit të subjekteve, si palë të interesuara në varësi të fushës së lëndës së revizionit (NJVL, ISHP, NP në nivel lokal dhe qendror dhe SHA në pronësi të shtetit etj.), me qëllim që gjendjet e konstatuara të përmbajtura në raportet përfundimtare të revizorit, njohuritë dhe informacionet të ndahen dhe parregullsitë / gjendjet e konstatuara të mos përsëriten edhe në funksionimin e tyre.

Në drejtim të ndarjes së njohurive dhe forcimit të bashkëpunimit me asociacionet profesionale, institucionet dhe organizatat civile për tema në fushën e revizionit, me ftesë të ESHR-së, në një pjesë të trajnimeve / punëtorive të organizuara morën pjesë edhe punonjësit e NJVL-së, Prokurorisë Publike, shërbimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, revizorët e brendshëm nga SHA dhe NP, punonjësit e Institucioneve Supreme të Revizionit në rajon, përfaqësuesit e mediave dhe organizatave civile. Në këto trajnime përfaqësuesit patën mundësinë të njihen me metodologjinë e kryerjes së revizionit, mënyrën e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, zbatimin e standardeve të revizionit INTOSAI, të kuptuarit e raporteve të revizionit, gabimet më të zakonshme të konstatuara në kryerjen e revizioneve, por edhe

për të shkëmbyer përvoja dhe praktika të mira në drejtim të avancimit të funksionimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Kënaqësia nga bashkëpunimi me ESHR-në

	Institucionet nga sektori publik	88%
	Sektori privat	67%
	Organizatat qytetare	83%
	Mediat	92%
	Personat fizikë	100%

ESHR-ja nëpërmjet punës së vet siguron:

Paanshmëri	79%
Pavarësi	77%
Ligjshmëri	83%
Objektivitet	76%
Transparencë	80%
Profesionalizëm	80%

2.2

BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHTETËRORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT CIVILE DHE PUBLIKUN E PËRGJITHSHËM

Bashkëpunimi i ESHR-së ka vazhduar edhe në vitin 2022 me asociacionet dhe institucionet e shumta profesionale vendase që kanë kontribut të madh në realizimin e qëllimeve strategjike. ESHR-ja njihet nga këto organizata si institucion me përgjegjësi shoqërore dhe me ndikim që siguron të dhëna me kohë dhe aktuale, informacione dhe shpjegime për kushtet dhe rekomandimet që i ofron nëpërmjet proceseve të revizionit.

Nëpërmjet bashkëpunimit me asociacionet profesionale, institucionet e arsimit të lartë, qendrat kërkimore shkencore dhe organizatat e tjera nga sektori civil, puna e ESHR-së u vë në dispozicion për qytetarët, u mundëson t'i analizojnë faktorët dhe t'i vlerësojnë performancat e administratës publike dhe e ka rritur ndërgjegjen të qytetarët për mjedisin mikro dhe makro në fushën e menaxhimit me fonancat publike dhe mbikqyrjen e shpenzimeve të mjeteve publike.

Për këtë qëllim, në vitin 2022 ESHR-ja ruajti format ekzistuese të bashkëpunimit dhe vazhdoi me procesin e zgjerimit, gjegjësisht lidhjen e formave të reja të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe profesionale dhe organizatat e tjera nga sektori civil dhe janë lidhur memorandumet e bashkëpunimit në vijim:



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qëllimi i këtij memorandumi është avancimi i bashkëpunimit në realizimin e kompetencave nga fushëveprimi i Kuvendit dhe ESHR-së, nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve profesionale të qëndrueshme dhe efikase në drejtim të forcimit të transparencës dhe efikasitetit të mbikqyrjes financiare publike. Me memorandumin e lidhur rregullohet mënyra e shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me raportet e revizorit, bashkëpunimi dhe ndihma teknike me shërbimet profesionale të Kuvendit në fushën e revizionit, organizimi i përbashkët i takimeve, edukimeve, brifingjeve dhe ngjarjeve të tjera për informim më të mirë të deputetëve dhe shpjegimin e raporteve të revizorit.

Me memorandumin rregullohet mënyra e shqyrtimit të raporteve përfundimtare të dorëzuara ose raporteve përmbledhëse për një grup subjektsh në mbledhjen e trupit amë të punës së Kuvendit, por edhe mënyrën e konsultimit dhe vendosjes se cilat raporte përfundimtare të revizorit ose raporte përmbledhëse për një grup subjektsh të ngjashme që janë lëndë e revizionit do të jenë lëndë për t'u shqyrtuar në seancën e Kuvendit.



Përfaqësuesit e Kuvendit në mënyrë aktive marrin pjesë edhe në punëtoritë, vizitat studimore të organizuara në kuadër të Komponentit 3: Përmirësimi i funksionit të kontrollimit legjislativ të Kuvendit në bazë të shqyrtimit dhe diskutimit për raportet e revizorit të ESHR-së.

Në muajin mars 2022, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Bullgarisë, kryerevizori shtetëror realizoi takim pune në Dhomën Ligjvënese të Republikës së Bullgarisë. Në takimin e punës morën pjesë edhe kryetari i Entit Kombëtar të Revizionit dhe kryetari i Nënkomisionit për kontrollim të mjeteve publike në Kuvendin Kombëtar. Tema kryesore e takimit të punës ishte bashkëpunimi mes Kuvendit dhe Institucioneve Supreme të Revizionit, shkëmbimi i përvojave për mënyrën e shqyrtimit dhe diskutimit të raporteve përfundim-

tare të revizorit në komisionet parlamentare amë me qëllim të zbatimit dhe veprimit më efikas të rekomandimeve të revizorit.

Në prill 2022, kryerevizori shtetëror, kryetari dhe zëvendëskryetari i Zyrës Kombëtare të Revizionit të Republikës së Bullgarisë realizoi takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në takim u diskutua për bashkëpunimin e Kuvendit me Entin Shtetëror të Revizionit, duke treguar edhe një herë mbështetjen për rolin e rëndësishëm dhe kryesor të ESHR-së si institucion që kryen revizion në të gjitha institucionet kryesore. Arsyeya kryesore e këtij takimi ishte bashkëpunimi i suksesshëm i institucioneve të revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë si partnerë në kuadër të Tving Projektit "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe

mbikëqyrja parlamentare", të financuar nga BE-ja, rezultati më serioz i të cilit është hartimi i Ligjit për revizionin shtetëror, i cili është në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nga Qeveria dhe Kuvendi.

Në qershor 2022, në Ohër kryerevizorët shtetërorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kroacisë, realizuan takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Takimi u organizua me qëllim që t'u japë mbështetje aktiviteteve për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kuvendit. Në takimin e mbajtur Kryetari i Kuvendit dhe njerëzit e parë të Institucioneve Supreme të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kroacisë, diskutuan se si të përmirësohet bashkëpunimi i ndërsjellë, duke ndjekur praktikat pozitive të vendeve anëtare të BE-së.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit të përfshira në Tvinging Projektin, në shtator 2022, në Kuvend u dorëzua **"Raporti i parë përmbledhës për revizionet e kryera të suksesit për masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ballafaqimin me krizën e shkaktuar nga Covid-19"**. Ai paraqet sublimim të gjetjeve kryesore të të tria revizioneve të suksesit të kryera individualisht sipas Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021:

Në kuadër të aktiviteteve nga ky komponent është përgatitur Doracaku i ri "Roli i Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kuvendit në forcimin e efikasitetit në menaxhimin me financat publike". Gjithashtu, janë përgatitur edhe aktet e tjera të cilat do ta lehtësojnë procesin e kuptueshmërisë së raporteve të revizorit.

Nëpërmjet mbështetjes aktive për marrjen e masave sipas rekomandimeve të dhëna të përmbajtura në raportet përfundimtare të revizorit dhe nxitjen e ndryshimit në mënyrën e përdorimit të mjeteve publike (paratë dhe prona) nga institucio-

net e sektorit publik do të kontribuojë në rritjen e së mirës së përgjithshme për të gjithë qytetarët.



Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në drejtim të forcimit të komunikimit dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së dhe Prokurorisë Publike, në vitin 2022 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit. Me këtë memorandum rregullohet mënyra e komunikimit, konsultimit dhe dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit në Prokurorinë Publike, për veprimin e mëtejshëm të tyre, shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve me qëllim të veprimit sa më efikas ndaj parregullsive të konstatuara. Nëpërmjet zbatimit të trajnimeve dhe punëtorive në të cilat revizorët shtetërorë dhe prokurorët publikë do të shkëmbejnë së bashku përvojat e tyre nga praktika dhe do të forcojnë njohuritë dhe aftësitë për rëndësinë e parregullsive në revizionet dhe trajtimin e tyre në procedurat e ndjekjes penale.

Në vitin 2022, përfaqësuesit e të dyja institucioneve, në punëtorinë me temë "Forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut" diskutuan dhe shkëmbyen mendime se si të forcohet komunikimi dhe të thellohet bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe PP-së. Në këtë drejtim, nga të dyja institucionet kanë nominuar persona për komunikim të vazhdueshëm.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë Amerikane për Zhvillimin Ndërkombëtar - USAID, është organizuar ngjarja njëditore me përfaqësuesit e

Entit Shtetëror të Revizionit, Prokurorisë Publike dhe Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit në të cilën u diskutua mënyra e shkëmbimit të informacioneve dhe veprimi sipas raporteve përfundimtare të revizorit.

Enti Shtetëror i Revizionit, Byroja për Prokurime Publike, Komisioni Shtetëror për Ankesa për Prokurime Publike, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës

Me këtë memorandum është themeluar trupi këshillëdhënës joformal për koordinim i cili do të shërbejë për shkëmbimin e përvojave nga fushëveprimi i kompetencave të palëve nënshkruese lidhur me sistemin e prokurimit publik, të avancojë bashkëpunimin e ndërsjellë dhe të sigurojë qëndrueshmëri në vazhdimësi në avancimin e sistemit të prokurimit publik në vend dhe do të kontribuojë në zbatimin e barabartë dhe të harmonizuar të Ligjit për prokurime publike dhe akteve nënligjore nga e njëjta fushë. Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë aktive në përgatitjen e Strategjisë për avancimin e sistemit të prokurimeve publike për periudhën 2022-2026¹⁰, si dhe gjatë përgatitjes së Doracakut mbi gabimet më të shpeshta gjatë zbatimit të prokurimeve publike¹¹.

Institucionet arsimore

Enti Shtetëror i Revizionit me Universitetin e Evropës Juglindor, si dhe me Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit me të cilin shprehën pëlqimin e tyre për të bashkëpunuar duke inkurajuar dhe afirmuar fushat me interes të përbashkët, si dhe sigurimin e disponueshmërisë të shkëmbimit profesional të përvojave. Në bazë të këtyre memorandumëve të lidhura të bashkëpunimit gjatë vitit 2022, përfaqësuesit e këtyre institucioneve të arsimit të lartë morën pjesë aktive në aktivitetet e organizuara nga ESHR-ja. Bashkëpunimi aktiv me këto institucione u realizua edhe duke iu përgjigjur pyetësorëve, e të cilat paraqesin bazë për përgatitjen e publikimeve, punimeve ose analizave shkencore në fushën e revizionit dhe sistemit të kontrollimit të brendshëm nga këto institucione të arsimit të lartë.

10 <https://www.bjn.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/Strategji-a.pdf>

11 <https://www.bjn.gov.mk/doracak-per-prokurime-publike/doracak-per-gabimet-e-shpeshta-gjate-zbatimit-te-prokurimeve-publike/>

Organizatrat qytetare

Instituti për Demokraci "Societas Civilis";

Me qëllim të nxitjes dhe afirmimit të fushave të interesit të përbashkët, veçmas në fushat e planifikimit strategjik, aktivitetet e komunikimit, humlumtimet, debatet, trajnimet dhe edukimet në fushat me interes të ndërsjellë të cilat janë lëndë të përmbajtura të revizionit shtetëror është lidhur Memorandum me "Societas Civilis".

Me këtë bashkëpunim, do të mundësohet që ESHR-ja të shpërndajë informacione dhe të dhëna të karakterit publik të strukturuar për nevojat e "Societas Civilis", por edhe komunikim aktiv me ESHR-në dhe pjesëmarrje në ngjarjet e organizuara në të cilat do të prezantohen gjetjet dhe rekomandimet e ESHR-së gjatë analizës së temës për të cilat ESHR-ja ka kryer revizionin. Punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë në një numër të madh punëtorish të dedikuara për të nxitur debatin publik për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.



**ENTI SHTETËROR
I REVIZIONIT**
Memorandumet
për bashkëpunim



Qendra për Komunikim Civil

Enti Shtetëror i Revizionit në zbatimin e revizioneve, në vazhdimësi i ndjek procedurat për zbatimin e prokurimeve publike të subjektet që janë lëndë e revizionit dhe tregon për lëshimet dhe dobësitë e konstatuara në fazat e planifikimit, zbatimit dhe ekzekutimit të procedurave të prokurimit publik. Në vitin 2022, Enti Shtetëror i Revizionit ka vazhduar bashkëpunimin me Qendrën e Komunikimeve Civile, në pjesën e prokurimeve publike në kuadër të punëtorive me temë "Prokurimet e gjelbra publike", të dedikuara për identifikimin, inkurajimin e zbatimit të tyre dhe uljen e rreziqeve të korrupsionit", si dhe në konferencën përfundimtare rajonale për gjendjen e prokurimeve publike në vendet e Ballkanit Perëndimor, në të cilën revizorët shtetërorë ndanë përvojat e tyre në fushën e revizioneve të prokurimeve publike.

Transparency International

Enti Shtetëror i Revizionit, mori pjesë edhe në humlumin mbi "Sistemin e Integritetit Kombëtar, i cili zbatohet në kuadër të "BE-së për sundimin e së drejtës: Angazhimi qytetar për integritetin publik (CEPI) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", të mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Nëpërmjet analizave dhe vlerësimit të 15 shtyllave të integritetit, sipas Metodologjisë së përgatitur nga Sekretariati i Transparency International, do t'i jepet një përgjigje efektivitetit të përpjekjeve kombëtare për ballafaqimin me korrupsionin.

Një nga shtyllat që është lëndë e kësaj analize është edhe ESHR-ja. Kjo shtyllë vlerësohet sipas treguesve të dhënë, të cilët i referohen pavarësisë, transparencës, integritetit dhe përgjegjësisë së këtij institucioni gjatë zbatimit të kompetencave të tij. Në dhjetor 2022 u zhvillua intervista me kryerevizorin shtetëror, ndërsa të dhënat e marra gjatë intervistës si dhe përmes kërkesave për qasje në informacionet me karakter publik do të jenë pjesë e raportit që do të publikohet në vjeshtën e vitit 2023.

Publiku i gjerë

ESHR-ja është institucion i pavarur që qytetarëve u mundëson të ndjekin se si shpenzohen paratë publike, nëpërmjet informimit për punën e institucioneve publike dhe për masat të cilat duhet të ndërmerren për të siguruar përgjegjësi dhe menaxhim transparent me mjetet publike. Në këtë drejtim në pajtim me Ligjin për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, gjatë vitit 2022 janë marrë 5 kërkesa për informacione të karakterit publik dhe ato janë përgjigjur pozitivisht brenda afatit të përcaktuar me ligj. Në të njëjtën kohë ESHR-ja në pajtim me Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritet Qeveritar të Hapur dhe angazhimin "Publikimi proaktiv i informacioneve të karakterit publik në faqet e internetit të institucioneve", i publikoi të gjitha dokumentet në faqen e vet të internetit të cilat janë lëndë e interesit të publikut të përgjithshëm.

2.3 | BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Për të arritur qëllimin themelor të revizionit - kujdesin për mjetet publike dhe avancimin e menaxhimit me to, zbulimi në kohë i lëshimeve nga standardet e pranuar dhe shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomizimit në menaxhimin me mjetet publike, ESHR-ja dha rekomandime të qarta dhe efektive, me qëllim që të ndërmerren hapa me të cilat lëshimet dhe shkeljet në të ardhmen do të parandalohen ose vështirësohen. Masat korrektuese për implementimin e rekomandimeve i mundëson udhëheqësisë së subjektit, lëndë e revizionit, ta përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomizimin në punë.

Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2022 përmes informacioneve të qarta, reale, objektive dhe në kohë për parregullsitë e konstatuara, mosharmozimi me rregullat ligjore, veprimet e paligjshme me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare, kontribuoi në përmbushjen e disa nga kompetencat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ESHR-ja i kushton vëmendjen e duhur përpunimit dhe analizës së informacioneve që dalin nga raportet përfundimtare të revizionit të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Këto të dhëna në baza të rregullt përpunohen nga aplikacioni i softuerit i cili është i integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga raportet përfundimtare të revizorit. Në këtë mënyrë, sigurohen informacionet e besueshme, të përditësuara, në kohë dhe relevante për nevojat e ESHR-së, organeve kompetente dhe palëve të tjera të interesuara.

Me dorëzimin e rregullt të raporteve përfundimtare të revizorit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e orienton vëmendjen drejt dobësive të konstatuara në punën e subjekteve të reviduara.

Vazhdimisht i evidentojmë, monitorojmë dhe analizojmë informacionet e marra kthyes nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, MF-Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryetares së Qeverisë së RMV-së e ngarkuar për politikën e qeverisjes së mirë, për trajtimin sipas raporteve përfundimtare të revizorit që u dorëzohen atyre.

Efektet e gjendjeve të konstatuara të cilat tregojnë parregullsi dhe paligjshmëri në punën e subjekteve ndaj menaxhimit më të mirë me mjetet publike mund të pritet vetëm nëse institucionet kompetente i ndërmarrin masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

Një nga qëllimet strategjike të ESHR-së është monitorimi dhe informimi për aktivitetet e ndërmarra të institucioneve kompetente për tejkalimin e parregullsisë dhe paligjshmërive të konstatuara në punën e subjekteve.

Aktivitetet e ESHR-së lidhur me parandalimin e korrupsionit zhvillohen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të intereseve, memorandumet e lidhura të bashkëpunimit, si dhe rregullativat e tjera ligjore relevante.

Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022 u janë dorëzuar raportet e revizorit institucioneve kompetente si në vijim:

- Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut 22 raporte të revizorit, për 19 subjekte të reviduara (revizione)

- Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit i janë dorëzuar 5 raporte të revizorit, për 4 subjekte të reviduara (revizione);
- Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit i janë dorëzuar 139 raporte të revizorit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore sipas detyrës zyrtare në përputhje me ndryshimet e Kodit Zgjedhor nenit 85-b ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020);
- Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave – Drejtorisë së Policisë Financiare i është dorëzuar 1 raport i revizorit;
- Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut i është dorëzuar 1 raport i revizorit;
- Zëvendëskryetares së Qeverisë së RMV-së të ngarkuar për politikën e qeverisjes së mirë i janë dorëzuar 26 raporte të revizorit për 21 subjekte të reviduara (revizione).

Në janar 2023, pas dorëzimit të kërkesës nga Komisioni Evropian, në lidhje me procesin e skringut, ESHR-ja dorëzoi kërkesë në organet kompetente për sigurimin e informacioneve kthyesë për aktivitetet e ndërmarra sipas dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit të publikuara për 5 vitet e fundit, dhe për të janë dorëzuar përgjigjet përkatëse tek institucionet kompetente.

Në të njëjtë kohë në prill 2023, ESHR-ja ka dorëzuar kërkesë në organet kompetente për sigurimin e informacioneve kthyesë për aktivitetet e ndërmarra sipas dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit.


Deri në ditën e njoftimit janë siguruar informacionet kthyesë nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Financave – Drejtoria e Policisë Financiare.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim në parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

JANË DORËZUAR RAPORTET E REVIZIONIT DERI TE INSTITUCIONET KOMPETENTE



Në pajtim me programin vjetor
të punës së ESHR-së për vitin
2022



- Prokurorisë Publike
- Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit
- Zëvendëskryetares së Qeverisë së ngarkuar për politikat e qeverisjes së mirë
- Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit në përputhje me Kodit Zgjedhor nenit 85-b
- Këshillit Gjyqësor
- Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Policisë Financiare



**KAPACITETET
ADMINISTRATIVE**

3.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE

Enti Shtetëror i Revizionit si institucion suprem i revizionit, kushton vëmendjen e duhur në ndërtimin e sistemit modern, efikas dhe funksional për menaxhimin me burimet njerëzore, duke i përdorur praktikat më të mira të ISR-së dhe metodologjisë së pranuar ndërkombëtarisht.

ESHR-ja kushton vëmendje të sigurojë dhe krijojë mjedis pune kulturore në nivel të lartë profesional dhe atmosferë të përshtatshme për mësim, zhvillim dhe përparim, nëpërmjet zhvillimit të kompetencave personale, për të arritur sukses në punë dhe realizimin me ligj të kompetencave të caktuara.

Enti Shtetëror i Revizionit dhe revizorët shtetërorë janë të njoftuar me vlerat dhe parimet të cilat janë vendosur në institucion, të cilat i ruajnë dhe i plotësojnë:

	Aftësitë profesionale;
	Kryerjen e detyrave të punës me përgjegjësi;
	Cilësi dhe etikë profesionale dhe integriteti;
	Kolegjialitetin dhe punën ekipore;
	Transparencën;
	Barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta;



Risinë dhe



Pavarësia e revizorëve të autorizuar shtetëror dhe revizorëve shtetëror në lidhje me subjektet e revizionit, institucionet shtetërore dhe përdoruesve tjerë të mjeteve publike

Në këtë drejtim, ESHR-ja u mundëson punonjësve ta mbajnë dhe rrisin interesimin për punën në institucion, nëpërmjet;

- përmirësimin permanent të kushteve për punë;
- kushteve të barabarta për punësim dhe avancim;
- përmirësimin të vazhdueshëm të aftësive profesionale të punonjësve dhe
- shpërblim adekuat sipas rezultateve të arritura.

Këto parime dhe vlera janë themelet e menaxhimit të mirë në ESHR dhe ndikojnë në sjelljen e punonjësve në tërësi, por edhe ndihmon se si ta transformojmë mënyrën me të cilën punojmë dhe na jep udhëzim të qartë për zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore.

Në pritje të tendencave të reja të zhvillimit të ISR-së, kërkesat nga standardet ndërkombëtare, si dhe detyrimet e ndërmarra me memorandumet e lidhura të bashkëpunimit, në dhjetor 2022, ESHR-ja përgatiti analizë të re funksionale e cila paraqet hap fillestar në vendosjen e ndryshimeve në rregullimin dhe realizimin e brendshëm të proceseve të punës në ESHR me qëllim që të sigurohet efikasiteti dhe efektiviteti më i madh në funksionim. Analiza dha pasqyrë gjithëpërfshirëse, të detajuar dhe esenciale të kompetencave të ESHR-së që janë zbatuar dhe

nevojave nga realizimi i qëllimeve strategjike të ESHR-së, gjegjësisht kryerjen e revizionit shtetëror, me qëllim që ato të jenë më efikase dhe më efektive.

Në bazë të kryerjes së analizës funksionale, u miratuan aktet e reja për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm, në të cilën është paraparë edhe sektori i ri për parandalimin e korrupsionit dhe departamenti i veçantë laborator i inovativ, si pjesë përbërëse e Sektorit të Revizionit të Sistemit të Informacioneve.



BURIMET NJERËZORE




116

TË PUNËSUAR NË ESHR
 PREJ TË CILËVE

72
 punonjës
 janë gra ose

44
 punonjës janë
 burra



62%

38%



STRUKTURA E
 UDHËHEQËSVE
 NË ESHR

2%



të emëruar

1%



sekretar i
 përgjithshëm

2%



këshilltar të KRSH
 3 punonjës

2%



8%




ndihmës të KRSH
 10 punonjës

2%





STRUKTURA GJINORE
E UDHËHEQËSVE TË
EKIPIT TË REVIZORËVE



STRUKTURA GJINORE E
REVIZORËVE SHTETËROR/
NËPUNËS ADMINISTRATIV/
PERSONI NDIHMËS-TEKNIKË



35

revizorët
shtetëror

67

1

nëpunës
administrativ

6

2

personat
ndihmës-teknikë

1



3.2 RITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËRORË

Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi siguron aktivitete për forcimin e burimeve njerëzore dhe krijon nivel të lartë profesional dhe atmosferë të përshtatshme për mësim, përparim dhe zhvillim e të gjithë punonjësve.

Në pajtim me kërkesat e INTOSAI-t dhe ISSAI-t, dhe me qëllim të marrjes së informacioneve më të detajuara për nevojën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit, si dhe rritjes së aftësive dhe njohurive të tyre përmes anketës/pyetësorit që i janë përgjigjur 71% e punonjësve, u përcaktuan fushat prioritare për edukimin e punonjësve dhe të njetët përfshihen në Planin Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2022.

Plani Vjetor për PVP-në për vitin 2022 të Entit Shtetëror të Revizionit, u realizua duke përdorur burimet e brendshme të institucionit dhe duke përdorur ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë të fushës përkatëse. Aktivitetet e dedikuara për organizimin e trajnimeve kryhen nga ESHR-ja me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, asocioneve profesionale, shoqatave, nismave ndërkombëtare, si dhe subjekteve private juridike nga vendi dhe jashtë të cilët ofrojnë edukim në më shumë fusha të lidhura me revizionin shtetëror, në (40) tema të ndryshme.

Me qëllim që të marrë informacione kthyesë për cilësinë e edukimeve të mbajtura, ESHR-ja rregullisht zbaton vlerësime për edukimet e organizuara, të cilat treguan se më shumë se 80% e punonjësve
















kanë ndikim pozitiv nga trajnimet e organizuara dhe ato do të kontribuojnë ta përmirësojnë punën e vet.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar edhe trajnimet e veçanta për revizorët shtetërorë të sapopunësuar, me qëllim të lehtësimit të përshtatjes së tyre profesionale në mjedisin e ri të punës, pastaj duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë për vendin përkatës të punës duke kryer detyra të ndryshme të revizionit, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme.

Forcimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së kryhet edhe nëpërmjet zbatimit të revizioneve paralele, ndërkombëtare, të përbashkëta dhe kooperative në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të ISR-ve (INTOSAI), si dhe aktivitetet që dalin nga Tvinging Projekti, bashkëpunimi dypalësh midis ESHR-së dhe ISR-ve të tjerë.

Janë realizuar vizita studimore të punonjësve të ESHR-së në ISR-të e tjerë, ku nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, punëtori dhe konferenca të organizuara në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të ISR-ve (INTOSAI) dhe forma të saj rajonale, Gjykata Ndërkombëtare e Revizionit, SIGMA, si dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare UN Women, UNDP, Instituti Kombëtar për Demokraci, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) dhe të tjera u mundësua rritja e njohurive dhe aftësive punonjësve të ESHR-së.

**Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2022
u realizua në tërësi dhe u zbatuan trajnimet në fushat si në vijim:**

	Revizioni, trajnimet metodologjike - niveli themelor dhe niveli i përparuar;
	Njoftimi financiar dhe i kontabilitetit;
	Zbatimi praktik i standardeve të revizionit të ISR-së (INTOSAI);
	Parandalimi i mashtrimit, korrupsionit dhe integriteti;
	Teknologjia informatike;
	Analiza e të dhënave;
	Zhvillimi i aftësive të buta dhe zhvillimi personal;
	Rregullativa ligjore;
	Mbrojtja dhe sigurimi i qasjes tek informacionet me karakter publik;
	Prokurimet publike;
	Tatimet dhe kontributet;
	Revizioni i njësive të vetëqeverisjes lokale;
	Planifikimi strategjik dhe vjetor;
	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe
	Llojet e tjera të trajnimeve.

3.3 BURIMET E TI-së

Në vitin 2022, Enti Shtetëror i Revizionit ka vazhduar me prokurimet e nevojshme dhe të planifikuara në fushën e teknologjisë së komunikimit të informacioneve dhe sigurisë së të dhënave, me qëllim të modernizimit të sistemit të informacioneve në Entin Shtetëror të Revizionit dhe mbështetjen e revizionit.



VPN dhe FTTP

U krye me sukses prokurimi dhe instalimi i zgjidhjes moderne, i cili ofron mbrojtjen e komunikacionit të rrjetit, të dhënave dhe shërbimeve, dhe njëkohësisht mundëson mbrojtjen më të lartë në pjesën e lidhjes VPN.

Përdorimi i qasjes në distancë nga subjektet që janë lëndë e revizionit, për sigurimin e të dhënave elektronike me kërkesën e revizionit, u realizua me sukses edhe në vitin 2022.



Audit management system

Është kryer prokurimi i zgjidhjes aplikative për mbledhjen e të dhënave për raportin vjetor, e cila nënkuptonte zhvillimin e zgjidhjes softuerike për nevojat specifike të ESHR-së. Gjithashtu, është zbatuar edhe prokurimi me qëllim të përmirësimit të sistemit AMS – sistemi kryesor elektronik për aktivitetet e punës, bazuar në proceset e ndryshme të revizionit. AMS sistemi u avancua me module të reja që do të lehtësojë ndjeshëm punën e ekipeve të revizorëve.



Pajisjet dhe aplikacionet

Si risi në punë, është fut zgjidhja aplikative për përdorimin maksimal efikas të burimeve për t'i printuar raportet e revizorit dhe dokumentet e tjera të cilat ESHR-ja i përdor në punën e vet. Rezultatet nga përdorimi i saj janë më shumë se të kënaqshme.

Në pjesën e kujdesit për nevojat e punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit, janë realizuar prokurime të kompjuterëve portativë me versionin e fundit të sistemit operativ, si dhe prokurimet e disqeve të jashtëm që revizorët i përdorin gjatë punës në terren. Vazhdon praktika e unifikimit të pajisjeve dhe mjeteve të përdorura nga revizorët në procesin e revizionit, si dhe mbrojtjen e të dhënave të marra nga subjektet që janë lëndë e revizionit dhe enkriptimin e të dhënave në nivel të përdoruesit.



Trajnimet e TI-së

Për punonjësit e rinj, është siguruar trajnimi në fushën e njohjes me sistemin e informacioneve, përdorimi adekuat i burimeve të TI-së, përdorimi i mjeteve softuerike, aplikacionet dhe Sistemi për menaxhim me proceset e revizionit që në mënyrë aktive përdoren në procesin e revizionit, si dhe njohja me politikat dhe procedurat e TI-së – bazë për përdorim të suksesshëm, korrekt dhe të sigurt të mjeteve dhe të dhënave.



Video konferencat

Praktika e përdorimit të platformës për të mbajtur video-konferenca dhe takime “online” me palët e brendshëm dhe të jashtëm dhe trajnimet, vazhdoi edhe këtë vit. Në këtë mënyrë realizoheshin lehtësisht aktivitetet e shumta, ku për shkak të ndalimeve të lidhura me pandeminë ishte e pamundur të realizohet prania fizike e të gjithë palëve të interesuara.



CAATs

Zhvillimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi i saj nga subjektet që janë lëndë e revizionit ka kontribuar në procesin e revizionit të përdoren teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter të njohura si CAAT's. CAAT's paraqesin vegla të bazuara kompjuterike, me ndihmën e të cilave revizorët kryejnë një sërë testesh të automatizuara për vlerësimin e sistemit të informacioneve të subjektit ose të të dhënave elektronike. CAAT's ofrojnë nivel më të lartë të sigorisë dhe sigurimin e dëshmime të përshtatshme dhe të mjaftueshme të revizionit. ESHR-ja në revizion e përdor softuerin IDEA për të analizuar të dhënat nga të cilat gjenerohen raportet financiare dhe për të zgjedhur mostrën për nevojat e procesit të revizionit.



Politikat dhe procedurat e TI-së

Është siguruar funksionimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së sistemit të informacioneve dhe aplikacioneve, duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: dispozicionin e të dhënave të përdoruesit të autorizuar, besueshmërinë, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në lokacionin qendror, pajtueshmërinë me ligjet, bërjen e rregullt të kopjes rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave.



Politika e Sigorisë së Sistemit të Informacioneve dhe ISO 27001:2013

Njëherazi, zbatohet në mënyrë konsekuente Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit, me vëmendje të veçantë drejt zbatimit të procedurave të sigorisë së TI-së dhe procedurave të TI-së për zbatimin e Sistemit për Menaxhim me Procesin e Revizionit. Në vitin 2022 u përditësuan politikat dhe procedurat e sigorisë së informacioneve në pajtim me ISO 27001:2013, me çka siguron drejtimin dhe mbështetjen e qartë për sigurinë e informacioneve, gjegjësisht ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacioneve dhe sistemeve të informacioneve.

3.4 MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-së

Mjetet financiare të domosdoshme për punën e Entit Shtetëror të Revizionit në pajtim me dispozitat e Ligjit për revizion shtetëror sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Buxheti i Entit Shtetëror të Revizionit është përgatitur në kuadër të kërkesave dhe nevojave të Entit Shtetëror të Revizionit. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut veçmas votoi pjesën për Buxhetin e Entit Shtetëror të Revizionit në kuadër të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Enti Shtetëror i Revizionit vazhdimisht dhe me përkushtim bën përpjekje për realizimin e kompetencave të deleguara me ligj dhe arritjen e treguesve të përcaktuar për matjen e rezultateve të punës së vet. Enti Shtetëror i Revizionit duke u nisur nga shembulli i saj, si organizatë me standarde të larta të funksionimit dhe menaxhimit financiar, vendosi tregues për matjen e performancës së funksionimit, gjegjësisht vlerës së shtuar të punës së ESHR-së.

Me sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për realizimin e vazhdueshëm të kompetencave të Entit Shtetëror të Revizionit, mundësohet që Enti Shtetëror i Revizionit të sigurojë kthimin e drejtpërdrejt të mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes evazionit të përcaktuar tatimor.

Në fakt, me revizionet e kryera nga Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, vlera e shtuar nga revizionet e kryera të Entit Shtetëror të Revizionit siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në raport 1:11, pra 1 buxhet i ESHR-së, siguron kthim në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vlerë prej të paktën 11 buxheteve të ESHR-së, gjegjësisht mjetet

e paarkëtuara / më pak të llogaritura dhe të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë 1464 milion denarë, gjegjësisht 23 milion euro.

Buxheti i përgjithshëm i miratuar i ESHR-së për vitin 2022 për llogaritë e buxhetit themelor (637, 631) është 142.845 mijë denarë, dhe realizimi i përgjithshëm i të ardhurave është në vlerë të përgjithshme prej 136.158 mijë denarë ose 95,31%, ndërsa realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve është 135,788 mijë denarë ose 95,05%.

Prej tyre 139,875 mijë denarë ose 97,92% janë mjete të siguruar / planifikuara nga llogaria e buxhetit themelor (637) dhe 2,970 mijë denarë ose 2,08% janë mjete të planifikuara nga llogaria e buxhetit themelor (631).

Llogaria 637 | buxheti themelor

Buxheti i miratuar për vitin 2022 i llogarisë 637 në shumën totale prej 139.875 mijë denarë u zbatua në shumën totale prej 133.664 mijë denarë, gjegjësisht përqindja e realizimit të mjeteve është 96%.

Shpenzimet e planifikuara të llogaria 637 e Entit Shtetëror të Revizionit në shumë prej 102.680 mijë denarë ose 73,4% u referohen pagave, kontributeve dhe kompensimeve të punonjësve, 27.075 mijë denarë ose 19,4% u referohen mallrave dhe shërbimeve, transferet dhe donacionet janë planifikuar në shumë prej 1.580 mijë denarë ose 1,1% nga shuma totale e planifikuar dhe 8.540 mijë denarë ose 6,1% u planifikuan për shpenzimet kapitale.

Nga aspekti i strukturës së shpenzimeve të realizuara të Entit Shtetëror të Revizionit, 100.722 mijë

denarë ose 75,4% u referohen pagave dhe kompensimeve të punonjësve, 23.527 mijë denarë ose 17.60% u referohen mallrave dhe shërbimeve dhe 8.112 mijë denarë ose 6% për shpenzimet kapitale dhe 1.303 mijë denarë për transferet e ndryshme ose 1% nga buxheti i përgjithshëm i realizuar.


Në vitin 2022 në strukturën e realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, përqindje më të madhe kanë shërbimet komunale, ngrohja, komu-


nikimi dhe transporti në shumë prej 10.231 mijë denarë, për shpenzimet rrugore dhe mëditjet janë realizuar mjetet në shumë prej 9.935 mijë denarë, për materialet dhe inventarin e imët janë realizuar 1.283 mijë denarë, për riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme janë realizuar 2.442 mijë denarë, për shërbimet me kontratë janë realizuar 3.638 mijë denarë, për shpenzimet tjera rrjedhëse 1.998 mijë denarë dhe për transferet e ndryshme janë realizuar mjetet në shumë prej 1.303 mijë denarë.



BUXHETI I MIRATUAR PËR VITIN 2022

për llogarit e
buxhetit themelor
{637 dhe 631}





Për shpenzimet kapitale janë realizuar mjetet në shumë prej 8.112 mijë denarë, dhe është arritur realizimi i 95% në krahasim me buxhetin e planifikuar. Këto shpenzime kapitale janë realizuar në bazë të analizave dhe planeve të detajuara të kryera për nevojën e prokurimit të mjeteve të reja themelore, por edhe zëvendësimin e mjeteve themelore të përhershme si pjesë e ciklit standard të zëvendësimit të mjeteve me qëllim të përmirësimit të funksionimit të ESHR-së.

Llogaria 631 | buxheti themelor

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar i llogarisë së buxhetit themelor 631 të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 është 2.970 mijë denarë, ndërsa realizimi më 31.12.2022 është 2.124 mijë denarë ose 71,5%.

Të ardhurat e kësaj llogarie në vitin 2022 janë në shumë totale prej 2.494 mijë denarë të cilat u referohen të ardhurave të arkëtuara nga revizionet e kryera para hyrjes në fuqi të Ligjit për revizion shtetëror në vitin 2010 dhe tepricës së të ardhurave të transferuara nga viti i kaluar. Për vitin 2022 janë realizuar shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 2.124 mijë denarë nga llogaria e buxhetit themelor 631. Nga aspekti i strukturës së shpenzimeve të realizuara, shpenzimet kapitale, marrin pjesë me 96% ose 2.040 mijë denarë dhe i referohen blerjes së veturave zyrtare. Në llogarinë për mallra dhe shërbime janë realizuar shpenzimet në vlerë prej 84 mijë denarë ose 4% nga totali i shpenzimeve dhe u referohen shpenzimeve për shërbime të komunikimit. Mjetet e pashpenzuara në fund të vitit janë në vlerë prej 370 mijë denarë dhe janë bartur si tepricë e të ardhurave për vitin e ardhshëm.

Llogaria 785 | buxheti i donacioneve

Në vitin 2022, Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit INTOSAI dhe Institucioni Suprem i Revizionit i Arabisë Saudite shpallën thirrje për aplikime për dhënien e granteve të dedikuara për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë në punë nëpërmjet mbështetjes në zgjidhjet e TIK-së. Enti Shtetëror i Revizionit ka aplikuar dhe ka marrë donacion / grant prej 30 mijë dollarë (\$) të dedikuara për blerjen e pajisjeve informatike për nevojat e ESHR-së, gjegjësisht 18 kompjuterë portativë dhe 2 dronë, me qëllim të përmirësimit të qëndrueshmërisë dhe sigurimit të vazhdimësisë në funksionimin e ESHR-së.


Enti Shtetëror i Revizionit, në dhjetor 2022, hapi llogarinë buxhetore të donacioneve me numër 0200215040 785 50, me qëllim të zbatimit të grantit të marrë nga General Court of Audit – Saudi FISP.

Në këtë llogari në vitin 2022 nuk u regjistrua asnjë transaksion për shkak se mjetet nga granti i miratuar në vlerë prej 30 mijë dollarë amerikanë u transferuan në janar 2023 nga ISR-ja e Arabisë Saudite në llogarinë e hapur të donacioneve të ESHR-së.

DONACIONET E MARRA NË VITIN 2022



aktivitetet e financuara
përmes donatorit



Raportet financiare të Entit Shtetëror të Revizionit i revidon shoqëria e jashtme e revizionit e zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Raporti nga revizioni i kryer i Entit Shtetëror të Revizionit nga ana e revizorit të pavarur është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit.



Në fakt, gjatë vitit 2022, me qëllim të forcimit të kapaciteteve të ESHR-së për përfshirjen e perspektivës gjinore në revizionet e suksesit dhe kryerjes së revizioneve gjinore, në bashkëpunim me UN Women është marrë mbështetja prej 74 mijë dollarë amerikanë për përgatitjen e udhëzimeve metodologjike për revizionet gjinore, është siguruar ndihma profesionale gjatë kryerjes së revizionit gjinor, vlerësimi i rezultateve nga revizionet e kryera, por edhe pjesëmarrja e revizorëve shtetërorë në punëtoritë në vend dhe jashtë vendit (takimet rajonale dhe vizitat studimore) për shkëmbimin e përvojës dhe praktikave të mira me ISR-të e tjerë.



Në bashkëpunim me Programin për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe me qëllim të përmirësimit dhe edukimit të vazhdueshëm të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit, në vitin 2022 u organizuan një sërë punëtorish në fushën e revizionit të NJVL-ve; raportet financiare në bazë të llogaritjes, analiza e rreziqeve dhe tipologjia e personave, për qëllimin e të cilit janë realizuar mjetet në shumën totale prej 74 mijë dollarë amerikanë.



Instituti Kombëtar për Demokraci (NDI), në bashkëpunim me Fondacionin Kombëtar për Demokraci (NED) për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave mbi mbikëqyrjen e mjeteve publike nga pushteti legjislativ dhe bashkëpunimi me revizionin shtetëror në nivel lokal dhe qendror në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ESHR-në ka siguruar mbështetje në shumë prej 29 mijë dollarë amerikane.



Në drejtim të zbatimit të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së, në bashkëpunim me Fondacionin Vestminster për Demokraci (FVD) në vend, është siguruar mbështetja prej 28 mijë funta, të dedikuara për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të ESHR-së me institucionet kompetente, Prokurorinë Publike, Kuvendin, organizatat joqeveritare, gazetarët dhe mediat, por edhe për forcimin e kapaciteteve të ESHR-së. FVD gjithashtu ka siguruar mbështetje nga ekspertët në kryerjen e tri revizioneve të suksesit.

Mbështetja e punës së Entit Shtetëror të Revizionit nga organizatat ndërkombëtare - aktivitetet e financuara përmes donatorit

Enti Shtetëror i Revizionit si ISR në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdimisht ka bërë përpjekje për të arritur bashkëpunim me një numër të madh organizatash ndërkombëtare me qëllim të sigurimit të mbështetjes për aktivitetet e saj në drejtim të arritjes së qëllimeve të përcaktuara strategjike.

3.5 | ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, janë çështje dhe aktivitete që janë me interes të veçantë për qytetarët të vendit tonë dhe më gjerë. Nga këto arsye Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi investon në aktivitetet të cilat janë të

orientuara drejt përmirësimit të qëndryeshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, nëpërmjet revizioneve të kryera dhe rekomandimeve të dhënë, por edhe nëpërmjet përpjekjeve të veta:

Kryerjes së revizioneve në fushën e mjedisit jetësor



Anëtarësimi në grupet e punës së INTOSAI dhe EUROSAI

Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi zbaton revizione në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Në Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, i parashikoi dhe kreu revizionet në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor:

Enti Shtetëror i Revizionit është anëtar aktiv në grupin e punës së EUROSAI dhe INTOSAI për revizionet e mjedisit jetësor.



Seleksionimi i mbeturinave

Janë vendosur kosha plehrash për seleksionimin e mbeturinave dhe janë lidhur kontrata me operatorët ekonomikë për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave.



Është zvogëluar përdorimi i letrës

Me miratimin e Rregullores për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror nga kryerevizori shtetëror janë krijuar kushtet, që raportet e revizorit të dorëzohen në formë elektronike, dhe në të njëjtën kohë është vendosur zgjidhja aplikative për përdorimin maksimal efikas të burimeve për printimin e raporteve të revizorit dhe dokumenteve të tjera që ESHR-ja i përdor në punën e vet.



Efikasiteti energjetik

Ndërtesa administrative e ESHR-së, është me efikasitet energjetik me vendosjen e sistemit modern të ngrohjes, ftohjes dhe ndriçimit. Kanë filluar aktivitetet për vendosjen e fotovoltaikeve në ESHR. Në kushtet e krizës energjetike, ESHR në tremujorin e fundit të 2022, ka arritur mesatarisht 35% të kursimit të energjisë elektrike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



**BASHKËPUNIMI
NDËRKOMBËTAR**

ESHR-ja si dhe ISR-të tjera, është aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar, me të cilën mundëson rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të revizionit.

Në vitin 2022 për shkak të gjendjes së imponuar nga pandemia e KOVID-19, vazhdoi trendi i realizimit të ngjarjeve ndërkombëtare në distancë, përmes video-konferencave dhe në formë të uebinarit. Qasja e mbajtjes së ngjarjeve ndërkombëtare virtuale mundësoi që ato të ndiqen nga një numër i madh punonjësish të ESHR-së. Gjatë vitit 2022, ESHR-ja mori pjesë në një numër të madh ngjarjesh ndërkombëtare (takime, punëtori, konferenca), nga të cilat mbi 90% u realizuan me video-link. Të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen me praktikat më të mira dhe të marrin pjesë në rrjetëzimin si mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre në disa fusha:

- revizioni i mjedisit jetësor;
- mbështetja e TI-së dhe revizioni i TI-së;
- përmirësimi i punës së ISR-së;
- borxhi publik;
- revizionet gjinore dhe buxheti gjinor;
- revizioni i komunave;
- etika dhe integriteti;
- pandemia e KOVID-19 si sfidë dhe mundësi për të rritur ndikimin e ISR-së, etj.

ESHR-ja është pjesëmarrëse aktive në shumë grupe ndërkombëtare operative të punës, ndër të cilat edhe:

GRUPI I PUNËS EUROSAI DHE INTOSAI



Kontributi i ESHR-së në realizimin e aktiviteteve të grupeve të punës dhe programeve të EUROSAI-t, gjatë vitit 2022 ishte zhvilluar në kontinuitet në përputhje me kushtet e vendosura nga COVID - 19.

Pjesëmarrja në revizionet kooperative me institucionet e tjera supreme të revizionit nga BE-ja dhe më gjerë, mbetet edhe më tej një nga prioritetet e ESHR-së duke pasur parasysh faktin se ky lloj bashkëpunimi kontribuon ndjeshëm në forcimin e vazhdueshëm të aftësive të revizorëve dhe përmirësimin e cilësisë së revizionit të suksesit.

Përfitimet nga bashkëpunimet me ISR-të e tjera janë të shumfalishta, veçanërisht e theksojmë mundësinë që kanë revizorët të avancojnë veten në mënyrë profesionale në formën e aktiviteteve kolegjiale (peer-to-peer), qasjen fleksibile dhe përdorimin e përvojave të pjesëmarrësve të tjerë dhe forcimin e vetëbesimit në kapacitetet personale për kryerjen e revizionit të suksesit nga njëra anë dhe promovimin e rezultateve të arritura të ESHR-së nga ana tjetër.

ORGANIZATA EVROPIANE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË REVIZIONIT (EUROSAI)



KOMITETI I KONTAKTIT



Në takimin e rregullt vjetor të Komitetit të Kontaktit të krerëve të institucioneve supreme të revizionit të Bashkimit Evropian, Gjykata Evropiane të Revizorëve, përfaqësuesve të SIGMA-s dhe Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t mori pjesë edhe Delegacioni i ESHR-së i kryesuar nga Kryerevizori Shtetëror.

Fokusi i këtij takimi ishin detyrat dhe sfidat strategjike të ISR-ve në BE gjatë vlerësimit të vlerës (së shtuar) të Mekanizmit për rimëkëmbje dhe qëndrueshmëri (Recovery and Resilience Facility) në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së. Qëllimi i takimit ishte çështja me interes të përbashkët me fokus në politikën dhe menaxhimin financiar të BE-së, si dhe përcaktimin e aktiviteteve të përbashkëta për arritjen e ndikimit të madh.

Në margjinat e këtij aktiviteti, Kryerevizori Shtetëror zhvilloi disa takime dypalëshe me kolegët dhe përfaqësuesit e ISR-ve nga vendet anëtare dhe vendeve kandidat për anëtarësim në BE dhe ESR, në të cilat u diskutua për pavarësinë e institucioneve supreme të revizionit dhe ndikimin e tyre në menaxhimin më të mirë me mjetet publike, rëndësinë e zbatimit të standardeve për kryerjen e revizionit, burimet njerëzore si parakusht për institucion profesional, si dhe vlerën dhe rëndësinë e matjes së rezultateve të punës së ISR-së.



TAKIMI POST-KONGRES EUROSAI



Me ftesë të kryetarit të ISR-së së Republikës Çeke, njëherazi edhe kryetar i EUROSAI-t, përfaqësuesit e drejtuesve të ISR-ve anëtarë të EUROSAI-t, morën pjesë në takimin dyditor post-kongres të EUROSAI-t në Pragë, Republika Çeke. Fokusi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i njohurive dhe përvojave për tema me interes të veçantë për revizionin e jashtëm për të siguruar përgjigje adekuata ndaj sfidave

të kohës moderne dhe për të siguruar vlerë të shtuar për qytetarët, nëpërmjet zbatimit të Planit Strategjik të EUROSAI-t 2024-2030. Në këtë drejtim, anëtarët e EUROSAI-t shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar më ngushtë në gjetjen e mjeteve, metodologjive dhe procedurave të reja të revizionit, shkëmbimin e njohurive dhe përvojave për temat me interes të veçantë për revizionin e jashtëm.

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË REVIZIONIT (INTOSAI)



Në përputhje me moton e INTOSAI-t (Experientia Mutua Omnibus Prodest - Të gjithë përfitojnë nga përvoja e përbashkët), ESHR-ja siguroi kontribut vital për promovimin e qeverisjes së mirë, forcimin e transparencës, llogaridhënies

dhe luftës kundër korrupsionit, dhe kështu kontribuon edhe në ruajtjen e besueshmërisë dhe forcimin e besimit të publikut në menaxhimin me mjetet publike.



XXIV INKOSAI – KONGRESI NDËRKOMBËTAR I INSTITUCIONEVE SUPREME TË REVIZIONIT



Në Brazil në periudhën prej 07 deri më 11 nëntor 2022 u mbajt Kongresi i XXIV Ndërkombëtar i INKOSAI-t (Kongresi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Revizionit) në të cilin ishte planifikuar pjesëmarrja e Kryerevizorit Shtetëror, Zëvendëskryerevizorit Shtetëror dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Por, për shkak të arsyeshme në kongres mori pjesë vetëm Zëvendëskryerevizori Shtetëror. Kongresi u organizua nga Gjykata Federale e Llogarive e Brazilit.

Këtë vit Kongresi mbledhi së bashku pjesëmarrësit nga më shumë se 120 vende, të cilët diskutuan mbi çështjet kryesore me të cilat përballlet komuniteti i revizionit të jashtëm dhe zgjidhjet e tyre të mundshme. ISR i Brazilit kryesoi INKOSAI-n XXIV të këtij viti, i cili u fokusua në dy tema kryesore - Puna e Institucioneve Supreme të Revizionit përballë fatkeqësive publike dhe Zëri global, rezultati global dhe ndikimi afatgjatë.

Në Kongres u miratuan dokumente të rëndësishme, të tillë si: Deklarata e Rios, rregullat dhe procedurat e organizatës, raportet për punën e trupave të veçantë të punës në kuadër të INTOSAI-t, si dhe Plani Strategjik i INTOSAI-t 2023-2028, ndërsa në të janë emëruar shtatë anëtarë të rinj të bordit drejtues të INTOSAI-t, si dhe dy revizorë të jashtëm, për periudhën 2023-2025.

Në kuadër të kongresit, Zëvendëskryerevizori Shtetëror z. Ademi realizoi takime me kryetarin e ISR-së së Brazilit, z. Bruno Dantas, organizator i Kongresit XXIV, me kryetarin e ISR-së së Norvegjisë, me Kryerevizorin e SHBA-së, me kryetarin e ISR-së së Mbretërisë së Arabisë Saudite dr. Hysam Allangari, me Kryerevizorin e ISR-së së Shqipërisë, si dhe me përfaqësuesit e ISR-ve të tjerë me të cilët shkëmbeu mendime dhe përvoja në lidhje me çështjet e revizionit shtetëror, me qëllim të zbatimit të standardeve të revizionit dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet ISR-ve.

PJESËMARRJA NË GRUPET E PUNËS NË KUADËR TË INTOSAI-T DHE EUROSAI-T

GRUPI I PUNËS I INTOSAI-T PËR REVIZIONIN E MJEDISIT JETËSOR



Në kuadër të grupit të punës për revizionin e mjedisit jetësor të INTOSAI-t, në korrik 2022 u mbajt Kuvendi i 21-të, në të cilën përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në diskutimet interesante të ekspertëve më të mirë për temat lidhur me "Forcimin e rezistencës" në

kontekstin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Temat kryesore që u diskutuan, ndër të tjera, janë: transporti i qëndrueshëm, financimi klimatik, menaxhimi me mbetjet plastike, si dhe aspektet e tjera që lidhen me qëllimet.

GRUPI I PUNËS I EUROSAI-T

GRUPI I PUNËS I INTOSAI-T PËR REVIZIONET E TI-SË



Përfaqësuesit e ESHR-së në grupin e punës së EUROSAI-t dhe INTOSAI-t për revizionin e TI-së, morën pjesë aktive në të gjitha punëtoritë online të organizuara nga ky grup, me të cilat i rritën aftësitë dhe njohuritë e tyre gjatë zbatimit të revizioneve të TI-së. ESHR-ja me përfaqësuesit e saj mori pjesë në takimin vjetor të grupit të punës EUROSAI për TI, i cili u mbajt në Bukuresht, Rumani.

Tema e takimit vjetor 2022 ishin standardet dhe udhëzimet e TI - e ardhmja e revizionit të TI-së. Takimi vjetor i grupit të punës të INTOSAI-t për revizionet e TI-së u mbajt në formatin online në maj 2022 me temën e përdorimit të TI-së dhe optimizimin e aktiviteteve të ISR-ve dhe fushat e sinergjisë me aktivitetet e grupit të punës.

GRUPI I PUNËS I INTOSAI PËR BORXHIN PUBLIK



ESHR-ja me përfaqësuesit e saj mori pjesë në Takimin Vjetor të grupit të punës INTOSAI për borxhin publik, i cili u mbajt në mënyrë virtuale. Tema e takimit vjetor për vitin 2022, ishte Të kuptuarit e mjedisit për borxhin publik në kushtet e post-pandemisë (Leksione për menaxhimin me mjetet publike) në të cilin edhe punonjësit e ESHR-së morën pjesë aktiv me prezantimin e tyre.

Në kuadër të këtij grupi të punës, ESHR-ja mori pjesë aktive si lider i ekipit në realizimin e dy aktiviteteve të Planit Strategjik për përgatitjen e:

- Përmbledhjes së procedurave praktike për autorizimin, miratimin dhe kornizën ligjore në menaxhimin me borxhin publik dhe
- Punimit kërkimor për hartimin e mandateve të ISR-së për revizionin e borxhit publik, kapaciteteve institucionale dhe mbështetjes dhe burimeve të Organizatës Rajonale

Këto procedura praktike pritet të miratohen gjatë vitit 2023.

GRUPI I PUNËS PËR REVIZIONIN E MJEDISIT JETËSOR TË EUROSAI



Në kuadër të grupit të punës për revizionin e mjedisit jetësor të EUROSAI-t, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në takimin pranveror me temë "Furnizimi me ujë, cilësia e saj dhe ndikimi i saj në ndryshimet klimatike", në të cilin u shkëmbyen përvojat në revizionet e zbatuara për menaxhimin me ujërat, politikat në menaxhimin me ujërat në nivel lokal dhe qendror dhe

implementimi i tyre, aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit jetësor, roli i ISR-së në mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve të këtij grupi të punës, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë edhe në Takimin e 20-vjetorit të grupit që u zhvillua në nëntor 2022 me titull "Mbrojtja ekologjike në kohëra turbulente" në kontekst të adaptimit të ndryshimeve klimatike.

GRUPI OPERATIV I EUROSAT-PËR REVIZIONIN E KOMUNAVE



ESHR-ja ka dhënë kontribut të veçantë në punën e grupit operativ të EUROSAI-t (TFMA) për revizionin e komunave, veçanërisht në pjesën e zbatimit të planit të veprimit për vitet 2021/22

Grupi i punës për revizionin e njëjësive të vetëqeverisjes lokale të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit (EUROSAI) – TFMA, në kuadër të aktiviteve të saj mbajti seminarin me temë “Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe administratës së komunave” më 19 dhe 20 tetor 2022, në Vilnius, Lituani. Në ngjarjen morën pjesë përfaqësuesit e ISR-së së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Izraelit, Lituanisë, Austrisë, Shqipërisë, Azerbajxhanit, Bosnjë e Hercegovinës, Gjeorgjisë, Estonisë, Maltës, Moldavisë, Letonisë, Rumanisë, Polonisë, Malit të Zi, Turqisë dhe Spanjës.

Përfaqësuesit e ESHR-së, morën pjesë aktive në seminar duke i prezantuar rezultatet nga zbatimi i revizionit të TI-së me temën “Cilësia e shërbimeve të cilat i ofrojnë NJVL-të nëpërmjet portaleve të tyre të internetit” dhe ishin moderatorë të grupit të punës me temën “Ndërtimi i kapaciteteve të pushtetit lokal në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve”.

Në takimin e pestë vjetor, ESHR-ja si koordinator i revizionit kooperativ të suksesit me temën “Të ardhurat personale të komunave në kushtet e pandemisë”, në të cilën morën pjesë ISR-të e

Shqipërisë, Rumanisë, Polonisë, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Turqisë, i prezantoi aktivitetet dhe rezultatet e aritura që pasojnë për përfundimin e plotë të revizionit. Ky revizion zbatohet si pjesë e aktiviteve në kuadër të TFMA-së. Raporti përmbledhës i këtij revizioni kooperativ pritet të publikohet në mesin e vitit 2023.

Analiza **“Mbledhja e të dhënave për mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e revizionit për NJVL-të”**¹², të përgatitur nga ESHR-ja u publikua në janar 2022. Kjo analizë është pasqyrë praktike në mënyrën dhe procedurat përmes të cilave ISR-të - anëtarë të TFMA-së monitorojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit për revizionet e kryera të komunave për llojet e ndryshme të revizionit. Analiza u krye si pjesë e aktiviteve të planifikuara në grupin e punës, në bazë të pyetësorit të dorëzuar dhe sigurimit të përgjigjeve të 23 anëtarëve nga gjithsej 27 anëtarë të grupit të punës për revizionin e njëjësive të vetëqeverisjes lokale të EUROSAI-t.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mirë. Në analizat janë prezantuar praktikatat e ndryshme të ISR-ve, nëpërmjet të cilave sigurohet funksionimi më efikas i sistemeve. Kjo temë është me interes të veçantë sepse monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është segment i rëndësishëm për sigurimin e transparencës dhe përgjegjësisë si elementë i menaxhimit të mirë.

12 <https://www.tfma.eu/page.aspx?id=110>; https://www.tfma.eu/files/files/tfma%2012-16/2_5_Questionnaire%20analysis_eng_Jan%202022_by%20MKSAAO.pdf?fbclid=IwAR0ZxcvjD8Jttr1kjWYIJJ_dWEAjWdVbHnT517FMUF_Gd2v65ALE9CN242s

RRJETI I ISR-VE I VENDEVE KANDIDATE DHE KANDIDATE TË MUNDSHME PËR ANËTARËSIM NË BE DHE GJYKATA EVROPIANE E REVIZORËVE

Në mbledhjen e rregullt vjetore të oficerëve për lidhje të ISR-së e cila u mbajt në mënyrë virtuale në maj 2022, vëmendje qendrore iu kushtua aktiviteteve për realizimin e planit kornizë të aktiviteteve të rrjetit për vitin 2022 edhe më tej. Në kuadër të projektit për revizion paralel të suksesit janë realizuar pesë punëtori virtuale.

Ndihmë profesionale dhe financiare për projektin siguroi ISR-ja e Suedisë, në koordinim me Grupin e Punës së Komitetit të Kontaktit për Revizion të Përbashkët (JWGAA) dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Gjykatës Evropiane të Revizorëve.

EUROSAI KONFERENCA E REVIZORËVE TË RINJ



Në shtator 2022 në Stokholm, Suedi, u mbajt Konferenca e Pestë e revizorëve të rinj të EUROSAI (5th Young EUROSAI Conference-YES), me temë "Kultura eksperimentale" në të cilën morën pjesë 90 përfaqësues të rinj nga ISR-të.

Qëllimi i këtyre konferencave është ndërtimi i bashkësisë profesionale ndërmjet të rinjve në kuadër të EUROSAI-t, promovimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve dhe pasurimi i përvojës profesionale dhe sociale të përfaqësuesve të rinj të ISR-së, si dhe standardet dhe vlerat profesionale nga të cilat përfitojnë të gjithë ISR-të.

Përfaqësuesit e ESHR-së, morën pjesë aktive në konferencë dhe mbajtën punëtori të përbashkët me kolegët e Gjykatës Evropiane të Revizorëve me temë "Fuqia e vizualizimit" me vështrim të veçantë për Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021.

Sipas të dhënave nga vlerësimi i pjesëmarrësve nga kjo ngjarje dhe shkalla e cilësisë së prezantimeve, si dhe sipas konstatimeve të Kryerevizorit Shtetëror të ISR-së së Suedisë, përfaqësuesit e ESHR-së e mbanin epitetin si ekipi me prezantimin më të mirë.

Në këtë konferencë, pjesëmarrësit patën mundësinë të shkëmbejnë përvoja dhe ide në drejtim të zhvillimit profesional të revizorëve.

BASHKËPUNIMI DYPALËSH DHE RAJONAL

INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT TË SERBISË

Si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm afatgjatë dypalësh, në vitin 2022, kryerevizorët shtetërorë të Entit Shtetëror të Revizionit dhe Institucionit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Serbisë nënshkruan Marrëveshje të Bashkëpunimit. Me marrëveshjen u përkufizuan aktivitetet dhe fushat e bashkëpunimit, të cilat përfshijnë zbatimin e revizioneve paralele të suksesit dhe shkëmbimin e përvojave në drejtim të përmirësimit të proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të vendeve anëtare të BE-së.

Në vitin 2022, si temë e rëndësishme dhe aktuale për të gjithë rajonin u zbatua revizioni kooperativ i suksesit "Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë të demografisë". Ekipet e revizorëve nga të dy institucionet, në kuadër të të tria takimeve të përbashkëta, diskutuan për rregullimin normativ, shtrirjen, qasjen metodologjike, përcaktimin e synimeve dhe pritshmërinë nga revizioni, por edhe shkëmbyen përvojat dhe rezultatet e tyre për të gjitha fazat e zbatimit të revizionit kooperativ të suksesit.

Në takimin e fundit në dhjetor 2022, u përcaktua afati kohor për përgatitjen e raportit të përbashkët, dhe njëherazi u përcaktua edhe tema e re për revizionin kooperativ të suksesit "Gatishmëria për implementimin e qëllimeve për zhvillimin e qëndrueshëm deri në vitin 2030", me të cilën pritet të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe ekologjik në shoqëri, dhe e cila do të jetë pjesë e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023 dhe do të zbatohet në vitin 2023.

INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I MALIT TË ZI

Enti Shtetëror i Revizionit, i përfaqësuar nga ndihmësit e Kryerevizorit Shtetëror, në mars të 2022 me ftesë të Institucionit Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi, morën pjesë aktive me prezantimin e tyre në konferencën rajonale me temën "Monitorimi i rekomandimeve nga revizionet e kryera". Në fokus të konferencës ishte përmirësimi i monitorimit sistematik dhe cilësor i zbatimit të rekomandimeve nga raportet e revizorit që kanë rol kryesor në matjen e ndikimit të revizionit. Pjesëmarrësit shkëmbyen përvoja dhe shembuj të praktikave të mira nga Institucionet Supreme të Revizionit në fushën e zbatimit të procedurave për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të revizorit në revizionet e rregullshmërisë, revizionet e pajtueshmërisë dhe revizionet e suksesit.

Në maj 2022, ESHR-ja priti delegacionin e Institucionit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Malit të Zi. Gjatë kohës së vizitës dypalëshe, punonjësit e ESHR-së përmes prezantimeve dhe diskutimeve me kolegët e tyre trajtuan tema dhe fusha të ndryshme duke përfshirë: komunikimin, transparencën dhe llogaridhënien e ESHR-së, mënyrën e prezantimit të gjendjeve të përcaktuara nga revizionet e kryera, përgatitjen e rezymesë nga raportet e revizorit dhe mjeteve të komunikimit, praninë në rrjetet sociale dhe promovimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin.

INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË SHQIPËRISË

Enti Shtetëror i Revizionit priti delegacionet e Institucioneve Supreme të Revizionit të Mbretërisë së Norvegjisë dhe Republikës së Shqipërisë. Gjatë vizitës Kryerevizori Shtetëror dhe kryetari i ISR-së së Shqipërisë nënshkruan Memorandum të mirëkuptimit ndërmjet të dy institucioneve me të cilin parashihen aktivitete të përbashkëta në periudhën e mëtejme dhe në drejtim të thellimit të bashkëpunimit të deritanishëm dhe forcimit të partneritetit dhe kapaciteteve të të dy institucioneve.

Në kuadër të vizitës, përfaqësuesit e të tria institucioneve të revizionit të kryesuar nga Kryerevizori Shtetëror, kryetari i institucionit suprem të revizionit të Republikës së Shqipërisë, udhëheqësi i departamentit ndërkombëtar të Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, realizuan takim me nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në takim u diskutua për strukturën sistematike dhe organizative të institucioneve të revizionit, bashkëpunimin me Kuvendin, si dhe praktikën e shqyrtimit të raporteve të revizorit në komisionet parlamentare dhe në seancën plenare në Dhomat Ligjvënëse.

INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË KOSOVËS

Me ftesën e Auditorës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Kryerevizori Shtetëror dhe Zëvendëskryerevizori Shtetëror bashkë me bashkëpunëtorët e tyre, qëndruan për vizitë zyrtare në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

Në takim të dy ISR-të i prezantuan rezultatet e arritura nga puna e vet, në krijimin e mjedisit kontrollues efektiv dhe mbrojtjen e mjeteve publike dhe bashkëpunimin me Kuvendin. Në të ardhmen

bashkëpunimi do të thellohet edhe më tej përmes shkëmbimit të përvojave dhe njohurive ndërmjet të dy institucioneve, me qëllim të ngritjes së nivelit të cilësisë së revizionit të jashtëm në menaxhimin me mjetet publike në të dy vendet.

INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË BULLGARISË

Institucionet Supreme të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë e përmbushën misionin e tyre për të qenë shembulli i parë dhe jashtëzakonisht i suksesshëm për të gjitha institucionet e tjera se si mund të arrihet bashkëpunimi i frytshëm përmes shkëmbimit të përvojës dhe njohurive profesionale.

Kryerevizorët shtetërorë shprehën kënaqësinë për rezultatet e arritura në kuadër të Tvinging Projektit "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare", pastaj duke theksuar se suksesi i arritur është rezultat i transparencës, ndershmërisë dhe sinqeritetit maksimal të kolegëve nga të dy ISR-të në shkëmbimin e njohurive dhe sfidave në punën e përditshme.

Njerëzit e parë të ISR-së nënshkruan Marrëveshje të Bashkëpunimit si vazhdimësi e asaj që ishte arritur dhe reflektim i bashkëpunimit afatgjatë. Format kryesore të bashkëpunimit do të jenë shkëmbimi i përvojave, organizimi i aktiviteteve për çështjet me interes të përbashkët, duke përfshirë konsultimet, seminarët, tryezat e rrumbullakëta, konferencat për problemet dhe sfidat kryesore në kryerjen e revizionit shtetëror, dhe planifikime të kryhen edhe revizionet paralele, të koordinuara dhe të përbashkëta.

INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË KROACISË

Kënaqësia nga bashkëpunimi dhe komunikimi i shkëlqyer për të cilën kujdesen të dy institucionet supreme të revizionit, si dhe implementimi i suksesshëm i aktiviteteve në kuadër të Tvinging Projektit, në të cilën ISR-ja e Kroacisë ishte partneri më i vjetër, vazhdoi edhe nëpërmjet organizimit të punësorive dypalëshe.

Shkëmbimi i përvojave, njohurive dhe diskutimeve aktive kontribuuan në forcimin e bashkëpunimit midis të dy ISR-ve dhe sigurimin e vlerës së shtuar në kryerjen e revizionit shtetëror. Në kuadër të punësorive dypalëshe u trajtuan më shumë tema dhe fusha të punës së revizionit:

- Dokumentet dhe planifikimet strategjike të revizioneve;
- Transparenca, llogaridhënia dhe komunikimi me palët e interesuara;
- Gjendjet e përcaktuara kryesore dhe rekomandimet e dhëna nga revizionet e kryera të suksesit;
- Revizioni i masave të ndërmarra sipas rekomandimeve të dhëna të përmbajtura

në Raportet Përfundimtare të Revizorit – revizionet follow up;

- Revizioni i prokurimeve publike dhe gjetjet më të shpeshta;
- Sfidat dhe rreziqet gjatë revizionit të përdoruesve të buxhetit të shtetit dhe revizionet financiare në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe partitë politike;
- Roli i revizorëve në rastet e mashtrimit ose mashtrimit të mundshëm ose për të cilën dyshohet gjatë revizionit me theks të veçantë të kufizimit të përgjegjësisë së revizionit;
- Etika dhe inteligjenca artificiale, çështjet dhe nismat dhe
- Risitë në funksionimin e të dy institucioneve dhe informimi për kryerjen e revizionit shtetëror.

Secili nga pjesëmarrësit pati mundësinë të fitonte njohuri të reja rreth fushave të caktuara të revizionit. Nga punëtoritë e mbajtura dolën konkluzione të shumta, por edhe kënaqësi nga bashkëpunimi dhe komunikimi i shkëlqyer për të cilën u kujdesën të dy institucionet supreme të revizionit.

NISMA PËR ZHVILLIM TË INTOSAI



Delegacioni i Entit Shtetëror të Revizionit, në kuadër të vizitës së ISR-së së Norvegjisë, mbajti edhe takim pune me drejtorin e përgjithshëm të Nismës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI), për shqyrtimin e mundësive për bashkëpunimin e mëtejshëm dhe mbështetjen e nevojave për zhvillimin profesional të Entit Shtetëror të Revizionit.

Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2023 iu bashkëngjiti programit të pionierëve LOTA, i cili ka për qëllim afrimin dhe përfshirjen e teknologjisë në botën e revizionit të ISR-ve nëpërmjet analizave të procesit të revizionit dhe zhvillimit të strategjisë për shfrytëzimin e teknologjisë në revizionet dhe revizionit të përdorimit të teknologjisë nga ana e qeverive.

INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË GJERMANISË



Në qershor 2022, Delegacioni i ESHR-së i kryesuar nga Kryerevizori Shtetëror dhe Zëvendëskryerevizori Shtetëror realizoi takim dypalësh me kryetarin e Institucionit Suprem të Revizionit të Gjermanisë.

Në takimin e punës, përfaqësuesit e të dy ISR-ve diskutuan dhe shkëmbyen praktika në shumë tema dhe fusha në kontekst të mandatit, rolit dhe fushëveprimit të ISR-ve, digjitalizimin e proceseve të revizionit nëpërmjet përdorimit

të teknologjive bashkëkohore dhe të reja dhe diskutuan për bashkëpunimin e përbashkët në të ardhmen të të dy institucioneve të revizionit dhe shkëmbimin e praktikave të mirë.

Si aktivitet afatshkurtër kryesor ndërmjet të dy institucioneve të revizionit u përkufizua komunikimi i ndërsjellë ndërmjet ISR-së dhe Kuvendit dhe shqyrtimi i raporteve përfundimtare të revizorit.

KËSHILLI NDËRKOMBËTAR I REVIZORËVE I NATO-S



Me marrjen e statusit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si anëtare e plotfuqishme e NATO-s, ESHR-ja si Trup Kompetent Kombëtar i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me përfaqësuesit e tij është ftuar dhe mori pjesë në takimin e Këshillit Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s.

Në qershor 2022, ESHR-ja për herë të tretë me përfaqësuesit e tij kombëtarë së bashku me 29 përfaqësuesit e tjerë kombëtarë të Trupave Kompetentë Kombëtarë të Revizionit që janë anëtarë të NATO-s, mori pjesë në takimin ku u shqyrtua Raporti Vjetor i veprimtarisë për Këshillin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s për vitin 2021, por diskutuan edhe për çështjet e revizionit me interes të përbashkët për pjesëmarrësit.

Aktivitetet e tjera ndërkombëtare

Në analizën krahasuese "Nisma e Transparencës për Ballkanin Perëndimor – Fokusimi në COVID-19 dhe shpenzimet për rimëkëmbjen", të përgatitur në kuadër të Nismës për Transparencë në Ballkanin Perëndimor, i zbatuar në kuadër të aktivitetit të nismës për qeverisje të mirë dhe fond të besueshëm për reformën e klimës së investimeve, u përfshin Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Qëllimi i kësaj nisme është të mbështesë qeveritë në Ballkanin Perëndimor në identifikimin e mundësive për të forcuar praktikën e transparencës fiskale gjatë situatave të jashtëzakonshme.

Në analizë ESHR-ja është theksuar si institucion rajonal për shembull të mirë, i cili nëpërmjet ndryshimeve urgjente në revizionet e planifikuara, arriti t'u përgjigjet sfidave të krizës. Si përgjigje të shpejtë ndaj pandemisë globale, ESHR-ja në mënyrë proaktive e ndryshoi Programin e vet Vjetor të Punës, ende përpara se të miratohej vendimi i parë për gjendjen e jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të përfshijë dy revizione të pajtueshmërisë të fokusuar në përgjigjen e Qeverisë ndaj COVID-19. Kjo praktikë ka vazhduar edhe me Programin e ri Vjetor të Punës së ESHR-së, në të cilin u përfshin 4 revizione në lidhje me masat e miratuara për ballafaqimin me krizën e COVID-19.

4.1

AKTIVITETET E PROJEKTIT

TVINING PROJEKTI "PËRMIRËSIMI I REVIZIONIT TË JASHTËM DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE"

Enti Shtetëror i Revizionit i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Revizionit të Republikës së Kroacisë si partner i vjetër dhe Institucionin Suprem të Revizionit të Republikës së Bullgarisë, si partner i ri, më 31 tetor 2022 e realizuan Tvinging Projektin "Përmirësimi i Revizionit të Jashtëm dhe Mbiqëqyrja Parlamentare".

Projekti i theksuar filloi të zbatohet më 1 shkurt 2021, ndërsa vlera e projektit është 1,5 milion euro dhe financohet nga fondet IPA 2018 të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i Tvinging Projektit është të përmirësojë efikasitetin dhe ndikimin e revizionit të jashtëm nëpërmjet harmonizimit të kornizës juridike dhe zhvillimin e mjeteve metodologjike, si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të ESHR-së për kryerjen efikase të revizionit të jashtëm. Përveç kësaj, projekti ka për qëllim të përmirësojë kontrollin parlamentar mbi mjetet publike dhe të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Aktivitetet e Tvinging Projektit janë organizuar dhe strukturuar në katër komponentë.



TVINING PROJEKTI MK 18 IPA FI 03 20

"Përmirësimi i Revizionit të Jashtëm dhe Mbiqëqyrja Parlamentare".

Buxheti 1.500.000 euro

21 muaj | 02.2021 - 10.2022

Forcimi i kornizës juridike relevante për revizionin e jashtëm dhe përmirësimi i planifikimit vjetor dhe strategjik të ESHR-së;

1

Përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe proceseve të revizionit të jashtëm;

2

Përmirësimi i funksionit të kontrollit legjislativ të Parlamentit të bazuar në shqyrtimin dhe diskutimin e raporteve të revizionit të ESHR-së;

3

Përmirësimi i komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe TI-së dhe kapacitetet e revizionit të TI-së.

4

Të gjithë punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit u përfshin në realizimin e aktiviteteve të tvingut në kuadër të komponentëve dhe zbatimit të pilot-revizioneve, me çka u mundësua të fitojnë njohuri për praktikat evropiane në zbatimin e revizionit.

Rezultatet dhe aktivitetet e arritura në kuadër të Tvinging Projektit u prezantuan në konferencën e mbajtur më 17 tetor 2022 në Shkup. Në të u prezantuan përmirësimet e akteve legjislative, strategjike dhe metodologjike të ESHR-së, si dhe mësimet e nxjerra nga pilot-revizionet dhe mjetet e komunikimit.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryerevizori Shtetëror në konferencën finale të Tvinging Projektit të mbajtur më 21 tetor 2022, nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtij Memorandumi është të vendosë marrëdhënie profesionalisht të qëndrueshme ndërmjet Kuvendit dhe Entit Shtetëror të Revizionit në drejtim të rritjes së mbikëqyrjes së shpenzimit të mjeteve publike dhe llogaridhënies më të madhe të institucioneve që financohen nga buxheti i shtetit.

Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së në vend, përfaqësuesit e subjekteve të reviduara, organizata civile dhe media, si palë të interesuara me të cilët bashkëpunon dhe komunikon Enti Shtetëror i Revizionit. Aktivitetet dhe rezultatet e Tvinging Projektit janë të përfshira në Raportin Përfundimtar i cili është dorëzuar dhe miratuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE DHE FORCIMIN E GRAVE



Enti Shtetëror i Revizionit dhe Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Forcimin e Grave (UN Women) edhe në vitin 2022 vazhduan me zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit, me qëllim që të dyja palët të bashkëpunojnë në avancimin e zbatimit të detyrimeve për barazinë gjinore në përputhje me ligjet dhe politikat nacionale, si dhe detyrimeve të ndërmarra ndërkombëtare dhe promovimit të përgjegjësisë gjinore dhe menaxhimit me mjetet publike dhe llogaridhënien nëpërmjet zbatimit sistematik të buxhetimit me përgjegjësi gjinore si mjet për krijimin e politikave. Në drejtim të plotësimit të qëllimeve të përcaktuara, UN Women siguroi mbështetje për revizorët shtetërorë për pjesëmarrjen në punëtoritë brenda dhe jashtë vendit, por edhe mbështetjen në zbatimin e revizionit të suksesit "Efektiviteti i masave të Qeverisë për barazinë gjinore dhe nismat buxhetore gjinore përkatëse" dhe përgatitjen e udhëzimeve metodologjike për revizionin e barazisë gjinore. Për të përfshirë perspektivën gjinore në revizionet e suksesit nëpërmjet shkëmbimit të përvojës dhe praktikave të mirë, revizorët shtetërorë morën pjesë në vizitën studiu në Zyrën Kombëtare të Revizionit të Suedisë dhe ministrive përkatëse resore në vend. Dy revizorë shtetërorë morën pjesë në trajnimin me temë "Barazia Gjinore dhe Ekonomia", të zbatuar nga Qendra për Trajnim të UNWOMEN.

Në konferencën rajonale në Stamboll, Turqi "Financimi transformues për avancimin e barazisë gjinore", Kryerevizori Shtetëror ndau përvojën dhe

praktikën e mirë të ESHR-së në zbatimin e revizionit gjinor të suksesit. Në punëtoritë e shumta të organizuara në Kosovë dhe Shqipëri, revizorët shtetërorë ndanë përvojat dhe praktikatat e tyre të mira nga zbatimi i revizionit të parë gjinor të suksesit në vendin tonë.

Delegacioni i ESHR-së, i kryesuar nga Kryerevizori Shtetëror, mori pjesë në takim rajonal në Banja Llukë, BeH, ndërmjet ISR-ve të Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, me qëllim të përcaktimit të mundësisë së zbatimit të revizionit paralel për barazinë gjinore në rajon.

Enti Shtetëror i Revizionit është një nga institucionet në të cilat ekziston shkallë e lartë e balancimit gjinor, si në menaxhimin e Institucionit, ashtu edhe ndërmjet revizorëve të autorizuar shtetërorë.

PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA



Enti Shtetëror i Revizionit me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në mars 2022 nënshkroi Memorandum të Mirëkuptimit me të cilën janë përkufizuar një sërë aktivitetesh që do të zbatohen në dy vitet e ardhshme. Me mbështetjen e UNDP-së, në vitin 2022 janë organizuar një sërë trajnimesh në fushën e:

- revizionit të raporteve financiare të bazës së llogaritur,
- llojeve të personaliteteve, komunikimit dhe kohezionit ekipor, me fokus në tipologjinë MBTI të personalitetit,

→ trajnimit për përgatitjen dhe revizionin e raporteve financiare nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe

→ sistemit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Me ftesë të Zyrës së Pavarur të Vlerësimit të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, në tetor 2022 Kryerevizori Shtetëror, mori pjesë në konferencën e Kapaciteteve Kombëtare për Vlerësim me temë "Sistemet rezistuese të vlerësimit për zhvillim të qëndrueshëm", e cila u mbajt në Torino të Italisë. Në konferencë, Kryerevizori Shtetëror mori pjesë aktive në punëtorinë e 11-të e cila u fokusua në metodologjinë e vlerësimit të Zyrës së Pavarur të Vlerësimit të UNDP-së, si zyra më e madhe e vlerësimit në sistemin e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Në kuadër të konferencës vjetore për decentralizimin dhe qeverisjen lokale me temë "Vetëqeverisja lokale - koha për mundësi dhe revizion", të organizuar nga UNDP-ja në partneritet me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Kryerevizori Shtetëror mori pjesë dhe ishte panelist në këtë ngjarje. Në fjalën e tij theksoi se ESHR-ja si institucion suprem i revizionit në vazhdimësi i thekson dobësitë sistematike në fushën e funksionimit dhe punës së NJVL-së dhe në periudhën e ardhshme pret të respektohen dispozitat ligjore të miratuara në pjesën e financimit të pushtetit lokal dhe financimit të kompetencave të bartura, duke pasur parasysh të dhënat reale, si dhe investimet serioze të burimeve njerëzore në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

FONDACIONI PËR DEMOKRACI VESTMINSTER NË VEND



Enti Shtetëror i Revizionit, Fondacioni për Demokraci Vestminster (VFD), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit të Komonuelthit Britanik edhe në vitin 2022 vazhduan me implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar. Me Memorandumin e theksuar është paraparë mbështetja në zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së për vitet 2020 – 2023, dhe zbatimi i projektit të titulluar “Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni përmes përmirësimit të zbatimit të rekomandimeve të ESHR-së”, të mbështetur nga Qeveria Britanike. Aktivitetet i referohen zbatimit të aktiviteteve të mbetura nga projekti për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së për vitet 2020 – 2023, duke u fokusuar në komunikimin dhe bashkëpunimin e ESHR-së me institucionet kompetente dhe organizatat joqeveritare.

Në këtë drejtim në vitin 2022, me qëllim të përmirësimit të komunikimit dhe bashkëpunimit të ESHR-së me institucionet kompetente siç është Prokuroria Publike, janë organizuar më shumë punëtori në të cilat janë prezantuar rezultatet e arritura të punës së ESHR-së dhe revizioneve të kryera, u shkëmbyen praktika dhe përvoja të mira, dhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve.

Në ngjarjen e mbajtur, Kryerevizori Shtetëror përpara përfaqësuesve të mediave nga televizionet kombëtare dhe portalet e internetit i prezantoi gjendjet kryesore të përcaktuara në Raportin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, të publikuar në faqen e internetit të ESHR-së. Krahas gjendjeve

kryesore të përcaktuara, përfaqësuesit e mediave, u njohën edhe me llojet e revizioneve, strukturën e raporteve të revizorit, si dhe me proceset e komunikimit të ESHR-së në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në funksionim.

Duke njohur rëndësinë dhe ndikimin e revizioneve të kryera të suksesit, VFD siguroi edhe mbështetje profesionale në kryerjen e revizioneve të suksesit në fushën e energjetikës, zhvillimin e barabartë rajonal dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, dhe të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Enti Shtetëror i Revizionit në bashkëpunim me Fondacionin mbajti panel-diskutim me temë “Të ardhurat personale të komunave për sigurimin e shërbimeve cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”. Fokusi i këtij paneli iu kushtua prezantimit të rezultateve nga hulumtimi i kryer për mendimin publik për cilësinë e shërbimeve të komunave në kushtet e pandemisë, të përgatitur për nevojat e ESHR-së. Në panel-diskutim, të pranishmit shkëmbyen mendime dhe informacione lidhur me funksionimin efikas të komunave në kushtet e pandemisë dhe sigurimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Për përmirësimin e vizualizimit dhe avancimit të aktiviteteve të revizionit të ESHR-së, janë përgatitur 4 video-klipe të cilat do të ngarkohen në kanalën YouTube të ESHR-së, në të cilin është prezantuar puna e ESHR-së, por edhe mbështetja në pjesën e prezantimit të raporteve të revizorit. Në drejtim të forcimit të aftësive për fjalimin publik dhe paraqitjen në media, punonjësit e ESHR-së morën pjesë në punëtorinë për fjalimin publik dhe marrëdhëniet me publikun, në të cilën u njohën me sfidat thelbësore në komunikimin me mediat dhe gazetarët hulumtues.

Në mbledhjet e punës u diskutuan dhe u shkëmbyen mendimet dhe përvojat mbi shembujt konkretë të komunikimit me mediat, lajmet e rreme dhe PR-në e krizës si mjet për të mbrojtur institucionin prej tyre, dhe u prezantuan edhe këshillat praktike për të folur më mirë në publik dhe paraqitjen në mediat. Menaxhmenti dhe revizorët e Entit Shtetëror të Revizionit patën mundësinë që nëpërmjet ushtrimit për incizimin e deklaratës, të forcojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre për të folur në publik dhe paraqitjen në mediat me qëllim që prezantimi të jetë më cilësor i rezultateve dhe aktiviteteve të revizionit nga kryerja e revizionit shtetëror me të cilën arrihet vlera e shtuar në shoqëri.

BASHKËPUNIMI ME ZYRËN E REVIZORIT KRYESOR TË NORVEGJISË



Në drejtim të vendosjes së bashkëpunimit institucional me interes të përbashkët ndërmjet të dy institucioneve, Kryerevizori Shtetëror dhe Kryerevizori i Norvegjisë nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit, që është bazë për vendosjen e bashkëpunimit pesëvjeçar duke siguruar ndihmë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të Entit Shtetëror të Revizionit, në bazë të parimeve dhe standardeve për profesionalizimin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI) dhe Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit (EUROSAI).

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është forcimi i kapaciteteve të ESHR-së për plotësimin e mandatit të tij

dhe për kryerjen e revizioneve me cilësi të lartë me çka do të promovojë transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë në menaxhimin me mjetet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bashkëpunimi do të përfshijë sektorë dhe lloje të ndryshme të revizioneve ku Zyra e Kryerevizorit të Norvegjisë ka kapacitete relevante dhe mund t'ia shtojë vlerën punës së ESHR-së, veçanërisht në pjesën e revizionit të suksesit, vendosjen e laboratorit të inovacionit për gjetjen e metodave dhe mjeteve softuerike për mbledhjen, analizimin dhe paraqitjen e të dhënave në revizionet, modernizimin e proceseve të punës përmes përmirësimit dhe lidhjes së sistemeve digjitale për mbështetjen dhe menaxhimin me proceset dhe zhvillimin e revizioneve të TI-së, zbatimin e vetëvlerësimit të sistemit të integritetit me zbatimin e metodologjisë së INTOSAI-t.

INSTITUTI KOMBËTAR PËR DEMOKRACI



Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI), në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes së mjeteve publike përmes tranzicionit të liderit", të financuar nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci (NDI), në vitin 2022, revizorët shtetërorë patën mundësinë të shkëmbejnë përvoja dhe praktika të mira në mbikëqyrjen e mjeteve publike nga ana e pushtetit ligjvënës dhe bashkëpunim me revizionin shtetëror në nivel qendror dhe lokal në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

INSTITUTI I AUTORIZUAR PËR FINANCAT PUBLIKE DHE

KONTABILITET DHE QENDRA PËR EKSELENCË NË FINANCA



Përfaqësuesit e ESHR-së me ftesë të **Institutit të Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitet (CIPFA) dhe Qendrës për Ekselencë në Financa (CEF)** morën pjesë në konferencën e dytë ndërkombëtare për financat publike, në Tiranë, Shqipëri. Konferenca rajonale paraqet mundësi të shkëlqyer për shkëmbimin e njohurive, përvojës, praktikave të mira dhe rekomandimeve për kontabilistët dhe revizorët nga sektori publik. Menaxhimi me ndryshimet, transformimi dhe vendimmarrja për sistemet e menaxhimit, me fokus të veçantë në sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve publike, ishte fokusi i kësaj konference.

Enti Shtetëror i Revizionit i përfaqësuar nga Kryerevizori Shtetëror, Instituti i Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitet nga Londra i përfaqësuar nga kryetari Majk Drajver dhe Qendra për Ekselencë në Financa nga Sllovenia të përfaqësuar nga drejtoresha Jana Repanšek, në qershor 2022 gjatë Konferencës së Dytë Ndërkombëtare për Financat Publike nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit, me të cilën u vendos baza formale për bashkëpunim për realizimin e aktiviteteve të orientuara në avancimin e përpjekjeve të përbashkëta për

menaxhimin e mirë me financat publike dhe qeverisjen e mirë, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira për përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve të nëpunësve dhe institucioneve publike, veçanërisht në fushën e parandalimit, nëpërmjet krijimit të kornizës efikase për menaxhimin me rrezikun nga korrupsioni. Me qëllim të realizimit të misionit të përbashkët në vitin 2022, në hapësirat e ESHR-së, Kryerevizori Shtetëror realizoi takim me përfaqësuesit e Institutit të Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitet dhe përfaqësuesit e Qendrës për Ekselencë në Financa.

Në drejtim të rritjes së njohurive, aftësive dhe kapaciteteve të revizorëve shtetërorë, në vitin 2022 u zbatua punëtorja me temë "Sfidat e zakonshme gjatë implementimit të standardeve të INTOSAI-t", ndërsa dy punonjës në mënyrë aktive morën pjesë në grupin e punës së CIFTA-së për përgatitjen e programit të ri për certifikim për zbatimin e revizionit të suksessit.

Bashkëpunimi në periudhën e ardhshme do të thellohet përmes shkëmbimit të përvojave dhe njohurive mes institucioneve, ndër të tjera edhe në pjesën e trajnimit dhe certifikimit të revizorëve shtetërorë për parandalimin e rrezikut nga korrupsioni.

4.2 INTEGRIMI NË BE

Në korrik 2022, BE-ja filloi fazën hyrëse të negociatave të aderimit me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të vendimit konfirmues të miratuar nga ana e Këshillit të Evropës në vitin 2020 dhe kornizës së aprovuar për negociata nga korriku 2022, e cila është në përputhje me Metodologjinë e reviduar për negociata.

Në vitin 2022 Enti Shtetëror i Revizionit i ka caktuar përfaqësuesit e saj si anëtarë në grupe pune për fusha dhe kapituj të veçantë në përputhje me Vendimin për themelimin e strukturës për negociata të aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian dhe Vendimin për përcaktimin e institucioneve, përfaqësuesit e të cilëve janë pjesë e grupeve të punës për përgatitjen e pozitive negociuese për negociatat e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Skriningu dypalësh është hapi i parë në procesin e negociatave të aderimit me BE-në, me të cilin u mundëson vendeve candidate të njoftohen me ligjet dhe standardet e BE-së dhe me detyrimet që rrjedhin prej tyre, si dhe me nivelin e gatishmërisë së vendit dhe planet e ardhshme për pajtueshmëri të mëtejshme.

Skriningu është operacion formal që vlerëson shkallën e pajtueshmërisë së legjislacionit kombëtar me të drejtën e BE-së, strukturën institucionale për zbatimin e ligjeve dhe planeve për harmonizim të mëtejshëm, ndërtimin e kapaciteteve institucionale, si dhe burimet e nevojshme njerëzore financiare dhe TI-së së nevojshme për zbatimin e standardeve evropiane, si dhe për të identifikuar fushat/çështjet për të cilat është e nevojshme periudha e tranzicionit.

Me qëllim për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate kësaj sfide, punonjësit e Entit Shtetëror të Revizion-

it, morën pjesë në një sërë trajnimesh, takimesh shpjeguese dhe përgatitore, të orientuar drejt mbështetjes dhe përgatitjes së skringut dypalësh.

Klasteri Vlerat Fundamentale, si klasteri i parë dhe më i rëndësishmi i përfshin pesë kapitujt e lidhur me sundimin e së drejtës:

- Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat fundamentale;
- Kapitulli 24 - E drejta, liria dhe siguria;
- Kapitulli 5 - Prokurimet publike;
- Kapitulli 18 - Statistika;
- Kapitulli 32 - Kontrolli financiar, por edhe
- Fushat e funksionimit të institucioneve demokratike dhe reformat në administratën publike dhe menaxhimi me financat publike.

Enti Shtetëror i Revizionit është i përfshirë në mënyrë aktive në disa fusha dhe kapituj dhe kontribuoi në skringun dypalësh për fusha dhe kapituj të veçantë

Pjesëmarrja e Entit Shtetëror të Revizionit në skringjet dypalëshe në Bruksel ishte e rëndësishme veçanërisht në lidhje me:

Kapitullin 32

kontrolli financiar

Enti Shtetëror i Revizionit i kryesuar nga Kryerevizori Shtetëror prezantoi rezultatet e arritura nga puna, harmonizimin e punës së ESHR-së me standardet ndërkombëtare të ISR-ve, praktikat më të mira dhe planet afatshkurtra dhe afatgjata, siç janë rregul-

limi i ESHR-së si kategori kushtetuese dhe miratimi i Ligjit të ri për revizionin shtetëror.

Gjyqësori, të drejtat fundamentale dhe sundimi i së drejtës

ESHR-ja i prezantoi kapacitetet e veta institucionale, aktivitete të cilat i ndërmerr në luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e përfshira në luftën kundër korrupsionit. ESHR-ja është një nga institucionet kryesore në sektorin publik në luftën kundër korrupsionit. Në skringing u prezantuan rezultatet e revizioneve të kryera dhe aktivitetet e ndërmarra nga ESHR-ja në fushën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Funksionimi i institucioneve demokratike

Si revizion i jashtëm i pavarur, objektiv dhe paanshëm, ESHR-ja i prezantoi përvojat e revizioneve të partive politike për llogaritë e funksionimit të rregullt dhe revizionet për financimet e fushatave zgjedhore, në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit.

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e përcaktuara me Ligjin për revizionin shtetëror, në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 në fushën e reformës së administratës publike si pjesë e procesit të negociatave në kuadër të Klasterit – Vlerat Fundamentale, Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit në lidhje me aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente për zbatimin efikas të Strategjisë për reforma në administratën publike për vitet 2018-2022, me të cilin u jepen rekomandime institucioneve kompetente për promovimin dhe realizimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të planifikuara në Strategjinë e re për reforma në administratën publike. Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer edhe revizionin e suksesit me temë "Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit për vitet 2017-2022 dhe zbatimin të planit të veprimit të strategjisë", në përputhje

me Programin Vjetor të ESHR-së për vitin 2022, me të cilat janë dhënë rekomandime që duhet të kontribuojnë në përmirësimin e zbatimit të planit të veprimit nga Strategjia 2017-2022, si dhe për hartimin e Strategjisë dhe planit të veprimit të ri 2023-2027 në drejtim të realizimit të suksesshëm të qëllimeve të përcaktuara strategjike për reformat në sektorin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe uljes së korrupsionit, në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe merr pjesë në realizimin e Programit Kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 23 Gjyqësori dhe të drejtat fundamentale, Fusha - Politika kundër korrupsionit dhe Kapitulli 32 Kontrolli financiar, Fusha - Revizioni i jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjera për parandalimin e korrupsionit.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesë e familjes së organeve të tjera shtetërore të cilat e përbëjnë "Trupin ndërrësor për koordinimin e aktiviteteve kundër korrupsionit". Ky trup ka për obligim t'i koordinojë aktivitetet e të gjitha organeve kompetente për luftën kundër korrupsionit, për të forcuar bashkëpunimin e ndërsjellë dhe raportimin reciprok, për shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave dhe për realizimin e rekomandimeve të përfshira në raportet e GREKO-s për Këshillin e Evropës dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

A large, bold, yellow number '5' is the central graphic element of the page. It is positioned on the left side, with its right edge extending towards the center of the page. The number is solid yellow and has a thick, uniform stroke.

**REVIZIONET
E KRYERA**

REVIZIONI PËRMES NUMRAVE PROGRAMIN VJETOR PËR PUNËN E ESHR-SË PËR VITIN 2022

205	12	6
Raportet e revizorit për revizionin e rregullshmërisë	Raportet e revizorit për revizionin e suksesit	Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
4	2	223
Revizioni i mjedisit jetësor	Revizioni i TI-së	Raportet e revizionit të dorëzuar Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
22	26	139
Raportet e revizionit të dorëzuar Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut	Raportet e revizionit të dorëzuar te Zëvendëskryetarja e Qeverisë e ngarkuar për politikat e qeverisjes së mirë	Raportet e revizionit të dorëzuar Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit sipas detyrës zyrtare në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Zgjedhor për nenin 85-b
1	1	1
Raportet e revizionit të dorëzuar Këshillit Gjyqësor	Raportet e revizionit të dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme	Raportet e revizionit të dorëzuar Ministrisë së Financave – Drejtoria e policisë financiare
5	333	1.242¹³
Raportet e revizionit të dorëzuar Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit	Subjektet e përfshira me revizion	Gjetjet dhe pyetje në raportet e revizionit
775	441.508	284.839
Rekomandimet në raportet e revizionit	Të hyrat publike të përfshira me revizion (në milion denarë)	Shpenzimet publike të përfshira me revizion (në milion denarë)

13 Në numrin e gjetjeve dhe çështjeve në raportet e revizionit janë përfshirë edhe 17 çështje të mbetura të cilat përsëriten në raportet përfundimtare të revizionit për të gjithë 141 pjesëmarrës në fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale në 2021, 1 çështje e mbetur është përfshi në raportin përfundimtar të revizionit të 19 pjesëmarrës në fushatën zgjedhore – koalicionet zgjedhore dhe 1 çështje e mbetur është përfshirë në raportin përfundimtar të revizionit për një pjesëmarrës në fushatën zgjedhore – gripi i zgjedhësve.

32	48	106.201
Janë kryer kontrolle për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up)	Janë lëshuar raportet për kontrollet e zbatuara për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up)	Aktiva/pasiva e reviduara nga Bilanci i gjendjes (në milion denarë)
1.464	441	2.341
Kompensimet e papaguara/ më pak të paguara/ tatimet publike në Buxhetin e shtetit (në milion denarë)	Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara (në milion denarë)	Përdorimi i mjeteve në kundërshtim me ligjin (në milion denarë)
6.089	2.953	987
Shuma totale e prokurimeve publike (në milion denarë)	Përfshirja e prokurimeve publike me revizion (në milion denarë)	Shuma totale nga parregullsitë e konstatuara te prokurimet publike (në milion denarë)
139	602	9.716
Janë kryer prokurime për të cilat nuk është zbatuar procedura për prokurime publike (në milion denarë)	Regjistrimi i zërave korrektuese në Bilancin e gjendjes (në milion denarë)	Gjendjet përcaktuese të cilat ndikojnë në veprimtarinë e subjektit lëndë të revizionit dhe investimet kapitale (në milion denarë)
246	6.304	33
Grante të anuluar/të humbura (në milion denarë)	Anulim/ndalim i granteve për investim[hua të miratuara por jo të tërhequra/kredi/grante] (në milion denarë)	Provizione të paguara për mjetet e patërhequra nga kredit/huat (në milion denarë)



REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

223
RAPORTE TË
REVIZIONIT


OPINIONE TË
REVIZIONIT
REVIZIONI I
RREGULLSHMËRISË

KONKLUZIONE
REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË/
REVIZIONI I SUKSESIT

205 opinione për raportet financiare



196 opinione për pajtueshmëri me rregulla dhe ligje⁴



6 konkluzione për revizionin e pajtueshmërisë

12 konkluzione për revizionin e suksesit

2 konkluzione për revizionin e TI-së

4 konkluzione për revizion të mjedisitë jetësor

145

Parti Politike dhe pjesëmarrës në fushatë zgjedhore – Zgjedhjet Lokale 2021

1.242 ⚠️
GJETJET DHE PYETJET TË DEDIKUARA ME REVIZION

333

SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

86

DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET TE PROKURIMET PUBLIKE

- 903 Revizione të rregullshmërisë
- 215 Revizione të suksesit
- 98 Revizione të pajtueshmërisë
- 26 Revizione të TI-së

- 25 Revizione të rregullshmërisë
- 151 Revizione të suksesit
- 6 Revizione të pajtueshmërisë
- 6 Revizione të TI-së

VLERA E PËRGJITHSHME E KONTRATAVE TË NDARA PËR PROKURIMET PUBLIKE

6.089.138

(në 000 denarë)

PROKURIME PUBLIKE TË REVIDUARA

2.953.311

(në 000 denarë)

986.970 ⚠️
PARREGULLSI TË KONSTATUARA TE PROKURIMET PUBLIKE

(në 000 denarë)

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura në bazë të prokurimeve publike;
- procedura të pa zbatuara të prokurimeve publike
- dobësi në planifikimin e prokurimeve publike
- parregullsi gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit/specifikime teknike
- dobësi në miratimin e vendimeve për prokurimet publike
- elemente të kufizuara të përfshira në dokumentacionet e tenderit në lidhje me konkurrencën

14 Numri i mendimeve për pajtueshmërinë me rregullat dhe ligjet është më i vogël në krahasim me numrin e raporteve financiare, duke pasur parasysh se në raportet përfundimtare të revizionit për revizionin e kryera të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë për llogaritë e të ardhurave të buxhetit të dotacioneve [930] për 8 NJVL dhe Qytetin e Shkupit, mendimi dhe pajtueshmëria me rregullat dhe ligjet sipas përdoruesve shprehet në raportet e revizionit gjatë revizionit të përdoruesit adekuat të dotacioneve me dedikim.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022 në të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme publike të reviduara të cilat janë shfaqur në grafikon më poshtë, janë përfshirë edhe të hyrat publike në shumë prej 9.793 milion denarë dhe shpenzime publike 9.667 milion denarë, të cilat i referohen personave juridik në të cilat shteti është pronari që dominon (SHA MEPSO), ndërmarrje publike dhe institucione tjera.

Gjithsej **411.508 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **284.839 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022

Në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, janë ulur shumat e të ardhurave publike të reviduara të përfshirë me revizionin e suksesit dhe revizionin e pajtueshmërisë, por prapë është realizuar rritje të të ardhurave publike të reviduara te:

- Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për rreth **9.700 milion denarë**,
- Buxhetet e njërive të vetëqeverisjes lokale për mbi **9.000 milion denarë**,
- Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për **263 milion denarë**, që është për një të tretën më shumë se viti i kaluar; dhe
- Partitë politike për punën e rregulltë dhe pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore – Zgjedhjet Lokale 2021 për **370 milion denarë** që është dy herë më shumë se vitin e kaluar.

Në bazë të totalit të shpenzimeve publike të reviduara, shohim një rritje të konsiderueshëm prej 49.000 milion denarë që është mbi 20% më shumë në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021. Në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, janë të vërejtur rritje të konsiderueshme të shpenzimeve publike të reviduara tek disa lloje të subjekteve që ndikojnë në rritjen totale të shpenzimeve publike të reviduara dhe atë te:

- Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për **67.000 milion denarë**, që është 6 herë më shumë në krahasim me vitin e kaluar;
- Buxhetet e njërive të vetëqeverisjes lokale për **8.700 milion denarë**, që është për 4 herë më shumë se vitin e kaluar;
- Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për **241 milion denarë**, që është për një të tretën më shumë se vitin e kaluar; dhe
- Partitë politike për punën e rregulltë dhe pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore – Zgjedhjet Lokale 2021 për **440 milion denarë** që është që është gati 2.5 herë më shumë se vitin e kaluar.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E REVIDUARA

Gjithsej **411.508 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **284.839 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022

	Të ardhurat e reviduara publike	Shpenzimet e reviduara publike
Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	227.343 217.686	79.847 12.693
Buxhetet e fondeve	123.039 121.805	115.742 115.718
Buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale	12.515 3.393	11.536 2.829
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së	1.045 782	1.014 773
Partitë politike	766 397	734 294
Ndërmarrjet publike	1.659 1.744	1.709 1.953
Institucionet tjera/Personat juridik në të cilat shteti është aksioner	8.134 13.939	7.958 15.220
Të përfshira me revizionin e pajtueshmërisë	35.322 94.878	63.063 79.558
Të përfshira me revizionin e suksesit	1.685 57.299	3.236 7.022

Përfshirja e shpenzimeve të reviduara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 është 82%, që është për 2% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Në strukturën e shpenzimeve të reviduara, janë përfshirë shpenzimet me revizionin e rregullshmërisë në vlerë prej 197.337 milion denarë gjegjësisht 77%, shpenzime me revizionin e suksesit të zbatuar në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021 dhe 2022

në vlerë totale prej 11.645 milion denarë gjegjësisht 4% dhe shpenzime me revizion të pajtueshmërisë në vlerë prej 2.423 milion denarë gjegjësisht 1%.

Në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, është vërejtur rritja e përfshirjes së shpenzimeve të reviduara të Buxheteve të Njësive të Vetëqeverisjeve Lokale që është 31%, në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 9%.

PËRFSHIRJA E BUXHETEVE NËPËRMJET SHPENZIMEVE TË REVIDUARA


Shpenzimet e reviduara sipas llojet e buxheteve (në milion denarë)	Buxhet i kryer për 2021	Të reviduar	Pjesëmarrja në %%
1	2	3	4
Shpenzimet e buxhetit të shtetit për vitin 2021 (Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për 2021 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.250/2022)	256.906	211.405	82
Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale	36.936	11.536	31

REKOMANDIMET DHE ZBATIMI I TYRE

Në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të informojë ESHR-në dhe organin përgjegjës për mbikëqyrje dhe kontroll, për masat e ndërmarra në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në raportet e revizionit në afat prej 90 ditëve nga

pranimi i raportit përfundimtar. ESHR-ja e ndjek zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, kontrolle dhe revizione mbi zbatimin e rekomandimeve, si dhe përmes informacionit të marrë nga subjektet.

2022



5.1 | VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

Me Programin Vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 janë përcaktuar aktivitete me prioritet në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe detyrave për punën e Entit Shtetëror të Revizionit, respektivisht realizimit të qëllimeve strategjike të institucionit.

Aktivitetet e ndërmarra për realizimin e qëllimeve strategjike sigurojnë përfshirje përkatëse të mjeteve publike të reviduara, rritjes së njohurive dhe aftësive të punonjësve, kryerjen e revizioneve të suksesit të programeve dhe projekteve të ndryshme që janë në funksion të realizimit të llogaridhënies dhe menaxhimit të mirë, rishikimit të rezultateve në bazë të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të sektorit publik, informimi i opinionit dhe palëve të interesuara për gjendjet e përcaktuara në raportet përfundimtare të revizionit.

Rezultatet kryesore nga puna e Entit Shtetëror të Revizionit në vitin 2022 përbëhen nga:

- mbështetja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e kompetencave të tij nëpërmjet identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të paligjshme të punës dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit;
- dhënia e rekomandimeve të qarta dhe efektive për institucionet shtetërore dhe të tjera nga sektori publik në avancimin e menaxhimit me mjetet publike;
- duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së përdorimit të fondeve publike / fondeve të tatimpaguesve, ndërsa me to edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shërbimeve të ofruara me respektimin e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, qasjes dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe qytetarëve;
- konstatimi i gjendjeve të evazionit fiskal, mospagimi i detyrave dhe shtesave publike në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me çka ESHR-ja siguron kthimin e fondeve të investuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në ESHR.
- revizion i dhënies së marrëveshjeve për PP me theks të veçantë në ndarjen e marrëveshjeve për PP në kushtet e pandemisë;
- dhënien e udhëzimeve për mënyrën e planifikimit të investimeve kapitale, sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe monitorimin e realizimit të tyre (me theks të veçantë të mjeteve të siguruar nga kreditorët ndërkombëtar) dhe përcaktimin e efekteve nga investimet e theksuara;
- monitorimi i shkallës së huamarrjes dhe kontributit të dhënë në mënyrën menaxhimi me financat publike.

REZULTATET KYÇE

NGA PUNA E ENTIT

SHTETËROR TË REVIZIONIT

106.200.612

Totali i
aktivës/pasivës

1.464.468

Kompensimet/
detyrimet publike/të
papaguara/ më pak të
paguara/në Buxhetin
e shtetit

441.862

Kompensimet e
papaguara më
pak të paguara
në Buxhetin e
komunave të
reviduara

2.341.039

Përdorimi i
mjeteve në
kundërshtim
me ligjin

6.089.138

Shuma
totale e
prokurimeve
publike

2.953.311

Përfshirja e PP-
së me revizionet

986.970

Shuma e
përgjithshme
nga parregullsitë
e konstatuara
te PP

VLERA E
SHTUAR E
REVIZIONEVE

139.337

Furnizimet e kryera
për të cilat nuk
është zbatuar
procedura për PP

602.006

Evidencimet
korrektuese
në Bilancet e
gjendjes

9.716.228

Gjendjet e përcaktuara që
ndikojnë në veprimtarinë
e subjektit lëndë të
revizionit dhe investimet
kapitale

246.000

Grantet e
anuluara/
humbura

6.303.750

Anulimi/ ndërprerja
e granteve për
investime
(të miratuara, por
huat/kredit/grantet
të pa tërhequr)

32.700

Provizionet
e paguara
për fondet e
patërhequra të
kredisë/huasë

në 000 denarë

5.2 BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2021

5.2.1 BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2021

Menaxhimi me financat publike është baza e zbatimit të politikës së shtetit, në drejtim të sigurimit të rritjes më të lartë ekonomike dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ministria e Financave si një nga bartësit kryesorë të procesit të përgatitjes, miratimit, menaxhimit dhe realizimit të buxhetit të shtetit, nëpërmjet planifikimeve afatmesme, aktivitetet i orienton drejt sigurimit të stabilitetit makroekonomik dhe financiar dhe qëndrueshmërisë fiskale të ekonomisë.

Strategjia fiskale si dokument i rëndësishëm strategjik i përkufizon politikat dhe qëllimet më të rëndësishme për veprim, si dhe projeksionet afatmesme makroekonomike dhe fiskale nëpërmjet të cilave do të vendosej lidhja ndërmjet prioritetëve të përcaktuara strategjike dhe burimeve të disponueshme të financimit, gjegjësisht të Buxhetit. Në të njëjtën kohë, udhëzimet dhe politikat në strategjinë fiskale paraqesin bazë për projeksionet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, me qëllim të forcimit të disiplinës fiskale dhe ndarjes përkatëse të mjeteve në dispozicion, në përputhje me prioritetet strategjike.

Gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, afatet e përcaktuara për aktivitetet kryesore dhe për miratimin e dokumenteve themelore të planifikimit janë respektuar, ndërsa Vendimi për përcaktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021 është përgatitur me vonesë prej katër muaj.

Konstatuam nevojën për përforcimin e aktiviteteve për kompletimin e kërkesave buxhetore të shfrytëzuesve buxhetorë me planet strategjike, në funksion të zbatimit të procesit integruar të planifikimit dhe buxhetimit për shkak të harmonizimit me qëllimet strategjike të Qeverisë dhe avancimit të cilësisë së procesit të përgjithshëm të planifikimit të buxhetit të shtetit dhe arritjes së shkallës më të lartë të realizimit të prioritetëve të saj strategjike.

Është e rëndësishme të intensifikohet procesi i harmonizimit të propozimeve të kërkesave buxhetore të Ministrisë së Financave me udhëheqësit e shfrytëzuesve buxhetorë, me qëllim të minimizimit të rrezikut që mjetet e planifikuara mos t'i pasqyrojnë nevojat reale të shfrytëzuesve buxhetorë, dhe me ç'rast Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të informohet për arsyet e mosharmonizimit të mjeteve të kërkuara dhe të miratuara të shfrytëzuesve buxhetorë.

Buxheti Themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 (Ilogaria 637) është miratuar në shumë prej 196.528.061 mijë denarë, që në krahasim me vitin 2020 është zvogëluar për 3,78%.


Realizimi i të ardhurave për periudhën janar - qershor 2021, si dhe nevojën për sigurimin e mjeteve për zbatimin e aktiviteteve të parapara me grupin e pestë dhe të gjashtë të masave për ballafaqimin me pasojat e shkaktuara nga pandemia e virusit Covid-19, ka ndikim që projeksionet initiale të të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, gjegjësisht rritjes së saj në 215 miliardë denarë që është për rreth 9% më shumë në krahasim me buxhetin e planifikuar fillimisht.

Si edhe në vitet paraprake, mjetet që ndahen nga Buxheti për vitin 2021 për financimin e Pushtetit Gjyqësor nuk e arrijnë përqindjen e përcaktuar ligjërish, gjegjësisht janë miratuar mjetet në shumë

prej 2.105.398 mijë denarë që paraqet 0,3% të BPV-së dhe është 60% më i vogël se limiti i përcaktuar ligjërish.

në 000
 denarë

**MJETET E MIRATUARA DHE
 TË PARAPARË ME LIGJ PËR
 PUSHTETIN GJYQËSOR
 PËR VITIN 2021**




Mjetet e miratuara për Prokurorinë Publike në shumë prej 574.361 mijë denarë paraqesin 0,18% të mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, edhe pse në përputhje me Ligjin për Prokurorinë Publike, lartësia e mjeteve për punën e prokurorisë publike duhet të jenë të paktën 0,4% të buxhetit të shtetit, nëse me të nuk

cenohet ndarja e drejtë e mjeteve buxhetore, që është nën 50% të limitit të përcaktuar ligjërish. Konstatuam se për buxhetin e miratuar për vitin 2021 nuk është hartuar dokumenti për pëlqimin e arritur për mjetet e miratuara ose raporti për arsyet e mosharmonizimit të mjeteve të kërkuara dhe të miratuara.

në 000
denarë


MJETET E MIRATUARA DHE TË PARAPARË ME LIGJ PËR PROKURORIN PUBLIKE PËR VITIN 2021



Deficiti buxhetor në vitin 2021 është 5,4% të BPV-së dhe ai është mbi përqindjen e projektuar prej 3,2% të paraparë në Strategjinë Fiskale për vitet 2021-2023, gjegjësisht 0,5% mbi përqindjen e projektuar prej 4,9% të paraparë në Strategjinë e Reviduar Fiskale për vitet 2021-2025, si rezultat i paparashikueshmërisë dhe rreziqeve që lidhen me kohëzgjatjen e pandemisë shëndetësore në korniza globale, implikimet në ekonominë në kushtet e paparashikueshme, si dhe pakot e realizuara të masave ekonomike.

Indikatorët makroekonomikë tregojnë se pavarësisht uljes së deficitit buxhetor për 2,8% në vitin 2021 në raport me vitin 2020, ndikimi i krizës ekonomike shëndetësore akoma e mban deficitin në nivel më të lartë lidhur me vitet e mëparshme, të paraqitur në grafikun në vijim:

**PJESMARRJA NË
 PËRQINDJE E DEFICITIT
 BUXHETOR NË BPV PËR
 PERIUDHËN 2011-2021**




Gjatë planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve respektohet parimi i bilancit buxhetor, që nënkupton gjithsej të ardhurat dhe të hyrat t'i mbulojnë mjetet e miratuara me buxhet. Të hyrat nga huamarrja përdoren për të mbuluar deficitin buxhetor, në drejtim të ruajtjes së likuiditetit të buxhetit. Në vitin 2021 financimi i deficitit, si dhe shlyerjet e borxhit, janë siguruar nëpërmjet huamarrjes nga burimet e huaja dhe vendase.

Totali i të ardhurave dhe të hyrave në vitin 2021 janë realizuar në shumë prej 226.628.817 mijë denarë, gjegjësisht për 5% më shumë në krahasim me vitin 2020. Rritja e të ardhurave dhe të hyrave, në pjesën më të madhe ka të bëjë me rritjen e transfereve dhe donacioneve për 67%, të ardhurat jotatimore për 47%, të ardhurat tatimore për 18% dhe të ardhurat kapitale për 5%. Realizim të zvogluar në kraha-

sim me vitin 2020 ka të të ardhurat nga shlyerja e huave për 43%, të huamarrja vendase për 36% dhe të huamarrja jashtë vendit për 2%.

Të ardhurat tatimore që janë në kompetencë të Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike, në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 marrin pjesë me 54%, me çka paraqesin të ardhura të rëndësishme për financimin e shpenzimeve të planifikuara të shfrytëzuesve buxhetorë për vitin aktual. Ato në krahasim me vitin 2020 janë realizuar për 18% më shumë, që është rezultat i rritjes së të gjitha llojeve të veçanta të të ardhurave tatimore.


Pjesëmarrja e tatimeve dhe taksave të veçanta në të ardhurat tatimore në Buxhetin Themelor në vitin 2021 janë paraqitur në grafikun në vijim:



Tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) paraqet zë të rëndësishëm në të ardhurat totale tatimore të Buxhetit Themelor për vitin 2021 me pjesëmarrjen prej 47%, të realizuar në neto shumë prej 58.193.877 mijë denarë, që paraqet rritje prej 24% në krahasim me vitin 2020. Në vitin 2021 është paguar TVSH-ja në bruto shumë prej 89.465.591 mijë denarë, nga e cila Drejtoria e të Ardhurave Publike ka realizuar kthimin e obligacioneve në shumë prej 31.271.714 mijë denarë. Të ardhurat më të mëdha janë arritur nga TVSH-ja të arkëtuar gjatë importimit të të mirave 72%, ndërsa pjesëmarrja e TVSH-së, të arkëtuar nga qarkullimi në vend është 28%.

Lidhur me të ardhurat tatimore, administrimi i të cilave është në kompetencë të Drejtorisë së Doganave, konstatuam se në vitin 2021 në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë arkëtuar **akciza dhe tatime të mjeteve motorike** në shumën totale prej 24.085.708 mijë denarë, që është për 9% më shumë në raport me vitin 2020.

Pjesmarrja e akcizës për mallrat e akcizës dhe tatimin e mjeteve motorike është prezentuar në grafikonin si vijon:



Një nga kompetencat themelore të Drejtorisë së Doganave është zbatimi i kontrollimit doganor dhe i akcizës në përputhje me Planin Vjetor për kontrollimin e shoqërive tregtare. Me kontrollimet e kryera në vitin 2021 janë përfshirë 2,5% të të gjitha shoqërive tregtare që janë lëndë e kontrollimit, dhe arsye e rëndësishme që ndikon në funksionimin e departamentit për kontrollimin e shoqërive tregtare dhe në numrin e kontrollimeve të kryera është ekipimi i pamjaftueshëm me kuadër të tij.

Në bazë të sistemeve të informacioneve në Drejtorinë e Doganave, konstatojmë se nuk përdoret softueri i integruar për kontrollimet dhe hetimet dhe nuk është vendosur lidhshmëria dhe inspektimi i softuerit në fletëparaqitjet e TVSH-së të shoqërive tregtare, të cilat janë pjesë e sistemit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Në rrjedhë janë aktivitetet për lidhshmërinë sistematike të Sektorit për Kontrollimin dhe Hetimet me Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe organet e tjera kompetente, që duhet të kontribuojë në forcimin e mbikëqyrjes, efikasitet më të madh të kontrollimeve, disiplinë më të madhe tatimore të tatimpaguesit, ndërsa me të edhe të ardhurat e rritura në buxhetin e shtetit.

Në drejtim të rritjes së shkallës së arkëtimit të taksave publike, revizioni në vazhdimësi jep rekomandime për analizën e nevojës së forcimit dhe ndarjes përkatëse të burimeve të kuadrit të DAP-së dhe Drejtorisë së Doganave, veçanërisht në pjesën e rritjes së numrit të inspektorëve dhe kontrollorëve me qëllim të zbatimit të numrit më të madh të kontrollimeve, efekti i të cilave rezulton me rritjen e të ardhurave në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Të hyrat nga huamarrja në vitin 2021 përfshijnë 36% në të ardhurat totale të Buxhetit Themelor për vitin 2021.

Të hyrat totale nga **huamarrja e jashtme** në vitin 2021 janë përafërsisht 57.561.838 mijë denarë dhe ato janë në mënyrë të parëndësishme më të vogla në krahasim me vitin 2020. Prej tyre, 42.509.336 mijë denarë ose 74% janë të hyrat nga letra shtetërore me vlerë e emetuar në tregun ndërkombëtar të kapitalit - eurobondi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Në krahasim me tregun e brendshëm të letrave me vlerë, në vitin 2021, në bazë të **huamarrjes në vend** janë evidentuar të hyrat në shumë totale prej 23.136.066 mijë denarë, që është për 46% më pak në krahasim me vitin 2020, për shkak se në vitin 2021 nuk është kryer huamarrja e shtetit me hua afatshkurtër nga bankat vendase, ndërsa janë realizuar edhe më pak të hyra nga obligacionet e emetuara shtetërore.

Shpenzimet dhe të dalat totale të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 janë realizuar përafërsisht në shumë prej 211.444.856 mijë denarë, gjegjësisht për 5% më shumë në krahasim me vitin 2020. Në strukturën e shpenzimeve dhe të dalave të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet për pagesën e kryegjësë me 20%, transferet rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore me 19%, shpenzimet për pagat, mëditjet dhe kompensimet me 14% dhe shpenzimet për subvencionet dhe transferet me 13%.

Pjesëmarrja e llojeve të veçanta të shpenzimeve dhe të dalave të tjera lidhur me totalin e realizuar të shpenzimeve dhe të dalave në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 është paraqitur në grafikun në vijim:



**STRUKTURA E
SHPENZIMEVE DHE
DALJEVE TË BUXHETIT
THEMELOR TË SHTETIT
PËR VITIN 2021**



Lidhur me kategoritë e veçanta të shpenzimeve dhe të dalave, konstatuam se rritje më të madhe procentuale ka në shpenzimet kapitale për 50,55%, prej të cilave pjesa më e madhe i referohen pagesës së garancive për borxhin e jashtëm, te rezervat dhe shpenzimet e padefinuara për 38,68% nga të cilat në vitin 2021 janë paguar edhe mjetet për

sigurimin e sasive shtesë të energjisë elektrike për ballafaqimin me gjendjen e krizës në furnizimin me energji elektrike, si dhe të shpenzimet për mallrat dhe shërbimet për 31,65% më shumë në krahasim me vitin 2020. Ulje prej vetëm 7,46% është shënuar të shpenzimet për subvencione dhe transfere.

Gjatë vitit 2021 në Fondin e SPIMV-së janë transferuar mjete në shumë prej 32.050.386 mijë denarë prej të cilave për pagesën e pensioneve në shumë prej 30.581 milion denarë.

Me revizion konstatuam se pjesëmarrja e mjeteve të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbulimin e deficitit rrjedhës të Fondit në vitin 2021 është 29% dhe në krahasim me vitin 2020 është rritur për 3% që sugjeron nevojën për mbështetjen financiare të Fondit për pagesën e pensioneve në shtet me mjetet e Buxhetit.

Nga Buxheti Themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021, nëpërmjet ministrive kompetente, si transfere rrjedhëse në NJVL, janë realizuar dotacionet në shumë totale prej 21.217.649 mijë denarë, që paraqet 10% të shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

Pjesëmarrjen më të madhe në transferet kanë bllok dotacionet, të cilat paraqesin 88% të mjeteve totale të paguara ndaj NJVL-së, dotacionet e TVSH-së marrin pjesë me 11%, ndërsa pjesëmarrja e dotacioneve me dedikim është 2%.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere janë realizuar në shumë prej 28.292.568 mijë denarë, me ç'rast pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet për transfere të ndryshme me 89%, prej të cilave pjesa më të madhe (35%) u referohet shpenzimeve nga programi P1 - Masat për përballjen me krizën COVID-19.

Shpenzimet kapitale në vitin 2021 janë 16.802.886 mijë denarë dhe ato janë rritur për 51% në krahasim me vitin 2020. Pastaj, 40% janë shpenzimet për

pagesën e garancive, prej të cilave 86% i referohen për pagesën e borxhit të jashtëm për "NP për rrugë shtetërore" për ndërtimin e segmentit rrugor të autostradës "Milladinovci-Shtip" dhe segmentit rrugor "Kërçovë-Ohër", 12% për "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut Transport" SHA Shkup për Projektin për prokurimin e mjeteve të reja të tërheqjes dhe 3% për Projektin për reformat në hekurudhë.

Gjatë vitit 2021, nga mjetet të cilat nuk janë shfrytëzuar për shpenzimet kapitale nga shfrytëzuesit buxhetorë, rindarja e mjeteve në shumë prej mbi 1.270.614 mijë denarë, të cilat në pjesën më të madhe janë dedikuar për programin P1 - Masat për përballjen me krizën COVID-19 dhe për tejkalimin e gjendjes së krizës me energjinë elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.


Lidhur me gjendjen e borxhit publik më 31.12.2021 konstatuam se ai është 7.135,3 milion euro, gjegjësisht ai është rritur në shumë absolute prej 652 milion euro, gjegjësisht për 10% në krahasim me vitin 2020. Edhe përkundër rritjes së borxhit publik si shumë absolute, gjendja e borxhit publik në krahasim me BPV-në më 31.12.2021 është 60,8% dhe është për 0,16% më pak në krahasim me vitin 2020, për shkak të uljes së 5% të BPV-së në krahasim me vitin e mëparshëm.

Borxhi shtetëror më 31.12.2021 është 51,8% të BPV-së dhe nuk ka dallime të rëndësishme krahasuar me vitin 2020 kur ishte 51,9% të BPV-së.

Në pajtim me të dhënat e Ministrisë së Financave, trendi i pjesëmarrjes së borxhit shtetëror dhe publik në BPV për periudhën 2011-2021 është paraqitur në grafikun në vijim:



**GJENDJA E BORXHIT
SHTETËROR DHE PUBLIK
NË % NGA BPV NË
PERIUDHËN 2011-2021**



Me qëllim të sigurimit dhe ruajtjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe forcimit të përgjegjësisë gjatë dispozicionit me mjetet publike, organet e pushtetit shtetëror, NJVL-të, institucionet të cilat kryejnë veprimtari me interes publik, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, entet, agjencitë, fondet dhe personat tjerë juridikë, themelues i të cilëve është Republika e Maqedonisë së Veriut ose NJVL-të kanë për obligim t'i raportojnë detyrimet e ndërmarra për shkak të evidentimit të tyre në Sistemin Elektronik për raportimin dhe evidentimin e detyrimeve, të cilin e menaxhon dhe mirëmban Ministria e Financave.

Nga gjithsej 1.382 subjekte, deri në dhjetor 2021, të dhëna kanë dorëzuar 1.063 subjekte për detyrimet e maturuara dhe të papaguara në shumë totale prej 24.159.958 mijë denarë, gjegjësisht 391.571.000 euro, që është për 36% më shumë në krahasim me vitin 2020, ku pjesëmarrje më të madhe kanë detyrimet e institucioneve shëndetësore publike me 46% dhe të komunave me 18%.

Lidhur me paqëndrueshmërinë financiare të komunave në vitin 2021, nuk ka ndryshime evidente në krahasim me periudhën e mëparshme, me çka është konstatuar se në dhjetor 2021, nga gjithsej 81 komuna, 12 komuna në Republikën e Maqedonisë

së Veriut punojnë dhe funksionojnë me llogari të bllokuar. Konstatuam se pavarësisht detyrimit ligjor, në Ministrinë e Financave nuk është dorëzuar asnjë vendim për deklarimin e paqëndrueshmërisë financiare nga kryetarët e komunave me llogari të bllokuara, për këtë arsye nuk është formuar trupi koordinues për tejkalimin e paqëndrueshmërisë financiare të komunave. Kjo gjendje u mundëson komunave të gjenerojnë detyrime të reja në baza të ndryshme, të fillojnë projekte të reja kapitale, që mund të ndikojë në përkeqësimin e likuiditetit të tyre dhe në gjendjen e përgjithshme financiare në të ardhmen, me të edhe mundësinë e nevojës shtesë për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut si mbështetje financiare për to, që do të nënkuptojë ngarkesë shtesë për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.



5.2.2 PROCESI I MARRJES DHE SHFRYTËZIMIT TË MJETEVE NGA INSTRUMENTI KORNIZA E INVESTIMEVE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR (WBIF)

Është kryer revizioni i suksesit me temë "Procesi i marrjes dhe shfrytëzimit të mjeteve nga Instrumenti Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)" dhe është përfshirë periudha e aplikimeve për ndihmën teknike dhe grantet e investimeve nëpërmjet WBIF në IPA II në periudhën (2014-2020). Gjithashtu është analizuar gatishmëria e sistemit për shfrytëzimin efikas të mjeteve IPA III

në periudhën (2021-2027), për shkak të rëndësisë së Instrumentit WBIF, i cili do të jetë mekanizëm për zbatimin e Planit Ekonomik të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor (2021-2027).

Pyetja themelore së cilës duhet t'i përgjigjet revizioni është:

"A është dizajnuar sistem efikas dhe efektiv për marrjen e mjeteve për Instrumentin WBIF - "Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor"?"

Për t'iu përgjigjur pyetjes themelore të revizionit, i përcaktuam pyetjet e mëposhtme specifike:

- A është krijuar sistem efikas për marrjen e mjeteve përmes WBIF në periudhën 2014-2020 (IPA II)?
- A është vendosur proces efektiv për zgjedhjen e projekteve për aplikim në thirrjen për marrjen e mjeteve nëpërmjet WBIF?
- A janë përdorur në mënyrë efektive mundësitë për të marrë grant-mjete nëpërmjet WBIF? Dhe
- A është i gatshëm sistemi për të thithur mjete për bashkëfinancimin e projekteve të parashikuara në Planin Ekonomike të Investimeve të Ballkanit Perëndimor në periudhën e programit IPA III (2021-2027)?

Me revizion u përfshin aktivitetet, masat dhe rezultatet e arritura në procesin e identifikimit, programimit, priorizimit dhe aplikimit me projektet strategjike për ndihmën teknike dhe granti i investimeve përmes Instrumentit WBIF i cili koordinohet përmes Sekretariatit për Çështje Evropiane në rolin e Koordinatorit Kombëtar të IPA-së (NIPAK) dhe Sekretariatit Teknik të NIPAK-së, aktivitetet e Komitetit Kombëtar për Investime, i cili ka rol këshillëdhënës dhe aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila e miraton Listën e vetme të

projekteve dhe i miraton aplikacionet për ndihmën teknike dhe grantin e investimeve.

Me revizionin e kryer konstatuam se Republika e Maqedonisë së Veriut ka themeluar Komitetin Kombëtar të Investimeve dhe Listën e vetme të projekteve që janë kusht për marrjen e mjeteve përmes Instrumentit Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Pra, nga viti 2009, kur u prezantua ky instrument, Republika e Maqedonisë së Veriut aplikoi në njëzet e tetë (28) thirrje për ndihmën teknike, ndërsa nga viti 2015, kur ka filluar procesi i ndarjes së granteve të investimeve dhe në shtatë (7) thirrje për grantin e investimeve.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen e internetit të WBIF¹⁵ Republikës së Maqedonisë së Veriut i janë ndarë mjete për projektet strategjike rajonale në fushën e transportit, energjetikës, mjedisit jetësor dhe mbrojtjes sociale në vlerë prej 2,6 miliardë euro. Këto projekte financohen me hua nga kreditorët zyrtarë në shumë prej 892 milion euro dhe grante përmes WBIF në vlerë prej 421,8 milion euro nga të cilat grante të investimeve në vlerë prej 391,9 milion euro dhe ndihmë teknike në vlerë prej 29,9 milion euro.

Me revizion konstatuam se sistemi për përdorimin dhe marrjen e mjeteve përmes Instrumentit WBIF nuk është disenjuar në mënyrë adekuate për shkak të mungesës së kornizës ligjore dhe institucionale gjithëpërfshirëse për hartimin e Listës së vetme të projekteve me kompetenca qarta të trupave dhe organeve për hartimin e listave të veçanta sektoriale, në pajtim me Metodologjinë e WBIF.

Në procesin e aplikimit mungon procedura e përcaktuar për aplikim, por ndërmjet institucioneve kompetente janë duke u zbatuar aktivitetet për plotësimin e kushteve për aplikim në thirrje. Pra, për të gjitha projektet, është marrë mendimi pozitiv nga ministritë e linjës dhe nga Ministria e Financave se projekti është pjesë e strategjive sektoriale dhe listës së vetme të projekteve, ndërsa Ministria e Financave dorëzon edhe shkresë për negociata me institucionet financiare ndërkombëtare për huamarrje. Gjithashtu, për secilin projekt nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut merret leja për aplikim. Edhe pse këto aktivitete zbatohen, revizioni ka konstatuar se nuk është disenjuar plotësisht sistemi efikas për zgjedhjen, prioritizimin, vlerësimin dhe renditjen e aplikacioneve për projekte, për çka ekziston rreziku i zgjedhjes së projekteve që nuk janë të "pjekura" dhe të rëndësishme strategjike, dhe në kushte të hapësirës fiskale të kufizuara.

Konstatuam ndryshim të politikës për financimin e projekteve strategjike me burime të tjera, jo me hua nga institucionet zyrtare financiare ndërkombëtare, të cilat kanë efektin e anulimit të granteve për ndihmën teknike në shumën totale prej 4 milion euro. Kjo gjendje ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të mjeteve nëpërmjet Instrumentit Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) për shkak të mungesës së mundësisë për të bashkëfinancuar projektet me kredi dhe grante investimi.

Në rrjedhë të implementimit janë dymbëdhjetë projekte strategjike në fushën e transportit, energjetikës dhe mjedisit jetësor, për të cilat janë miratuar grante të investimeve në vlerë prej 385 milion euro. Për pjesën më të madhe të projekteve, investimi nuk ka filluar, nuk janë lidhur marrëveshjet e grantit dhe ka ngecje në lidhje me dinamikën e planifikuar të realizimit, e cila është konstatuar në raportet mujore të monitorimit për vendin tonë nga IFICO¹⁶.



NDARJA E GRANTEVE INVESTUESE



Vlera totale e granteve
investuese të aprovuar
(392 milion euro)
dhe **ndihmë teknike**
(29 milion euro)
nga WBIF është
421 milion euro

Në rrjedh janë **12 grante
investuese** në vlerë prej
385 milion euro

- 3 janë në **shtyrje**
serioze
102,5 milion euro,
- 4 janë në rrugë kritike të
tejkalimit
44,5 milion euro
- 5 janë me **dinamik të**
rregullt të realizimit
238 milion euro





**RREZIQET E PËRCAKTUARA NGA
HUMBJA E MJETEVE GRANTE TË
MARRA NGA WBIF**

PROJEKT	PËRDORUES	STATUS	GRANTE TË APROVUAR NË EURO
Interkoneksioni Energjetik Shqipëri – Maqedonia e Veriut II	SHA MEPSO	X	12.000.000
Ndërlidhja hekurudhore, Seksioni Beljakovce - Kriva Pallankë - faza II	NP HRMVI	X	71.558.824
Interkoneksioni rrugor, Nënsek Bukoyçani – Kërçovë	NP për rrugë shtetërore	X	20.248.000
Interkoneksioni rrugor, seksioni Kriva Pallankë - Deve Bair	NP për rrugë shtetërore	–	2.520.400
Interkonektori i Gazit Maqedoni e Veriut - Greqi	SHA NER	–	12.724.000
Interkoneksioni hekurudhor stacioni kufitar i përbashkët Tabanovcë	MTL	–	2.765.227
interkoneksioni rrugor autostrada Bllace – Shkup (kryqëzimi i Stenkovec)	NP për rrugë shtetërore	–	26.578.396
Rehabilitimi i objekteve për arsimit fizik në shkollën fillore dhe të mesme	MASH	✓	3.069.000
Stacioni i trajtimit të ujërave të zeza Shkupi	NP Ujësjiellësi dhe kanalizimi	✓	72.740.391
Qendra Fotovoltaik Solar Oslomej 1	SHA ESM	✓	1.595.109
Elektranet fotovoltaike diellore Oslomej 2 dhe Manastir	SHA ESM	✓	5.161.408
Interkoneksioni hekurudhor, seksioni Kriva Pallankë - Kufiri me Bullgarinë	NP HRMVI	✓	155.562.188



Ngecje



Dinamik e ngadalhtë




Në rrjedhë


Si është paraqitur në infografik, prej 12 granteve të investimeve me vlerë të përgjithshme prej 385 milion euro, deri në ditën e revizionit, 3 kanë ngecur në vlerë të përgjithshme prej 102,5 milion euro.

Në fund të korriut 2022 në kuadër të thirrjes së gjashtë investuese, Bashkimi Evropian ka miratuar projektet e para për zbatimin e Planit Ekonomik dhe Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Republika e Maqedonisë së Veriut ka aplikuar me katër projekte investive dhe ka marrë mbështetje për të gjitha.

Pas kësaj thirrjeje, 40% nga totali i mjeteve të miratuara për Ballkanin Perëndimor janë për projektet në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paraqitur në grafikun.



STRUKTURA E MJETEVE TË MIRATUARA PAS THIRRJES SË GJASHTË PËR GRANTIN INVESTUES NËPËRMJET WBIF



■ Mali i Zi

■ Serbia


■ Shqipëria

■ Maqedonia e Veriut

■ Bosna dhe Hercegovin

■ Kosova

Me këtë thirrje, janë miratuar 4 grante investimi, të paraqitura në grafikon.



Edhe pse deri tani janë miratuar fonde të konsiderueshme, sistemi nuk është plotësisht i përgatitur për thithjen e fondeve për bashkëfinancimin e projekteve strategjike.


Revizioni konstatoi se për shkak të kushteve të reja në IPA III në periudhën programore për absorbim më efikas të mjeteve në periudhën e re programore, imponohet si detyrim të disenjohet sistemi efikas për programimin e projekteve, gjegjësisht projektet strategjike dhe "të pjekura" të harmonizuara me Planin Ekonomik të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor, zgjedhjen efikase të projekteve për aplikim dhe konsistencë të politikave për financimin e projekteve me rëndësi rajonale.

Konkluzionet e lartpërmendura tregojnë se në periudhën e deritanishme, institucionet kompetente

kanë ndërmarrë masa dhe aktivitete për marrjen e mjeteve për bashkëfinancimin e projekteve strategjike rajonale që plotësojnë kushtet për financim përmes Instrumentit Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Sistemi ende nuk është plotësisht i përgatitur për absorbimin më të madh të mjeteve, gjegjësisht përdorimin efikas dhe efektiv të tyre.

Sistemi për marrjen e mjeteve përmes Instrumentit Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) në të ardhmen duhet të projektohet nëpërmjet kornizës ligjore dhe institucionale me sistem të qartë të përcaktuar të institucioneve dhe trupave kompetente, si dhe të kryet revidimi i projekteve në listën e projekteve me qëllim të përkuqizimit të tyre të qartë sipas rëndësisë strategjike dhe "pjekurisë".

5.2.3 MINISTERIA E FINANCIVE



Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e raporteve financiare të Ministrisë së Financave së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021 si dhe revizionin e raportit financiar të Ministrisë së Financave-funksionet e shtetit për vitin 2021, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e Ministrisë së Financave konstatuam se për menaxhim efikas me pronën me të cilën disponon, është e nevojshme që Ministria e Financave të sigurojë **të dhëna të plota dhe të sakta për pronësinë, të drejtën e përdorimit, si dhe vlerën e pronës së plotë. Është e nevojshme të sigurohen aktzotërimet për një pjesë të pronës së paluajtshme me të cilën disponon Ministria, si dhe përcaktimi i vlerës dhe evidentimi i tyre kontabël.**

Në lidhje me zbatimin e kompetencave të Ministrisë lidhur me regjistrimin vjetor të mjeteve dhe detyrimeve është konstatuar se nuk është i plotë dhe nuk është zbatuar plotësisht në përputhje me aktet që rregullojnë mënyrën e zbatimit të tij.

Në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimeve publike, sa i përket zbatimit të plotë të dispozitave të Ligjit për prokurime publike, kemi dhënë rekomandime, zbatimi i të cilave do të sigurojë rritje të transparencës dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, janë theksuar çështjet, ndër të cilat janë procedurat gjyqësore në vazhdim që mund të kenë ndikim në rrjedhat e ardhshme financiare të Ministrisë.

Gjithashtu, **kemi kryer revizionin e raportit financiar të Ministrisë së Financave-Funksionet e shtetit për vitin 2021, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë**, me ç'rast konstatuam se Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale i janë paguar mjetet **për monitorimin e zgjedhjeve në vitin 2021**, edhe pse në Ligjin për realizimin e buxhetit për vitin 2021 nuk është paraparë se aktivitetet e theksuara do të paguheshin nëpërmjet Ministrisë së Financave-funksionet e shtetit.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë theksuam gjendjen në lidhje me Raportin e Zyrës Evropiane për Luftën kundër Mashtrimit (OLAF) nga viti 2019 për kontrollim / hetim të zbatuar të aktiviteteve të realizuara me mjetet nga fondet IPA, në përputhje me të cilin nga ndarja Funksionet e shtetit gjatë vitit 2021 është realizuar kthimi i mjeteve të Komisioni Evropian, në shumë prej 108.229 mijë denarë, gjegjësisht 1.754.000 euro. Për gjendjen e konstatuar Ministria e Financave ka ndërmarrë aktivitete për të njoftuar Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe Avokatin

e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të zbatimit të procedurave për kthimin e mjeteve në buxhetin e shtetit, e cila procedurë është në rrjedh.

5.2.4 DREJTORIA DOGANORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Drejtorja e Doganave zbaton mbikëqyrjen doganore, kontroll doganor, doganimin e mallrave, masat hetuese dhe të inteligjencës me qëllim të pengimit, zbulimit dhe hetimit të kundërvajtjeve doganore dhe veprave penale, zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale dhe çështjeve të tjera në fushën e punës doganore. Një nga kompetencat themelore të Drejtorisë së Doganave është llogaritja dhe arkëtimi i detyrimeve të eksportit dhe importit, tatimet dhe taksat e tjera publike dhe kompensimet nga importi, eksporti ose transiti i mallrave. Detyrimet të cilat i administron Drejtorja e Doganave janë: dogana, TVSH-ja e importit, akcizat dhe kompensimet.

Është kryer revizioni i raporteve financiare në Drejtorinë e Doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, për llogaritë e buxhetit themelor dhe llogarinë e buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Për zbatimin e kompetencave lidhur me regjistrimin vjetor të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve, kemi dhënë rekomandime për sigurimin e të dhënave për vlerën e tokës në treg, për shkak të harmonizimit dhe evidentimit të tyre në librat e punës, si dhe vendosjen e evidencës së plotë të një pjesë e rezervave të materialeve.

Kemi bërë analizën e kërkesave të paarkëtuara nga aktvendimet e lëshuara për arkëtim shtesë të doganave dhe detyrimeve doganore, të miratuara në procedurën administrative, me ç'rast konstatuam se kërkesat rrjedhin nga viti 1999 dhe më 31.12.2022 janë në vlerën totale prej 3.518.482 mijë denarë, prej të cilave 99% janë kërkesa nga subjekte juridike.



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministry of Finance
DREJTORIA E DOGANAVE

Drejtorja e Doganave është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Financave me cilësinë e personit juridik, i themeluar dhe i organizuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Drejtorinë e Doganave.

në 000 denarë

Vendimet e papaguara për persona juridik nga 01.01.1999 deri me 31.12.2022

numri rendor	Numri i obliguesve	Statusi	Shuma e vendimeve të papaguara	Numri i vendimeve të papaguara
1	67	aktivë	575.950	2.547
2	17	likuidimit	159.245	75
3	83	falimentimi	232.683	641
4	561	të fshirë	2.458.559	3.498
5	6	joaktivë	24.818	65
6	12	të pamigruar	12.829	35
7	2	para falimentimit	48.559	265
GJITHSEJ	748		3.512.643	7126

Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e subjekteve juridike janë fshirë nga regjistri qendror, janë në falimentim ose likuiduar dhe për to nuk ekziston mundësia për arkëtim, konstatuam se për sigurimin e informacioneve cilësore dhe objektive për shumën e mjeteve si të ardhura të pritura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është e nevojshme që organet kompetente të ndërmarrin aktivitete për sigurimin e të dhënave objektive dhe të besueshme në raportet financiare.

Aktivitetet për kërkesat e theksuara janë të rregulluara me ligj, prandaj theksuam nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të Drejtorisë së Doganave dhe Ministrisë së Financave për miratimin e aktit nënligjor, në përputhje me të cilin do të rregullohet mënyra e veprimit me kërkesat e vjetruara.

5.2.5 QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si bartës i pushtetit ekzekutiv, punët në lidhje me kompetencat e saj kryen në mënyrë të pavarur, në kuadër të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe në bazë të parimeve të transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Sekretariati i Përgjithshëm është themeluar si shërbim profesional i Qeverisë i cili siguron bashkëpunim dhe ndihmë profesionale **për nevojat e Qeverisë, Kryetarit të Qeverisë, zëvendësve të tij** si dhe anëtarëve të Qeverisë në realizimin e kompetencave të tyre.

Me revizionin e raporteve financiare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe revizionit të pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor për vitin 2021, konstatuam se për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës së Zyrës së Kryetarit të Qeverisë dhe të Sekretaria-

tit të Përgjithshëm të Qeverisë janë miratuar aktet e veçanta, edhe pse Sekretariati i Përgjithshëm, si shërbim profesional i Qeverisë, është një organ shtetëror.

Në lidhje me mjetet e paguara në shumë prej 71.129 mijë denarë në bazë të kontributeve për sigurimin e detyrueshëm social për shoqërinë aksionare, konstatuam se nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion se ishte kryer rritja e kryegjësë themelore të shoqërisë, as dokumenti për regjistrimin e shtetit si pronar i aksioneve dhe të njetët nuk janë pjesë e evidencës në librat afariste të Qeverisë.

Për objektin ndërtimor në të cilin Qeveria kryen aktivitetet aktuale nuk është siguruar dokumenti për të drejtën e përdorimit.

Në lidhje me zbatimin e kompetencave që kanë të bëjnë me regjistrimin vjetor të mjeteve dhe detyrimeve, konstatuam se raporti për regjistrimin e kryer të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve për vitin 2021 nuk është miratuar nga ana e sekretarit të përgjithshëm dhe nuk është kryer harmonizimi



i gjendjes **së kontabilitetit me gjendjen** faktike të përcaktuar me regjistrimin.

Janë evidentuar softuerët dhe licencat në shumë totale prej 576.524 mijë denarë, edhe pse disa janë prokuruar dhe përdoren në shumë institucione të administratës publike, për një pjesë revizioni nuk ka siguruar dokumentacion se përdoren nga Qeveria apo u janë dhënë në përdorim institucioneve të tjera, ndërsa për një pjesë ka filluar procedura hetimore.

Në kuadër të Buxhetit / planit financiar të Qeverisë për vitin 2021 janë paraparë mjete për realizimin e disa nënprogrameve në kuadër të programeve të qeverisë.

Në lidhje me realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me Nënprogramin **D-8 - Avancimi i konkurrencës lokale dhe rajonale në fushën e turizmit** si pjesë e projektit për konkurrencën lokale dhe rajonale, e cila pagesë ndaj furnizuesve bëhet nga buxheti i Qeverisë në shumë prej 58,555 mijë denarë, konstatuam se Qeveria nuk ka informacione të plota për mjetet e shfrytëzuara për të cilën është planifikuar programi, si dhe të dhënat nëse pajisjet dhe objektet ndërtimore janë evidentuar plotësisht si pronë shtetërore të përdoruesit përfundimtarë.


Mjetet e planifikuara për realizimin e **Nënprogramit C4 – Programi** për uljen e ndotjes së ajrit në shumë prej 80.000 mijë denarë, janë shfrytëzuar vetëm 30% për shkak të numrit të pamjaftueshëm të aplikacioneve të paraqitura nga komunat, me ç'rast ndarjen e kryen komisioni me përfaqësuesit e shumë institucioneve, ndërsa kriteret dhe pikët për zgjedhjen e projekteve Sekretariati i Përgjithshëm i përcakton në thirrjet publike.

Nëpërmjet Nënprogramit Qeveritar **P1 – Masat** për ballafaqimin me krizën Kovid-19, janë paguar mjete në shumë prej 6.097.000 mijë denarë pa kritere të përcaktuara në lidhje me përzgjedhjen e institucioneve dhe shumën e miratuar të mjeteve të pakthyeshme financiare, prej të cilave 33% nga përfituesit e mjeteve nuk kanë dorëzuar raport për aktivitetet e realizuara në Qeveri, për shumën prej 2.000.000 mijë denarë, gjegjësisht 32,5 milion euro.

Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2018-2022 dhe pjesëmarrja e programit P1 Masat për ballafaqimin me krizën e Kovid-19 është paraqitur në grafikun si vijon:

në 000
denarë

**MASA PËR
BALLAFAQIMIN ME
KRIZËN KOVID-19**



Me analizën e kryer, konstatuam se buxheti në vitin 2021 në krahasim me vitin 2018 është rritur për 5 herë, si rezultat i vendosjes së programit P1 Masat për ballafaqimin me krizën e Kovid-19. Pjesëmarrja e këtij programi në realizimin total të buxhetit të Qeverisë është mbi 75% nga mjetet totale të realizuara.

Theksojmë se në pajtim me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021 janë kryer tre revizione të suksesit nga ana e revizorëve të autorizuar shtetërorë për efikasitetin e masave ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ballafaqimin me krizën e

shkaktuar nga virusi Kovid-19 me të cilat u përfshin mjetet për mbështetjen financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Programit Qeveritar P1-Masat për ballafaqimin me KOVID-19.


Duke vepruar sipas rekomandimeve të dhëna nga revizori i autorizuar shtetëror, janë kryer pagesat në bazë të kthimit të mjeteve nga programi P1 nga subjektet që nuk i kanë përbushur detyrimet kontraktuese, në bazë të cilës në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më 26.01.2023 janë paguar gjithsej 29.802 mijë denarë, gjegjësisht 4,8 milion euro.

Në bazë të zbatimit të procedurave për prokurimet publike, te një pjesë e tyre konstatuam parregullsi në mënyrën e planifikimit, zbatimit dhe realizimit. Për një pjesë të procedurave për prokurimet publike kanë filluar procedurat përpara organeve kompetente.

Në pjesën Theksimi i **çështjeve** për pasiguri dhe vazhdimësi janë zbardhur gjendjet ndër të cilat edhe gjendjet që u referohen mjeteve **të paguara për angazhimin e ekipit të avokatëve** për përfaqësimin në procedurat e arbitrazhit që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura ose të ratifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2017, Qeveria themeloi Trup Koordinues për

monitorimin e procedurave të arbitrazhit, detyra e të cilit është të sigurojë qasje të koordinuar në lidhje me aktivitetet që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që zhvillohen ose do të zhvillohen përpara arbitrazheve ndërkombëtare të kontraktuara.


Në periudhën 2018-2022 në vazhdim janë pesë procedurat e arbitrazhit kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilat janë paguar mjetet për shërbimet e avokatëve në shumë të përgjithshme prej 959,917 mijë denarë, gjegjësisht 15,6 milion euro, të paraqitura në grafikun si në vijim:



Trupi Koordinues përgatiti analizë dhe përcaktoi nëse shteti i humb kontestet, shuma totale e mjeteve që do të duhet të paguhen është 82.267.500 mijë denarë, gjegjësisht 945 milion euro dhe 420 milion dollar, që do të ketë implikime në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitet e ardhshëm.

Për shkak të kësaj gjendjeje, theksuam nevojën për të përcaktuar arsyet për të cilat janë iniciuar procedurat e arbitrazhit, si dhe veprimet përkatëse të organeve kompetente.

Në kuadër të Programit të Qeverisë **D9 – Mbështetja financiare e investimeve**, në periudhën 2018-2022 janë paguar mjetet në shumë të përgjithshme prej **3.524.067 mijë denarë ose rreth 57,3 milion euro**, si mbështetje financiare për investimet e subjekteve afariste që investojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shkak të rritjes së konkurrencës së ekonomisë maqedonase dhe punësimit, të paraqitura sipas viteve në grafikun si në vijim:



Theksojmë se për llojin, mënyrën dhe vëllimin e kryerjes së aktiviteteve të monitorimit dhe kontrollimit të realizimit të kontratave të lidhura, është para-

parë që ministri i Ekonomisë të miratojë akt, i cili nuk është miratuar deri në ditën e revizionit

5.3 | REGJISTRIMI

5.3.1 REGJISTRIMI I POPULLSISË, AMVISËRIVE DHE BANESAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2021



Regjistrimi si aktivitet me interes të lartë shtetëror është operacioni statistikor më voluminoz në lidhje me numrin e pjesëmarrësve në zbatimin e tij, si dhe madhësinë e buxhetit me të cilin financohen aktivitetet.

Enti Shtetëror i Statistikës, si koordinator kombëtar i sistemit statistikor në vend, në periudhën prej 05.09.2021 deri më 30.09.2021 zbatoi regjistrimin e nëntë me rend të popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021, me gjendjen më 4 shtator 2021, në orën 24.00.

Enti Shtetëror i Revizionit zbatoi revizionin e pajtueshmërisë me temë:

“Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021”, me qëllim që të jep konkluzion nëse procedura e përgatitjes, organizimit, zbatimit dhe publikimit të të dhënave të regjistrimit është zbatuar në pajtim me rregullativën ligjore dhe nënligjore.

Regjistrimi i vitit 2021 është zbatuar në periudhën e krizës ekonomike dhe shëndetësore të shkaktuar nga pandemia KOVID-19, me zbatimin e metodës së kombinuar të regjistrimit, **regjistrimi administrativ** – me shfrytëzimin e të dhënave nga Baza e të Dhënave të Para-Regjistrimit, si përmbledhje e të dhënave nga gjashtë institucionet shtetërore dhe **regjistrimi në terren** - regjistrimi në softuerin aplikativ me futjen e të dhënave të regjistrimit në kompjuterët portativë (laptop).

Me revizion i konstatuam këto gjendje sipas fushave të veçanta:

Korniza juridike

Zbatimi i secilit regjistrim rregullohet me ligj të veçantë për regjistrim. Ligji për regjistrim është miratuar në janar të 2021, me të cilin është rregulluar se regjistrimi do të zbatohet në muajin prill, ndërsa me ndryshimet e ligjit është prolonguar për shtator 2021, me ç'rast kemi përcaktuar periudhë të shkurtër për kryerjen e aktiviteteve përgatitore, të cilat ndikuan në realizimin e kompetencave të Entit Shtetëror të Statistikës.

Për arsye të kryerjes së vazhdueshme të aktiviteteve të regjistrimit, si dhe lehtësimit të procesit të

mbikëqyrjes dhe kontrollimit në punën e pjesëmarrësve të regjistrimit, rekomanduam miratimin e procedurës që do të përcaktonte qartë, saktë dhe në mënyrë të njëpasnjëshme të gjithë procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim. Një numër më i madh i akteve të brendshme janë miratuar me lejen paraprake të drejtorit dhe zëvendës drejtorit, por një pjesë e akteve miratohen vetëm me lejen paraprake të drejtorit.

Përgatitja dhe zbatimi i regjistrimit, 2021

- Për regjistrimin e personave të cilët në momentin e regjistrimit janë në shërbim të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, personat që vuajnë masën e paraburgimit ose dënimin me burg, personat në shtëpitë edukative-korrektuese, si dhe për personat që i përkasin kategorisë së të pas-trehëve, nuk janë përgatitur raporte individuale dhe të dhënat gjenden në Publikimin e shtypur dhe të publikuar, në dispozicion pas përfundimit të regjistrimit.
- **Regjistrimi i mëparshëm** është kryer në periudhën prej 01.03.2021 deri më 15.03.2021. Revizionit nuk i janë dorëzuar dëshmitë se pas ndryshimit ligjor të kësaj periudhe, është kryer sërish regjistrimi i mëparshëm, për të vërtetuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për këtë kategori personash. Të dhënat e regjistrimit janë pjesë e publikimit dhe ishin në dispozicion pas përfundimit të regjistrimit.
- **Regjistrimi në terren** është kryer në softuerin aplikativ me futjen e të dhënave të regjistrimit në kompjuterët portativë (laptop), i cili u realizua me 505 instruktorë dhe 4482 regjistruar, i cili numër është më i ulët sesa ishte planifikuar.
- Në tre ditët e fundit të regjistrimit u mundësua që në ambientet e komisioneve të zonave të regjistrimit të regjistroheshin personat të cilët për arsye të ndryshme nuk u regjistruan, regjistrimi i kësaj mënyre nuk është paraparë në Ligjin për regjistrim.
- Gjatë regjistrimit u paraqitën **një sërë problemesh**: jehona e vogël e kandidatëve për regjistruar dhe instruktorë, problemet me zgjidhjen e aplikimit në terren, problemet me lidhjen e internetit, sulmet e hakerëve që shkakton edhe ndërprerjen në regjistrim një periudhë të caktuar.
- **Vetëregjistrimi** i personave-shtetas që janë në punë të përkohshme ose që qëndrojnë jashtë vendit është zbatuar nga 1 mars 2021 deri më 30 shtator 2021. Edhe pse gjatë vitit 2019 është prokuruar aplikacioni softuerik për regjistrim, nuk është prokuruar asnjë aplikacion softuerik për vetëregjistrim. Konstatuam se aktivitetet për prokurimin e aplikacionit kanë filluar më 25.02.2021 dhe kontrata e prokurimit është lidhur më 28.02.2021. Aplikacioni softuerik është blerë pa kompensim, për çka Enti Shtetëror i Statistikës mori përsipër të nxjerrë në pah emrin e ofruesit në aplikim, me të cilin kryhet promovimi i tij, duke treguar se bëhet fjalë për sponsorizim, pa i kërkuar Ministrisë së Drejtësisë vendim, me të cilën do të konfirmojë interesin publik të këtij sponsorizimi. Gjithashtu, kemi konstatuar se personi juridik që ka krijuar aplikacionin menaxhohet nga personi i cili është anëtar i Këshillit të Statistikës në periudhën nga 25.05.2019 deri më 23.09.2020. Në librat e punës së Entit Shtetëror të Statistikës ky aplikacion nuk është evidentuar.

Trupat profesionalë, grupet e punës dhe pjesëmarrësit e tjerë në zbatimin e regjistrimit


→ Për realizimin e aktiviteteve të regjistrimit, janë formuar trupa profesionalë dhe grupe të punës për përgatitjet, organizimin dhe zbatimin e regjistrimit. **Byroja e regjistrimit**, si trup profesional është rregulluar në Ligjin për regjistrim, ndërsa **shtabi i regjistrimit**, si trup profesional është formuar me vendim të drejtorit. Përcaktuam se disa nga kompetencat e tyre janë identike dhe disa nga anëtarët e shtabit janë gjithashtu anëtarë të atyre grupeve të punës. **Grupet e punës** janë formuar për kryerjen e punëve profesionale të regjistrimit dhe numri i tyre është 10. Konstatuam se ka punonjës që janë anëtarë në më shumë grupe të punës, instruktorë shtetërorë që janë edhe anëtarë të trupave të punës.

→ Për pjesëmarrësit në regjistrim janë paguar **kompensimet** në shumë prej 191.405 mijë denarë, gjegjësisht rreth 3,1 milion euro, pa përcaktuar saktë numrin e anëtarëve të grupeve të punës, si dhe kriteret dhe sasinë e pikëve në bazë të të cilave është llogaritur pjesa e kompensimeve, që ka ndikim në vërtetimin e realitetit dhe objektivitetit të kompensimeve të paguara.

Financimi i regjistrimit

Plani financiar për regjistrimin është miratuar në **mars 2021** në shumë prej **522.751 mijë denarë, gjegjësisht rreth 8,5 milion euro.**

Pagesa e mjeteve ka filluar në vitin 2019 dhe mbi 40% të mjeteve janë realizuar gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020.




Për realizimin e regjistrimit janë shpenzuar mjete në shumë prej 479.111 mijë denarë, gjegjësisht rreth 7,9 milion euro, në të cilin pjesëmarrjen më të madhe prej mbi 49% kanë shpenzimet për

prokurimin e laptopëve dhe 40% për kompensimet e pjesëmarrësit në zbatimin e aktiviteteve të regjistrimit.



**PJESËMARRJA
 E LLOJEVE MË
 TË VEÇANTA
 TË SHPENZIMEVE**



- Fushata për popullarizimin e Regjistrimit
- kompensime për zbatimin e aktiviteteve të regjistrimit
- Përgatitja e instrumenteve të regjistrimit
- Pajisje
- Aplikacioni i regjistrimit
- Shpenzime materiale për Regjistrimin
- Shpenzimet për trajnimin e instruktorëve shtetërorë dhe komisioneve të regjistrimit të rajonit
- Shpenzimet e paparashikuara

Procedurat për prokurimet publike të zbatuara për nevojat e regjistrimit, 2021

- Për nevojat e regjistrimit janë lidhur dhe realizuar kontrata në vlerë prej **237.905 mijë denarë gjegjësisht 3,9 milion euro**, që paraqet 43% nga totali i mjeteve financiare të Planit Financiar.
- Me procedurat për prokurimin publik, janë blerë 5.650 laptopë identikë, në shumë prej 199.498 mijë denarë, gjegjësisht rreth 3,2 milion euro, për të cilat kemi konstatuar parregullsi të caktuara në lidhje me afatin e dorëzimit, mënyrën dhe afatin e pagesës së laptopëve, pranimin sasiar dhe cilësor të laptopëve dhe lidhjen e anekseve për prokurimin e shërbimeve shtesë. Pas përfundimit të aktiviteteve të regjistrimit të vitit 2021, pjesa më e madhe e laptopëve u janë dhënë institucioneve shtetërore që kanë nevojë për pajisjen informatike,

- Fushata mediatike për regjistrim me të cilën u informua popullsia për qëllimet dhe rëndësinë e regjistrimit, u zbatua me 40% më shumë mjete se sa është planifikuar.

Për gjendjet e konstatuara në lidhje me prokurimet publike dhamë rekomandime dhe kemi sugjeruar nevojën për transparencë të plotë të procedurave dhe mundësimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Rezultatet e regjistrimit janë publikuar më 30.03.2022, gjashtë muaj pas përfundimit të aktiviteteve në terren, në pajtim me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka 1.836.713 popullsi rezidente, 598.632 amvisëri dhe 839.174 banesa.



**REGJISTRIMI
2021**

5.4

ADMINISTRATA PUBLIKE



5.4.1 REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Institucionet e sektorit publik kanë përgjegjësi të punojnë në arritjen e vlerës më të mirë për subjektet afariste dhe qytetarët, për të siguruar zhvillimin social dhe ekonomik dhe prosperitetin e vendit në tërësi.

Në pajtim me Metodologjinë për aderim të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, reforma në administratën publike është fushë e cila është pjesë e procesit të negociatave në kuadër të Klasterit - Vlerat Fundamentale.

Me qëllim për të dhënë kontributin e vet, Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksessit me temë "Reforma në administratën publike", për t'iu përgjigjur pyetjes **"A sigurojnë aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente, zbatim efikas të Strategjisë për reforma në administratën publike 2018-2022"**, me të cilin kemi mbuluar periudhën nga shkurti 2018 deri në korrik të vitit 2022.

:



Reforma në administratën publike është proces i vazhdueshëm i riorganizimit të institucioneve në sektorin publik dhe avancimin e kapaciteteve të tyre administrative.

Duke respektuar aktivitetet e realizuara të institucioneve kompetente për krijimin e administratës publike funksionale, e cila do të siguroj shërbime cilësore dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe subjektet afariste, në lidhje me kushtet normative për realizimin e vazhdueshëm të kompetencave të administratës publike, konstatuam:

Afatet për miratimin e ligjeve kryesore për zbatimin e reformave në administratën publike vazhdimisht shtyhen. Procedura për miratimin e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Ligjit për nëpunësit administrativë dhe Ligjit për shërbimin e udhëheqësisë së lartë që ka filluar në vitin 2019 vazhdon akoma;

→ **Është prolonguar procesi i riorganizimit dhe optimizimit të numrit të organeve të administratës shtetërore,** për shkak të vendosjes së strukturës koherente institucionale, eliminimit të kompetencave të mbivendosura të institucioneve dhe sigurimit të linjave efektive të përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

→ Është miratuar **plani i veprimit i reviduar** për zbatimin e strategjisë, me të cilin janë kryer **ndryshimet në 33% të aktiviteve të planifikuara,** janë përcaktuar aktivitetet e reja, janë kryer ndryshimet në afatet e zbatimit dhe të indikatorëve për matjen e suksesit, si dhe është zvogëluar shumica e mjeteve të planifikuara financiare,

Në lidhje me kapacitetet institucionale për përbushjen e qëllimeve të Strategjisë, konstatuam nevojën e vendosjes së mekanizmit të qëndrueshëm për menaxhimin dhe koordinimin e të gjithë pjesëmarrësve në proces;

STRATEGJIA PËR REFORMË TË ADMINISTRATËS PUBLIKE 2018/2022



Këshilli për Reformë të Administratës Publike



Sekretariati për Reformat e Administratës Publike



Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës



Grupe të punës



Personat kontaktues

- **Në lidhje me kapacitetet e kuadrit** për përmbushjen e qëllimeve reformuese, janë konstatuar ndryshme të shpeshta, ekipimi i pamjaftueshëm i kuadrit, realizimi jo i plotë i kompetencave të trupave përgjegjës për procesin e reformave si dhe komunikimi dhe koordinimi joefikas vertikal dhe horizontal i të gjithë pjesëmarrësve në proces;
- Këshilli për reforma në administratën publike është trupi më i lartë politik për koordinimin e aktiviteteve dhe ka **mbajtur vetëm shtatë takime në periudhën katërvjeçare**, ndërsa nga java e fundit, prej korrikut të vitit 2021 deri në fund të vitit 2022, më shumë se një vit e gjysmë, nuk është mbajtur mbledhje e re. **Në periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2022 janë kryer gjashtë ndryshime** në përbërjen e tij, si pasojë e ndryshimeve të vazhdueshme strukturore në Qeveri.
- **Gjithsej mjetet e planifikuara** për zbatimin e masave të Strategjisë janë **1.802.140 mijë denarë, gjegjësisht rreth 30 milion euro**, me pjesëmarrjen më të madhe mbi 56% të siguruar nga fondet dhe instrumentet e BE-së;
- **Konstatuam** se nuk është realizuar transparenca, llogaridhënia dhe monitorimi i mjeteve financiare të shpenzuara në buxhetin e shtetit, sepse përveç Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, institucionet e tjera nuk kanë hapur nënprogram të veçantë në kuadër të Programit Qeveritar K – Reforma në administratën publike;


Në lidhje me **Sistemin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit** të aktiviteteve reformuese, konstatuam se nuk është vendosur sistemi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të nevojshme për vlerësimin e shkallës së zbatimit dhe efikasitetit të masave dhe aktiviteteve të paraparë me Strategjinë. Pra:

- Për disenjimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të TI-së për monitorim, vlerësim dhe raportim për Strategjinë, nuk është kryer analiza dhe hulumtimi i tregut për shumën e nevojshme të mjeteve financiare.
- Nuk është kryer përditësimi i rregullt i **indikatorëve për matjen e suksesit** të aktiviteteve të strategjisë, gjegjësisht nga gjithsej 79 indikatorë të paraparë, në vitin 2021 janë matur vetëm 28 indikatorë, respektivisht vetëm 35%;
- Nga gjithsej 205 aktivitete të planifikuara **janë realizuar vetëm 106 aktivitete që paraqet 52% realizim.**

Implementimi i aktiviteteve për periudhën prej shkurtit 2018 deri në dhjetor 2021 është shfaqur në grafikun si vijon:

%

SATISI I AKTIVITETEVE NGA STRATEGJIA PËR RAP



■ Aktivitetet e realizuara

■ Aktivitetet në rrjedhë

■ Aktivitetet të cilat vonohen

- Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës **nuk ka vendosur evidencë të sistematizuar** për secilin aktivitet të strategjisë, si dhe raportet gjysmëvjetore dhe vjetore nuk përmbajnë të dhëna për mjetet e planifikuara dhe të realizuara.
- Raporti i katërt vjetor nga viti 2021 nuk përmban pasqyrë të plotë financiare dhe është dhënë analizë vetëm për mjetet e shpenzuara në vlerë prej 1.111.359 mijë denarë, që paraqet 61% të mjeteve totale të planifikuara për periudhën 2018-2022;

Duke pasur parasysh se administrata publike funksionale është parakusht për qeverisje demokratike efektive dhe transparente, për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, deri te trupat dhe institucionet kompetente për koordinim të aktiviteteve, Enti Shtetëror i Revizionit dha rekomandime **që janë në funksion të përmirësimit**, forcimit dhe krijimit të sistemit efikas të planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe njoftimit për realizimin e aktiviteteve në Strategjinë e re për reforma në administratën publike 2023-2030, me synim për reforma të suksesshme **në administratën publike si qëllim strategjik i shtetit**.

5.5

ZHVILLIMI RAJONAL



5.5.1 ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL ME THEKS TË VEÇANTË TË DEMOGRAFISË

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **"Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë të demografisë"**, si revizion paralel me ISR-në e Republikës së Serbisë, me qëllim për t'iu përgjigjur pyetjes: **"A siguron sistemi i menaxhimit të politikave për zhvillim të barabartë rajonal zvogëlimin efektiv të pabarazive brenda dhe ndërmjet rajoneve planifikuese dhe kohezionit të tyre përkatës demografik, ekonomik, social dhe hapësinor?"**


Fushëveprimi dhe dëshmitë të cilat i siguroam nëpërmjet zbatimit të metodologjisë dhe teknikave të revizionit, na japin bazë për ta shprehur konkluzionin si në vijim:

Korniza e vendosur strategjike dhe normative, struktura institucionale, minimumi i përcaktuar ligjor i mjeteve që duhet të ndahen nga buxheti i shtetit, klasifikimi i rajoneve të planifikimit sipas shkallës së zhvillimit dhe ndarja e mjeteve sipas këtij kriteri, transparenca gjatë planifikimit dhe zgjedhjes së projektit, si dhe sistemi i vendosur elektronik për zhvillimin rajonal (SiReRa), sigurojnë progres në bazë të zbatimit të politikave, por ai i njeti kontribuon në masë të pamjaftueshme në uljen efektive të pabarazive brenda dhe ndërmjet rajoneve të planifikimit dhe kohezionit të tyre përkatës demografik, ekonomik, social dhe hapësinor.


Politika për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal zbatohet nëpërmjet dokumenteve të planifikimit dhe programore, por për të siguruar bazë solide për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve në funksion të zhvillimit të barabartë rajonal, është i nevojshëm miratimi dhe përditësimi i tyre në kohë në pajtim me rezultatet nga zbatimi i Regjistrimit të popullsisë në vitin 2021. Në rregullativën ekzistuese ligjore nuk është rregulluar planifikimi hapësinor, nuk është miratuar plani i ri hapësinor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të të cilit duhet të harmonizohen dokumentet e planifikimit për zhvillimin rajonal, ndërsa mungojnë edhe kriteret për përcaktimin e programeve vjetore të ministrive të linjës që kanë rëndësi rajonale. Në Programin për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e barabartë rajonal për periudhën 2021 – 2024, nuk ka demarkacion të qartë ndërmjet bartësve të aktiviteteve, periudhës kohore dhe mjeteve financiare të nevojshme për zbatimin efektiv të politikave për zhvillimin e barabartë rajonal.

Struktura institucionale e sistemit për zbatimin e politikës së nxitjes së zhvillimit të barabartë rajonal siguron funksionalitetin e tij, por është e nevojshme të forcohen kapacitetet administrative dhe teknike të institucioneve për realizimin më efektiv të aktiviteteve të planifikuara.

Për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal nga buxheti i shtetit, duhet çdo vit të ndahen mjete në vlerë prej më së paku 1% të BPV-së, të cilat për financimin e projekteve shpërndahen sipas rajoneve të planifikimit, në pajtim me Vendimin për klasifikimin e rajoneve të planifikimit dhe shkallën e zhvillimit. Edhe pse është shënuar **trendi i rritjes** së mjeteve të ndara për këtë dedikim në vitet e fundit, por ato nuk janë në nivelin e përcaktuar me ligj, që mund të shihet në grafikun si në vijim.



**PJESËMARRJA
E MJETEVE TË
NDARA NË LIGJET
E PARAPARA**



Në periudhën **2019-2021**, nga buxheti i shtetit, në funksion të zhvillimit të barabartë rajonal, janë ndarë mjete në shumën totale prej 9.329.889 mijë denarë, që paraqet **46% të minimumit të përcaktuar me ligj** prej 20.034.090 mijë denarë. Gjatë ndarjes së mjeteve sipas rajoneve **nuk është siguruar zbatimi konsekuent i Indeksit për shkallën e zhvillimit** sipas rajoneve të planifikimit.

Kështu, Rajoni i Shkupit si më i zhvilluari edhe pse duhet të marrë pjesë me 7,2%, ndërsa Rajoni Verilindor si më pak i zhvilluar me 17,3% të mjeteve totale buxhetore për këtë dedikim, më së shumti mjete janë alokuar në Rajonin e Shkupit (26,2%), ndërsa në Rajonin Verilindor janë alokuar 8,4%.

Shfrytëzuesit buxhetorë të cilët përmes aktiviteteve të tyre programore realizojnë aktivitete në funksion të zhvillimit rajonal, ato i realizojnë nga buxhetet e tyre, në bazë të prioriteteve dhe kriterëve të përcaktuara strategjike dhe programore, *përkatësisht nuk e përdorin indeksin e përcaktuar të zhvillimit, që tregon mungesë koordinimi dhe ndikon në zhvillimin e rajoneve.*

Janë konstatuar dobësi në funksionimin e sistemit SiReRa që kanë të bëjnë me:

- mosplotesimin e bazave të të dhënave,
- paplotësi e matricës financiare që duhet të sigurojë lidhjen e programeve/projekteve të zhvillimit me qëllimet strategjike prioritare dhe
- moslidhjen e automatizuar me sistemet e tjera të TI-së,

nuk sigurojnë kushte për monitorimin e vazhdueshëm të planifikimit dhe zbatimit të projekteve, gjendjen në rajonet e planifikimit dhe shkallën e zhvillimit të tyre.

Është siguruar transparencë adekuate në procesin e krijimit të dokumenteve të planifikimit dhe programore dhe miratimit të tyre, por mungesa e raporteve vjetore nuk lejon llogaridhënie adekuate për aktivitetet totale të realizuara që janë në funksion të zhvillimit të barabartë rajonal, me çka është zvogëluar mundësia për koordinim në veprimet dhe propozimin e masave përkatëse nga organet kompetente.

Edhe përkundër aktiviteteve të ndërmarra në nivel qendror dhe rajonal në vitet e mëparshme,


pabarazitë socio-ekonomike dhe demografike ndërmjet dhe në kornizat e rajoneve të planifikimit nuk janë ulur.

Në vend, shkalla e shtimit natyror ka shënuar rënie të vazhdueshme me 2.5% në vitin 2010 në vitin 2021 ajo ka parashenjë negative dhe është -5.4%. Trend të uljes së shkallës së rritjes natyrore ashtu si është paraqitur në grafikun në vijim shënojnë të gjitha rajonet, Trendi i shkallës së rritjes natyrore sipas rajoneve.

Të gjithë rajonet shënojnë saldo negative të migracionit të popullsisë nga fshati, veçanërisht Rajoni Lindor, Rajoni i Pellagonisë dhe Rajoni Jug-perëndimor.

Si pasojë e rritjes negative natyrore dhe saldosh negative të lëvizjeve migratore, Rajoni i Vardarit dhe Rajoni Juglindor kanë më pak se 150.000 mijë banorë, numri i të cilit është kriter i pragut minimal për përcaktimin/përkufizimin e rajonit. Pragut minimal i afrohet edhe Rajoni Lindor dhe Rajoni Verilindor.

Sipas rezultateve nga zbatimi i Regjistrimit të popullsisë në vitin 2021, në shtet ka **205 vendbanime/fshatra të braktisura** dhe në krahasim me vitin 2002 numri i tyre është rritur për 40%. Në **Rajonin e Shkupit krijohet 43% e BPV-së së përgjithshme**, ndërsa **Rajoni Verilindor theksohet me nivel më të lartë të papunësisë prej 32,4%**. Dallimet e konstatuara në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të planifikimit tregojnë për planifikimin joefikas të aktiviteteve për realizimin efektiv të politikës për zhvillimin e barabartë rajonal.



TRENDI I SHKALLËS SË RRITJES NATYRORE SIPAS RAJONEVE



Vardarit Lindjes Jugperendimor Juglindorë Pellagonisë Pollogut Verilindor Shkupit

—●— viti 2019

—●— viti 2020

—●— viti 2021

Me qëllim të rritjes së efektivitetit të sistemit për krijimin e politikave dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve për reduktimin e pabarazive ndërmjet dhe brenda kornizave të rajoneve të planifikimit janë dhënë rekomandime në funksion të aktiviteteve të ndërmarra për miratimin e akteve nënligjore me të cilat do të mundësohet programi i

integruar gjithëpërfshirës i masave për realizimin e zhvillimit të barabartë rajonal, rritjen e koordinimit dhe komunikimit ndërmjet bartësve të aktiviteteve dhe forcimit të kapaciteteve të tyre, ndarjen korrekte dhe proporcionale të mjeteve buxhetore si dhe forcimin e monitorimit dhe llogaridhënies për masat e ndërmarra.

5.6

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TEKNOLOGJIK

5.6.1 ZHVILLIMI DHE FUNKSIONIMI I ZONAVE ZHVILLIMORE TEKNOLOGJIKE INDUSTRIALE

Kemi kryer revizionin e pajtueshmërisë me temë *"Zhvillimi dhe funksionimi i zonave zhvillimore teknologjike industriale"* me të cilën kemi përfshirë çështjet lidhur me kushtet, mënyrën dhe procedurën për themelimin, zhvillimin, funksionimin dhe kryerjen e veprimtarive të ZZhTI-së, analizën e mundësive për investime në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Drejtorisë, e cila në emër të Qeverisë menaxhon me zonat.

Kjo është zbatuar si pilot-revizion në kuadër të Tvinig Projektit¹⁷ MK 18 IPA FI 03 20 të titulluar si "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrjes parlamentare".

Revizioni e mbuloi periudhën prej vitit 2015 deri në vitin 2021, por disa fusha, çështje, ngjarje dhe analiza të caktuara janë përfshirë përpara vitit 2015 dhe njëpasnjëshëm deri në ditën e njoftimit për revizionin e kryer.

Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale (ZZhTI) janë formuar për të krijuar kushte për investime nga ana e personave fizikë ose juridikë, të huaj ose vendas të cilët duhet të kontribuojnë për zhvillimin e teknologjisë bashkëkohore me vendosjen e prodhimtarisë fitimprurëse ekonomike dhe përdorimin efikas të resurseve si dhe zbatimin e standardeve më të larta ekologjike. Misioni i Drejtorisë

së ZZhTI-së është që RMV-ja të rritet në qendër afariste ndërkombëtare në Evropën Juglindore me oferta shumë cilësore infrastrukturore në ZZhTI dhe shërbime cilësore, me qëllim të zhvillimit të barabartë rajonal në vend.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka themeluar 14 (katërbëdhjetë) ZZhTI. Në periudhën e kryerjes së revizionit **8 (tetë) ZZhTI janë në funksion**, prej të cilëve për ZZhTI-në në Tetovë është lidhur kontrata për Partneritet Privat Publik (PPP). **Jooperative janë 5 (pesë) ZZhTI**, një ZZhTI-Rankovcë është tjetërsuar, ndërsa aktivitete kanë filluar për themelimin e **3 (tre) ZZhTI të reja**. Në bazë të Ligjit për zona të gjelbra industriale, Qeveria e RMV-së ka themeluar 3 (tri) zona industriale (ZI) prej të cilave operative është **ZI Kosel**.

Ndarja e ndihmave shtetërore është rregulluar me rregullativën ligjore komplekse¹⁸, gjatë së cilës me revizion është konstatuar se dispozita të përcaktuara juridike nuk janë të sakta, nuk janë miratuar akte nënligjore, ndërsa kompetencat e ndara në disa organe shtetërore, e vështirësojnë kontrollimin dhe koordinimin dhe nuk mundëson pasqyrë të plotë të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë për shfrytëzues në vend.

Me analizat dhe revizionin e kryer të Programeve Vjetore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2017-2022, konstatuam se aktivitetet për tërheqjen e investimeve të huaja në këtë periudhë **nuk janë përfshirë në prioritetet strate-**

17 Twinning Project MK 18 IPA FI 03 20 „Improvement of external audit and Parliamentary oversight“

18 Ligji për zonat zhvillimore teknologjike industriale, Ligji për kontroll të ndihmës shtetërore, Ligji për zonat e gjelbra - industriale, Ligji për themelimin e Agjencisë për investime të huaja dhe promovim të importit në RM dhe Ligji për mbështetje financiare të investimeve


gjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të nuk është miratuar Strategjia për tërheqjen e investimeve të huaja.

Me revizion është konstatuar se Drejtoria angazhon persona me **kontratë në vepër** numri i të cilëve gjatë viteve ka ndryshuar. Në periudhën e kryerjes së revizionit, **aktive janë 72** kontrata në vepër, respektivisht numri i personave të angazhuar me kontrata në vepër është pothuajse i barabartë me numrin e **personave të punësuar të rregullt (85)**, dhe gjysma e kontratave janë lidhur me personat të cilët më gjatë se 24 muaj janë angazhuar nga Drejtoria. Kjo gjendje paraqet rrezik për kryerjen e vazhdueshme dhe cilësore të obligimeve të punës për shkak të karakterit kohor të angazhimit të tyre.

Në periudhën 2017-2021, Drejtoria ka ndarë ndihma shtetërore në shumën totale prej **4.641.728 mijë denarë (75,5 milion euro)**, nga të cilat drejtpërdrejt nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë paguar mjete në shumë prej **2.307.195 mijë denarë (37,5 milion euro)**, ndërsa lirimet doganore dhe tatimore janë në shumë prej **2.334.532 mijë denarë (38 milion euro)**. Në vitin 2021, shuma totale e ndihmës shtetërore të ndarë është 1.504.576 mijë denarë (24,5 milion euro), nga të cilat drejtpërdrejt nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë paguar mjete në shumë prej 731.842 mijë denarë (11,9 milion euro), ndërsa lirimet doganore dhe tatimore janë 772.734 mijë denarë (12,6 milion euro).



PERSONAT TË CILËT KANË QENË/ JANË ANGAZHUAR ME KONTRAT NË VEPËR




■ të pranuar në marrëdhënie pune të rregullt

■ personat që nuk janë më të angazhuar me kontratë në vepër

■ personat me kontratë në vepër

në 000
denarë

NDIHMA SHTETËRORE E PAGUAR NË PERUDHËN 2017-2021



Nga zbatimi i revizionit është konstatuar se me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore, si dhe dekretet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut **nuk janë përcaktuar kriteret transparente dhe të përafërta për caktimin e shumës së ndihmës¹⁹ individuale**, me çka ndihma shtetërore ndahet pa vlerësim të përfitimit për të përcaktuar shumën e saj, pa metodologji të përcaktuar për dhënien, ndërsa duke negociuar ndërmjet personave të autorizuar në Drejtori dhe shfrytëzuesi i ndihmës individuale.

Investimet infrastrukturore në zonat janë në kompetenca të Drejtorisë, e cila në pajtim me Ligjin për ndërtim, ka marrë leje për ndërtim për gjithë zonën si tërësi funksionale. ZZhTI-ja dhe ZI-ja janë themeluar në toka në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut me **sipërfaqe totale prej 847 ha, prej të cilave 512 ha janë sipërfaqe shfrytëzuese** (parcelë për dhënien me qira shfrytëzuesve), **ndërsa me qira afatgjatë janë dhënë 153 ha ose 30%** nga sipërfaqet totale shfrytëzuese.

Investimet e kryera nga Drejtoria në të gjitha zonat me gjendjen më 31.12.2021 janë vlerësuar **në shumën totale prej 6.152.930 mijë denarë (rreth 100 milion euro)**.


Është konstatuar se **Drejtorja nga ministria kompetente merr leje për shfrytëzim pasi të jetë ndërtuar e gjithë zona, për këtë arsye për pjesët e ndërtuara individuale nuk mund të bëhet pranimi teknik dhe të merret leja për shfrytëzim**. Kjo situatë ka bërë që disa nga projektet investuese të realizuara në zonat, në periudhën 2007-2021, në librat e punës së Drejtorisë, të kenë status të mjeteve materiale në përgatitje edhe pse ato shfrytëzohen. Shuma e vlerësuar e tyre **në fund të vitit 2021 është 2.677.763 mijë denarë, që paraqet 43,50% të investimeve totale të kryera të Drejtorisë në zonat**.

Si rezultat i mosmiratimit të dokumenteve programuese dhe strategjike, në sipërfaqe prej 153 ha ose 30% të sipërfaqes totale shfrytëzuese në periudhën 2012-2021 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut **janë themeluar zona të cilat**

19 Numri i investimeve të huaja, numri i punonjësve, investimet e kryera dhe kriteret e ngjashme

në 000
denarë

INVESTIME NE ZTZHI DHE ZI



nuk janë vendosur në funksion dhe nuk janë operative dhe në të cilat nga buxheti i Drejtorisë janë investuar mjete për infrastrukturën e brendshme themelore dhe shpronësimin e tokave në shumë totale prej 393.686 mijë denarë ose 6% të investimeve totale. Investimet më të mëdha në zonat jofunksionale janë kryer në Gjevgjeli, Dellçevë dhe Kratovë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me PPP është themeluar **ZZhTI Tetovë**, me çka kontrata për PPP me partnerin privat është lidhur për **96 vjet**, ndonëse me rregullativën ligjore është përcaktuar **periudha maksimale të jetë 35 vjet**, duke llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës. Me kontratën për PPP, partneri publik është i obliguar të sigurojë njësi profesionale për menaxhimin me projektin në kohëzgjatje të plotë të kontratës e cila njëkohësisht ka përfaqësues të vet të partnerit privat dhe trup kontaktues për partnerin privat. Me revizion konstatuam se janë caktuar **7 persona**, të cilët nuk kanë obligime pune dhe **nuk kryejnë aktivitete të lidhura me real-**

izimin e kontratës për PPP, dhe as nuk janë anëtarë në njësinë e theksuar profesionale.

Në vitin 2015, në bazë të Vendimit të miratuar për fillimin e procedurës për tjetërsimin e tokës ndërtimore nga Qeveria e RMV-së, është lidhur kontratë për tjetërsimin e tokës ndërtimore të **ZZhTI Rankovcë**. Me kontratën ishte paraparë ndërtimi i infrastrukturës së brendshme tërësisht në kuadër të zonës²⁰, në afat **jo më gjatë se 92 (nëntëdhjetë e dy) muaj** nga solemnizimi i kontratës dhe realizimi i **minimum 2.000 punësimeve të reja**. Për shkak të mosfillimit të ndërtimit në afatin e paraparë, **me Aktvendim nga marsi i vitit 2019, Leja për ndërtim në ZZhTI Rankovcë është shpallur i pavlefshëm** me çka dispozitat nga kontrata nuk janë realizuar. Me revizionin konstatuam se te blerësi/investitori janë bërë numër i madh i ndryshimeve statusore, dhe ndër të tjerat është ndryshuar edhe emri i kompanisë. Në prill të vitit 2021 për kompaninë është hapur procedurë e falimentimit dhe ajo nuk disponon me pronë për arkëtimin e dënimit kontraktues të paraparë me kontratë. **ZZhTI Rankovcë** është rast

i vetëm ku në bazë të ndryshimeve të rregullativës ligjore, **është kryer tjetërsimi i tokës**, ndërsa te ZZhTI-të e tjera në vend, toka **jepet me qira afatgjate**.

Drejtori i Drejtorisë nuk ka emëruar **persona të autorizuar** nga radhët e të punësuarve të cilët do të mbikëqyrnin ZZhTI dhe shfrytëzuesit, si është paraparë në Ligjin e ZZhTI-së që **mund të ndikojë** në kontrollimin, zbulimin dhe parandalimin e parakohshëm në rast të funksionimit të paligjshëm të shfrytëzuesve.

Për kryerjen e punëve të kontabilitetit - financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore, Drejtoria ka vendosur praktikë me procedurë të prokurimit publik për angazhimin e personave të jashtëm juridikë që kontribuon në disa dobësi në përgatitjen e raporteve financiare.

5.6.2 MBËSHTETJA FINANCIARE (GRANTET KOFINANCIARE), PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME PËR INOVACIONET DHE ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK

Kemi kryer revizionin e pajtueshmërisë me temë **"Mbështetja financiare (grantet kofinanciare) për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për inovacionet dhe zhvillimin teknologjik"** te Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZhT) në pajtim me Programin Vjetor të Punës për vitin 2022 për periudhën 2019 - 2021.

Me revizionin e kryer janë konstatuar disa aktivitete të padefinuara dhe të paharmonizuara në rregullativën ligjore dhe dokumentet strategjike:

→ **nuk është kryer azhurnimi** i Statutit të FIZhT-së me ndryshimet e rregullativës ligjore, të cilat **rregullojnë** kompetencat dhe periudhën e angazhimit të Këshillit Drejtues, detyrimet dhe përgjegjësitë e drejtorit,

mandatin e Komitetit për aprovimin e investimeve, afatin e miratimit të vendimit nga ana e Komitetit, mënyrën e përcaktimit të kompensimeve të Komitetit dhe gjendjet e tjera që udhëzojnë në **kolizionin e akteve të miratuara** me dispozitat e Ligjit për veprimtari inovative;

→ **zbatimi i aktiviteteve** nga ana e FIZhT-së, të cilat **nuk janë definuar** në Ligjin për veprimtari inovative dhe **nuk janë të harmonizuara** me Strategjinë për inovacione 2012-2020, ndërsa janë ndarë me Planin e Qeverisë së RMV-së për rritjen ekonomike, për të cilat janë lidhur kontrata për ndarjen e mjeteve në shumë prej rreth **596 milion denarë**;

→ **realizimi jo i plotë** i masave dhe aktiviteteve të përcaktuara me **Strategjinë për inovacione të RMV-së 2012-2020 dhe Planeve të Veprimit për periudhën 2013-2015, 2016-2018 dhe 2019-2020**. Pra, në kompetencat e FIZhT-së janë përcaktuar **16 masa**, prej të cilave **7 shtatë masa nuk janë realizuar**;

→ **mungesa e Strategjisë së Specializimit Inteligent**, dhe rrjedhimisht nuk është **siguruar vazhdimësia** e aktiviteteve në veprimtarinë inovative pas vitit 2020, dokumenti strategjik i cili ka ndikim në krijimin dhe realizimin e politikave në fushën e inovacioneve, gjegjësisht sigurimi i qasjes moderne për zhvillimin ekonomik, nëpërmjet lidhjes së komunitetit akademik, sektorit të biznesit, institucioneve qeveritare dhe sektorit qytetar për zbulimin dhe veprimin e përbashkët në fushat në të cilat shteti ka potencial më të madh dhe resurse të mjaftueshme për të investuar;

→ **Mungon baza e centralizuar** me të dhënat për mbështetjen e dhënë financiare me qëllim të **monitorimit të zbatimit** të instru-

menteve të veçanta për mbështetjen financiare, **lëvizjen** e përdoruesit nga aplikimi, kontrollimin administrativ, **para selektimin dhe selektimin** e projektit, **lidhjen** e kontratës, **pagesën e** mjeteve, **monitorimin** e përmbushjes së detyrimeve nga kontrata dhe **inspektimin në shkallën e shfrytëzimit** të mbështetjes së dhënë financiare.

Me analizën e kryer të **akteve për sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës**, me revizionin janë konstatuar se ato **nuk përputhen me kompetencat, peshën dhe madhësinë e punës** së FIZhT-

së, gjegjësisht **nga sistematizimi i 16 vendeve të punës, janë plotësuar vetëm 8.**

Për shkak të **vëllimit të rritur të punës** si rezultat i ndryshimeve ligjore, rritjes së buxhetit, përcaktimeve të **zgjeruara** programore dhe strategjike të FIZhT-së, kompetencave të **caktuara** për zbatimin e PrrE-së, shtylla 3, në kushtet e pamjaftueshme të kapacitetit administrativ, FIZhT-ja **vazhdimisht angazhon persona të jashtëm** të cilët kryejnë detyrat e punës lidhur me veprimtarinë, për të cilat në **periudhën 2019-2021 janë paguar mjete në shumë prej rreth 46 milion denarë.**


Viti	2019	2020	2021
Personat e angazhuar me kontratë në vepër - angazhim i vazhdueshëm	38	45	50
Mjetet e paguara për kontratë në vepër - angazhim i vazhdueshëm (në 000 denarë)	7.544	13.384	19.377
Personat e angazhuar me kontratë në vepër - bashkëpunëtorë të jashtëm	16	15	18
Mjetet e paguara për kontratë në vepër - bashkëpunëtorë të jashtëm (në 000 denarë)	1.746	2.277	1.472

Revizioni konsideron se angazhimi i personave me kontratë në vepër, pavarësisht pëlqimit të dhënë nga ministria kompetente, **kontribuon në mostransparencën dhe sjelljen subjektive** gjatë lidhjes së kontratës dhe **përcaktimit të kompensimit** mujor për angazhimin e personave në punë të cilët në vazhdimësi janë të angazhuar në FIZhT për periudhë më të gjatë kohore.

Sa i përket **realizimit dhe monitorimit të mbështetjes financiare** nga Plani për Rritjen Ekonomike, shtylla 3, FIZhT në periudhën 2019-2021 nga publikimi i thirrjeve publike ka lidhur kontratë për **364 projekte**, prej të cilave përfundimisht **më 20.05.2022 janë realizuar 93 projekte dhe 258 projekte janë në rrjedhë.**

në 000
denarë

REALIZIMI I THIRRJEVE PUBLIKE PËR NDARJEN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PERIUdhËN 2019-2021, NGA PRRK SHTYLLA 3




Gjithashtu, me revizionin është **konstatuar** se në periudhën 2019-2020, **FIZhT-ja ka angazhuar profesionistë** për vlerësimin dhe dhënien e mendimit profesional të projekteve nga publikimi i thirrjeve publike për mbështetjen financiare, për të cilat **janë paguar mjetet** në shumën totale prej rreth **16 milion denarë**.

Dhënia e mbështetjes financiare është proces i ndërlikuar, ndërsa **për monitorimin dhe kontrollimin e realizimit të kontratave** është i nevojshëm **kuadri kompetent dhe profesional**, të cilin FIZhT-ja nuk e ka në dispozicion gjatë periudhës së revizion-

it, për çka nuk mund t'u përgjigjet detyrimeve të përcaktuara në kontratat e lidhura.

Për shkak të së theksuarës, e me qëllim të **realizimit në kohë** të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura me shfrytëzuesit, projektet e të cilëve janë aprovuar për financim, FIZhT-ja publikon thirrje publik "Shërbimet për menaxhimin me projektet (monitorimi)". Në periudhën 2019-2021 FIZhT-ja **ka lidhur katër kontrata kornizë** për prokurimin e shërbimeve për menaxhimin me projektet (monitorimi) në shumën totale prej rreth **101 milion denarë**.

5.7 SHËNDETËSIA



5.7.1 FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, gjatë së cilës konstatuam:

- dobësi në funksionimin e sistemit të TI-së së Fondit, në pjesën e mungesës së vazhdueshme të stafit të TI-së, mungesës së strategjive të TI-së dhe politikave dhe procedurave të papërditësuara të TI-së për sigurinë e TI-së, strukturës së vjetërsuar të serverit dhe mosfunksionalitetit të një pjese të moduleve në vendosjen e sistemit të TI-së;
- ekziston rreziku për shkak të mosplotësisë së vendeve të udhëheqësve dhe të sistematizimit të punës nga kufizimi joadekuat i përgjegjësive dhe realizimi jo i plotë i aktiviteteve në sektorët;
- në procesin e përgatitjes së llogaritjeve për shërbimet e kryera shëndetësore të cilat janë bazë për përgatitjen e faturave mujore nga IPSH-ja, gjegjësisht raportet nga ISHP-ja, nuk janë siguruar kontrollime të instaluar në sistem, ndërsa për shkak të vëllimit të të dhënave në llogaritjet nuk ekziston mundësia mbi të që të kryhet kontrollimi i plotë manual për arsye që Fondi nuk disponon me kapacitete të mjaftueshme të personelit:


- dobësi në kontrollimet e brendshme dhe në terren gjatë konfirmimit të objektivitetit të ndërhyrjeve të faturuara mjekësore të realizuara nga IPSH-ja. Në kushtet e kapaciteteve të kufizuara të personelit dhe mundësive për kontrollim të plotë, vështirë është të konfirmohet besueshmëria e llojit të faturuar dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore të kryera në faturat e IPSH-së të cilave në vitin 2021 u janë paguar 3.296.901 mijë denarë. Sipas të dhënave të paraqitura në Raportin Vjetor gjatë vitit 2021, nga gjithsej 41 kontrollime të planifikuara, vetëm 7 janë kryer në IPSH nga kujdesi shëndetësor spitalor, ndërsa kontrollimet e tjera janë kryer në ISHP edhe përkundër faktit se kompensimi i dakorduar i IPSH-së varet drejtpërdrejt nga lloji dhe vëllimi i shërbimeve të kryera shëndetësore;
- në procesin e përshkrimit dhe lëshimit të barnave që janë në përgjegjësinë e Fondit nuk është siguruar kontrollimi i plotë i sistemit gjatë përgatitjes dhe dërgimit të faturave nga barnatoret, për të cilat gjatë vitit 2021 janë paguar 2.624.853 mijë denarë. Në bazë të të dhënave nga baza elektronike e të dhënave, është konstatuar se në disa prej faturave paraqiten më shumë receta me të njëjtin numër, me ç'rast gjatë vitit 2021 janë faturuar dy herë 21.047 receta në vlerë të përgjithshme prej 2.224 mijë denarë;
- parregullsi dhe mosrespektim të afateve në pjesën e kryerjes së kontrollimeve dhe shqiptimit të dënimeve kontraktuese, të cilat kanë ndikuar që të mos sanksionohen institucionet shëndetësore të cilat nuk veprojnë në përputhje me marrëveshjet e lidhura me Fondin;

Në funksion për t'i mundësuar ISHP-së të ofrojë shërbime shëndetësore që janë deficitare ose të planifikuara në mënyrë joadekuate për shkak të terapisë së shtrenjtë, është dhënë mundësia ligjore, në kuadër të kompensimit kontraktues vjetor të përfshijë kompensimin e kushtëzuar për prokurimin e gjeneratave të reja të barnave për trajtimin e sëmundjeve të caktuara. Mjetet e ndara për kompensim me kusht kanë shënuar rritje të vazhdueshme, ndërsa në vitin 2021, Fondi miratoi kompensimin me kusht për 17 (shtatëmbëdhjetë) ISHP, në shumën totale prej 1.265.265 mijë denarë, prej të cilëve 91% i referohet prokurimit të barnave, të paraqitur në grafik. Nga Fondi nuk janë vendosur kontrollime për mënyrën e përcaktimit dhe realizimit të tij, përkatësisht miratohen dhe paguhen fondet pa u përcaktuar nëse janë ofruar të gjitha shërbimet shëndetësore për nga lloji dhe vëllimi;

- gjatë pagesës së kompensimeve për pushimin e lindjes nuk janë vendosur kontrollime për shkak të të cilave janë paguar kompensimet edhe kur personat e siguruar kanë marrë pagë për orarin efektiv të punës;
- dobësi në procedurën e referimit për trajtim jashtë vendit të personave të siguruar, gjegjësisht nuk është siguruar mbrojtja adekuate juridike e personave dhe nuk është vendosur kontrollimi, përkatësisht sistemi për monitorimin dhe analizën e suksesit të trajtimit. Fondi ka evidentuar paradhënie për trajtim jashtë vendit ndaj institucioneve të huaja shëndetësore në shumë prej 234.178 mijë denarë, për të cilat nuk ka informacione të sakta për gjendjen e trajtimit për shkak të mossigurimit të dokumentacionit;

në 000
denarë

**SHUMA E MJETEVE TË MIRATUARA PËR
KOMPENSIM ME KUSHT PËR PERIU DHËN
NGA VITI 2017 DERI NË VITIN 2021**



- regjistrimi i mjeteve nuk është zbatuar në tërësi, ndërsa disa nga objektet ndërtimore dhe toka kanë status të parregulluar dhe janë të evidentuar në mënyrë jo të plotë në librat e punës;
- nuk është vendosur evidencë për rezervat e materialeve, ndërsa gjendja e detyrimeve në raportet financiare është paraqitur në mënyrë joreale;
- parregullsi në zbatimin dhe realizimin e kontratave të prokurimeve publike, si dhe dobësi gjatë angazhimit të personave të huaj me kontratë në vepër.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi, revizioni zbulon për:

- mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera në institucionet shëndetësore, duke sugjeruar se nuk është siguruar blerja

reale e shërbimeve të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor. Fondi, në kuadër të buxhetit të përcaktuar, në vend të kompensimit të shërbimeve shëndetësore të kryera është i detyruar të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të të gjithë ISHP-ve. Në vitin 2021, 106 nga gjithsej 116 ISHP kanë marrë statusin e paqëndrueshëm për shkak të vëllimit dukshëm më të ulur të realizuar të shërbimeve në krahasim me kompensimin e dakorduar;

- mungesën e informacioneve të plota për kërkesat në bazë të kontributit të papaguar për sigurim shëndetësor dhe arkëtimin jashtëzakonisht të pasigurt të kërkesave të cilat kanë ndodhur përfundimisht më 31.12.2008.


Në pjesën Çështjet e tjera njoftojmë për këtë si në vijim:

- në kushtet e pandemisë, për shkak të mospajtimave të më shumë termineve në ISHP dhe marrëveshjeve të palidhura me IPSH-në për diagnostikimin e Covid-19, nuk janë siguruar shërbime të mjaftueshme shëndetësore për të siguruarit në ngarkim të Fondit. Sipas të dhënave të publikuara

nga Instituti i Shëndetit Publik, nga fillimi i pandemisë në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë kryer gjithsej 2.170.602 teste në gjithsej 33 laboratorë IPSH dhe ISHP. Lëvizja e trendit dhe struktura e testeve PCR të kryera dhe numri i laboratorëve në ISHP dhe IPSH nga fillimi i pandemisë deri në shtator 2022 janë paraqitur në info-grafikët e mëposhtëm:



**NUMRI I
TESTEVE
PCR**




30.06. 2020	30.09. 2020	31.12. 2020	31.03. 2021	30.06. 2021	30.09. 2021	31.12. 2021	31.03. 2022	30.06. 2022	30.09. 2021
-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------

—●— Shëndeti publik

—●— Shëndeti privat



NUMRI I LABORATORËVE



30.06. 2020	30.09. 2020	31.12. 2020	31.03. 2021	30.06. 2021	31.12. 2021	31.03. 2022	30.06. 2022	30.09. 2022
----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------

—●— Laboratorët publik

—●— Laboratorët privat

Numri i testeve të kryera dhe shuma e çmimit të këtyre shërbimeve në laboratorët privatë në periudha të ndryshme thekson shpenzimet e mjeteve financiare të qytetarëve në shëndetësinë private. Të llogaritur me çmimin më të ulët të testeve PCR, për 870.664 teste të bëra në IPSH, bëhet fjalë për shumë jo më pak se 18,6 milion euro, duke mos i

marrë parasysh testet e shpejta të antigjenit dhe çmimet më të larta të arkëtuara të cilat lëviznin edhe deri në 5.500 denarë për test;

Gjithashtu, theksojmë se lista e barnave në ngarkim të Fondit nuk është përditësuar nga viti 2015, dhe njëherazi nuk është miratuar Strategjia Nacionale për E-Shëndetësi.

5.7.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Institucionit Shëndetësor Publik Klinikës Universitare për Radioterapi dhe Onkologji Shkup, për vitin 2021.

Me revizionin e kryer janë konstatuar më shumë gjendje ndër të cilat:

- dobësi në procesin e llogaritjes dhe pagesës së pagave dhe kompensimeve të pagës;
- dobësi në planifikimin, zbatimin dhe kontrollimin e kompensimit të kushtëzuar që ndikojnë në realizimin e qëllimit të tij;
- dobësi në zbatimin e regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve;
- ndërmarrjen e detyrimeve në shumën më të madhe se buxheti i miratuar dhe pagesa jo në kohën e tyre;
- mosharmonizimi ndërmjet evidencës së kontabilitetit dhe materiale dhe gjendjes së përcaktuar nga regjistrimi i barnave dhe materialeve mjekësore, si dhe faturimi jo i plotë i barnave të konsumuara nga spitali ditor dhe
- zbatimi joadekuat i Ligjit për prokurime publike në pjesën e procedurave të zbatuara për prokurimet publike.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi**, raportuam për:

- procedurat për servisimin e pajisjes, për të cilën operatorët ekonomikë kanë pozicion monopol / të drejtë ekskluzive, janë lidhur kontratat për servisim të plotë, ku nuk ekziston mundësia të krahasohet / përcaktohet realiteti i mjeteve të paguara në bazë të vëllimit të shërbimeve të kryera.
- akceleratorin e prokuruar linear nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, i cili deri në ditën e kryerjes së revizionit nuk është futur në përdorim, për arsye që Klinika nuk disponon me hapësirë adekuate në të cilën ai do të mund të instalohet;
- kërkesat e paarkëtuara nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet e kryera shëndetësore sipas programeve për mbrojtjen shëndetësore dhe nga ISHP-të e tjera për shërbimet e kryera ndërklinike, arkëtimi i të cilave është i pasigurt.

Në pjesën **Çështjet e tjera**, raportuam për:

- problemet me të cilat përballet Klinika për shkak të mosdispersimit të shërbimeve shëndetësore në fushën e onkologjisë dhe radioterapisë, edhe pse në territorin e shtetit janë krijuar kushtet për dhënien e këtyre shërbimeve në shumë qendra mjekësore dhe
- Sistemin Nacional për Punën Materiale-Financiare dhe Kontabilitet dhe Sistemin Qendror për Regjistrimin e Orës së Punës pranë Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët nuk janë vendosur në tërësi.

5.8 | ENERGJETIKA



5.8.1 SHA PËR TRANSMETIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE MENAXHIM ME SISTEMIN ELEKTROENERGJETIK, NË PRONËSI TË SHTETIT SHKUP

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit Elektrotransmetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëria Aksionare për transmetim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi të shtetit Shkup, për vitin 2021 (SHA MEPSO Shkup).

Transmetimi i energjisë elektrike është aktivitet i rregulluar energjetik dhe kryhet në përputhje me Ligjin për energjetikë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, rregulloret dhe rregullat e miratuara ose të lejuara nga Komisioni Rregullator për Energjetikë, Shërbimet e Ujit dhe Shërbimet për Menaxhimin me Mbeturinat Komunale (KRRE), si dhe me kushtet për kryerjen e veprimtarisë së përcaktuar në licencat e lëshuara për kryerjen e veprimtarisë energjetike përkatëse.

Konstatuam se rekomandimet e dhëna të revizorit të autorizuar shtetëror në raportin nga zbatimi i revizionit të rregullshmërisë për vitin 2016 që i referohet strategjisë së TI-së dhe kontrollimeve të vendosura të TI-së të sistemeve, në pjesën më të madhe nuk janë zbatuar, që akoma ndikon në prezencën e rreziqeve të larta në proceset financiare të TI-së në funksionimin e shoqërisë.

Shërbimi për revizion të brendshëm, që ka ndikim kryesor në mënyrën e vendosjes së kontrollimeve të brendshme, nuk kryen funksionin si është paraparë me rregullativën ligjore për këtë arsye nuk arrihen qëllimet për të cilat është formuar dhe ndikimi i efektivitetit të sistemit të kontrollimit, posaçërisht në pjesën e përcaktimit në kohë të rreziqeve në veprimtarinë e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (STE) të SHA MEPSO Shkup për të cilin aktivitetet nuk është kryer revizioni i brendshëm.

Konstatuam mosharmonizime me rregullativat, gabime dhe lëshime në pjesën e mënyrës së kryerjes së regjistrimit vjetor, llogaritjen e pagës së punonjësve, mënyrën e trajtimit të rezervave, mënyrën e evidentimit të interesit dhe provizioneve për huat afatgjata dhe mënyrën e pagesës së sponsorizimeve dhe donacioneve që ndikon në realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare.

Edhe pse shërbimet kompetente në vazhdimësi ndërmarrin aktivitete, **nuk është kryer plotësisht konfirmimi** i gjendjes së tokës të evidentuar në librat tregtarë me ç'rast ekzistojnë dallimet ndërmjet gjendjes së kontabilitetit, gjendjes faktike dhe aktzotërimeve.

Në pronësi të SHA MEPSO Shkup është rrjeti elektrotransmetues që përbëhet nga objektet lineare infrastrukturore (**largpërçues**), stacionet transformatorë (**trafostacionet**), **impiantet, objektet dhe mjetet** që janë në funksion të kryerjes së transmetimit të energjisë elektrike dhe menaxhimit me sistemin elektrotransmetues i cili funksionon **në 400 kv dhe 110 kv** nivel tensioni. Konstatuam se **ekziston mosharmonizim në numrin e largpërçuesve dhe trafostacionet të evidentuar** te departamenti kompetent në SHA MEPSO Shkup dhe me të dhënat në evidencën e kontabilitetit.

Disa nga trafostacionet është dashur të jenë në **pronësi të përbashkët** të SHA MEPSO Shkup dhe EVN Maqedoni SHA, sipas aktzotërimeve të lëshuar, janë regjistruar si pronë vetëm e EVN Maqedoni SHA.

Edhe pse SHA MEPSO Shkup po bën përpjekje për regjistrimin e tyre në bazë të Ligjit për transformimin e Elektroekonomisë së Maqedonisë, nga ana e Agjencisë së Kadastrës së Patundshmërive të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në periudhën e kryerjes së revizionit nuk është kryer regjistrimi i tyre në aktzotërimet e shoqërisë. Kjo gjendje ka ndikim në **shumën e tarifës së transmetimit të EE-së**, e cila përcaktohet me vendim nga KRRE-ja të bazuar në të dhënat kontabël dhe evidencat financiare të dorëzuara nga SHA MEPSO Shkup.

Me revizionin konstatuam se **30% e mjeteve materiale në përgatitje** ose 428.352 mijë denarë paraqesin mjete të investuara në periudhën 2005-2019 në pajisje, shërbime konsulente, provizione të paguara për lejin e huave dhe mjete të patërhequra për hua për projekte, për të cilat, për shkak të mungesës së informacioneve, nuk lidhen siç duhet me investimet në mjetet konkrete. Këto mjete materiale në përgatitje nuk janë vënë në përdorim, që ndikon në kostot e amortizimit, me të edhe në rezultatet e realizuara financiare.

Në vitin **2021**, si **rezultat i rritjes enorme** të çmimit të energjisë elektrike në bursat evropiane, **prodhimi i pamjaftueshëm i energjisë elektrike nga prodhuesit vendas** dhe marrja e paautorizuar e energjisë elektrike nga sistemi i elektrotransmetimit nga PPB, kontribuuan që të ardhurat e SHA MEPSO Shkup të realizuara nga tregtarët e energjisë elektrike (EE) – Palët përgjegjëse të bilancit (PPB) dhe SHA ESM Shkup, në bazë të kompensimit për lëshimet

/ zhbancimet për të marrë EE-në nga sistemi i elektrotransmetimit në vitin 2021 të arrijnë 4.210.704 mijë denarë ose 68,5 milion euro, që **paraqet realizim pesë herë më të madh** në krahasim me vitin 2020, kur të ardhurat arritën 841,792 mijë denarë ose 13,7 milion euro.

Pra, në kushtet e rritjes së çmimit të EE-së, një pjesë e tregtarëve - PPB në vazhdimësi e zvogëlonin blerjen e EE-së nga tregu i hapur dhe e shfrytëzonin bilancin e energjisë së SHA MEPSO Shkup për furnizimin e konsumatorëve të tyre. Kjo shkaktoi rritje drastike të shpenzimeve të SHA MEPSO Shkup ndaj sistemit evropian të elektrotransmetimit. **Lëshime / zhbancime jashtëzakonisht të mëdha janë bërë në muajin tetor 2021, për çka nga ana e SHA MEPSO Shkup janë faturuar dhe arkëtuar 77,8 milion kWh nga prodhuesi i EE - SHA ESM Shkup në vlerë të përgjithshme prej 25 milion euro pa TVSH.** Ky është rezultat i faktit se SHA ESM Shkup nuk arriti t'i realizojë planet për prodhimin e EE-së, për shkak të të cilit EE-ja u tërhoq nga sistemi i rrjetit evropian, me çka për SHA MEPSO Shkup është krijuar obligimi ndaj sistemit evropian të elektrotransmetimit në të njëjtën shumë prej **25 milion euro.**

Arsye shtesë që ka çuar në gjendjen e krijuar është edhe mënyra e vendosur e informimit të tregtarëve – PPB, të cilët në mënyrë të kundërligjshme kanë marrë EE nga sistemi i elektrotransmetimit, sepse të dhënat e marra nga MEMO SHPKNJ, nëpërmjet Elektrodistribucionit SHPKNJ **arrijnë me vonesë pas 45 deri në 60 ditë**, për shkak SHA MEPSO Shkup nuk është në gjendje të ndërhyjë shpejt dhe të marrë masa në kohë ndaj tregtarëve - PPB.

Duke pasur parasysh ndikimin e përgjithshëm të cilin e shkaktoi mungesa e EE-së në gjendjen ekonomike në vend, në nëntor 2021 Qeveria miratoi Rreg-

ullore me të cilën²¹ tregtarët - PPB ishin liruar nga obligimi për rritjen e garancisë bankare në bazë të kontratave të lidhura për përgjegjës të bilancit, ndërsa SHA MEPSO Shkup nënshkroi kontrata për riprogramimin e borxheve të tyre të maturuara, por të paarkëtuara. Në dhjetor 2022, **kërkesat në bazë të kontratave të lidhura për riprogramim për EE të tërhequr nga sistemi i elektrotransmetimit janë 883.802 mijë denarë ose mbi 14 milion euro**, ku në raportin e revizionit sugjerohet se ekziston rreziku dhe pasiguria nga arkëtimi i tyre.

Në vitin 2021, **është bërë harmonizimi i vlerës për një pjesë të kërkesave sipas kontratave të riprogramuara nga PPB dhe për gjoba dhe dëme për shkak të ndërprerjes së furnizimit të energjisë elektrike të kontraktuar në vlerë prej 15 milion euro**. Gjatë vitit 2022 është arkëtuar një pjesë nga kërkesat në vlerë prej 1,2 milion euro.

SHA ESM Shkup është prodhuesi më i madh i EE-së në vend dhe në pajtim me Ligjin për energjetikë, është detyruar që furnizuesi Universal - EVN Home SHPK t'i ofrojë për shitje një përqindje të caktuar të EE-së. Duke vepruar sipas Ekstrakteve të Qeverisë, EE që e prodhon SHA ESM Shkup, disa vite më parë, pothuajse e gjithë sasia e prodhuar i shitet furnizuesit Universal me çmim të përcaktuar (të reduktuar), nga Qeveria, i cili është shumë më i ulët se çmimi i tregut dhe çmimi i bursës HUPX. **Mekanizmi i bilancit** në SHA MEPSO Shkup është i dizajnuar në atë mënyrë që për më shumë EE të ndërmerren se sa është planifikuar nga EPS, tregtarët EE - PPB i paguajnë SHA MEPSO Shkup, dhe për EE të paplanifikuar të mbetur në sistemin elektrotransmetues, SHA MEPSO Shkup ka obligim që t'i paguajë PPB-së, sipas çmimeve të barazuara të

përcaktuara sipas Metodologjisë për llogaritjen e çmimit të barazuar, të përcaktuar në Rregullat për Balancimin e Sistemit Elektroenergjetik, i cili ndikohet drejtpërdrejt nga çmimi i bursës HUPX.

Me revizion konstatuam se në vitet 2021 dhe 2022 **ekzistojnë barazime të mëdha të lëshimeve nga sasi të planifikuara të EE-së të SHA MEPSO Shkup. Këto lëshime duhet të ndodhin vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe paraqitja e tyre krijon pasiguri të mëdha në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi këtë bazë dhe ruajtjen e likuiditetit të nevojshëm të mjeteve monetare, si dhe ruajtjen e mekanizmit të bilancit**. Mbi këtë bazë, shpenzimet për suficitin e realizuar të EE-së nga furnizuesi Universal i SHA MEPSO Shkup në vitin 2021 arrijnë në 158,817 mijë denarë pa TVSH, ndërsa të ardhurat e realizuara nga furnizuesi Universal janë 412,404 mijë denarë pa TVSH.

SHA MEPSO Shkup në periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2021 ka lidhur kontratë me **SHA TEC Negotinë**, që ka të bëjë me sigurimin e EE-së në rast të kërcënimit të sigurisë në furnizimin, avaritë apo lëshimet e mëdha të konsumit të EE-së nga sasi të parapara në SEE. Është paraparë që SHA TEC Negotinë të mbajë fuqinë në dispozicion të termocentralit vetëm për nevojat e SHA MEPSO Shkup, për të cilën periudhë janë paguar gjithsej 531,998 mijë denarë me TVSH të përfshirë, nga të cilat në vitin 2021 janë paguar 219,778 mijë denarë. Edhe pse financiarisht u ndihmua termocentrali TEC Negotinë, gjatë paraqitjes së krizës energjetike në tetor të 2021, nuk është kryer aktivizimi i saj për prodhimin e EE-së.

21 Rregullore për kushtet dhe kriteret për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në rast të fatkeqësive natyrore dhe të kohës, avari dhe shqetësime në tregjet e energjisë elektrike, mënyra e furnizimit me energji elektrike në gjendje të krizës, masat që ndërmerren në rast të gjendjes së krizës, si dhe detyrime dhe të drejtat e bartësve të licencave për kryerjen e veprimtarisë së elektroenergjisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 264/21, 300/21 dhe 74/22)

Për balancimin e sistemit elektroenergjetik (SEE), kushti i domosdoshëm është që hyrja totale e EE-së në sistem të jetë i barabartë me totalin e daljes. Konsumi mesatar vjetor i EE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pesë vitet e fundit, është rreth 7,430 GWh, ku pjesëmarrjen më të madhe në konsumin e përgjithshëm me mbi 65% e ka konsumi i amvisërive dhe ndriçimi rrugor. Sipas parashikimeve të SHA MEPSO Shkup në periudhën prej 2025 deri 2030 përshtatshmëria e sistemit për sa i përket energjisë do të plotësohet nga **importi i konsiderueshëm prej rreth 55% të nevojave totale** të EE-së për arsye se prodhimi i **EE-së pritet të jetë në nivel të ulët rreth 3600 GWh** për shkak të reduktimit të funksionimit të TEC Manastir. Me aktivizimin e centraleve nga burimet e rinovueshme të energjisë si dhe centralet elektrike me gaz importi i EE-së do të zvogëlohej.

Me revizion theksuam se për shkak të rritjes së konsumit të EE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nevojiten projekte për prodhimin e madh të EE-së.



5.8.2 GATISHMËRIA E SISTEMIT ENERGJETIK PËR TU BALLAFAQUAR ME KRIZËN ENERGJETIKE

Me revizionin e kryer të suksesit „Gatishmëria e sistemit energjetik për tu ballafaquar me krizën energjetike” ka përfshi periudhën prej vitit 2019 deri në vitin 2022 për t’iu përgjigjur pyetjes: „**Nëse masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente në sektorin energjetik mundësojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë në sigurimin e energjisë elektrike në afat të gjatë?**”. Nga 17 Objektivat e Zhvillimit të Rinovueshme që duhet të arrihen deri në vitin 2030 nga ana e të gjitha vendeve në botë, objektivi 7 - **“Sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë”** është e lidhur ngushtë me këtë revizion të suksesit.

Zhvillimi i sistemit elektroenergjetik në shtet ka filluar në vitin 1909 deri më 2006 kurë u krye privatizimi i shpërndarja e EE, ndërsa prodhimi dhe transmetimi i EE mbetet në pronësi të dy shoqërive në pronësi shtetëror.

1909

Centrali i parë i
energjisë me avull



mbas 1944

Është formuar „Ndërmarrja
federale elektro energjisë“

2005

Ndërmarrja e vetme SHA «Ekonomia
elektrike e Maqedonisë» është e ndarë
në tri ndërmarrje shtetërore (prodhimi,
transmetimi dhe shpërndarja e EE)

2006

Shpërndarja e energjisë elektrike
është e privatizuar, ndërsa prodhimi
dhe transmetimi i energjisë
elektrike i kryejnë dy SHA në pronësi
të shtetit

Republika e Maqedonisë së Veriut disponon **me sasi të kufizuar** të qymyrit dhe nuk disponon me naftë dhe gazin natyror, që shkakton varësi për prokurimin e reagensëve të cilit janë bazë për prodhimin e EE dhe ndodhet në pozitën më të pavolitshëm në krahasim me shtetet në rajone, me ç’ rast nevojat e veta të EE i siguron me 33% import. Prodhimi i EE është **39% nga qymyri, 28% nga uji dhe 2% nga fryma.**

Aktivitetet energjetike me Ligjin për Energji realizohen nëpërmjet: SHA ESM Shkup si prodhuesi më i madhe i EE, SHA MEPSO Shkup e cila është e ngarkuar për transmetimin e EE dhe menaxhimin me sistemin elektrotransmetimit, EVN Home e cila është përgjegjës për shpërndarjen dhe transmetimin e EE, KRE e rregullon dhe kontrollon mënyrën e kryerjes së aktiviteteve energjetike dhe operatorin

e organizimit të tregut të EE – MEMO DDOELL Shkup. Krijimi i politikave energjetike kryet nga Qeveria në koordinim me Ministrin e Ekonomisë dhe Agjencisë për energjetik. Roli i komunave në sistemin energjetik i referohet në pjesën më të madhe realizimit të Programit për efikasitet energjetik.

Dokumenti kyç për realizimin e politikave energjetike në shtet është Strategjia për zhvillim të energjetikës në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040, e miratuar në vitin 2020. Për realizimin e saj është përgatit Draft-Program për realizimin e Strategjisë për periudhën 2021 – 2025, e cila nuk është miratuar ende. Për pajtueshmërinë e shtetit tonë me detyrimet ndërkombëtare të përcaktuara nga politikat, objektivat dhe bashkësisë energjetike për zhvillim të BRE vazhdimisht i nënshtrohen ndryshimeve në rregullativën ligjore. Me ndryshimet e

Ligjit për energjetik në vitin 2022 është shfuqizuar dispozita që parashikon miratimin e planeve strategjike dhe të veprimtimit për BRE, ndërsa objektivat për BRE janë paraparë të caktohen në **Planin për energjetik dhe klima**, të cilët në maj 2022 është miratuar. Këto plane të ligjit parashohin miratimin e „**Plani indikativ për ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE**” me të dhëna për teknologjitë e prodhimit të EE dhe forcën totale të instaluar sipas rajonit në të cilin mund të lidhet sistemi i elektrotransmetimit dhe elektroshpërndarësit. Duka pasur parasysh se forma dhe mënyra e përgatitjes së Planit Indikativ nuk është e përcaktuar, i njëjti nuk është miratuar. **Strategjia për rindërtimin e ndërtesave për ndërtesa banesore, publike dhe komerciale**, e cila duhet të kontribuojë në efikasitet më të madh të energjisë, gjithashtu nuk është miratuar.

Kapaciteti më i madh prodhues i EE nga qymyri në SHA ESM Shkup është **REK Manastir, me tre blloqet e tij**, prej 233 MW secili dhe prodhim vjetor prej rreth 1200 GWh për bllok dhe REC Osllomej në Kërçovë, me fuqi të instaluar të bllokut prej 125 MW. Për nevojat e REK Manastirit kryet eksploatimi i qymyrit-linjit, i cili ka një **vlerë të ulët kalorifik** prandaj nevojitet një blerje shtesë e qymyrit kalorifik për homogjenizimin e tij. Në REC Osllomej, për shkak të shterjes së minierave kryesisht kryet prokurimi i qymyrit. Sasitë e mbetura të eksploatimit të qymyrit në miniera arrijnë në **69,780 mijë tonë**. Në periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2022, pjesëmarrja e TEC e SHA ESM Shkup në prodhimin total të EE në vend tregon trend në rënie me prodhimin më të lartë në vitin 2019 prej 57% dhe prodhimi më i ulët është shënuar në vitin 2021, në të cilin filloi kriza energjetike, prej 39%. Në REC Manastir në periudhën 2019-2022 ka mosharmonizim në mes të sasive të qymyrit të gërmuar, importuar dhe konsumuar me stokun e qymyrit në deponi që ndikon në përcaktimin dhe planifikimin e saktë të sasive të

nevojshme të qymyrit. Në periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2022, për nevoja të REC Manastir dhe REC Osllomej janë lidhur kontrata në vlerë të përgjithshme prej 8.277.906 mijë denarë dhe realizim prej 5.087.078 mijë denarë pa TVSH dhe janë prokuruar gjithsej 1.206 mijë tonë qymyr.

Prokurimi i qymyrit, naftës dhe gazit e cila bëhet nga SHA ESM Shkup është i liruar nga LPP dhe është i rregulluar me udhëzime të brendshme, me të cilat nuk përcaktojnë saktë: dokumentacionin e nevojshëm që duhet të dorëzojë OE, mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe afatet e zbatimit të procedurave që ndikojnë në konkurrencë, cilësinë dhe origjinën e energjisë.

Gjatë planifikimit të procedurave për prokurimin publik të makinerisë së re ndihmëse në REC Manastir, të zbatuar në vitin 2020 dhe 2022, dhe është realizuar në vlerë të përgjithshme prej 1475.123 mijë denarë, nuk janë bërë analiza për të përcaktuar nevojën dhe përfitimin ekonomik të tyre, veçanërisht pasi sasitë e qymyrit për eksploatim janë në rënie, dhe ende përdoren shërbimet për angazhim të makinerive ndihmëse, për të cilat janë lidhur kontrata në vlerë prej 1.530.182 mijë denarë.

Puna e vazhdueshme e TEC Manastir dhe TEC Osllomej është veçanërisht e rëndësishme për plotësimin e nevojave me EE në vend. Në vitin 2022, Blloku 3 i REK Manastir ka qenë jashtë funksionit për 365 ditë, ndërsa Blloku 1 dhe 2 kanë pasur gjithsej 29 ditë jashtë funksionit. Ndërprerja e bllokut 3 çoi në prodhimin më të ulët të EE prej rreth 1,621 mijë MWh EE, të cilat janë të rëndësia të madhe për zvogëlimin e mungesës së EE dhe ballafaqimin me krizën energjetike.

Në periudhën prej vitit 2019 deri 2022, SHA ESM Shkup mungesën e EE e plotëson me blerjen e EE nga tregu i hapur vlere e të cilës shënon trend të rritjes dhe është 87,8 milion euro dhe shpenzimet e të cilave janë më të larta nga të ardhurat e realizuara

nga shitja e tepricave të natës të EE të cilat janë 41,8 milion, që tregon mungesën e EE-së dhe ndikon në likuidimin e shoqërisë.

Edhe pse SHA ESM Shkup ka paguar një shumë të konsiderueshme të mjeteve, ende nuk i ka realizuar të gjitha aktivitetet nga plani operativ për të siguruar lejen për pajtueshmëri me planin operativ. Raportet mujore nga kontrollet e kryera të emisioneve nga lëndët ndotëse, në REC Manastir në periudhën 2019-2022, tregojnë se ka një **tejkallim të emetimeve të të gjitha substancave ndotëse** në ajër mbi vlerat kufitare maksimale të lejuara. Kjo veçanërisht vlen për SO₂ - dioksid squfuri, ku vlera më e lartë e matur në vitin 2022 e tejkalon kufirin e vlerës së lejuar pothuajse njëzet herë.

TEC Negotino është një termocentral e cila është ndërtuar 45 vite më parë dhe në periudhën e mëparshme nuk është kryer modernizimi i saj. Me shfaqjen e krizës energjetike në dhjetor të vitit 2021, ajo u vu sërish në funksion dhe deri në fund të vitit 2022, në bashkëpunim me SHA ESM Shkup, ka prodhuar 412.615 MWh EE, për të cilat janë konsumuar 114.292 t naftë. TEC Negotino nuk është në gjendje të prodhojë EE pa mbështetjen e sistemeve më të mëdha energjetike në vend, ku duke pasur parasysh pozitën jashtëzakonisht të mirë për lidhjen e rëndësishme të rrugëve me vendet fqinje dhe afërsinë e

lumit Vardar, imponohet nevoja për modernizimin e saj në pajtim me strategjitë e zhvillimit të energjisë dhe skenarët e gjelbër, të cilat do të kontribuojnë në uljen e mungesës së EE në vend.

Në periudhën 2019-2022, shumica e "projekteve të mëdha" nuk kanë filluar ose janë me shkallë të ulët të realizimit përveç rivitalizimit dhe modernizimit në TC Manastir Faza II dhe ndërtimi i FEC me kapacitet të instaluar 10 MW (në rrethin e REC Oslomej - FE Oslomej 1) që ndikon në stabilitetin afatgjatë në sigurimin e një sasi e madhe EE dhe duke mbuluar mungesën e EE në vend në afat të gjatë.

Prodhimi i EE nga BRE merr pjesë me rreth 30% në prodhimin e përgjithshëm të EE dhe është një faktor i rëndësishëm për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Interesimi për ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e EE nga BRE shënon një trend në rritje, veçanërisht gjatë kohës së krizës energjetike, kur FEC-të shkaktojnë interesin më të madh, për dallim nga periudha e kaluar kur interesi ishte më i përqendruar tek ndërtimi i HEC-ev.

Mungon informacioni për procedurën për ndërtimin e termocentraleve për prodhimin e EE nga BRE, mënyrën e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe transmetimit dhe të dhëna për kornizën e mundshëm financiar dhe kohor të investimeve, që e bën procedurën komplekse, të ngadaltë dhe jo efikase.



1



Miratimi/pëlqimi i ndërtimit
 (autorizimi mbi 10 MW+nga Qeveria/ Komisioni në ME)



2



Dokumentacion i në lidhje me miratimin për ndërtim
 (projekte, elaborate, dësmi të marrëdhënies pronësore dhe juridike,
 etj.)



3



Dokumentacion i lidhur me kyçje të transmetimit
 dhe shpërndarjes së rrjetit



4



Aprovim për vënien në përdorim të elektro-centralit



5




Licencë për kryerjen e veprimtarisë energjetike

Ekzistojnë dobësi në mënyrën e organizimit të masave për mbështetjen e prodhimit të EE nga BRE në lidhje me përcaktimin e specifikimeve teknike për pajisjet dhe sistemet dhe shitjen e EE-së së prodhuar nga prodhuesit të autorizuar që përdorin premi, që shkakton shkelje të parimit të konkurrencës gjatë dhënies së premive dhe në tregun e EE. Mundësia e shfrytëzuar për të shkëputur kontratat e prodhuesve që përdorin tarifa preferenciale, të cilave në periudhën e kaluar iu dha mbështetje shtetërore në vlerë prej 2.751.025 mijë denarë, u ndikua negativisht gjatë krizës energjetike.


Masat e parapara për përmirësimin e efikasitetit energjetik nga komunat i referohen aktiviteteve të planifikuara në **Programet për energji efikase dhe planet vjetore për realizimin e tyre**, detyrim ligjor

që e respektuan një numër i vogël komunash. Nuk është vendosur platformë për monitorim dhe verifikim, me çka nuk është e mundur monitorimi i të dhënave për llojin e masave të zbatuara për energjinë efikase si dhe kursimet e arritura të energjisë, dhe nuk është shfrytëzuar as mundësia e dhënë në ligj për formimin e Fondit për energji efikase. Komunat, krahas kësaj pjese po përballen edhe me problemet lidhur me mjetet financiare, burimet administrative dhe njerëzore dhe gjatë ndërtimit të kapaciteteve elektroenergjetike.

Për tejkalimin e situatës me krizën energjetike nga ana e Qeverisë janë miratuar detyrë dhe rekomandime për kursimin e EE prej 15%, ku janë arritur kursime në nivel të përgjithshëm, por nga subjektet individuale nuk janë respektuar.



MJETET E SHPENJUARA NGA MBËSHTETJA E NDARË NGA SHTETI



qymyr
naftë

energji elektrike
gaz natyror

MEPSO
të tjera

Mjetet financiare në vlerë prej 17197.808 mijë denarë që Qeveria i ndau në vitin 2021 dhe 2022 si mbështetje shtetërore për prodhuesin më të madh të EE në vend, janë shpenzuar për sigurimin e mbështetjes financiare për prokurimin e burimeve për prodhimin e EE, prokurimi i EE në tregun e hapur dhe kosto të tjera për të ruajtur likuiditetin aktual të shoqërisë për t'u përballur me krizën energjetike.

Me shfaqjen e krizës energjetike në fund të vitit 2021, për shkak të çmimit të lartë të EE, dhe me qëllim për ta shfrytëzuar përparësin që u jepet konsumatorëve të vegjël në Ligjin për energji dhe të bëjnë kursime të mjeteve financiare, një numër i madh i subjekteve juridike dhe komunave që sipas ligjit bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve që duhet të prokurojnë EE në tregun e hapur, themeluan subjekte të reja juridike/shfrytëzuan ato ekzistuese dhe iu bashkuan rrjetit të shpërndarjes dhe përdorën çmime të privileguara të sub-

vencionuar të EE e cila u paguhet konsumatorëve të vegjël dhe amvisërive, që ndikon negativisht në sektorin energjetik dhe në likuiditetin e subjekteve të cilët kryejnë veprime energjetike dhe në rritjen e çmimit të EE.

Nevojiten ndryshime të menjëhershme në mënyrën e menaxhimit me gjendjet në politikat energjetike të shtetit, marrjen e masave dhe aktiviteteve nga ana e institucioneve kompetente për monitorimin e realizimit të kornizës strategjike në nivel shtetëror dhe lokal, përmirësimi i kapaciteteve prodhuese të energjisë nëpërmjet realizimit të projekteve të mëdha investive, përfshirja më e madhe e BRE-së në prodhimin total të EE dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë, të gjitha me qëllim rritjen e gatishmërisë së shtetit për t'u përballur me krizën energjetike.

5.9 SHOQËRIA INFORMATIKE SISTEMET E INFORMACIONEVE



5.9.1 REGJISTRAT BUJQËSORË NË MBPE DHE AUV, DHE PËRDORIMI I TYRE NË FUNKSION TË REALIZIMIT EFEKTIV TË TË DREJTAVE DHE PLOTËSIMIT TË DETYRAVE TË EKONOMISË BUJQËSORE

Kemi kryer revizionin e suksesit - revizioni i sistemeve të informacioneve me temë "Regjistrat bujqësorë në MBPE dhe AUV, dhe përdorimi i tyre në funksion të realizimit efektiv të të drejtave dhe plotësimit të detyrave të ekonomisë bujqësore" për t'iu përgjigjur pyetjes "Nëse menaxhimi dhe kontrollimet në sistemet dhe regjistrat mundësojnë menaxhimin dhe monitorimin efektiv të subvencionimit të ekonomisë bujqësore?".

Në pajtim me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022 është kryer revizioni i suksesit - revizioni i sistemeve të informacioneve.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural kanë vendosur sisteme të informacioneve për menaxhimin me regjistrat në kompetencat e tyre dhe sigurimin e mbështetjes financiare adekuate, por regjistrat e vendosur dhe kontrollimet e vendosur në regjistrat nuk sigurojnë menaxhim efektiv me procesin e realizimit të të drejtave dhe plotësimin e detyrimeve të ekonomisë bujqësore.

Me revizionin konstatuam gjendje të veçanta në fushën e lëndës së revizionit, si:

- regjistri i tokës bujqësore shtetërore mbahehet në mënyrë manuale në tabela në nivel lokal, edhe pse është vendosur sistemi i

- informacioneve që nuk është i përditësuar me të gjitha të dhënat për tokën bujqësore shtetërore me qira;
- regjistri i verërave mbahet në nivel lokal dhe nuk gjenerohet raporti përmbljedhës në nivel shtetëror;
 - në sistemin e RUEB-së nuk janë instaluar mjaft kontrollime të kryqëzuara përkatëse me bazat e të dhënave elektronike përkatëse në kompetencat e institucioneve të tjera, për shkak të të cilave ekonomive bujqësore u mundësohen privilegje në drejtim të arritjes së mbështetjes më të madhe financiare përmes programeve të tjera të cilat i realizon MBPE-ja;
 - ministria nuk ka vendos kontrollime për të shmangur financimin e dyfishtë të ndihmës shtetërore për të njëjtin qëllim të ekonomive bujqësore për shkak të mungesës së evidencës së ndihmës shtetërore të dhënë;
 - në MBPE, AUV dhe AMFBZHR janë plotësuar vetëm 30% e numrit të parashikuar të punonjësve të TI-së, dhe mungojnë politikat dhe procedurat adekuate të TI-së;
 - në MBPE dhe AUV përdoren pajisje kompjuterike të vjetruara dhe sistemi operativ që nuk mbështetet më nga prodhuesi;
 - shkëmbimi i të dhënave ndërmjet regjistrave është jashtë platformës për interoperabilitet;
 - sistemi i informacioneve në MBPE nuk është sanuar plotësisht nga sulmet sajber dhe nuk është në gjendje t'i marrë të dhënat nga regjistri i AUV-së dhe

- në MBPE dhe AUV mungon plani për vazhdimësi në funksionimin që mundëson cënueshmërinë e sistemeve dhe shërbimeve kryesore.

Për tejkalimin e gjendjeve të theksuara kemi dhënë rekomandime me qëllim të marrjes së masave dhe aktiviteteve nga institucionet dhe personat përgjegjës, ndërsa në funksion të vendosjes së politikave efektive për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara me menaxhimin e sistemeve të informacioneve dhe regjistrave në MBPE, AUV dhe AMFBZHR, për shkak të përmirësimit të evidencës së mbështetjes së dhënë shtetërore në bujqësi dhe zhvillim rural, tokën bujqësore shtetërore dhe menaxhimin e qëndrueshëm me subvencionet e ekonomisë bujqësore.

5.9.2 EFEKTIVITETI I SISTEMIT TË INFORMACIONEVE NË DREJTORINË E TË ARDHURAVE PUBLIKE PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE PUBLIKE

Realizuar revizionin e suksesit - revizionin e sistemit të informacioneve me temë "Efektiviteti i sistemit të informacioneve në Drejtorinë e të Ardhurave Publike për administrimin e tatimeve publike", për t'u përgjigjur pyetjes "A mundëson dizajni i sistemit të informacioneve të DAP-së menaxhim efikas, të plotë dhe të qëndrueshëm me tatimet publike?".

Drejtoria e të Ardhurave Publike ka vendosur sistemin e informacioneve për menaxhim me tatimet publike, por dizajni i vendosur i sistemit në tërësi nuk siguron menaxhim efikas dhe të qëndrueshëm me procesin për administrimin me tatimet publike. Për shkak të kësaj është e nevojshme të ndërmerren masa dhe aktivitete shtesë për modernizimin e sistemit, duke mundësuar mjedis më të besueshëm dhe më të sigurt për informacionet dhe të dhënat, si dhe mundëson shërbime të reja të digjitalizuara për institucionet, tatimpaguesit dhe qytetarët.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendje të caktuara në fushat që janë lëndë e revizionit si në vijim:

- të dhënat për tatimpaguesit ndahen në mënyrë distributive në shumë baza të të dhënave, përkatësisht mungon integrimi i bazave të të dhënave që çon në përpunimin e parakohshëm të të dhënave dhe gjenerimin e informacioneve përkatëse për marrjen e vendimeve përkatëse;
- baza themelore e të dhënave është përpunuar në platformë nga gjenerata e vjetër për të cilën nuk ka mirëmbajtje, as mundësi për plotësimin dhe lidhjen me bazat e tjera në kohë reale;
- të dhënat për tatimpaguesit nuk mund të gjenerohen përmes sistemit të vetëm - sistemit të integruar përmes mjedisit të agreguar aplikativ dhe gjenerimit të informacioneve të përditësuara tatimore për të gjitha palët e interesuara nuk është e mundur pa aktivitete shtesë të punonjësve / punonjësve të TI-së së DAP-së;
- nuk është i mjaftueshëm numri i përherëshëm i punonjësve të TI-së për funksionimin normal të sistemit të informacioneve, udhëzimet e miratuara për sigurinë e TI-së janë vjetruar, ndërsa mungon edhe monitorimi i implementimit dhe zbatimit të tyre.

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet nënsistemeve të informacioneve të DAP-së, si dhe shkëmbimi i të dhënave me sistemet e informacioneve të jashtme (regjistrat) organizohet në mënyrën që siguron plotësi dhe saktësi në mënyrë efikase. Shkëmbimi i të dhënave bëhet në përputhje me marrëveshjet e lidhura shumë kohë më parë, por ekziston shkëmbimi i pamjaftueshëm i të dhënave përmes platformës së ndërveprimit për shkak të mungesës së punonjësve të trajnuar të TI-së për të krijuar procedura për zbatimin e shërbimeve të internetit. Ekziston mundësia e futjes / ndryshimit manual të të dhënave të tatimpaguesve pa kontrollim të dyfishtë gjatë futjes fillestare / ndryshimit të të dhënave të tatimpaguesve.

Nga ana e DAP-së për të ardhurat publike nuk është siguruar lokacioni rezervë me hapësirat minimale dhe parakushtet teknike për vazhdimin me punë në kushtet pas katastrofës nuk parashikohen as aktivitete në raste të tilla. Në disa pajisje kompjuterike që përdoren nga DAP-i, janë instaluar sisteme operative të gjeneratës së vjetër, dhe mungojnë një numër i caktuar i licencave për mbrojtje nga viruset kompjuterike.

Për tejkalimin e gjendjes së theksuar kemi dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve nga institucionet dhe personat kompetentë, dhe në funksion të vendosjes së politikave efektive për përmirësimin e gjendjes së përcaktuar me administrimin e sistemit të informacioneve të DAP-së për shkak të përmirësimit të evidencës së tatimpaguesve, evidencës së detyrimeve tatimore dhe menaxhimit të qëndrueshëm me tatimet publike.

5.10

GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS



5.10.1 EFEKTIVITETI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR REFORMA NË SEKTORIN E GJYQËSORIT 2017 - 2022 DHE ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË

Realizuar revizionin e suksesit me temë "Efektiviteti i zbatimit të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017 - 2022 dhe zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë", në pajtim me Programin Vjetor të ESHR-së për vitin 2022.

Qëllimi i revizionit të kryer ishte dhënia e përgjigjes: ***A kontribuojnë masat dhe aktivitetet e përkufizuara në Planin e Veprimit për realizimin e qëllimeve nga Strategjia për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017 - 2022?***

Strategjia për reforma në sektorin e gjyqësorit 2017-2022 është bazë për vazhdimin e reformave në sektorin e drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në Raportet për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga KE-ja, Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe e drejta fundamentale në rrugën e proceseve të eurointegrimi.


Me revizionin është konstatuar se prej 130 masave të përfshira në Strategjinë dhe Planin e Veprimit, vetëm 52% janë realizuar plotësisht, 34% pjesërisht dhe 14% të porealizuar.

Kjo gjendje vjen si pasojë e përkufizimit joadekuat të masave për arritjen e qëllimeve, mungesës së indikatorëve të qartë dhe të matshëm, afateve jo-reale, burimeve të vlerësuara të mjeteve financiare, koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve / trupave kompetentë që janë bartës të masave dhe aktivitetëve.

Me hartimin dhe miratimin e Strategjisë me Planin e Veprimit për periudhën 2017-2022, janë paraparë implikime fiskale nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2018-2021, si dhe mjetet e planifikuara nga IPA dhe ndihma tjetër e huaj.

Nga revizioni i kryer dhe analiza e të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave – CFCD dhe Këshillit Buxhetor Gjyqësor, në kuadër të **Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut** nga mjetet e planifikuara në shumën totale prej **366 milion denarë** për financimin e **15 masave**, më 31.12.2021, gjithsej janë realizuar rreth **74 milion denarë**, gjegjësisht vetëm **20%**.

Për masën 3.1.4-1 nuk janë paraparë
mjete financiare me Plan Veprimin




- Mjetet totale të planifikuara nga Buxheti i Shtetit
- Mjetet totale të realizuara nga Buxheti i Shtetit

Shkalla e ulët e realizimit të mjeteve të planifikuara është për shkak të mosrealizimit të mjeteve të parapara për masën 2.2.8-2 – **Ndërtimi i kushteve të reja hapësinore**, që paraqet 40% e mjeteve të parapara, si dhe mospërdorimi i mjeteve të parapa-

ra në tërësi me masën 4.1.3.5-1 – **Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për rregullimin hapësinor dhe ndarjen e Prokurorisë Publike nga gjykatat**, ku janë planifikuar 15% më shumë mjete sesa nevojiten.

në 000
denarë


**MASAT NGA PLAN I
VEPRIMIT PËR VITET
2017-2022 TË FINANCUAR
NGA BUXHETI I SHTETIT**



■ Mjetet totale të planifikuara nga Buxheti i Shtetit
■ Mjete totale të realizuara nga Buxheti i Shtetit

në 000
denarë

**MASAT NGA PLAN I
VEPRIMIT PËR VITET
2017-2022 TË FINANCUAR
NGA BUXHETI I SHTETIT**



Në lidhje me monitorimin dhe raportimin për zbatimin e aktiviteteve për përmbushjen e objektivave të Strategjisë, revizorët konstatuan lëshime në funksionimin e trupit përgjegjës **Këshilli për ndjekjen e implementimit të Strategjisë**, si dhe në punën e saj pa përcaktuar Metodologjinë për ndjekjen dhe vlerësimin e rezultateve të masave dhe aktiviteteve të zbatuara, me qëllim të vlerësimit dhe

matjes së shkallës së qëllimeve të arritura dhe të realizuara.

Me revizionin e zbatuar u arrit bindja e arsyeshme se masat dhe aktivitetet e përkufizuara në Planin e Veprimit kontribuojnë **pjesërisht** në arritjen e qëllimeve të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit për periudhën 2017 - 2022.

5.11 | RINI DHE SPORT

5.11.1 AGJENCIA PËR RINI DHE SPORT

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Agjencisë për Rini dhe Sport për vitin 2021. Me revizionin e kryer kemi konstatuar gjendjet të cilat orientojnë në parregullsitë e funksionimit të Agjencisë, si dhe gjendjet të cilat ndikojnë në objektivitetin dhe besueshmërinë e raporteve financiare:

- nuk janë vendosur kontrollime të brendshme përkatëse në lidhje me përdorimin e mjeteve të cilat transferohen te Federatat Nacionale të Sportit (FNS) dhe raportet e dorëzuara financiare për realizimin e aktiviteteve të tyre, dhe moskompletimi i revizionit të brendshëm me kuadër adekuat dhe pasiviteti i shërbimit të inspektimit mundëson shfaqjen e parregullsive dhe dobësive në funksionimin dhe pamundësinë e zbulimit dhe korrigjimit të tyre në kohën e duhur,
- personat përgjegjës në Agjenci si dhe Këshilli i Sportit nuk kanë përcaktuar metodologji përkatëse për përgatitjen e listave të rangut të FNS-së, gjegjësisht nuk janë vendosur kriteret për ndarjen e mjeteve dhe për mënyrën e vendimmarrjes dhe kontrollimit të vërtetësisë së të dhënave të cilat janë shprehur në kërkesat të cilat ia dorëzojnë FNS-së,
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e ka miratuar programin pesëvjeçar për zhvillimin e sportit në pajtim me nenin 23 të Ligjit për sport për të përcaktuar qëllimet dhe nevojën për kuadrin e specializuar, nga të cilat do të burojnë kriteret që duhet të merren parasysh në pjesën e ndarjes së mjeteve. Për shkak të kësaj, përcaktimi i shumave me të cilat financohet funksionimi i FNS-së nga Agjencia kryhet në bazë të gjykimit të personave që janë të përfshirë në këtë proces të funksionimit,
- nuk ka vendosur kriteret përkatëse për ndarjen e mjeteve nga programet në përputhje me nenin 24 të Ligjit për sport dhe sistem të mbështetjes objektive, proporcionale dhe të drejtë financiare të FNS-së në pajtim me aktivitetet prioritare afatshkurtra dhe afatgjata, ndërsa kontratat e lidhura nuk përmbajnë dispozita që do të saktësojnë qëllimin e mjeteve të aprovuara. Mandej është kryer alokimi joadekuat i mjeteve buxhetore sipas FNS-së individuale.
- nuk ka përcaktuar formën dhe përmbajtjen adekuate të raportit financiar që duhet ta përgatit FNS-ja, nëpërmjet të cilit do të bëhet lidhja e shpenzimit të synuar të mjeteve me raportet financiare dhe dokumentacionin financiar si vërtetim i shpenzimeve të kryera dhe kontrollimit efikas financiar, me çka krijon mundësi për përdoruesit e mjeteve që të përdorin mjetet e ndara për qëllimet e tjera nga ato të miratuar nga kontratat e lidhura,
- në këtë bazë janë konstatuar dobësi në lidhje me ndarjen e vauçerëve si dhe kontrollimin e shpenzimeve të mjeteve. Pra, në përputhje me nenin 30a të Ligjit për tatimin mbi fitim tatimpaguesve u mundësohet lehtësimi tatimor, gjegjësisht ulja e tatimit mbi fitim e llogaritur në shumën e mjeteve të dhuruara për subjektet sportive më së shumti deri në 50% të tatimit të llogaritur në bazë të vauçerit të lëshuar nga Agjen-

cia. Në procedurën dhe për qëllimet që janë paraparë nga neni 14-d deri në 14-e të Ligjit për sport në bazë të vauçerit të lëshuar nga Agjencia në vitin 2021 sipas kësaj baze shteti ka hequr dorë nga arkëtimi prej 616.920 mijë denarë tatim mbi fitim që janë ndarë me vauçerë të lëshuar në 46 FNS, 664 klube sportive dhe 174 atletë individualë për të cilët përdorimi i synuar i këtyre mjeteve nuk mund të konfirmohet për shkak të mosvendosjes së kontrollimit efektiv të mjeteve të paguara dhe kontrollimeve të dokumentacionit të nevojshëm. Duke pasur parasysh se poseduesit e vauçerëve, kanë detyrime që vetë të gjejnë tatimpagues të interesuar për të dhuruar mjete financiare dhe të realizojnë të drejtën e lirimit nga tatimi, paraqitet rreziku që një pjesë e mjeteve të dhuruara t'i kthehen tatimpaguesit dhe ekziston mundësia e marrëveshjes së ndërsjellë.

- një pjesë e raporteve financiare për mjetet e shpenzuara që janë transferuar në FNS nuk përmbajnë dokumentacion të plotë mbështetës për shpenzimet që janë bërë për të gjitha mjetet që janë transferuar nga Agjencia, një pjesë e dokumentacionit për realizimin e udhëtimeve të sportistëve jashtë vendit është e parregullt ose mungon plotësisht, një pjesë e FNS-së paguan shumën e tepërt të mjeteve personave udhëheqës në federata, ndërsa është kryer transferimi i mjeteve nga llogaritë e dedikuara të FNS-së për klubet sportive pa siguruar dokumentacionin adekuat për shpenzimin e realizuar.
- janë konstatuar dobësi dhe mangësi në lidhje me regjistrimin e zbatuar të mjeteve dhe detyrimeve si dhe saldoja e evidentuar në shumë të konsiderueshme të pozicionit për investime për të cilin nuk kemi marrë shpjegime adekuate në lidhje me objektivitë e tij.

- një pjesë e shpenzimeve për prokurimet e bëra nga FNS-ja në vlerë prej 4,348 mijë denarë për shkak të moszbatimit të procedurave të prokurimit publik në pajtim me Ligjin për prokurime publike, gjë që krijon mundësinë që FNS-ja t'i pranojë shpenzimet në raportet financiare në çmimet më të larta se çmimet e tregut, me çka nuk realizohet ekonomia në shpenzimin e mjeteve buxhetore.
- në pjesën e realizimit të investimeve kapitale për të cilat punon Agjencia, te 6 objekte është konstatuar vonesë e konsiderueshme në realizimin e punimeve të ndërtimit prej ku është paraqitur edhe pasiguria në lidhje me përfundimin e ardhshëm të këtyre objekteve.

Në pjesën e çështjeve kryesore të pasigurisë dhe vazhdimësisë kemi kryer zbardhjen që kanë të bëjnë me:

- iniciimin e 8 procedurave gjyqësore pranë gjykatave kompetente në të cilat Agjencia për Rini dhe Sport është palë e paditur në bazë të kërkesave për dëmshpërblim, borxh nga faturat si dhe për përcaktimin e së drejtës së pronësisë në vlerë të përgjithshme prej 275,149 mijë denarë për të cilat ekziston pasiguria në lidhje me implikimet financiare që do të shkaktojnë në funksionimin e Agjencisë.
- zgjidhjen joadekuate në Ligjin për sport me përfshirjen e Lojërave Universitare me të cilën u jepet mundësia sportistëve që nuk kanë arritur rezultate të larta të ushtruar në drejtën e kompensimit monetar nga kategoria botërore, edhe pse garat në këto lojëra nuk janë në nivele të kampionateve botërore dhe evropiane.

5.12 MJEDISI JETËSOR



5.12.1 TATIMET PËR MJEDISIN JETËSOR NË FUNKSION TË ZBATIMIT EFEKTIV TË POLITIKAVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë ***“Tatimet për mjedisin jetësor në funksion të zbatimit efektiv të politikave për mbrojtjen e mjedisit jetësor”***, me qëllim për të dhënë përgjigje pyetjes: ***“Nëse tatimet për mjedisin jetësor kontribuojnë për avancimin e cilësisë së mjedisit jetësor dhe shfrytëzimin racional të pasurive natyrore?”***

Në pajtim me statistikën oficiale, tatimet për mjedisin jetësor klasifikohen në katër kategori, si në vijim: tatimet për ndotjen, tatimet për shfrytëzimin e burimeve, tatimet energjetike dhe tatimet e transportit.

Nga totali i tatimeve për mjedisin jetësor, me revizion janë përfshirë: tatimet për ndotjen dhe tatimet për shfrytëzimin e burimeve, si dhe një pjesë e tatimeve të transportit për mjedisin jetësor, të cilat për periudhën e përfshirë me revizion prej vitit 2019 deri në vitin 2021 janë 838.142 mijë denarë.

Fushëveprimi dhe dëshmitë të cilat janë siguruar gjatë zbatimit të metodologjisë dhe teknikës së revizionit japin një bazë për të shprehur përfundimin e mëposhtëm:

Korniza strategjike dhe normative, pajtueshmëria kombëtare me legjislacionin e BE-së për mjedisin

jetësor, vendosjen e parimit “ndotësi paguan”, vendosja e kompensimeve për mjedisin jetësor dhe investimeve në fusha të veçanta sigurojnë përparim të caktuar në lidhje me zbatimin e politikave, por i njëjti është i pamjaftueshëm për avancimin e cilësisë së mjedisit jetësor dhe shfrytëzimit racional të pasurive natyrore.

Mungon qasja e integruar në zgjidhjen e problemeve me mjedisin jetësor në nivel nacional dhe lokal, ndërsa administrimi i kompensimeve për mjedisin jetësor nga më shumë institucione nuk mundëson kontroll nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH), kompetent për zbatimin e politikës së mjedisit jetësor.

Nuk respektohet parimi “ndotësi paguan” gjatë përcaktimit të lartësisë së kompensimeve. Subjektet kompetente nuk e llogaritin pjesën variable të kompensimit për lëshimin e ujërave, janë përcaktuar shumë fikse të kompensimeve për menaxhimin e hedhurinave, kompensimet për mbajtjen e lejes integruese ekologjike nuk lëvizin në kornizat e përcaktuara me ligj sipas pikave të emisionit, ndërsa komunat nuk kanë qasje të barabartë gjatë përcaktimit të bazës për llogaritjen e kompensimeve të shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e hedhurinave komunale.

Mungon sistemi unik i informacioneve i cili do t'i përmbajë informacionet dhe të dhënat nga të gjitha institucionet e përfshira në procesin e llogaritjes dhe arkëtimit të kompensimeve, koordinimin dhe komunikimin e rregullt institucional për shkëmbimin e të dhënave, ndërsa Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (ISHMJ) nuk ka kompetenca ligjore për sanksionimin e tatimpaguesve të cilët nuk e kanë paguar kompensimin, që nuk mundëson ad-


ministrim efektiv të të hyrave nga kompensimet e mjedisit jetësor.

Për periudhën nga viti 2020 deri në ditën e kryerjes së revizionit, në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë realizuar të hyrat në bazë të kompensimeve për shfrytëzimin dhe lëshimin e ujërave në vlerë prej 101.616 mijë denarë, për të cilat janë lidhur marrëveshjet, ndërsa përqindja e ujit pa të ardhura në nivel të shtetit prej 60,46% është dukshëm më e lartë se vendet e BE-së (30%).

Për shkak të vendimeve të palëshuara / të lëshuara jo në kohë për pagesën e kompensimit për posedimin e lejes A-integruese, padi jo në kohë dhe jo i plotë, përfundimisht më 31.12.2021, janë realizuar më pak të hyra edhe në buxhetin e MMJPH-së, gjegjësisht, kërkesa të papaguara prej 9.453 mijë denarë, ndërsa janë fshirë 30.273 mijë denarë.



STRUKTURA E MOSHËS SË KËRKESAVE



■ më të vjetra se 2019

■ viti 2019

■ viti 2020

■ viti 2021


Vetëm 37% nga komunat realizojnë të hyra në bazë të kompensimeve për menaxhimin e hedhurinave komunale, mjete të cilat duhet të përdoren për realizimin e planeve dhe qëllimeve rajonale për menaxhimin e kësaj fushe.

Laboratoria qendrore për mjedisin jetësor nuk është akredituar plotësisht, dhe për shkak të mos vendosjes së bashkëpunimit me MMJPH-në, ISHMJ-ja përdor shërbime nga laboratorët privatë të akredituarë, të cilët në të njëjtën kohë kryejnë matjet dhe përgatisin elabore të ndotësve.

Nuk mund të sigurohet treguesi për shkallën e shfrytëzimit të mjeteve nga kompensimet e mjedisit jetësor në lidhje me financimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit jetësor.

Në periudhën 2019-2021, programet për investimin në mjedisin jetësor kanë realizim prej 62,7%, dhe për shkak të mos ndërmarrjes së masave nga palët kontraktues janë ndërprerë marrëveshjet për realizimin e projekteve nga Programi për menaxhimin e ujërave në shuma prej 6.520 mijë denarë.

Mjetet nga buxheti i MMJPH-së nuk janë të mjaftueshme për financimin e aktiviteteve në fushën e ajrit dhe mbrojtjes së natyrës, ndërsa në nivel lokal, mjetet e planifikuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor nuk sigurojnë realizimin e dokumenteve të planit dhe zbatimin e aktiviteteve në zonat prioritare dhe aglomerimet.



5.13 | BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE EKONOMIA E UJËRAVE

5.13.1 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË SË UJËRAVE

Është kryer revizioni i raporteve financiare i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për vitin 2021, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, ku janë konstatuar më shumë gjendje, si në vijim:

- në Sektorin për Çështje Financiare ekziston kufizimi joadekuat i përgjegjësive dhe realizimi jo i plotë i aktiviteteve dhe evidentimi i dokumentacioneve financiare në më shumë evidenca të cilat nuk harmonizohen;
- nevoja për punësime e theksuar në Planin Vjetor të Punësimit nuk është e harmonizuar me numrin e personave të angazhuar në formë të punësimit në kohë të caktuar, nëpërmjet agjencisë private të punësimit dhe kontratës në vepër;
- në funksionimin e sistemit të TI-së së Ministrisë ekzistojnë dobësi për shkak të mungesës së kuadrit të TI-së, mungesës së politikave dhe strategjisë së TI-së, mungesës së evidencës së plotë për harduer dhe softuer me të cilën disponon Ministria, mosfunksionimit të një pjese të pajisjeve dhe të kontratave të lidhura për mirëmbajtjen e sistemit të TI-së dhe një pjese të aplikacioneve;
- një pjesë e regjistrave të vendosur për të cilët kompetente është Ministria nuk janë të pajtueshme dhe të lidhura ndërmjet vete dhe nuk është vendosur sistemi i integruar informativ.
- politika e tokës, menaxhimi me tokën bujqësore dhe dhënia me qira e saj nuk janë kryer në mënyrë efikase për faktin se nuk janë miratuar procedurat interne, nuk është vendosur regjistri funksional i tokës dhe nuk ka të dhëna të plota në evidencat e njësive rajonale për tokën e dhënë me qira dhe për pagesat e evidentuara të qirasë;
- Sektori i Pylltarisë dhe Gjuetisë përballet me mungesën e kuadrit profesional në fushën e së drejtës dhe pylltarisë, nuk miratohen planet për implementimin e dokumenteve strategjike, nuk janë miratuar dokumentet themelore të planit dhe nuk është vendosur kadastrin e pyjeve;
- realizimi i projekteve kapitale për ndërtimin e infrastrukturës së ekonomisë së ujërave, të financuar me mjetet buxhetore, nuk zhvillohet sipas dinamikës dhe vlerës së dakorduar, për këtë arsye janë lidhur anekset;
- për shkak të realizimit jo në kohë të projektit për ndërtimin e sistemit për ujitje me mjetet e huas, për shërbimet konsultative janë rritur shpenzimet dhe pjesëmarrja buxhetore, ndërsa janë paguar edhe provizione për mjetet e patërhequra nga huat për më shumë projekte në shumën totale prej 323 mijë euro;
- regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve nuk është zbatuar në tërësi dhe nuk është kryer harmonizimi me gjendjen faktike, ndërsa evidentimi i mjeteve materiale dhe jomateriale dhe mjeteve materiale në përgatitje nuk është i plotë. Për pjesën më

të madhe të kërkesave nuk është vendosur evidenca analitike sipas komitentëve, nuk ka të dhëna për bazën dhe strukturën e moshës së tyre dhe nëse janë ndërmarrë aktivitete për arkëtimin e kërkesave;

- detyrimet drejt furnitorëve nuk evidentohen në evidencat e kontabilitetit në mënyrën që do të mundësonte paraqitjen e tyre të saktë dhe në kohë në raportet financiare, ndërsa detyrimet afatgjate për huat të cilat i paguan Ministria nuk janë evidentuar në librat afariste;
- janë konstatuar parregullsi në mënyrën e zbatimit të dispozitave të Ligjit për prokurime publike në pjesën e kriterëve joadekuate të vendosura për vlerësimin e elementit cilësia nga ofertat më të volitshme ekonomike që ndikon në procedurat e konkurrencës;
- janë paguar 72.415 mijë denarë në bazë të aktvendimeve të kryera, prej të cilave 51% u referohen shpenzimeve dhe kamatave të paguara në procedurat dhe janë paguar shtesat për pagat e policisë pyjore për më shumë orë të punës se sa të miratuara.
- janë realizuar vetëm 12,6% të Programit për Politikën Fitosanitare për vitin 2021 në pjesën më të madhe për pagesën e kompensimit të komisioneve profesionale për regjistrimin e produkteve fitofarmaceutike;
- pa vendosur evidencë dhe kontrollim të kontabilitetit bëhet prokurimi dhe lëshimi i fletëdërgesave për drunjte e prerë dhe masat e kontrollimit për vënien në qarkullim të miellit;
- janë bërë pagesa në llogarinë e Ministrisë për kompensim për riprodhimin e zgjeru-

ar të pyjeve në vlerë të përgjithshme prej 4.508 mijë denarë, të cilat nuk janë transferuar në dobi të Buxhetit.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi**, raportojmë për këtë si në vijim:

- gjatë vitit 2022 është kryer sulmi kibernetik në sistemin e TI-së së Ministrisë sipas të cilit të gjitha dokumentet dhe evidencat kanë humbur, si dhe posta elektronike e punonjësve;
- gjatë vitit 2021 janë paguar 9.573 mijë denarë për 177 aktvendime të kryera sipas kërkesave të padisë nga ana e punonjësve që u referohen kompensimeve të paguara të parapara me ligj dhe marrëveshje kolektive;
- nëpërmjet buxhetit të Ministrisë janë realizuar projektet kapitale për përshtatjen dhe ndërtimin e stacioneve të filtrimit për ujin e pijshëm dhe rrugën hyrëse deri te stacioni, që duhet të zhvillohet nëpërmjet komunave;
- Ministria paraqitet si e paditur në 124 procedura gjyqësore në të cilat është kërkuar kthimi në shumë prej 434.245 mijë denarë, prej të cilave 77% u përkasin procedurave të ngritura nga personat fizikë dhe juridikë për kompensimin e dëmit material në bazë të ndërprerjes së kontratave për qira;
- në vitet 2021 dhe 2022 janë parashtruar më shumë kallëzime penale në institucionet kompetente për shkak të dyshimit për veprimin e paligjshëm të një pjese të punonjësve gjatë kryerjes së aktiviteteve të punës.



5.13.2 SISTEMI PËR MENAXHIM ME KRIZAT DHE MBROJTJE NGA ZJARRET


Kemi kreu revizionin e suksesit me temë „Sistem për menaxhim me krizat dhe mbrojtje nga zjarret” me qëllim që t’i përgjigjet pyetjes:

„Nëse sistemi i vendosur për parandalim dhe mbrojtje nga zjarret mundëson ruajtje efektive të mjedisit jetësor, shëndetin dhe jetën e njerëzve?”


Në periudhën prej 2019 deri më 2021 zjarret që kanë ndodhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut shkaktuan **dëme të mëdha** në mjedisin jetësor. Në atë periudhë është djegur sipërfaqe prej **29.224,51 ha ose 3%** nga sipërfaqja e përgjithshme pyjore në shtet dhe masa drusore e shkatërruar prej **594.009,68 m³**.



SIPËRFAQJA
 PYJORE E DJEGUR
 DHE MASA
 DRUSORE E
 DJEGUR



Sipas Raportit Vjetor të NP „Pyjet Kombëtare” dëmet materiale të shkaktuara nga zjarret janë të mëdha dhe kapin vlerën e:



Të dhënat tregojnë se për ta rindërtuar sipërfaqen e djegur nevojiten 50 vite.

Nga revizioni i kryer i kornizës ligjore me të cilën rregullohet **sistemi dhe politikat kombëtare për parandalimin dhe mbrojtje nga zjarret** është konstatuar ritëm i ngadalësuar i miratimit të masave strategjike dhe programatike për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarret, **nuk janë paraparë** projekte zhvillimore në zonë dhe **mungojnë** veprimet, aktivitetet dhe procedura me karakter parandalues dhe operativ të cilat duhet ti zbatojnë pjesëmarrësit në Sistemin për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe qasje e pakoordinuar në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar në trajtimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet e tjera.

Me revizionin e kryer konstatuam se nga viti 2018 nuk është miratuar **Strategjia Kombëtare për mbrojtje dhe shpëtim** për periudhë pesë vjeçare dhe **programe vjetore për mbrojtje dhe shpëtim**. Në vitin 2019 Qeveria ka miratuar **Platformën Kombëtare për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat**, por për të njëjtën, për periudhën që është përfshirë

me revizion (2019-2021) nuk është miratuar **Plan i Veprimit**.

Me **Ligjin për pyjet** është paraparë detyrim për Qeverinë pas një propozimi të marrë më parë nga ministri i MBPEU të miraton **Planin Kombëtar për menaxhimin me zjarret në sipërfaqet e hapura**, e cila edhe **pas 9 viteve** nga vendosja e detyrimit për miratimin e tij, **nuk është miratuar** akoma. Për zbatimin e **Planit Kombëtar**, Qeveria në vitin 2013 duhej të formohet **Komiteti Kombëtar**, i njëjti **nuk është formuar**, ndërsa në draft-versionin e Ligjit të ri për pyjet, i cili është në hartim e sipër, ky trup **nuk është paraparë**.

Në pajtim me Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim është paraparë detyrim për miratimin e **Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet e tjera në nivel qendror dhe lokal** të përgatitur nga **Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim**. Revizorët theksuan se **Metodologjia e vlefshme për përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe planifikimin e mbrojtjes dhe shpëtimit** është miratuar në vitin 2006, **nuk i kushton** vëmendje pjesës për **përpunimin e mënyrës dhe procedurës së procesit** të hartimit, analizimit dhe vlerësimit të rreziqeve, si dhe **nuk përmban** kornizë kohore në të cilën është e nevojshme të kryet përditësimi i vlerësimit. Detyrimi i ngjashëm ligjor për përpilimin e **Vlerësimit të rrezikshmërisë së sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet** është përcaktuar edhe në Ligjin për menaxhimin me krizat dhe revizioni konsideron se është e nevojshme institucionet kompetente të ndërmarrin aktivitetet **për shqyrtimin** e nevojës për ekzistencën e dy metodologjive të ndara për të njëjtit lloj të rreziqeve dhe dy vlerësime të cilët kanë përmbajtje pothuajse identike.

Me revizionin e kryer konstatuam se nuk janë siguruar kushtet e **plota** për parandalimin dhe parajlmërim të hershëm në rast të zjarrit në sipërfaqe

të hapur, **veprimi operativ** në kohë gjatë shuarjes së tyre, si dhe **masat për zvogëlimin** dhe rregullimin e pasojave nga zjarret dhe rindërtimin e mjedisit jetësor.

Qeveria në vitin 2018 ka miratuar **Rregullore për shenjat e alarmit, mënyrën dhe procedurat e alarmit dhe veprimet e popullatës**, por e njëjta **nuk është e zbatueshme**, nga arsyeja që **sistemi për paralajmërim dhe alarm**, i cili daton nga viti 1980, **nuk është funksional**.

Me **Vendimin për llojin, numrin, personelin dhe përbërjen materiale të ekipeve të reagimit të shpejtë** të miratuar nga Qeveria dhe **Vendimin për dislokimin e ekipeve për reagimit të shpejtë sipas rajoneve** të miratuar nga drejtori i DMSH-së **në vitin 2006**, është paraparë themelimi i **8 ekipeve** për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri. DMSH i ka formuar ekipet e mbrojtjes nga zjarri, por rajonet në të cilat janë formuar **nuk korrespondojnë** me rajonet e përcaktuara në vendimin për formimin e tyre. Në vend të ekipeve të planifikuara për mbrojtje nga zjarri në **Tetovë, Veles, Shtip dhe Strumicë**, janë formuar ekipe në **Berovë, Valandovë, Gostivar dhe Vinicë**.

Me revizion janë konstatuar dallimet në vlerën e kompensimeve të parapara në Rregulloren për vlerën dhe mënyrën e realizimit të kompensimit të qytetarit në kryerjen e të drejtës dhe detyrimeve në mbrojtje dhe shpëtim, në të cilën janë përcaktuar përqindjet për llogarinë e kompensimit të personave të angazhuara në ekipet për përgjigje të shpejtë në pajtim me titujt të tyre, por nuk është përcaktuar baza mbi të cilën do të llogariten përqindjet e përcaktuara në këtë mënyrë

Mënyra e financimit të veprimtarisë së cilën e kryejnë Njësia Teritoriale Kundër Zjarrit (NJKZ) nd-

ikon në funksionimin efikas të tyre, ndërsa kuadri ekzistues dhe kapacitetet teknike janë të pamjaftueshme.

Me revizion është konstatuar se në aktin e sistematizimit të NP „Pyjet Kombëtare” janë paraparë **250 vende të punës për roje të pyjeve**, por për shkak të mungesës së kriterëve për sistematizim, disa nga filialet përballen me një **numër të pamjaftueshëm të rojeve të pyjeve**, ndërsa në një filiale sipas strukturës madhore dhe realizimit të së drejtës për pensionim, vitin e ardhshëm do të mbesin pa roje të pyjeve.

Gjithashtu në raport me numrin total të **zjarrfikësve të paraparë** në të gjitha NJTKZ-të është **1423, ndërsa numri i plotësuar** i këtyre vendeve të punës është **994 zjarrfikës**²². Me revizion është konstatuar se në rregullativën ligjore **nuk është përcaktuar** numri i zjarrfikësve profesional sipas **madhësisë së zonës të cilën e mbulon NJTKZ, niveli i rrezikshmërisë nga zjarret, lloji i objekteve që mbrohen, numri dhe madhësia e njësive kundër zjarrit në personat juridik dhe numrin dhe madhësinë e njësive vullnetare kundër zjarrit**.

Trajnimi joadekuat i forcave për mbrojtje dhe shpëtim, **e zvogëlon** efikasitetin e institucioneve në ballafaqimin me zjarret në sipërfaqe të hapur.

Personat të cilët udhëheqin me veprimet e shuarjes së zjarrit detyrohen që në afat prej tre muajve duke llogaritur nga dita e marrjes së asaj aftësie të japin **provimin profesional për udhëheqës të veprimit e shuarjes së zjarrit dhe shpëtimin e njerëzve dhe pronës** në pajtim me **Programin për aftësimin e udhëheqësit të veprimit për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e njerëzve dhe pronës**. Provimi mbahet para Komisionit të formuar nga drejtori i DSHM.

²² Burim i informacionit: Informacionet për nevojat dhe Plan të aktiviteteve për shkak rritjes së efikasitetit të sistemit për mbrojtje dhe shpëtim në ballafaqimin me zjarret në sezonin në vijim

Në periudhën lëndë të revizionit **nuk është formuar dhe nuk ka qenë aktive.**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për zjarrfikje në vitin 2017, NJTKZ janë decentralizuar dhe prej MPB-së kalojnë në kompetencat e komunave, me të cilin një pjesë e mjeteve financiare për paga dhe shtesa vazhdojnë të sigurohen nga buxheti i MPB-së, ndërsa nga viti 2019, me Vendim të Qeverisë këto mjete transferohen nëpërmjet llogarisë së MM. Shuma e dotacioneve është përcaktuar në bazë të numrit të zjarrfikësve në kohën e marrjes së kompetencave nga ana e komunave në vitin 2005. Rregullativa ligjore përcakton se komuna pas secilit angazhim të numrit plotësues të zjarrfikësve mbi numrit ekzistues (pas ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit për zjarrfikje) është e detyruar të siguron mjete për pagat e zjarrfikësve nga buxheti personal, që për komunat të cilët realizojnë të hyra më të ulëta është një faktor kufizues gjatë angazhimit të zjarrfikësve dhe mund të ndikon negativisht në rast të nevojës për reagim të shpejtë dhe parandalim në kohë të zjarrit që përhapet në sipërfaqet e hapur.

Për shkak të **mospërputhjeve** të konstatuara në respektimin e dispozitave ligjore të cilat i referohen **rritjes së pagës** të zjarrfikësve profesional për shkak natyrës dhe llojit të punës që kryejnë, disa nga zjarrfikësit kanë filluar **procedurë gjyqësore** pranë gjykatave kompetente, të cilët kanë përfunduar me aktgjykim në favor të tyre. Në bazë të kësaj, **në periudhën prej 2017 deri më 2022**, nga

ana e komunave të cilët u përfshinë me revizion **në emër të borxhit kryesor, shpenzimet gjyqësore dhe të avokatëve janë paguar pothuajse 148 milion denarë.**

Gjendje të ngjashme revizorët konstatuan edhe në QMK, ku për shkak të mos respektimit të plotë të dispozitave ligjore të cilat i referohen punonjësve të cilët detyrat e tyre të punës kryejnë **në ndërtime dhe kujdestari** për të cilat **nuk kanë marrë kompensime**, janë filluar **procedurat gjyqësore** para organeve kompetente të cilët kanë përfunduar në favor të punonjësve. Në bazë të kësaj, **në periudhën 2020-2021** QMK-ja ka realizuar **shpenzime në shumë prej 9 milion denarë, të cilët i referohen borxhit kryesor, interesit dhe përmbauesve.**

Janë konstatuar dhe dobësi sistematike të cilët i referohen **rregullimit jo të saktë** të kompetencave për konfirmim **të të hyrave të realizuara nga kompanitë e sigurimit**, si dhe **mungesë të dispozitës për mbikëqyrje të mjeteve të paguara për riprodhim të zgjatur** nga ana e subjektit të cilët ekonomizojnë me pyjet në pronësi të shtetit dhe privat dhe subjektet juridike të cilët kryejnë qarkullim me dru. Në bazë të kësaj, me revizion përfunduar se **në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë paguar 379 milion denarë.**



5.13.3 PËRDORIMI I UJËRAVE PËR UJITJE

Kemi kryer revizionin e suksesit me temën "Përdorimi i ujërave për ujitje" me qëllim t'i përgjigjemi pyetjes: **"A është siguruar menaxhimi i mirë me sistemet e ujitjes?"**, ku është përfshirë periudha prej vitit 2019 deri në vitin 2021.

Konstatuam se politikat e miratuara, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ushtruesit dhe organet kompetente të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave nuk sigurojnë përdorim racional dhe efikas të ujërave për ujitje dhe menaxhim të mirë me sistemet e ujitjes.

Modeli ekzistues për menaxhimin me sistemet, parregullsinë dhe implementimin jo të plotë të dispozitave ligjore, kompetencat e ndara dhe kapacitetet e pamjaftueshme të institucioneve, dokumentet

themelore të planifikimit të pamiratuara dhe objektivat dhe prioritetet strategjike të pacaktuara për menaxhimin me ujërat, rezultuan me mospërbushjen e qëllimeve për ekonomizimin ekonomik, përdorimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes.


Përafërsisht mjetet totale në dispozicion nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut **92,2 milion euro** dhe nga kreditë **193 milion euro**, janë të dedikuara për ndërtimin e hidrosistemeve shumëpërdorimëshe dhe rikonstruksionin e sistemeve të ujitjes, realizimi i të cilave nuk zhvillohet në pajtim me dinamikat e planifikuara dhe për të cilat, për shkak të fillimit të aktiviteteve jo me kohë, janë paguar provizionet për mjetet e papërdorura.

Në mungesë të kriterëve objektive për zgjedhjen e projekteve të cilat do të financohen nga mjetet buxhetore, është dhënë prioriteti për realizimin e projekteve për ndërtimin e tri rajoneve, ndërsa për të tjerat nuk janë siguruar mjetet, kurse për rehabilitimin e digave dhe sistemeve të ujitjes janë dedikuar vetëm 1% nga mjetet e siguruar, të paraqitur në grafikun si në vijim:



në 000
denarë

PROJEKTE TË FINANCUARA NGA MJETET BUXHETORE PER INVESTIME KAPITALE NE INFRASTRUKTUREN E EKONOMISE SE UJËRAVE PLANI 2015-2025




Është konstatuar **realizimi i ngadalësuar dhe përm-bushja jo e plotë** e qëllimeve për ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së ekonomisë

së ujërave në vend me mjetet e huas në bankat e jashtme ose institucionet ndërkombëtare financiare, të paraqitur në grafikun si në vijim:

në 000
denarë

KONTRATA TË LIDHURA PËR HUA



⚠ nuk janë lidhur kontrata me kooperativat bujqësor; në vitin 2022 dergohet ujë për ujitje gjeneron shpenzime të larta për energji elektrike

⚠ nuk ka realizim të programit (faza e zgjedhjes së konsulentit) nuk janë tërhequr mjetet nga huat 80.000 euro provizion vjetor për mos tëheqjen e mieteve nga huat

⚠ realizimi nuk ka filluar ende


⚠ për rehabilitim të sistemeve në Bregalnice, Tikvesh dhe Pollog - mirëmbajtja e shpërfillur pajisja e vendosur është larguar

Është konstatuar **ndarja e pabarabartë e mjeteve dhe shkalla e ulët e realizimit** të projekteve nga **Plani për investim në infrastrukturën e ekonomisë së ujërave për periudhën 2015-2025** me të cilën janë paraparë investime në ekonominë e ujërave në vlerë prej **19,88 miliardë denarë ose mbi 323**

milion euro. Nga gjithsej investimet e kontraktuara në vlerë prej 5.667,556 mijë denarë, deri në qershor 2022 janë paguar 3, 250.507 mijë denarë, që është 16% nga mjetet e parapara, të paraqitura në grafikun si në vijim:

ha

PLANË PËR INVSETIME NË INFRASTRUKTURËN E EKONOMISË SË UJËRAVE 2015-2025




Gjithashtu, theksojmë se në një pjesë të madhe është shpërfillur mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve ekzistuese të vjetruara dhe pjesërisht jofunksionale, për shkak se në vazhdimësi zvogëlo-

hen sipërfaqet e ujitura nëpërmjet sistemeve, ndërsa 2/3 e sipërfaqes bujqësore ujitet jashtë sistemeve ose nuk faturohen, të paraqitur në grafikun si në vijim:

ha

SIPËRFAQE TË UJITURA DHE SHFRYTËZEUS TË UJIT



⚠️
17% nga sipërfaqja totale [144.894 hektar] e cila ë shtë e pajisur me sisteme për ujitje, ujitjet nëpërmjet **ushtruesit e veprimtarisë së ekonomisë së ujërave**

⚠️
Rreth **80.000 bujq** në vit ujitin rreth **60.000 hektar** sipërfaqe bujqësore jashtë nga sistemet për ujitje me sisteme të pajisura vetë ose nuk tregohen nga ana e ushtruesve të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave


⚠️
Gjendja e keqe në të cilën gjen-den sistemet i ka detyruar **63.691 bujq** të investojnë në sisteme-bunar personale ose **1/2 i tyre të cilët kanë** ujitje realisht [sipas regjistrimit të fundit të bujqësisë nga viti 2007]

Edhe përkundër aktiviteteve që i ndërmoren punonjësit në filialet e SHA Ekonomia e Ujërave, në kushtet e mungesës së mjeteve financiare, personalit, mekanizmave, pajisjeve dhe pjesëve rezervë nuk janë në gjendje t'i realizojnë aktivitetet e planifikuara për mirëmbajtjen dhe të sigurojnë funksionim të plotë të sistemeve. Në të njëjtën kohë edhe pse me programin buxhetor janë ndarë mjete për investimet tjera në infrastrukturën e ekonomisë së ujërave, shkalla e realizimit të aktiviteteve të planifikuara është shumë e ulët, për shkak të zbatimit joefikas të procedurave për prokurimet publike nga ana e SHA Ekonomia e Ujërave.

Në mënyrë plotësuese, çmimet në bazë të së cilave faturohet shërbimi i ujitjes nuk sigurojnë qëndrueshmëri, respektivisht mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemeve dhe ngarkesën proporcionale të përdoruesve, ndërsa mënyra e vendosur e faturimit nuk siguron arkëtim dhe përcaktim të plotë të kompensimeve.

SHA Ekonomia e Ujërave në vazhdimësi planifikon mbi 7.000m³ ujë për hektar sipërfaqe, edhe pse norma për ujitjen e kulturave të cilat kërkojnë ujitje më intensive është 4788m³ ujë për hektar, ndërsa shumica e kulturave kërkojnë më pak ujë. Nga ana tjetër, në vazhdimësi theksohet se rreth 20% sipërfaqe më pak nga të planifikuarat, ndërsa janë treguar disa herë më shumë sasi të ujit të konsumuar nga të planifikuarat për të njëjtat sipërfaqe. Kjo, në pjesën më të madhe është rezultat i kontrollimit të pavendosur të shpenzimit të ujit, gjendja e keqe në të cilën gjenden sistemet dhe planifikimi joadekuat. Pikërisht, jo vetëm që janë planifikuar sasi disproporcionale të larta të ujit për njësi sipërfaqe, realisht janë konsumuar sasi më të mëdha uji, të cilat janë dukshëm më të larta se sa nevojitet realisht për ujitjen e sipërfaqeve të njëjta, të paraqitur në grafikun si në vijim:





Duke pasur parasysh se kompensimi për ujitje arkëtohet në vlerë fikse sipas kulturës dhe sipërfaqes së lajmëruar, gjegjësisht nuk merret parasysh sasia e harxhuar reale e ujit, kjo gjendje do të thotë se uji i harxhuar më shumë paraqet humbje, respektivisht për të nuk arkëtohen të ardhurat. Kjo gjendje është theksuar veçanërisht në vitet 2019-2021 kur janë harxhuar mbi 451 milion, gjegjësisht 92 milion m³ ujë mbi të planifikuarën. Me atë ujë, të llogaritur sipas normës së lartpërmendur në dy vitet do të mund të sigurohej ujitja intensive e 113 mijë hektarëve shtesë, që të llogaritur sipas çmimit më të ulët prej 2 mijë denarë për hektar, është të paktën 226.000 mijë denarë ose rreth 3.6 milion euro humbje të të ardhurave për SHA Ekonomia e Ujërave.

Në mënyrë plotësuese, institucionet kompetente ballafaqohen me mungesën e vazhdueshme të kuadrit cilësor dhe profesionist. SHA Ekonomia e Ujërave ka shuma të larta të kërkesave të paarkëtuara nga përdoruesit e shërbimeve të tyre dhe detyrime të papaguara kundrejt shtetit, furnizuesve dhe punonjësve, ndërsa disa nga ndërmarrjet publike të Ekonomisë së Ujërave, hidrosistemet e të cilave janë të parindërtuara dhe nuk funksionojnë në kapacitet të plotë ballafaqohen me mungesë të vazhdueshme të mjeteve financiare për punën e rregullt dhe për servisim të detyrimeve kreditore, për këtë arsye përdorin mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën kohë ata realizojnë humbje të vazhdueshme nga puna të cilat për tri vitet e fundit shuma është mbi 1,3 miliardë denarë ose mbi 20 milion euro.

SHA Ekonomia e Ujërave në vitin 2021 nuk ka bërë pagesa në dobi të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të TVSH-së në shumën prej 56.571 mijë denarë dhe kompensimit për përdorimin e ujit në disa baza në shumën totale prej 30.150 mijë denarë.

Gjendja joadekuate e sistemeve dhe menaxhimi joadekuat i tyre, shpie në ngarkesën shtesë financiare të ofruesit të shërbimeve për ujitje për arsye të pagesës së dëmeve dhe padive nga përdoruesit në bazë të tharjes ose vërshimeve të plantacioneve dhe mbjelljeve. Në vitin 2022 NP Strezhovë ka paguar rreth 61 milion denarë në bazë të dëmit ose përafërsisht një milion euro, ndërsa SHA Ekonomia e Ujërave zhvillon procedura gjyqësore në bazë të dëmeve në shumë prej 142.070 mijë denarë ose përafërsisht rreth 2,3 milion euro.

Vlera totale aktuale e objekteve, impianteve dhe pajisjeve të ekonomisë së ujërave të operatorëve të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave arrin në mbi 210 milion euro, por për shkak të sistemeve të ndërmarra jo të plota për ujitje dhe evidentimi jo i plotë, ajo nuk e pasqyron sasinë dhe vlerën e përgjithshme të sistemeve të ujitjes në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në evidencën e SHA Ekonomia e Ujërave nuk është futur vlera e sistemeve të rikonstruara për ujitje nga projekti Lugina e Vardarit Jugor në vlerë të përgjithshme prej 1.109.701 mijë denarë, si dhe digat e rikonstruara për të cilat nuk ka të dhëna për vlerën. Në të njëjtën kohë marrëdhëniet pronësore juridike të parregulluara dhe aktzotërimet e pasigurta e bëjnë të pamundur realizimin e së drejtës së pronësisë dhe posedimit të tyre.

Theksojmë se, sipas Komisionit për Digat, është i nevojshëm riparimi urgjent i disa digave me të cilat menaxhon SHA Ekonomia e Ujërave, të cilat një periudhë të gjatë nuk janë mirëmbajtur dhe riparuar dhe nuk është ndjekur siguria dhe stabi-

liteti i tyre, ndërsa disa prej tyre janë lëshuar deri në nivelin që i bën të dëmtuar me rrezik të papranueshëm për mjedisin.

Regjistrat dhe bazat e të dhënave ekzistuese për sipërfaqet bujqësore të mundshme dhe të ujitura dhe përdoruesit e ujit për ujitje nuk janë kompatibilë dhe të përditësuar, për shkak se nuk ka informacione të sinkronizuara për shkallën e përdorimit dhe për nevojat reale të sistemeve të ujitjes.

Nuk ka evidencë të kompletuar dhe të përditësuar të lejeve të lëshuara për të drejtën e ujit, një sasi e madhe nga uji për ujitje përdoret pa siguruar leje, dhe njëherazi nuk ka sistem për ndjekjen e gjendjes së konsumimit dhe gjendjen e bilancit të ujit në vend, që veçanërisht është theksuar me rezervat e ujërave nëntokësorë. SHA Ekonomia e Ujërave ka siguruar 13 leje për të drejtat e ujit të cilat i referohen vetëm një pjese të sistemeve dhe akumulacioneve më të mëdha për ujitje, dhe në të njëjtën kohë ka siguruar 64 leje për nxjerrjen e rërës, zhavorreve dhe gurëve nga lumenjtë, që udhëzon në prioritetet e përcaktuara joadekuate.

Sistemi i pavendosur i kontrollimit në menaxhimin e ujërave, mungesa e matjes së sasisë dhe cilësisë së ujit të konsumuar për ujitje, planifikimi joadekuat dhe gjendja e keqe e sistemeve që janë ndërtuar 50 vite më parë, shpien në përdorimin joracional dhe të papërshtatshëm, si dhe në prishjen e cilësisë së ujit.

5.14

FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET KOMUNALE

5.14.1 NPK KOMUNALEC SVETI NIKOLLË

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021 në Ndërmarrjen Publike Komunale "Komunalec" Sveti Nikollë për vitin 2021.

Me revizionin e kryer janë konstatuar gjendjet e caktuara, ndër më të rëndësishmet janë:

- mungojnë procedurat e miratuara të shkruara me kompetenca dhe përgjegjësi të kufizuara dhe të përkufizuara për aktivitetet e rëndësishme në lidhje me operacionet ekonomike: rrjedha e dokumentacionit për secilin nivel të përgjegjësive, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi të personave të përfshirë në proceset dhe sistemi për monitorimin dhe kontrollimin gjatë marrjes dhe lëshimit të dokumentacionit kontabël, miratimi dhe pagesa e tij.
- nuk është respektuar plotësisht detyrimi për lidhjen e kontratave me përdoruesit e shërbimeve të ujit të pijshëm dhe me ofruesin e shërbimit për ujin e shpërndarë.
- mungon sistemi i vendosur për përzgjedhjen e mbetjeve të krijuara si një nga parakushtet për uljen e sasisë së tyre, dhe në funksion të mbrojtjes së mjedisit jetësor, nuk është kryer matja e mbetjeve të larguara dhe nuk është vendosur evidenca përkatëse;
- nuk janë realizuar aktivitetet e përcaktuara në pajtim me Programin Vjetor të NPK-së, ndërsa gjatë kontrollimit në terren vëmë re një zjarr aktiv në hedhurishte i cili ndikon në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.
- humbja e ujit në sistemin e ujësjellësit prej 38% për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ku shkarkohet sasi e madhe e ujit nga sistemi, pastrimi i filtrave dhe sedimenteve në stacionin e filtrimit, ujitja e sipërfaqeve të gjelbra publike, shkarkimi i ujit në shatërvanët e qytetit për pastrimin dhe rimbushjen e tyre, çezmat e qytetit, lidhjet pa leje dhe ilegale, vjedhjet e ujit dhe të ngjashme.



Hedhurishtja "Mavrovicë"

- shlyerja e parakohshme e detyrimeve për kompensimin e përdorimit të ujit dhe shkarkimit të ujit nga NPK Komunalec Sveti Nikollë në shumë prej 2.066 mijë denarë janë realizuar më pak të ardhura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
 - janë realizuar më pak të ardhura edhe në Buxhetin e Komunës së Sveti Nikollës, si rezultat i shlyerjes së parakohshme të detyrimeve për kompensim për ruajtjen e pastërtisë publike në shumë prej 24,834 mijë denarë dhe 104 mijë denarë në bazë të kompensimit të mbetjeve.
 - janë përcaktuar gjendjet në pjesën e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, gjendja e të cilave me vite është aktuale dhe nuk mundëson harmonizimin ndërmjet evidencës kontabël dhe gjendjes faktike (regjistrimi i parealizuar i tokës, mjeteve materiale në përgatitje, nuk është kryer kontrollimi i realitetit të shumave të deklaruara të kërkesave dhe detyrimeve në bazë të dokumentacioneve të jashtme dhe të brendshme).
 - në regjistrat tregtare nuk është kryer regjistrimi i kryegjësë themelore dhe nuk është përcaktuar vlera e tregut të pronës, ndërsa në librat tregtare janë evidentuar tokat dhe objektet për të cilat nuk janë siguruar dokumentet për pronësinë, ndërsa vlerësimi i pozicioneve të bilancit nuk është në përputhje me SNK-në.
 - NPK nuk ka ndërmarrë masa për arkëtimin e kërkesave në vitet e mëparshme, por nuk është kryer as vlerësimi i shkallës së arkëtueshmërisë së tyre për shkak të veprimeve të mëtejshme.
 - është konstatuar se dy mjete ngarkuese dhe traktor me dedikim për grumbullimin e mbeturinave në vitin 2021 nuk kanë leje komunikacioni të vlefshëm, ndërsa janë shfrytëzuar në vitin 2021 dhe për to nuk janë evidentuar shpenzimet për karburant në shumë prej 514 mijë denarë dhe për riparime në shumë prej 322 mijë denarë.
 - janë konstatuar parregullsi në procesin e ndarjes dhe realizimit të kontratave për prokurime publike, por janë bërë shpenzime për vendosjen e sistemit parking-menaxhment pa siguruar më parë lejet dhe dokumentacionin e projektit.
- Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi, revizioni theksoi se për shkak të pamundësisë për t'i paguar me rregull detyrimet ndaj NP Zletovicë SH nga ana e NPK "Komunalec" Sveti Nikollë të cilat më 31.12.2022 janë përcaktuar në shumë prej 10,242 mijë denarë dhe kamatë penale në shumë prej 4,128 mijë denarë ekziston mundësia që NP Zletovicë SH të ndërmerr masa shtesë për arkëtimin e kërkesave, që do të ndikonte negativisht në gjendjen financiare të NPK-së në periudhën e ardhshme.** Gjithashtu, theksojmë se në vitin 2020 është bërë rikonstruksioni i një pjese të stacionit të pastrimit, në kuadër të projektit Interreg IPA SVS programi për bashkëpunim midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet komponentit BIOREAL në shumë prej 9.239 mijë denarë e cila deri në vitin 2010 ka qenë jofunksionale. Përkundër rindërtimit, stacioni i pastrimit në vitin 2020 pjesërisht ka punuar, ndërsa nga viti 2021 përsëri nuk është në funksion.
- Ekziston pasiguria në bazë të rezultateve nga gjithsej 12 procedura gjyqësore të cilat janë në rrjedhë, me shumën totale prej 3.347 mijë denarë.


5.14.2 NP UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI - SHKUP

Ndërmarrja Publike Ujësjiellësi dhe Kanalizimi – Shkup është themeluar për kryerjen e veprimtarisë komunale si veprimtari me interes publik në zonën e Qytetit të Shkupit. Themelues i ndërmarrjes është Qyteti i Shkupit i cili i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji për ndërmarrje publike dhe rregullat tjera ligjore. Ndërmarrja ishte themeluar në vitin 1946 si ndërmarrje tregtare e qytetit "Ujësjiellësi", me Vendim të Kuvendit Popullor të atëhershëm të Qytetit, ndërsa si ndërmarrje publike ishte themeluar me Vendim për ndarje të ndërmarrjes publike "Komunalec" – Shkup në vitin 1992.


NP Ujësjiellësi dhe Kanalizimi Shkup furnizon me ujë të pijshëm popullsinë prej mbi 600.000 banorë të Qytetit të Shkupit për çka shfrytëzon ujë prej dy zonave burimore Rashçe 1 dhe Rashçe 2 dhe nga 7 puse në zonat e puseve Lepenec dhe Nerezi. Përfshirja bëhet në bazë të Lejes²³ dhe Vendimit²⁴ të lëshuar nga MMJPH.

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të NP Ujësjiellësi dhe Kanalizimi Shkup për vitin 2021, gjatë të cilit konstatuam:

- në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2022 sasia e ujit të prodhuar devijon ndjeshëm nga sasia e ujit me të ardhura, përkatësisht përqindja e ujit pa të ardhura lëviz rreth 60% që është dyfishi më i lartë se niveli i saj optimal i paraparë me Strategjinë për reduktimin e ujit të humbur në sistemin e furnizimit me ujë të Qytetit të Shkupit.



PËRQINDJA E UJIT PA TË ARDHURA NË PERIUDHËN 2017-2022



23 Leje për përdorim të ujit nr. 11-4914/7 nga 02.01.2014

24 Vendim për vazhdimin e afatit kohor të lejes УП11-11/5-929/2019


→ me kontrollimin e kryer në kontratat e lidhura, konstatuam se nga gjithsej 295.750 shfrytëzues, deri në ditën e njoftimit të revizionit, NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Shkup nuk ka lidhur kontratë për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella me 30% të shfrytëzuesve të shërbimeve (89.634 shfrytëzues), mund të shkaktojnë arkëtimin më të vështirë të shërbimeve të kryera dhe paraqesin vështirësi për realizimin e vazhdueshëm të të drejtave dhe detyrimeve të ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve. Pjesa më e madhe e shfrytëzuesve me të

cilët nuk është lidhur kontratë, 97% janë nga kategoria e amvisërisë, ndërsa 3% janë nga kategoria ekonomike.

→ Detyrimet e shprehura, por të papaguara ndaj Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të kompensimit të papaguar të përdorimit të ujit dhe kompensimit të shkarkimit të ujit prej shumë viteve më parë (para viteve 2017-2022) kapin shumën prej 185.543 mijë denarë.

në 000
denarë

**KOMPENSIMET E ARKËTUARA PËR
PËRDORIMIN E UJIT DHE PËR SHKARKIMIN
E UJIT NGA NP UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI
SHKUP DHE DETYRIMET E PAGUARA
AKTUALE NË BUXHETIN E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT 2017-2022**



- regjistrimi i kryer i mjeteve dhe detyrimeve në fund të vitit nuk është zbatuar në tërësi dhe në mënyrë të rregullt në pajtim me Rregulloren për kryerjen e regjistrimit, që ndikon në paraqitjen reale dhe objektive të të dhënave në raportin financiar – Bilanci i gjendjes më 31 dhjetor, si dhe cilësinë e informacioneve të cilat i ofron ai.
- tokat dhe objektet ndërtimore përfaqësojnë 83% të vlerës totale të mjeteve materiale të shoqërisë, me çka janë konfirmuar:
 - të drejtat pronësore të parregulluara në AKP për tokën dhe një pjesë të objekteve ndërtimore të cilat në librat afariste janë evidentuar në shumë prej 100.729 mijë denarë,
 - për 14 objekte²⁵, të cilat NP i përdor, për shkak të mungesës së dokumentacioneve shoqëruese për përcaktimin e vlerës së mjeteve dhe pranimit-dorëzimit, nuk janë evidentuar në evidencat materiale dhe kontabël dhe për to nuk llogaritet amortizimi;
 - mosharmonizimi i evidencës materiale për objektet lineare me të dhënat nga aktzotërimet dhe të evidencës, si dhe tokat dhe objektet, të cilat janë evidentuar në evidencat kontabël, por për to nuk janë siguruar dokumente të rregullta dhe të besueshme me të cilat nuk mund të konfirmohet saktësia e tyre.

Gjendjet e theksuara ndikojnë në parametrat gjatë formimit të çmimit të tarifave për shërbimet e ujit, e cila formohet në pajtim me Metodologjinë për

caktimin e tarifave për shërbimet e ujit dhe është miratuar nga KRRE-ja në bazë të të dhënave zyrtare nga evidencat kontabël dhe raportet financiare të dorëzuara nga NP Ujësjiellësi dhe Kanalizimi Shkup.

- Evidenca kontabël e mjeteve materiale dhe jomateriale në shumë prej 269.447 mijë denarë është vendosur në kohë jo të duhur dhe joadekuate;
- Janë konstatuar edhe dobësi në zbatimin e Ligjit për prokurime publike, ndër të tjera edhe në pjesën e sigurimit të konkurrencës, trajtimit të njëjtë të të gjithë pjesëmarrësve të operatorëve ekonomikë në zbatimin e procedurës, si dhe të përdorimit racional dhe efikas të mjeteve në procedurat për ndarjen e kontratave për prokurime publike.

Gjithashtu, konstatuam edhe gjendje që kanë të bëjnë:

- nuk janë dorëzuar raportet gjashtëmuajore për punën e ndërmarrjes, me çka është zvogëluar transparencja gjatë informimit të llojit dhe fushëveprimit të kryerjes së veprimtarisë, si dhe për punën financiare të ndërmarrjes;
- gjatë punësimit të punonjësve të rinj nuk sigurohen njoftimet për mjetet e siguruar financiare nga organet kompetente;
- kontributi themelues i ndërmarrjes nuk është i shënuar në regjistrin kompetent;
- mjetet e tërhequra pas regjistrimit, janë larguar nga evidenca kontabël, edhe pse nuk janë ndërmarrë masa të më-

25 SPUZ Vollkovë, Stacion pompimi në Shuto Orizarë (objekt i ri), Puset Draçevë, Punkt Ujësjiellësi Avtokomandë dh e zyrë në Avtokomandë, Baraka rr. Petar Çajkovski dhe Rezervarët: Radishan zonë e ulët i Ri, Sopishtë i vjetër, Ujësjiellësi, Vendbanimi për fundjavë Morane, Studeniçanë, Porupi, Usje dhe moçal në Kuçevishtë

tutjeshme për tjetërsimin ose shkatërrimin e tyre;

- nuk është kryer harmonizimi i stoqeve të pjesëve rezervë, lëndëve të parë dhe materialeve, të cilat janë prokuruar para vitit 2017;
- parregullsi në mënyrën e llogaritjes së pagave për nëpunësit administrativë.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi i theksojmë çështjet e mëposhtme që kanë të bëjnë me:


- Nevojën për rishikimin e vendimit të miratuar për shumën e tarifës së paguar nga SHA në pronësi private për shërbimin e kryer për furnizimin me ujë dhe përcaktimin real të vlerës së tij. Në fakt, në periudhën prej vitit 2016 deri në periudhën e përfundimit të revizionit, çmimi i shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm për SHA në pronësi private është dukshëm më i ulët se çmimi i shërbimeve për kategorinë e ekonomisë, që ka kontribuar që NP Ujësjellësi dhe Kanal-

izimi Shkup, për 1.020.059 mijë denarë për të fituar më pak të ardhura në bazë të shërbimit të shfrytëzimit të ujit, dhe kështu të deklarohen për 100.883 mijë denarë më pak TVSH dhe për 22.705 mijë denarë më pak për të llogaritur kompensimin për shfrytëzimin e ujit, i cili paraqet të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Nevojën për analizë të hollësishme të kërkesave nga blerësit dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, të cilat shënojnë trend të vazhdueshëm të rritjes në periudhën nga viti 2018 deri në ditën e kryerjes së revizionit që mund të ndikojë negativisht në likuiditetin e NP në periudhën e ardhshme.


në 000
denarë

KËRKESAT NGA BLERËSIT NË PERIUDHËN PREJ VITIT 2017 DERI NË VITIN 2021



në 000
denarë

DETYRIME NDAJ FURNITORËVE PREJ VITIT 2017 DERI VITIN 2021




→ Në bazë të analizave të zbatuara të shpenzimeve për avokatë, noterë, përmbarues (shërbime juridike) dhe shpenzimeve gjyqësore përcaktuam se në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2021, shpenzimet për angazhimin e avokatëve, noterëve dhe përmbaruesve për përgatitjen e urdhërpagesave noteriale për borxhet e papaguara ndaj NP Ujësjetllësi dhe Kanalizimi Shkup nga amvisëritë dhe bizneset, gjithsej janë 492.533 mijë denarë, ose përafërsisht 8 milion euro dhe shpenzimet gjyqësore në shumë prej 23.496 mijë denarë.

Në vitin 2021 këto shpenzime gjithsej janë 116.021 mijë denarë, ose 1,9 milion euro për 72.331 procedura. Shkaku për shumën veçanërisht të lartë të shpenzimeve për angazhimin e noterëve dhe avokatëve rezultoi nga neni 68 të Ligjit për noter me të cilin ndër të tjera është përcaktuar se për kërkesa me para për ujë dhe mbeturinë në shumë totale mbi 6 mijë denarë, propozimi për lëshimin e vendimit për urdhërpagesë noteriale, detyrimisht e harton avokati dhe patjetër duhet të përmbajë vulën dhe nënshkrimin e avokatit.

në 000
denarë

**SHPENZIME PËR AVOKATË, NOTERË, DHE
PËRMBARUES NË PERIUdhËN PREJ VITIT
2017 DERI VITIN 2021**



5.15 | PUNË DHE SOCIALE


5.15.1 MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për vitin 2021, ndër të tjera i konstatuam gjendjet si në vijim:

- parregullsi në aktin nënligjor në pjesën e mënyrës së zgjedhjes, kriteret për zgjedhje, kualifikimet e nevojshme, të drejtën dhe lartësinë e Komisionit për përgatitjen e gjetjes, mendimin dhe vlerësimin për përcaktimin e invaliditetit;
- nuk janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe përbërjen joadekuate të komisioneve individuale për revizionin e gjetjes, mendimin dhe vlerësimin për përcaktimin e invaliditetit;
- parregullsi në angazhimin e personave të punësuar në kohë të caktuar;
- nuk është rregulluar qartë mënyra dhe procedura e zbatimit dhe shpërndarja e shumës së mjeteve të parapara me Ligjin për lojërat e fatit ku janë konstatuar parregullsi në mënyrën e shpalljes së thirrjes publike, përzgjedhja dhe vlerësimi i aplikacioneve të dorëzuara, kontratat e lidhura dhe shpërndarja e mjeteve;
- shpërndarja e bllok-dotacioneve nëpër komuna nuk kryhet me zbatim të plotë dhe konsistent të kriterëve dhe formulave të parapara me Rregulloret për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve;
- përdorimi joadekuat i aplikacionit të Projektit për avancimin e shërbimeve sociale i cili është krijuar për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të sistemit pensional dhe sistemit të mbrojtjes sociale (SPIL projekti) dhe mosharmonizimi ndërmjet shumës së të drejtave të paguara të paraqitur në evidencën kontabël dhe në projektin SPIL, nuk mundëson kontrollim të plotë në bazën e arritjes së të drejtës, si dhe konfirmimi i shpenzimeve të përgjithshme të evidentuar në llogarinë e kompensimeve sociale;
- evidentimi jo në kohë dhe kronologjik i faturave të pranuar;
- janë konstatuar parregullsi në mënyrën e realizimit të së drejtës së kompensimit me para për ndihmë dhe përkujdesja nga personi tjetër në pjesën e kompletimit të formularëve të plotësuar për dhënien e gjetjes, çmimit dhe mendimit nga ana e kontrollimeve dhe komisioneve profesionale nga Qendrat për Punë Sociale. Pagesa e kompensimeve për ndihmë dhe përkujdesja nga personi tjetër në gjashtë vitet e fundit sipas numrit të përdoruesve janë paraqitur në grafikun:

në 000
denarë

**KOMPENSIMET E PAGUARA
PËR NDIHMË DHE
KUJDESJE NGA PERSONI
TJETËR NË GJASHTË VITET
E FUNDIT SIPAS NUMRIT
TË SHFRYTËZUESVE**



→ zbatimi jo i plotë i regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve dhe pajisjeve të paevidentuar;

→ në librat e punës janë paraqitur të dhënat për mjetet e përhershme, por për to nuk është vërtetuar gjendja fillestare dhe nuk është vendosur evidenca e plotë dhe e saktë;


- dobësi në sistemin e kontrollimit të brendshëm në pjesën e procedurave të përcaktuara për vërtetimin e shumës dhe objektivitetin e dokumentacioneve financiare dhe kontrollimet e vendosura për rrjedhjen e dokumentacioneve mes sektorëve dhe evidencimin e transaksioneve në evidencat kontabël.
- Në pjesën e çështjeve kryesore të pasigurisë dhe vazhdimësisë njoftuam për:
 - nga ana e MPPS-së për periudhën prej 10 viteve janë paguar mjete në shumë prej 43.620 mijë denarë në bazë të kontratave për qira të hapësirës së zyrës për nevojat e veta për çka është e nevojshme në periudhën e ardhshme në koordinim me institucionet kompetente shtetërore të gjejnë zgjidhje të përhershme për sigurimin e hapësirës përkatëse për funksionimin e vazhdueshëm të MPPS-së.
 - janë konstatuar parregullsi të caktuara gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtimore për:
 - objektin në pjesën jugore të Dhomës së Shëndetit Nada Mihajlova në Shtëpinë e Pleqve në Komunën e Probishtipit për të cilat janë paguar shuma të përgjithshme prej 54.983 mijë denarë me afate të ndërtimit prej 16 muajve nga dita e vendosjes në punë dhe skadon më 07.12.2021, ndërsa punimet ndërtimore nuk kanë përfunduar. Për shkak të së theksuarës do të ketë implikime financiare në buxhetin e MPPS-së në periudhën e ardhshëm.
 - ndërtimin e kopshtit për fëmijë në Komunën e Çairit²⁶ në shumën totale prej 120.084 mijë denarë dhe 25 muaj afati për kryerjen e punimeve ndërtimore nga vendosja e punës, por për shkak të proceseve gjyqësore dhe ndalimit të përkohshëm të dhënë për pagesën e mjeteve nga llogaria e kontraktuesit të punimeve ndërtimore në muajin korrik 2022 është lidhur kontratë për ndryshimin dhe plotësimin e kontratës²⁷ me të cilën ndryshohen rolet e pjesëmarrësve në grup. Për shkak të së theksuarës ekziston pasiguria në pjesën e marrjes së detyrimeve për përfundimin e punimeve ndërtimore të objektit.
 - Në pjesën e Shtesës për pengesën e ndryshimeve dhe kufizimeve ligjore të moshës për realizimin e së drejtës për aftësi të kufizuar deri në 65 vjeç i kufizon qytetarët ta realizojnë këtë të drejtë kur më së shumti do të kenë nevojë, gjegjësisht kur do të bien në pleqëri të thellë dhe do të përballen me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore. Gjendja e përcaktuar çon në uljen e përdoruesve të shtesës për aftësi të kufizuar, është paraqitur hollësisht në grafikun si në vijim:

26 Kontrata nr. 02-2911/8 nga 14.07.2020

27 Marrëveshje për ndryshim dhe plotësim të kontratës nr.02-2256/3 nga 25.07.2022



**PAGESAT E SHITESAVE PËR
PENGESA NË PESË VITET E
FUNDIT TË SHPREHUR SIPAS
NUMRIT TË SHFRYTËZUESVE**



→ Procedurat gjyqësore në të cilat MPPS-ja paraqitet si palë e paditur në 13 procedura gjyqësore kërkohet arkëtimi në shumë prej 23.285 mijë denarë në bazë të borxhit kryesor

nga kreditorët që mund të shkaktojnë më tej ngarkim të shumës së vlerësuar me shpenzime gjyqësore dhe kamatë dhe të ndikojë në punë në të ardhmen e MPPS-së.

5.15.2 FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT


Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, ku janë konstatuar gjendjet si në vijim:

- ekzistojnë procedura të cilat nuk janë adaptuar me ndryshimet e Ligjit për SPI-në, ndërsa kontrollimet e brendshme të vendosura nuk sigurojnë çdo herë konfirmimin e të dhënave të futura dhe saktësinë dhe në kohë në procedurë;
- nuk janë tejkaluar gjendjet e konstatuara nga vitet e mëparshme dhe i referohen mungesës së kuadrit të trajnuar dhe profesionist për aktuarin dhe largimin permanent të punonjësve nga sektori i TI-së dhe revizioni i brendshëm që ndikon në zhvillimin e kapaciteteve aktuariale dhe të parashikueshme pensionale, funksionimin e sistemit të informacioneve dhe përditësimin e të gjitha sistemeve të vendosura dhe efektivitetin e sistemit të kontrollimeve të brendshme.
- dobësi në ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave në evidencën e amzës që e pamundësojnë konfirmimin e të dhënave të regjistruara, të nevojshme për realizimin e të drejtave për SPI-në;
- për shkak të mosmarrjes së të dhënave adekuate për punësimin dhe regjistrimin e tatimpaguesve, si dhe gabime gjatë futjes nga ana e institucioneve të tjera, në llogarinë e pagesës të dedikuar për mbledhjen e mjeteve nga arkëtimi i kontributit për SPI-në ka mjete të pashpërndara në shumë prej 156.102 mijë denarë (nga të cilat një pjesë në shumë prej 90.971 mijë denarë janë saldoja e llogarisë së theksuar nga vitet e mëparshme) të cilat Fondi nuk mund t'i shfrytëzojë, për këtë arsye të siguruarit nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre nga SPI-ja;
- informacione të dorëzuara jo në kohë nga institucionet kompetente për ndryshimin e statusit të të siguruarve që ka për pasojë pagesë të pabazuar të pensioneve (në bazë të dëmeve për pensionet e paguara të shfrytëzuesve të vdekur, pensionet e përkohshme, pensionet familjare ose llojet e tjera të pagesave të pensioneve të pabazuara) të pensioneve në shumë totale prej 223.753 mijë denarë, për të cilat janë evidentuar kërkesat nga qytetarët dhe parapagesa e pensioneve në shumë prej 6.907 mijë denarë, të cilat rrjedhin nga viti 2012 për pensionet e derdhura në banka, për të cilat nuk është bërë kthimi i mjeteve nga llogaritë e transaksioneve të shfrytëzuesve të vdekur dhe përqindja e ulët e kthimit të më shumë mjeteve të paguara;
- parregullsi të konstatuara në një numër të kufizuar të procedurave të zbatuara për ndarjen e kontratave për prokurime publike.


Në pjesën e çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi njoftuam për;

- mjetet e tërhequra në mënyrë të pabazuar nga llogaria e Fondit nga ana e përmbaruesve në bazë të urdhëresave të përmbarimit, në të cilat si debitorë paraqiten shfrytëzuesit e pensionit, si dhe kryerja e vazhdueshme e aktiviteteve nga ana e Fondit të lidhura me realizimin e urdhëresave të përmbarimit;

- sistemin e vendosur për përcaktimin, kontrollimin dhe arkëtimin e kontributit i cili nuk bazohet në integrimin plotësisht të përditësuar dhe të saktë dhe shkëmbimin në kohë të të dhënave nga institucionet, që ndikon në plotësinë e të ardhurave, si dhe në likuiditetin e Fondit dhe qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve;
- strukturën dhe nivelin e të ardhurave të realizuara në periudhën raportuese, rritjen e deficitit në pagesën e të ardhurave pensionale, si dhe pasiguritë në punën e Fondit lidhur me lëvizjet inflatore dhe lëvizjet e pafavorshme demografike;
- në vitin 2021 janë realizuar të ardhura në shumë prej 81.508.271²⁸ mijë denarë me strukturën e të ardhurave që janë paraqitur në grafikun si në vijim:



STRUKTURA E TË ARDHURAVE TË FONDIT



■ Kontributet për SPI
■ Akcizat

■ Të ardhurat të tjera
■ Transferat nga nivelet tjera të pushtetit

28 Të ardhurat totale të shfaqur në raportin financiar të Fondit për vitin 2021 është 86.432.482 mijë denarë dhe në të njëjtit përmbajnë tepricë të transferuar të të hyrave nga viti paraprak në vlerë prej 4.924.211 mijë denarë.

→ të ardhurat burimore, respektivisht të ardhurat nga kontributi i arkëtuar për SPI-në në vitin 2021 janë rritur për 6.38% në krahasim me vitin paraprak 2020 dhe janë 49.289.354 mijë denarë, që paraqet pjesëmarrje prej 60.47% nga totali i të ardhurave të realizuara. Rritja e realizuar e të ardhurave në vitin 2021 edhe më tej nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për përfitimet sociale që, gjithashtu, shënon rritje nga viti në vit. Pra, shpenzimet për përfitimet sociale (pagesa e të ardhurave pensionale bashkë me kontributin për sigurimin shëndetësor të pensionistëve, transferet në shtyllën e dytë pensionale dhe pensionin invalidor) në vitin 2021 janë 79.677.493 mijë denarë për gjithsej 328.570 shfrytëzues të të ardhurave


pensionale, gjegjësisht përfundimisht me dhjetorin 2021 mjetet e paguara janë për 3.8% më të larta në krahasim me vitin 2020.

→ Fondi edhe përkundër rritjes së të ardhurave në bazë të kontributeve nga SPI-ja ka mungesë (deficit) të mjeteve për pagesën e shpenzimeve për përfitimet sociale, për këtë arsye në vitin 2021 nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë transferuar mjete në shumë prej 30.580 milion denarë. Pjesëmarrja e këtyre mjeteve në të ardhurat totale të Fondit shënon ulje në krahasim me vitin 2020 dhe është 37.5%, prej të cilave 29% janë për mbulimin e deficitit rrjedhës për pagesën e pensioneve, që është paraqitur në grafikun:



në 000
denarë

**PJESËMARRJA E MJETEVE TË
TRANSFERUARA NGA BUXHETI I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT NË TË ARDHURAT TOTALE
TË FONDIT**



■ Të ardhurat e përgjithshme


■ Transferet nga Buxheti

→ ndikimi i strukturës së pavolitshme demografike të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të lëvizjeve inflatore rrjedhëse mbi punën e Fondit, si dhe obligimin ligjor për harmonizimin e lartësisë së të ardhurave pensionale me indeksin e shpenzimeve për jetesë dhe rritjen e pagave pritet që në afat të gjatë punët financiare të Fondit të vazhdojnë të ngarkohen nga problemi aktual i deficitit të lartë që mbulohet me transferet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

→ është konstatuar rritja e vazhdueshme e kërkesave të papaguara për kontributet e sigurimit pensional, të cilat më 31.12.2021 janë paraqitur në shumë prej 4.945.481 mijë denarë. Kërkesat që nuk janë arkëtuar nga viti 2016 deri në vitin 2021 janë në rritje dhe në vitin 2021 janë rritur për 38,9%, gjegjësisht për 1.384.466 mijë denarë në shumë absolute. Është i nevojshëm intensifikimi i aktiviteteve në lidhje me arkëtimin e tyre nga ana e DAP-së që ka kompetenca për kryerjen e arkëtimin për këtë periudhë. Lëvizja e kërkesave në bazë të kontributeve të papaguara për periudhën 2009-2021 është paraqitur në grafikun:

në 000
denarë

**LËVIZJA E KËRKESAVE NË
 BAZË TË KONTRIBUTEVE
 TË PAPAGUARA PËR
 PERIUDHËN 2009-2021**




■ Kontributete e papaguara për periudhën 2009-2021

→ kërkesat në bazë të kontributeve të papaguara që kanë ndodhur deri në fund të vitit 2008 tashmë kanë parashkrim absolut. Fondi ka nisur nismë për ndryshim dhe plotësim të ligjit të theksuar në drejtim të ndryshimit të tretmanit të kontributeve dhe ato të kenë karakter të mjeteve për konsumim personal, ndërsa pagesa të mos parashkruhet, por nuk është vepruar

sipas saj. Analiza e lëvizjes së kërkesave në bazë të kontributeve të papaguara deri në fund të vitit 2008, për periudhën 2016-2021 rezulton se janë fshirë në vazhdimësi për shkak të pamundësisë së arkëtimit të tyre, e cila është paraqitur në grafikun:

në 000
denarë

LËVIZJA E KËRKESAVE NË BAZË TË KONTRIBUTEVE TË PAPAGUARA TË CILAT KANË NDODHË DERI NË FUND TË VITIT 2008, PËR PERIUDHËN PREJ 2016-2021



5.15.3 AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Është kryer revizioni i pajtueshmërisë me temën "Realizimi i të drejtave nga kompensimi me para" në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pagesat e bëra në vitin 2021.

Realizimi i së drejtës për kompensimin me para është rregulluar me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë dhe Ligjin për sigurim material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit. Të drejtat e sigurimit në rast të papunësisë realizohen në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht në Qendrën përkatëse të Punësimit ku personi është i evidentuar si i papunë. Agjencia është institucion publik që kryen punë profesionale, organizative, administrative dhe të tjera që ka të bëjë me sigurimin dhe punësimin në rast të papunësisë, siguron mbështetje, ndihmë dhe shërbime për pjesëmarrësit në tregun e punës, nëpërmjet 30 Qendrave të Punësimit (QP) në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me revizionin e kryer janë konstatuar më shumë gjendje, si në vijim:


Korniza juridike:

Ligji për punësim dhe sigurim më rast të papunësisë i rregullon procedurat dhe kushtet për realizimin e kompensimit me para (KP) dhe kushtet për ndërprerjen e së drejtës, por janë konstatuar parregullsi dhe mungesa të dispozitave të sakta në pjesën e: mënyrës së llogaritjes së lartësisë së kompensimit me para për punën me orar të pjesshëm të llogaritur në punë me orar të plotë, si dhe kushtet në të cilat personat e papunë nuk mund të marrin kompensim me para;

- Ligjet për sigurimin material nuk kanë vazhdimësi në miratimin e tyre, kanë afat të kufizuar për paraqitjen e kërkesës, kriteret të ndryshme lidhur me datën e përfundimit të marrëdhënies së punës dhe kohëzgjatjen e shërbimit, gjë që ndikon në numrin e shfrytëzuesve dhe të drejtën që personat i realizojnë në periudha të ndryshme kohore në pajtim me kushtet;
- ekipimi joadekuat i stafit të sektorit për punë të brendshme kontribuon të mos jetë i kryer revizioni i procesit të plotë të realizimit të së drejtës për kompensim me para.

Realizimi i së drejtës për KP:

Shuma totale e mjeteve të paguara për kompensim me para dhe sigurimi material në formë të kompensimit me para në vitin 2021 është 1.524.106 mijë denarë ose 45,34% nga gjithsej shpenzimet e Agjencisë, për gjithsej 26.158 shfrytëzues gjatë vitit, në pajtim me LPSKM-në dhe ligjet për SM për periudhën 2019-2021 janë paraqitur në grafikun:



Me revizionin e kryer të procedurave për realizimin e së drejtës nga KP-ja dhe SM-ja dhe pagesa e tyre konstatuam këtë si në vijim:

- me udhëzimet dhe aktet e brendshme për realizimin e së drejtës nga KP-ja dhe SM-ja dhe pagesat e tyre nuk janë përcaktuar kontrollime dhe ndarje të kompetencave gjatë pranimit dhe përpunimit të kërkesave për KP, kompletimi i dokumentacionit, llogaritja e shumës dhe miratimi i vendimit në procedura. Mungesa e ndarjes së plotë të kompetencave të punonjësve të përfshirë në procesin e realizimit të të drejtave nga KP-ja, për shkak të mungesës së kuadrit veçanërisht në qendrat më të mëdha të punësimit, gjë që krijon rrezik që sistemi i krijuar i realizimit të të drejtave nga kompensimi me para nuk do të garantojnë saktësinë dhe afatin kohor të procedurës në tërësi.
- konstatuam gjendje në pjesën e sigurimit të kompletuar të dokumentacionit gjatë zgjidhjes së procedurave për realizimin e së drejtës së KP-së dhe qasjes jo të njëjtë të veprimtari nga ana e qendrave të punësimit që ndikon në përcaktimin e së drejtës dhe vlerës së KP-së që i caktohet personit të papunë;
- nuk është vendosur shkëmbimi elektronik i të dhënave dhe lidhja e evidencës ndërmjet Agjencisë dhe Fondit të SPI-së që ndikon në sigurimin në kohë të të dhënave dhe përgatitjen e zgjidhjeve në procedurat për realizimin e së drejtës;
- mungesa e bashkëpunimit të rregullt dhe dinamika e përcaktuar për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Agjencisë dhe organeve


inspektuese për marrëdhënie pune kontribuon për mungesën e të dhënave dhe informacioneve të rregullta për personat e papunë shfrytëzues të KP-së që janë të angazhuar në punë ose që kryejnë veprimtari në kundërshtim me ligjin;

- në pjesën e realizimit të së drejtës së KP-së konstatuam se shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara në bazë të ndryshme ndryshoi gjatë viteve, ndërsa është rritur në pjesën e pagesës së KP-së së personave të papunë në vitin 2020 në mbështetje të personave të cilët humbën punën e tyre si pasojë e largimit nga puna nga punëdhënësit gjatë Kovid-19;
- në pjesën e realizimit të së drejtës së SM-së në formë të KP-së, konstatuam se 62% nga shfrytëzuesit shfrytëzojnë kompensim me para deri në 6 muaj për shkak të humbjes së punës me orar të caktuar të punës dhe punë sezonale, ndërsa 77% nga shfrytëzuesit shfrytëzojnë SM në periudhë prej 25-60 muaj, ndërsa të dhënat tregojnë se pavarësisht angazhimit të Agjencisë dhe pjesëmarrjes së saj në ndërmjetësim, numri është i vogël i personave të punësuar në periudhën 2017-2021, veçanërisht shfrytëzuesit e SM-së të cilët kanë vështirësi të përshtatën me ndryshimet në tregun e punës dhe të gjejnë punë, kjo është arsyeja pse ata përdorin më shpesh SM në formë të KP-së deri në pensionimin e tyre.

Të dhënat për **efektet nga ndërmjetësimi gjatë punësimit të shfrytëzuesve të KP-së** të cilët marrin pjesë në ndërmjetësimin dhe është realizuar punësimi është paraqitur në grafikun:



EFEKTET NGA NDËRMJETËSIMI GJATË PUNËSIMIT TË SHFRYTËZUESVE TË KP-SË TË CILËT MARRIN PJESË NË NDËRMJETËSIMIN DHE PUNËSIMIN E REALIZUAR



Kthimi i mjeteve nga përdoruesit e KP-së dhe SM-së për shumën e përdorur në mënyrë të paarsyeshme i konstatuam situatat e mëposhtme:

- Agjencia nuk ka miratuar udhëzim/procedurë për mënyrën e kthimit të mjeteve të shfrytëzuara nga shfrytëzuesit e kompensimit me para në rast të paraqitjes së kushteve për ndërprerjen e së drejtës për kompensim me para, për arsye se ekziston qasje jo e njëjtë e veprimit të qendrave të punësimit në procedurën e rikthimit të mjeteve të shfrytëzuara, përgatitjes së vendimeve për ndërprerje dhe evidentimit të kërkesave në bazë të rikthimit të mjeteve.
- Agjencia nuk ka vendosur sistem të lidhur me evidencat e institucioneve të tjera kompetente për marrjen e dokumentacioneve dhe informacioneve të nevojshme (zgjidhjet për realizimin e së drejtës së pensionit, informacionet për shfrytëzuesit e vdekur, të dhënat për të ardhurat sociale etj.), si mekanizma për zbulimin e përdoruesve të KP/SM që realizon të ardhura në para në baza të ndryshme, që kontribuon të bëhet pagesa e përdoruesve të cilët ka ndodh diçka nga kushtet e parapara për ndërprerjen e së drejtës.

Ankesat për të drejtën e përealizuar dhe vendimmarrja e tyre

- me revizion i kemi përfshirë ankesat e paraqitura kundër vendimeve për të drejtën e përealizuar në QP-të e përfshira dhe vendimmarrjen sipas tyre, ku prej të cilave nga 215 ankesa të parashtuara në MPPS si organ i shkallës së dytë, 58 nga ankesat janë miratuar dhe janë kthyer në rivendimmar-

rje, dhe 157 u refuzuan. Konstatuam se në raste të caktuara organi i shkallës së dytë për zgjidhjen e ankesave nuk i vlerëson të gjitha dëshmitë dhe faktet relevante të dorëzuara nga Agjencia dhe palët dhe ankesat refuzohen si të pabazuara, ndërsa gjatë përsëritjes së procedurës miratohet vendimi pozitiv, që krijon mundësi për dëmin material të personave të papunë për të drejtën e përealizuar të KP-së dhe SM-së.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim të marrjes së masave dhe aktiviteteve nga organet dhe personat kompetentë të menaxhimit dhe udhëheqjen e Agjencisë në funksion të përmirësimit të gjendjeve të caktuara.

5.15.4 INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL SHTËPIA E PLEQVE KIRO KËRSTESKI PLLATNIK PRILEP

Është kryer revizioni i raporteve financiare të Institucionit Publik Komunal Shtëpia e Pleqve Kiro Kërsteski Pllatnik Prilep për vitin 2021, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e kryer, janë përcaktuar gjendjet si në vijim:

- nuk janë miratuar procedurat e shkruara për rregullimin e procedurave të punës me të cilat do të rregullohet sistemi i kontrollimit të brendshëm dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në pjesën e punës materiale dhe financiare;
- mungojnë normativat dhe llogaritjet e shpenzimeve të produkteve të nevojshme ushqimore, një pjesë e listës së ushqimit nuk është aprovuar dhe nuk është siguruar përmbushja e plotë e normave të përcaktuara për vlerën ushqimore të të ushqyerit për pleqtë dhe

→ Shtëpia funksionon me numër të pamjaftueshëm të kuadrit profesionist për kryerjen normale, cilësore dhe në kohë të shërbimeve dhe kujdesit të nevojshëm për pleqtë, veçanërisht geronto-amvise, higjieniste dhe ndihmës personel në kuzhinë.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi**, i kushtuam vëmendje se:

→ në vitin 2022, pas 17 vite, për herë të parë, Shtëpia rriti çmimet e akomodimit dhe i përshtati ato me rritjen e shpenzimeve të punës, të cilat ndërkohë janë rritur ndjeshëm;

→ shërbimi i përgatitjes së ushqimit për projektin "Kuzhina Popullore" ofrohet nga Shtëpia me të njëjtin çmim të përcaktuar në fillim të projektit në vitin 2007 edhe pse shpenzimet për prodhimet ushqimore janë rritur ndjeshëm, dhe gjithashtu e kryen me të njëjtin staf në kuzhinë, i cili nuk është i mjaftueshëm për përgatitjen e vazhdueshme të ushqimit për përdoruesit e rregullt të Shtëpisë;

→ në tre tremujorët e parë të vitit 2021 është blerë sasi disa herë më e madhe barnash dhe pelenash në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit aktual 2022;

→ përdoruesit e akomoduar në dhomat të cilat janë në gjendje të keqe, për mirëmbajtjen e së cilës nuk janë planifikuar mjete me programet vjetor për financimin e ndërtimit, pajisjeve dhe mirëmbajtjen e objekteve për mbrojtjen sociale dhe shtëpive të pleqve;

→ shuma e zvogëluar e bllok-dotacioneve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 edhe përkundër asaj që është rritur numri i përdoruesve, duke përfshirë edhe ata me rrezik social të cilët janë të vendosur në Shtëpi me vendim nga Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale Prilep dhe

→ në periudhën e kaluar janë realizuar punësime me pëlqim vetëm nga Komuna e Prilepit dhe një pjesë nga rrogat e punonjësve janë paguar nga llogaria e buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese, me ç'rast nuk janë marrë mjetet nga Komuna e Prilepit si themelues i Shtëpisë edhe përkundër marrjes së kompetencave dhe detyrimit për financimin.

5.16 | ARSIMI

5.16.1 SHFK "LUBEN LLAPE" - KOMUNA E AERODROMIT

Shkolla Fillore Komunale "Luben Llape" Komuna e Aerodromit - Shkup, ka cilësinë e personit juridik. Shkolla është e regjistruar në regjistrin qendror të shkollave fillore komunale në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe regjistrin e shkollave fillore komunale që e mban komuna për zonën e saj. Në shkollë ka 42 paralele, gjegjësisht 44 paralele në vitin mësimor 2021/2022 me 1.236 fëmijë të regjistruar.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtuesmerise në SHFK "Luben Llape" Komuna e Aerodromit - Shkup, në llogaritë e shpenzimeve të buxhetit të dotacioneve, buxhetit themelor dhe buxhetit të aktiviteteve vetë-financuese për vitin 2021, janë konstatuar gjendjet si në vijim:

- nuk është vendosur sistemi i kontrollit të brendshëm, gjegjësisht nuk është siguruar kontrollimi ex-ante dhe ex-post dhe nuk janë miratuar procedurat e shkruara për punën financiare dhe materiale;

- mosrespektimi i procedurave për punën e arkivit dhe zyrës në raport me evidentimin e faturave hyrëse dhe dalëse në evidencën themelore të Protokollit;
- vlerësimi joreal dhe joobjektiv i kërkesave, detyrimeve dhe mjeteve themelore dhe regjistrimi jo i plotë dhe jo i rregullt i kryer në pajtim me rregullat ligjore.

Në pjesën - Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi, revizioni i theksoi gjendjet në financimin e arsimit fillor ku pagat marrin pjesë me 96%, ndërsa shpenzimet e mbetura me 4% në shpenzimet totale të shkollës me mbi një mijë e dyqind nxënës. Për shkak të kësaj gjendje, revizioni sugjeron se arsimit fillor është e nevojshme t'i bëhet analizë e sistemit të përgjithshëm të planifikimit dhe financimin e veprimitarisë me qëllim të sigurimit të mjeteve të mjaftueshme për financimin e shkollave fillore dhe realizimin e procesit cilësor arsimor.



5.17 KULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

5.17.1 AGJENCIONI I FILMIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare të Agjencisë së Filmit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, së bashku me revizioni i pajtueshmërisë për vitin 2021.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendjet e caktuara ndër më të rëndësishmet janë:

- nuk është i vendosur sistemi i kontrollit të brendshëm nëpërmjet miratimit të procedurave të shkruara për procesin e pagesës dhe procesin e financimit të projektit, me përgjegjësitë dhe detyrimet e përcaktuara të personave të përfshirë në procesin dhe mënyrën e ndarjes dhe monitorimit të realizimit të projekteve;
- Agjencioni nuk ka dorëzuar propozim në Qeveri për miratimin e Strategjisë për Zhvillimin e Veprimtarisë së Filmit me planin e veprimit, që ndikon në vendosjen e prioritetëve dhe objektivave në zgjedhjen e projekteve të filmit në konkurset vjetore, përcaktimet e mjeteve të nevojshme financiare për realizimin e tyre dhe ndërmarrjen e masave organizative dhe administrative për mbështetjen, nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së filmit;
- miratimi jo në kohë, dorëzimi në Qeveri dhe publikimi jo i plotë i Raportit Vjetor të Punës së Agjencisë me çka nuk është siguruar puna transparente dhe informimi në kohë i themeluesit të Agjencisë për gjendjen faktike të detyrimeve të papaguara në bazë të mjeteve të ndara për projektet.
- mosvendosja e njësisë për revizionin e brendshëm në pajtim me rregullativën ligjore e cilla kontribuon që personi udhëheqës të mos marrë këshillë dhe bindje të arsyeshme objektive të pavarur me qëllim të përmirësimit të punës dhe rritjes së efikasitetit të sistemit për kontrollim të brendshëm në pjesën e përdorimit të mjeteve të transferuara të shtëpive të producentëve dhe mundëson paraqitjen e parregullive në pjesën e përdorimit të mjeteve gjatë realizimit të projekteve;
- nuk janë miratuar rregulloret e punës me të cilën do të rregullohet puna e këshilltarëve të filmit, recensentëve dhe këshilltarëve financiarë, si dhe dobësitë e konstatuara në pjesën e miratimit të propozim-vendimeve për zgjedhjen nga ana e Këshillit të Filmit që mund të ketë ndikim në veprimin subjektiv gjatë zgjedhjes së projekteve të filmit;
- gjatë shpalljes së konkurseve për projektet e filmit, Agjencia nuk u përmbahet kriterëve dhe kushteve të detyrueshme nga Ligji për veprimtarinë e filmit, as nuk ka miratuar akt-procedurë interne me aktivitetet dhe hapat e përcaktuar që ndërmerren gjatë zbatimit të procedurës pas konkursit, me çka është e mundur vendimmarrja subjektive gjatë zgjedhjes së projekteve që do të pranohen, përkatësisht refuzohen;
- mosvendosja e kontrollit në plotësimin e kushteve nga ana e shtëpive të producentëve para lidhjes së kontratave, si dhe në të gjitha fazat nga realizimi i kontratave për të cilat është kryer pagesa e mjeteve

nga buxheti i Agjencisë. Pastaj u konstatua se nuk është siguruar dokumentacioni i plotë dhe monitorimi i rëndësishëm së garancive bankare në përputhje me shpalljen e publikuar dhe mosrespektimi i dinamikës së përcaktuar për realizimin e filmit në pjesën e mjeteve për financimin e projektit, lidhja e anekseve të kontratave, dëshmia për mjetet e siguruar gjatë ndërrimit të shtëpive të koproduktionit dhe dallimet e konstatuara ndërmjet planit financiar dhe dokumentacionit të bashkëngjitur;

- evidentimi i papërditësuar i projekteve të caktuara në të gjitha fazat e realizimit dhe nuk janë ndërmarrë masa për zgjidhjen e kontratave të dhëna për projektet ku është konstatuar mosrespektimi i dispozitave të kontratave;
- regjistrimi i kryer në mënyrë jo të plotë dhe joadekuate i mjeteve dhe detyrimeve në pajtim me dobësitë dhe rregullat ligjore në punën e arkëtarit;
- mënyra e përcaktuar për evidentimin e detyrimeve pas nënshkrimit të parakontratës për financimin e projekteve të filmit, ndikimin e keqvlërësimit të pozicioneve të bilancit dhe paraqitjen e detyrimeve financiare afatshkurtra në shumë më të madhe se 405.780 mijë denarë;
- mosvendosja e mekanizmave të kontrollit dhe harmonizimit për konfirmimin e plotësisë së vendimeve të lëshuara dhe monitorimin e arkëtimit të tyre dhe aktiviteteve të pandërmarra për sigurimin e informacioneve nga producentët për totalin e të ardhurave të realizuara nga shpërndarja, eksploatimi dhe shitja e filmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj;

- parregullsi në mjetet e ndara për subjektin juridik në bazë të memorandumit të bashkëpunimit, kontratës për financim dhe raporteve të dorëzuara dhe dokumentacionit financiar që nuk parashikohen me LVF;
- përdorimi i dedikuar i pakonfirmuar i mjeteve që janë paguar në përputhje me kontratat për financimin e projekteve në veprimtarinë e filmit në shumë të përgjithshme prej 24.015 mijë denarë për shkak të mangësive në dokumentacionin e bashkëngjitur nga ana e shtëpive të producentëve dhe shpërndarja e shpenzimeve në zërat joadekuate të parashikuar në planin financiar.

Në pjesën e çështjeve kryesore të pasigurisë dhe vazhdimësisë raportuam për:

- procedurat gjyqësore pranë gjykatës kompetente ku agjencioni paraqitet si palë në kontestet gjyqësore, zgjidhja e të cilave varet nga ngjarjet e ardhshme, rezultati i të cilave nuk mund të parashikohet dhe zgjidhja e të cilave mund të ketë efekt në raportet financiare;
- nuk janë ndërmarrë aktivitete për veprimin me pajisjet e kinemasë të dhëna për përdorim të përkohshëm institucioneve kombëtare dhe lokale;
- parregullsi në angazhimin e punonjësve me kontratë në vepër në kushtet kur agjencioni nga numri i përgjithshëm i vendeve të sistematizuara të punës ka të plotësuar 31,43%.




5.17.2 EFIKASITETI I POLITIKAVE DHE MASAVE PËR MBROJTJE, MENAXHIM DHE REVITALIZIM TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË PATUNDSHME

Është kryer revizioni i suksesit me temë "Efikasiteti i politikave dhe masave për mbrojtje, menaxhim dhe revitalizim të trashëgimisë kulturore të patundshme" për t'iu përgjigjur pyetjes: "A sigurohet realizimi i mbrojtjes efikase të trashëgimisë kulturore të patundshme me kornizën e përhershme juridike, mënyrën e vendosur të mbajtjes së evidencës, financimin e aktiviteteve dhe masave të ndërmarra të institucioneve kompetente për identifikim, mbrojtje dhe mbikëqyrje?".

Trashëgimia kulturore është themeli i identitetit kulturor dhe nacional i një populli, shprehja e vlerave kulturore dhe historike që ndajmë dhe kontribuon në mirëqenien e shoqërisë dhe ekonomisë sonë. Shteti ynë ka trashëgimi të pasur kulturore nga gjeneratat e kaluara e cila është me rëndësi të paçmueshme, që duhet të mbrohet, ruhet dhe mirëmbahet si investim i përhershëm për gjeneratat e ardhshme. Trashëgimia kulturore është vlerë themelore e Republikës së Maqedonisë së Veriut që mbrohet në të gjitha rrethanat.










Trashëgimia kulturore mund të jetë në pronësi të shtetit, njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë.

Sipas vetive të saj, trashëgimia kulturore mund të ndahet në: **të patundshme, të tundshme dhe jo-materiale, përkatësisht në trashëgimi kulturore shpirtërore**. Në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturor (LMTK), trashëgimisë kulturore të patundshme i përkasin: përmendoret, njësitë monumentale dhe peizazhet kulturore.



Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (DMTK) në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me aktet për mbrojtjen janë regjistruar 1.292 pasuri të patundshme (përmendore dhe njësi monumentale), të paraqitur në grafikun:

1292 PASURITË E PALUAJTSHME TË REGJISTRUARA

	Tjerra (kategori të dryshëm të pasurisë kulturore)	209
	Pllaka përkujtimore	35
	Njësi monumentale	11
	Shtëpi	467
	Kisha dhe manastire	205
	Dyqane	184
	Lokacione arkeologjike	122
	Xhami	39
	Hamam	20

Përkundër regjistrimit të pasurive me “aktin për mbrojtje” ligji njeherë “pasuri për të cilat në thelb supozohet se përfaqësojnë trashëgimi kulturore”. Numri i përgjithshëm i pasurisë për të cilat supozohet se përfaqësojnë trashëgimi kulturore dhe janë evidentuar në evidencat e institucioneve kompetente është 6.747.

Korniza institucionale për krijimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollimin e aktiviteteve dhe projekteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme përbëhet nga institucionet e mëposhtme: Ministria e Kulturës, Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe 9 Institucione Kombëtare (IK).²⁹

Me revizionin e kryer konstatuam gjendjet e caktuara në fushat që janë lëndë e revizionit:

Korniza juridike dhe përcaktimi institucional i institucioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme:

- ekzistojnë paqartësi dhe mungesë e caktuar e dispozitave me të cilat është rregulluar saktësisht menaxhimi dhe shfrytëzimi nga ana e pronarëve, gjegjësisht shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore të patundshme, mungesa e dispozitave për sanksionim për shkak të gjobave të paparashikuara dhe dispozitave të sakta ligjore për kontrollimin e funksionimit të DMTK-së;
- nuk ekziston harmonizim të dispozitave të LMTK-së dhe Ligjit për ndërtim në përfundim të ndryshëm kulturor të pohimit “rikonstruksioni”, si dhe mënyrën e kategorizimit të trashëgimisë kulturore të patundshme që kontribuon për ndërlikimin e

29 3 Qendra konservuese (Qendra Kombëtare Konservatore Shkup, Qendra Konservatore Shkup dhe Qendra Konservatore Gostivar), 5 Ente për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe muzeumeve (në Ohër, Prilep, Strumicë, Shtip dhe Manastir) dhe 1 Institucion për menaxhimin e lokalitetit arkeologjik të Stobit.

procedurave dhe zgjatjen e procedurave për ndërmarrjen e masave konservatore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

- mungesa e dokumenteve strategjike të miratuara në fushën e trashëgimisë kulturore, që krijojnë paqartësi në lidhje me qëllimet prioritare dhe parimet bazë, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- nuk janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për miratimin e dokumenteve planore dhe programore për menaxhimin dhe revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit e cila përfaqëson një tërësi monumentale që ka ndikuar në përcaktimin e veprimtarive mbrojtëse, rregullimin, ruajtjen e përhershme të vlerave kulturore dhe autenticitetit, mundësinë e revitalizimit dhe shfrytëzimit racional të tërësisë monumentale dhe zonave të kontaktit të saj;
- mungon zbatimi i plotë i aktiviteteve të planifikuara të Planit për mbrojtjen e integruar të qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të rezultateve për mbrojtje;
- kompetencat e përcaktuara me ligj të institucioneve³⁰ nuk sigurojnë lidhje dhe kontrollim të ndërsjellë nga MK-ja të punës së DMTK-së, që ndikon në koordinimin e ndërsjellë në krijimin e politikave të trashëgimisë kulturore. Te një pjesë e IK-së³¹ nuk është kryer detyrimi i paraparë me ligj për riorganizim nga Enti për Mbrojtjen e Përmendoreve dhe Kulturës dhe Muzeu në

Qendrën Konservatore në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe mundësisë për forcimin e kapaciteteve dhe rezultateve më të mira në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme dhe

- mungesa e theksuar e stafit profesional (konservator, konservator i lartë, konservator këshilltar, etj.) në IK, që ndikon në kryerjen e funksionit themelor dhe të veprimtarive për të cilat janë formuar.

Instrumentet e mbrojtjes përmes identifikimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe sistemi informativ për trashëgiminë kulturore:

- zbatim i pa plotë të klasifikimit të pasurive të patundshme të regjistruara, që nënkupton identifikimin e trashëgimisë kulturore me shifër dhe emra zyrtarë, e cila është zbatuar vetëm për monumentet e kulturës për të cilat është lëshuar vendimi i rivlerësimit;
- vlerësimi profesional dhe shkencor i vlerës dhe pronave të trashëgimisë kulturore "rivlerësim", në periudhën nga viti 2005 deri në korrik 2022 është realizuar në 233 pasuri të patundshme, që përfaqëson 18% të numrit të përgjithshëm prej 1.292 pasurive të patundshme të regjistruara mirë në regjistrin kombëtar të trashëgimisë kulturore, edhe pse procedura duhej të përfundonte më 31 dhjetor 2007;
- të dhënat mbrojtëse që duhet të mbahen për pasuritë dhe trashëgiminë kulturore që në mënyrë të arsyeshme supozohet se përfaqësojnë trashëgiminë kulturore, nuk është vendosur plotësisht dhe në kohë nga IK-ja dhe DMTK-ja dhe nuk është vendosur

30 MK dhe DMTK

31 Enti për mbrojtje të monumenteve të kulturës dhe muzeumeve në Ohër, Prilep, Strumicë, Shtip dhe Manastirë;

mënyra e unifikuar e mbajtjes së evidencës themelore në IK;


- Regjistri kombëtar i trashëgimive kulturore të patundshme që mbahet në DMTK nuk përmban të dhëna të përditësuara dhe të plota dhe ai sipas përmbajtjes dhe mënyrës së vet të mbajtjes nuk është përgatitur sipas kërkesave të rregullativës ligjore dhe akteve nënligjore,
- nuk është ndërtuar Sistemi Kombëtar i Informacioneve për trashëgimi kulturore që ndikon në mungesën e informacioneve të disponueshme publikisht, gjithëpërfshirëse dhe të sakta për trashëgiminë kulturore dhe mbrojtjen e saj, krahasueshmërinë dhe përdorshmërinë e të dhënave. Kah fundi i vitit 2021 kanë filluar aktivitetet për vendosjen e tij.

Financimi, masat e ndërmarra për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme, mbikëqyrja dhe kontrollimi:

- mënyra e vendosur e financimit të trashëgimisë kulturore të patundshme nuk parashikon kritere të qarta dhe objektive për shpërndarjen e shumës së mjeteve dhe është një nga dobësitë më të theksuara në zbatimin e funksioneve të institucioneve kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme;
- mjetet financiare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga burimet buxhetore dhe të huaja për periudhën 2018-2021 janë realizuar në shumë të përgjithshme prej 293.528 mijë denarë, gjatë së cilës mjetet buxhetore të miratuara nga Ministria e Kulturës sipas Draft-Programeve për të gjitha institucionet kombëtare ulen çdo vit, e cila varion mesatarisht nga 16% në 23% në vit. Shuma e burimeve financiare të siguruara dhe ekspertëve nuk janë të mjaftueshme për zbatimin efikas të aktiviteteve për mbrojtjen e drejtpërdrejtë, ndërsa alokimi jo i rregullt i mjeteve për mbrojtje e kufizon mundësinë e mbrojtjes në kohë dhe përkatëse të pasurisë së patundshme, të paraqitur në grafikun:

në 000
denarë

**FONDET TOTALE TË
KËRKUARA NGA IK DHE
FONDET E MIRATUARA
NGA MK SIPAS PROGRAMIT
VJETOR**



■ mjetet totale të kërkuara nga MK sipas Draft-programit të IK për projektet

■ mjetet e miratuara nga MK sipas programit vjetor

□% të miratuar në lidhje me fondet e kërkuara nga IK

- mungesa e kujdesit të rregullt, mirëmbajtjes, sigurisë dhe masave për mbrojtjen e menjëhershme nga pronari dhe institucioni kompetent për mbrojtje që kontribuojnë në dëmtimin, humbjen, shkatërrimin dhe rritjen e kostove për mirëmbajtjen dhe funksionimin aktiv të trashëgimisë kulturore;
- prania është investimi i vazhdueshëm në projektet për rindërtimin e plotë të konakëve të manastireve, ndërtimin e objekteve të reja si objekte mbështetëse, të cilat dalin jashtë kornizave të ndërhyrjeve konservuese për të cilat ndahen mjete të konsiderueshme financiare, në vend të ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e pasurive të mbrojtura kulturore, që kontribuon në dëmtimin e përhershëm, humbjen dhe shkatërrimin e trashëgimisë kulturore;
- marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore-juridike, gjegjësisht periudha e gjatë e procedurave të shpronësimit të patundshmërisë në pronësi private në të cilat shtrihet e mira kulturore ndikojnë në mundësinë e ndërmarrjes së masave mbrojtëse, përfundimit të kërkimeve arkeologjike, konservimit dhe revitalizimit të monumenteve të kulturës dhe zonave arkeologjike që janë me interes publik për shtetin;
- mungesa e akteve të brendshme nga institucionet kompetente për ndërmarrjen e masave parandaluese për mbrojtjen dhe parandalimin e veprimeve të kundërligjshme dhe veprimeve emergjente, konflikteve të armatosura dhe fatkeqësive natyrore që kontribuojnë në mungesën e informacioneve në kohë dhe të besueshme për gjendjen e tyre dhe dëmtimet dhe shkatërrimet që kanë ndodhur në trashëgimisë kulturore të patundshme;
- kryerja e mbikëqyrjes inspektuese nga DMTK-ja është në kushtet e mungesës së theksuar të inspektorëve, gjegjësisht ekipimit me tre inspektorë në vitin 2021 me kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes së të gjitha llojeve të trashëgimisë kulturore në gjithë territorin e shtetit. Në këto kushte, shërbimi inspektues nuk ka kryer mbikëqyrje ndaj masave të menjëhershme mbrojtëse të ndërmarra dhe pjesërisht ka kryer mbikëqyrjet kontrolluese pas vendimeve të lëshuara.
- Për tejkalimin e gjendjeve të theksuara më lartë, institucioneve kompetente u janë dhënë rekomandimet të cilat bazohen në rezultatet nga revizioni i kryer.

5.18 VETËQEVERISJA LOKALE



5.18.1 NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

Gjatë vitit 2022 është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021, në nëntë njësi të vetëqeverisjes lokale: Haraçin, Butel, Qyteti i Shkupit, Gjoçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Sveti Nikollë, Tetovë dhe Shtip gjatë të cilave janë konstatuar gjendjet si në vijim:

Në komunat e reviduara janë përcaktuar dobësi në sistemin për kontrollim dhe menaxhim financiar, në bazë të procedurave të shkruara, ndarja e detyrave dhe mekanizmave të kontrollimit të përcaktuar në proceset e punës, vendosja joadekuate e organizimit të revizionit të brendshëm dhe mosfiksionimi i tij.

Janë konstatuar dobësi në procesin e buxhetimit, ndërsa në komunat e: Haraçinës, Butelit, Gjoçe Petrovit, Karposhit dhe Tetovës prezent ishte paraqitja e devijimit të konsiderueshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara për shkak të ribalanceve të pakryera ose të kryera në mënyrë joadekuate të buxhetit. Për shumë vite, Komuna e Karposhit dhe e Tetovës funksionojnë me llogari të bllokuar, ndërsa kryetarët nuk kanë miratuar vendim për të shpallur jostabilitet financiar dhe Plani i masave për tejkalimin e tij, që shpie në më shumë vite të stërngruar me borxhe dhe jolikuiditet të komunave.

Në komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në administrimin e kompensimeve dhe taksave komunale (taksa komunale për: firmën gjegjësisht emërtimin e hapësirës afariste, përdorimin e muzikës në lokalet publike, përdorimin e hapësirës përpara hapësirave afariste për kryerjen e veprimtarisë, përdorimin e hapësirës për parkingun e mjeteve

motorike, taksën për qëndrimin e përkohshëm, kompensimin për posedimin e lejes integruese ekologjike - B), ndërsa në Komunën e Haraçinës, Sveti Nikollës, Tetovës, Shtipit dhe Qytetit të Shkupit, janë konstatuar dobësi në administrimin e tatimit mbi pronë, që ka ndikim në realizimin e të ardhurave në buxhetin e komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit.

Qyteti i Shkupit dhe komunat e Sveti Nikollës dhe Tetovës nuk realizojnë të ardhura nga kompensimet për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, dhe as të ardhura në bazë të kompensimit për mirëmbajtjen e gjelbërimit publik të qytetit.

Komunat e Haraçinës, Butelit, Gjorçe Petrovit, Karposhit, Tetovës dhe Shtipit nuk i respektojnë afatet e përcaktuara me ligj gjatë zbatimit të procedurave për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje që shpie në informimin jo në kohë të kërkuarve për plotësimin e dokumentacionit, prolongimin e procedurave dhe pamundësinë e pronarëve për të regjistruar pronën në kohën e duhur në Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive.

Komunat e Tetovës, Butelit dhe Karposhit nuk dorëzojnë raporte vjetore në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve për përdorimin e mjeteve të realizuara nga kompensimi në këtë bazë, të cilat duhet të përdoren me dedikim për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik me të cilën bëhet mbulimi i objekteve pa leje dhe për rregullimin infrastrukturor të hapësirës në të cilën ndodhen ato.

Komunat e Haraçinës, Butelit, Gjorçe Petrovit, Karposhit, Kisella Vodës dhe Tetovës nuk i respektojnë dispozitat ligjore kur punësojnë persona përmes agjencive private të punësimit, kontratave të autorit dhe kontratave në vepër, ndërsa në komuna të caktuara numri i personave të angazhuar me kontratë në vepër gjatë vitit e tejkalon numrin e punonjësve të rregullt në komunë.

Në komunat e Butelit, Gjorçe Petrovit, Kisella Vodës, Sveti Nikollës, Tetovës dhe Shtipit janë konstatuar parregullsi në ndarjen e mjeteve për aktivitetet në fushën e sportit dhe kulturës dhe për mbështetjen e sektorit joqeveritar në shumë të përgjithshme prej 20,935 mijë denarë. E pranishme është paraqitja pa kritere për zgjedhjen e projekteve dhe lartësia e mjeteve për t'u dhënë mjete shoqërive dhe shoqatave dhe klubeve sportive.

Janë konstatuar parregullsi edhe në mënyrën e evidencimit të kërkesave, përcaktimin e strukturës së tyre të moshës, ndërsa për kërkesat tatimore që nuk janë arkëtuar në afatin e përcaktuar nuk llogaritet dhe arkëtohet kamata dhe nuk merren masat për arkëtimin e tyre.

Komunat e Kisella Vodës, Tetovës dhe Shtipit nuk mbajnë evidencë kontabël për kërkesat në bazë të kompensimit për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore dhe në bazë të vendimeve të miratuara për shitjen e tokës ndërtimore të pandërtuar në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa në Komunën e Gjorçe Petrovit dhe në Qytetin e Shkupit ato evidentohen ditën kur arkëtohen, dhe jo në periudhën e paraqitjes së tyre.

Në Qytetin e Shkupit janë evidentuar kërkesat për tatime më të vjetra se dhjetë/dhe pesë vjet në shumë të përgjithshme prej 771.863 mijë denarë, ndërsa në Komunën e Tetovës janë shlyer kërkesat për tatim mbi pronë në shumë prej 34.494 mijë denarë dhe taksë komunale për firmë në shumë prej 13.958 mijë denarë pa dokumente mbështetëse / gjegjësisht të caktohet mundësia ligjore për arkëtimin e tyre.

Pa Vendim të këshillit komunal të Sveti Nikollës dhe në mungesë të kritereve të përcaktuara, kushteve për dhënien dhe çmimin është lëshuar me qera prona komunale.

Komunat e reviduara gjatë kryerjes së aktiviteteve për ndërtimin / rikonstruksionin e rrugëve urbane dhe ndërrurbane, rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për ndërtim, në lidhje me miratimin e siguruar për ndërtimin e objekteve që i përkasin kategorisë së dytë të ndërtesave, aktivitetet e ndërtimit kryhen pa përgatitur projektin dhe dokumentacionin e projektit vetëm në bazë të llogaritjes së specifikimit teknik / rimatjes dhe nuk bëhet pranim-dorëzimi i ndërtimeve të kryera.

Në komunat e reviduara prezent janë problemet në pjesën e regjistrimit të pronës dhe detyrimeve, gjendje e cila është aktuale me vite të tëra dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve ndërmjet evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike të përcaktuar me regjistrim. Prona që është në pronësi të komunave nuk është evidentuar plotësisht në librat e punës.

Në Komunën e Haraçinës dhe Tetovës janë ndërmarrë obligime / paguhen mjetet në shumë totale prej 33.269 mijë denarë pa dokumente mbështetëse (kompensimet e këshilltarëve, karburanti i konsumuar, reprezentacioni, riparimi dhe servisimi i mjeteve motorike, mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane dhe ndërrurbane, etj.).

Në komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në procedurat për prokurimet publike në pjesën e: specifikimeve teknike dhe llogaritjes së rimatjes, sasive të papërcaktuara për pozitat e veçanta (Komuna e Butelit, Gjorçe Petrovit, Kisella Vodës dhe Tetovës), mospërputhjes gjatë vlerësimit të ofertave (Qyteti i Shkupit, Komuna e Karposhit dhe Kisella Vodës), mospërputhjeve në realizimin e kontratave (Komuna e Haraçinës dhe Shtipit) dhe mosrespektimit të afateve të përcaktuara me ligj (Gjorçe Petrov, Karposh dhe Tetovë). Pa zbatuar prokurimet publike janë prokuruar mallra dhe shërbime dhe janë kryer punë për të cilat janë paguar mjete në shumë totale

prej 10.563 mijë denarë (Komuna e Haraçinës, Qyteti i Shkupit, Kisella Vodës, Sveti Nikollës, Tetovës).

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë janë theksuar gjendjet të cilat u referohen procedurave gjyqësore. Komunat e Gjorçe Petrovit, Karposhit, Kisella Vodës, Sveti Nikollës, Tetovës dhe Qytetit të Shkupit janë të akuzuar në gjithsej 640 procedura në bazë të borxhit në shumën totale prej 2.176,850 mijë denarë, dhe janë në cilësinë e paditësve në 27 procedura për gjithsej 194.533 mijë denarë.

Aktivitetet për ndërtimin e parkut argëtues, rregullimin partern me infrastrukturën e jashtme, edhe pse kanë filluar në vitin 2017, nuk kanë përfunduar për shkak të strukturave të ndërtuara / vendosura pa leje në tokën ndërtimore, i është ndarë në shfrytëzim të përhershëm Qytetit të Shkupit, me qëllim të ndërtimit të parkut argëtues, dhe 7 rekuizita të blera në parkun argëtues janë në gjendje të keqe dhe ekziston rreziku i mosfunksionimit teknik të tyre. Në vitin 2019, nga Qyteti është blerë infrastruktura e rrjetit dhe IP telefoni i dedikuar për objektin afarist të Shtëpisë së Qytetit, në shumë prej 25.367 mijë denarë me TVSH të përfshirë. Për shkak të shitjes së objektit afarist, pajisjet e blera janë jofunksionale për tjetër qëllim dhe janë në magazinë, për të cilën ekziston rreziku që teknologjikisht të vjetrohët.

Në Komunat e Gjorçe Petrovit dhe Karposhit theksuam gjendje të cilat i referohen ndërtimit të objektit afarist administrativ në Komunën e Gjorçe Petrovit për të cilën procedura ka filluar në vitin 2013 dhe është ende në vazhdim, si dhe ndërtimin e objektit administrativ të Komunës së Karposhit, që ka filluar në vitin 2011, ishte ndërprerë në vitin 2016 dhe aktivitetet vazhdojnë në vitin 2021.

Në vitin 2016, sipas Marrëveshjes për huamarrje ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Republikës së Maqedonisë së

Veriut, Ministrisë së Financave dhe Komunës së Tetovës kanë lidhur marrëveshje për nën-hua për: ndërtimin e bulevardit, blerjen e autobusëve, kontejnerëve gjysmë nëntokësorë dhe automjeteve speciale për trajtimin e mbetjeve, për të cilin është pranuar kësti i parë për projektin e ndërtimit të bulevardit në shumë prej 3.030 mijë denarë, por ai nuk është paguar deri në fund të vitit 2022.

Gjatë vitit 2021, nga Komuna e Shtipit janë paguar mjetet në shumë prej 2.500 mijë denarë në emër të shlyerjes së kështit të parë në pajtim me Marrëveshjen për rregullimin e mënyrës së shlyerjes së borxhit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave, NP ISAR Shtip dhe Komunës së Shtipit, nga fakti se NP ISAR Shtip si debitor kryesor nuk është në gjendje t'i paguaj këstet e parapara me kohë. Borxhi i përgjithshëm ndaj Ministrisë së Financave është 220.889 mijë denarë (borxhi kryesor në shumë prej 68.998 mijë denarë dhe kamata ndëshkimore ligjore në shumë prej 151.901 mijë denarë).


5.18.2 TË ARDHURAT PERSONALE TË KOMUNAVE PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE CILËSORE TË QYTETARËVE GJATË KOHËS SË PANDEMISË

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **"Të ardhurat personale të komunave për sigurimin e shërbimeve cilësore të qytetarëve gjatë kohës së pandemisë"** në kuadër të aktiviteteve të grupit të punës TFMA-EUROSAI për revizionin e komunave, si revizion kooperativ në të cilën morën pjesë shtatë Institucione Supreme të Revizionit: Shqipëria, Mali i Zi, Rumania, Sllovakia, Polonia, Turqia dhe koordinatori Enti Shtetëror i Revizionit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i revizionit ishte t'i përgjigjet pyetjes **"A janë të mjaftueshme të ardhurat personale të komunave për sigurimin e shërbimeve cilësore të qytetarëve gjatë kohës së pandemisë?"**


Fushëveprimi dhe dëshmitë të cilat i siguroam gjatë zbatimit të teknikave dhe metodologjive të revizionit, na jep bazë ta theksojmë konkluzionin si në vijim:

Të ardhurat e realizuara personale të komunave në vitin 2020 shënuan rënie prej 15,2% në krahasim me vitin e kaluar dhe shuma e tyre prej 8 mijë denarë për kokë banori, nuk është e mjaftueshme për krijimin e politikave efikase në nivel lokal dhe zbatimin efektiv të tyre me qëllim të sigurimit të shërbimeve cilësore për qytetarët, aq më tepër që 1/3 prej tyre përdoret për nevojat e organeve komunale.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka model monotip/njëshkallor të vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht të gjitha komunat kanë kompetenca të njëjta, në varësi të kapaciteteve të ndryshme gjeografike, demografike dhe socio-ekonomike. Masat e ndërmarra në drejtim të rritjes së të ardhurave personale të komunave paraqesin bazë solide për gjendjen më të mirë të tyre financiare, por ende nuk janë të mjaftueshme për t'i kryer me sukses kompetencat ligjore. Për këto arsye një pjesë e kompetencave financohen nëpërmjet dotacioneve të pushtetit qendror dhe donacioneve të siguruara nga burimet ndërkombëtare.



STRUKTURA E TË ARDHURAVE TË REALIZUARA TOTALE TË KOMUNAVE SIPAS BURIMEVE NË VITET 2019 DHE 2020




■ Buxheti themelor	■ Aktivitete vetëfinanciare	■ Donacione
■ Donacione nga TVSH-ja	■ Donacione nga pushteti qendror	■ Kredite

Në totalin e të ardhurave të realizuara të komunave, me pjesëmarrjen më të madhe prej 50% janë mjetet e marra nga pushteti qendror në bazë të bllok-dotacioneve për financimin e shpenzimeve vijuese dhe rrogave të punonjësve në fushën e arsimit, mbrojtjes së fëmijëve, kulturës dhe mbrojtjen kundër zjarrit, me 38% janë të ardhurat personale, me 6% janë të ardhurat nga tatimi bartës, gjegjësisht dotacionet nga tatimi i vlerës së shtuar, dhe me 2% janë të ardhurat nga aktivitetet vetëfinancuese, të ardhurat nga donacionet dhe nga huamarrjet.

Mungesa e planifikimit strategjik për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë me prioritete dhe synime strategjike qartë të përcaktuara në nivel kombëtar, nga të cilat lindin masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, institucionet përgjegjëse dhe indikatorët e caktuar për matjen e efekteve të implementimit, si dhe procesin e zbatuar të decentralizimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore dhe rolin vartës të komunave në sistemet e vendosura për ballafaqimin me pandeminë të shkaktuar nga KOVID-19, janë arsytet pse komunat nuk janë në gjendje të marrin masa të shpejta dhe të pavarura për ndihmë dhe mbrojtje të popullsisë në kushtet e pandemisë.

Ndikimi i pandemisë në strukturat e buxhetit komunal sipas burimeve të financimit në krahasim me vitet 2019 dhe 2020 tregon se të ardhurat e buxhetit themelor të cilat marrin pjesë me rreth 40% në të ardhurat totale të komunave, shënojnë rënie prej

15,2%, ndërsa dotacionet nga pushteti qendror të cilat përfshijnë ½ e të ardhurave totale kanë rritje prej 12%. Me shpejtësi janë rritur të ardhurat nga huamarrjet (85%) në krahasim me vitin 2019.




Në procesin buxhetor nuk është siguruar respektimi i parimeve të pjesëmarrjes dhe transparencës, gjë që nuk paraqet bazë solide për miratimin e buxhetit civil në të cilin do të përfshihen interesat dhe nevojat e palëve të interesuara. Vetëm 5% e qytetarëve janë konsultuar nga komuna e tyre gjatë përgatitjes së buxheteve dhe programeve komunale, ndërsa 39% konsiderojnë se buxheti i komunës nuk përfshin nevojat e banorëve të komunës. Ndryshimet dhe plotësimet e pazbatuara në kohë të buxheteve, gjegjësisht përshtatja e shpen-

zimeve në pajtim me të ardhurat e realizuara të cilat në vitin 2020 janë në lartësi prej 70% nga të planifikuarat, rezultojnë me rritje të pjesëmarrjes së detyrimeve në të ardhurat personale për 7% në krahasim me vitin e kaluar. Rritja e detyrimeve dhe rritja e shpejtë e të ardhurave nga huamarrja në krahasim me vitin e kaluar, në kushtet e krizës së zgjatur shëndetësore dhe ekonomike, nuk sigurojnë bindje për qëndrueshmëri dhe stabilitet financiar të komunave.




PJESËMARRJA E DETYRIMEVE NË REALIZIMIN E TË ARDHURAVE PERSONALE SIPAS LLOJIT TË KOMUNAVE


Komunat rurale



Komunat të qytetit




Komunat në teritorin e qytetit të Shkupit



Përshtatjet ekonomike dhe programore të buxheteve, nuk janë në drejtim të marrjes së aktiviteteve shtesë për kënaqësinë e nevojave të qytetarëve të cilët në periudhën e pandemisë janë më së shumti në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes sociale. Mjetet që komunat i kanë shpenzuar në fushën e arsimit prej 2%, mbrojtje sociale prej 1% dhe mbrojtje shëndetësore nën 1% janë të parëndësishëm në krahasim me shpenzimet totale, që tregojnë edhe rezultatet nga Anketa e kryer. Kështu, problemi më i madh për qytetarët, si në komunat rurale, ashtu edhe në komunat e qytetit në kohën e pandemisë janë shërbimet shëndetësore, mbyllja e vendeve të punës dhe mënyra e zbatimit të mësimit nëpërmjet a.q. "të mësuarit në distancë", që rezultojnë në perceptimin e qytetarëve me cilësinë e shërbimeve komunale të jetës me notën mesatare prej 2.7 (shkalla nga 1 deri në 5).



**PËRGJIGJET E TË ANKETUARVE NË PYETJEN: A ISHTE
 NË KOHË OFRIMI I SHËRBIMEVE NGA KOMUNA
 GJATË PANDEMISË?**



Komunat nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet për hartimin e planeve për rimëkëmbjen pas krizës, në drejtim të tejkalimit të pasojave shëndetësore dhe socio-ekonomike nga pandemia, që tregojnë mungesën e vizionit për rikuperim dhe masave për përshtatje, ndërtimin dhe stabilitetin financiar të qëndrueshmërisë së komunave që sigurojnë mjedis të qëndrueshëm për investime dhe zhvillim ekonomik.

Me qëllim që të rritet efektiviteti në realizimin e të ardhurave personale të komunave dhe sigurimin e shërbimit cilësor të qytetarëve kemi dhënë rekomandime në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve për miratimin e akteve strategjike dhe normative për menaxhimin integruar me krizat dhe mbrojtje dhe shpëtim, rishqyrtimin e organizimit territorial të shtetit në nivel lokal dhe modelin e decentralizimit dhe kompetencave të komunave, rritjen e transparencës në proceset buxhetore, si dhe miratimin e planeve për rikuperim pas krizës.

5.19 PARTITË POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE

5.19.1 KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE – MJETET E PAGUARA PËR ZGJEDHJET LOKALE 2021

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është organ për zbatimin e zgjedhjeve. Kompetencë e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve është të kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve në pajtim me Kodin Zgjedhor dhe të kryejë mbikëqyrje mbi punën e organeve zgjedhore.

Është kryer revizioni i pajtueshmërisë, me qëllim që të përgjigjet nëse mjetet e paguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale 2021, në pajtim me rregullativën ligjore dhe aktet e brendshme.

Me revizionin e kryer konstatuam se pagesa e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale 2021 është kryer në pajtim me marrëveshjet e lidhura ndërmjet pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, marrëveshjet për asignim, planet e mediave nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore dhe raportet për realizimin e shërbimeve të përgatitura nga radiodifuzerët, të konfirmuar nga ASHMAAV-ja dhe faturat nga ana e radiodifuzerëve për shpenzimet që kanë të bëjnë me reklamimin politik me pagesë.

Mungesa e Sekretarit të Përgjithshëm të KSHZ-së, i cili duhet të përgjigjet për punën e shërbimeve profesionale të KSHZ-së, është bërë pranimi jocilësor i sistemit biometrik të identifikimit të zgjedhësve, mospajtimi i hapësirave adekuate për ruajtjen e pajisjeve për identifikimin biometrik të zgjedhësve, analiza e të dhënave nga sistemi i integruar biometrik i identifikimit të zgjedhësve për të përcaktuar efektivitetin e sistemit biometrik të identifikimit të zgjedhësve, zbatimi i PP-së për përgatitjen dhe printimin e materialit zgjedhor konfidencial në të cilin nuk janë përkufizuar vlerat individuale të prokurimit, ka ndikim në procesin e zbatimit të zgjedhjeve. Ndikim plotësues kishte edhe rregullimi i pamjaftueshëm i rregullativës ligjore, plotësimet dhe ndryshimet e shpeshta të Kodit Zgjedhor, si dhe plotësimi dhe ndryshimi i ligjit përpara zbatimit të zgjedhjeve.

Shpërndarja e mjeteve të paguara për reklamimin politik me pagesë në shumën totale prej 322.977 mijë denarë është paraqitur në grafikun si në vijim:



REKLAMIMI POLITIK ME PAGESË PËR PJESËMARRËS

7%

partitë politike në Kuvend të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk fituan deputet të mjaftueshëm për të formuar grup deputetësh ose 17.755 mijë denarë

17,755
mijë denarë

45% pozitë

dy partitë politike më të mëdha të cilit fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së ose 154.588 mijë denarë

154,588
mijë denarë

3%

partitë politike që nuk janë të përfaqësuar në Kuvend ose kandidat ose

6,629
mijë denarë

322.977
mijë denarë

45% opozitë

dy partitë politike më të mëdha të cilit fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së ose 144.005 mijë denarë

144.005
mijë denarë

SHPERNDARJA E FONDEVE SHITESË TË PAGUARA PËR RRETHIN E DYTË TË VOTIMIT

37.593 mijë denarë

fonde të paguara për dy partitë politike më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së

26.115 mijë denarë

fonde të paguara për dy partitë politike më të mëdhenj të cilit fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së

878 mijë denarë

fonde të paguara për partitë politike të cilët në zgjedhjet e fundit nuk siguruan mjaftueshëm deputet për të formuar grup deputetesh

850 mijë denarë

fonde të paguara për partitë politike të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend të RMV-së ose kandidat



Për rrethin e dytë të votimit zbatohen mënyra të ndryshëm të shpërndarjes dhe pagesës së fondeve, gjegjësisht te një pjesë e partive politike janë paguar fonde në pajtim me numrin e votuesit total të regjistruar në territorin e komunës në të cilën zhvillohet rrethi i dytë i votimeve, ndërsa te një pjesë shpërndarja dhe pagesa është kryer në pajtim me numrin e votuesit total të regjistruar në territorin në të cilën zhvillohet rrethi i dytë i votimeve dhe ku pjesëmarrësi në procesin zgjedhorë paraqitet me kandidatin e vet.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi e theksuam gjendjen që ka të bëjë me atë se edhe përkundër që dy pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore të bartësit e qarkullimit pagesor nuk kanë hapur llogari të transaksionit me shenjë "për fushatën zgjedhore", komisioni zgjedhor kompetent ka miratuar vendime me të cilat konfirmohet lista e kandidatëve për zgjedhjen e kryetarit të komunës, gjegjësisht zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe mundësohet që ata të marrin pjesë në procesin zgjedhor.

5.19.2 FUSHTA ZGJEDHORE - ZGJEDHJET LOKALE 2021

Enti Shtetëror i Revizionit është përgjegjës për monitorimin e financimit të fushatës zgjedhore nëpërmjet sistemit të raportimit financiar të vendosur me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore, ndërsa në pajtim me metodologjinë e përcaktuar në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror dhe standardet ndërkombëtare të revizionit.

ESHR-ja kreu revizionin e rregullshmërisë (revizionin financiar së bashku me revizionin e pajtueshmërisë) të Raportit të Plotë Financiar me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet në fushatën zgjedhore (raporti financiar për fushatën zgjedhore).

Në secilin proces zgjedhor aktivitetet e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, ndër të tjera janë: të kryejnë regjistrimin në organet kompetente, regjistrimin e llogarisë së transaksionit dhe bazat ligjore për të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në procesin zgjedhor.

Në Raportet Përfundimtare, revizori i autorizuar shtetëror njoftoi për: gjendjet e konstatuara, parregullsitë dhe paligjshmëritë në funksionimin, financimin dhe realizimin e shpenzimeve, gjendjet që kanë ndikim mbi punën në periudhën e ardhshme dhe dobësitë sistematike të rregullativës ligjore.

Në pajtim me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, janë kryer revizionet e raporteve financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të të gjithë 141 pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore Zgjedhjet Lokale 2021, si në vijim:

27	parti politike
22	koalicione dhe
92	kandidatë të pavarur të mbështetur nga "grupi i zgjedhësve".

Me revizionin e kryer të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, janë konstatuar gjendjet të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, si në vijim:

- një pjesë e pjesëmarrësve nuk kanë përgatitur dhe dorëzuar raport financiar për fushatën zgjedhore;
- një pjesë e pjesëmarrësve nuk i kanë përgatitur dhe dorëzuar të gjitha raportet e përcaktuara ligjërisht dhe atë: Raportin me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet e llogarisë së transaksionit për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes së saj deri në përfundimin e rrethit zgjedhor, raportin financiar për fushatën zgjedhore, si dhe 2 (dy) raporte me formularë për pranimin e donacioneve në llogaritë e transaksionit për financimin e fushatës zgjedhore;
- zbatimi jokonsekuent i afateve për dorëzimin e raporteve për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera në procesin zgjedhor të një pjesë e pjesëmarrësve;

- zbatimi jokonsekuent i afateve të përcaktuara ligjërisht për mbylljen e llogarisë së transaksionit me shenjën "për fushatën zgjedhore" dhe fshirjen e numrit unik tatimor para organit kompetent të një pjesë e pjesëmarrësve;
- te një pjesë e pjesëmarrësve në raportin e plotë financiar nuk janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet për reklamimin politik me pagesë në bazë të marrëveshjes së asigimit, të paguar nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe kryerja e qarkullimit pagesor me asigim nuk realizohet nëpërmjet llogarisë së transaksionit të pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore dhe
- për dy pjesëmarrës në fushatën zgjedhore edhe përkundër faktit që të bartësit e qarkullimit pagesor nuk kanë hapur llogari të transaksionit me shenjën "për fushatën zgjedhore", komisioni zgjedhor kompetent ka miratuar vendime me të cilat konfirmohet





lista e kandidatëve për zgjedhjen e kryetarit të komunës, gjegjësisht zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe mundësohet që ata të marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Fushata zgjedhore mund të financohet nga mjetet e llogarisë së rregullt të PP-së, anëtarësisë së PP-së, donacioneve të PP-së, donacioneve të personave fizikë në lartësi prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, personave juridikë në lartësi prej 30.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe kredive të PP-së të dedikuara për fushatën zgjedhore.

Për plotësimin e detyrave ligjore të radiodifuzerëve, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portal-et) në pjesën e publikimit të reklamimit politik me pagesë, në procesin zgjedhor, mjetet financiare janë siguruar nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa paguhen nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BURIMET E FINANCIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE ZGJEDHJE LOKALE 2021

449.157 mijë denarë të ardhurat totale të realizuara në llogaritë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore

	Mjetet me para për publikimin e reklamimit politik me pagesë	322,977 mijë denarë
	Të ardhurat nga transmetimi i mjeteve nga donacionet e llogarisë për punën e rregullt të partisë politike	18,740 mijë denarë
	Të ardhurat nga donacionet e personave fizikë dhe juridikë në para, sende dhe shërbime	33,052 mijë denarë
	Të ardhurat nga transmetimi i mjeteve nga llogaria për punën e rregullt	74,388 mijë denarë

Nga analiza e kryer e burimeve të përgjithshme të financimit të fushatës zgjedhore, është konstatuar se ajo është financuar me mjetet në shumën totale prej 449.157 mijë denarë, ndërsa struktura e burimeve të financimit veçmas për pjesëmarrës është paraqitur në pasqyrën më lartë:

Nga analiza e të ardhurave sipas llojit të burimit financiar është përcaktuar se fushata zgjedhore është financuar me 72% nga mjetet e siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut të paguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ndërsa 28% janë mjetet e siguruara nga burimet tjera të financimit.

5.19.3. PARTITË POLITIKE PUNA E RREGULLT

Partitë politike janë organizata jofitimprurëse, vullnetare të qytetarëve, të formuara për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe bindjeve politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera dhe për shkak të pjesëmarrjes në procesin e miratimit të vendimeve politike gjatë pjesëmarrjes në pushtet.

Partitë politike, qëllimet e tyre i arrijnë përmes formimit demokratik dhe shprehjes së vullnetit politik duke marrë pjesë në zgjedhje, si dhe në mënyra të tjera demokratike.

Mjetet për veprimin e tyre i sigurojnë nga burimet publike dhe private të financimit. Si burime publike të financimit, mjetet totale për financimin vjetor të partive politike janë planifikuar në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për çdo vit fiskal, ndërsa nga burimet private të financimit të parapara me ligj, partitë politike në pjesën më të madhe mjetet i sigurojnë nga anëtarësimi dhe donacionet.

Gjithashtu, në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe kryerjes së aktiviteteve të përcaktuara me statusin e partisë dhe me ligj, partitë politike kanë të drejtë të pronësisë së hapësirave afariste, pajisjeve,

materialeve të zyrës, mjeteve të transportit dhe pronave tjera të tundshme.

Enti Shtetëror i Revizionit si organ kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes në punën financiare dhe materiale të partive politike, në vazhdimësi i kryen revizionet e llogarive për punën e rregullt të partive më të mëdha në shtet.

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, janë planifikuar dhe kryer revizionet e raporteve financiare të katër partive politike: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe Alternativës, me të cilat janë përfshirë 58% nga burimet e përgjithshme publike të financimit të partive politike në vitin 2021.

Me revizionet e kryera janë konstatuar gjendjet të cilat udhëzojnë për nevojën e forcimit të aktiviteteve të personave përgjegjës të partive politike për tejkalimin e tyre, veçanërisht në pjesën e zbatimit të regjistrimit të plotë të mjeteve dhe detyrimeve, duke vendosur mënyrën e grumbullimit, pagesës dhe evidentimit të të ardhurave në bazë të anëtarësimit për konfirmimin e plotë të saj, evidencën e plotë të pronës me të cilat disponojnë partitë, si dhe vlerësimin e pozicioneve të bilancit individual të përfshira në librin kryesor të zbatohen në pajtim me parimin e kontabilitetit të paraqitjes së modifikuar të ndryshimeve / transaksioneve të punës.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë janë zbuluar gjendjet të cilat u referohen detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve të cilët rrjedhin nga vitet e kaluara dhe për strukturën e burimeve të financimit nga aspekti i pjesëmarrjes së burimeve private dhe publike të financimit.

Pjesëmarrja e llojeve individuale të të ardhurave sipas viteve dhe sipas PP është paraqitur me grafikun:


**TË ARDHUAT E REALIZUARA
TË PARTIVE POLITIKE NGA
BUXHETI I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË
VERIUT, DONACIONET DHE
ANËTARËSITË**

në 000
denarë


Me analizat e të ardhurave totale sipas llojeve të burimeve të financimit, është konstatuar se pjesëmarrja e financimit publik nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në punën e rregullt të PP-së shënon trend të rritjes në vitin 2021 që është për 6% më shumë në krahasim me vitin 2020, që vjen si pasojë e rritjes së të ardhurave totale burimore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, me revizionet e kryera në vazhdimësi i theksojmë dobësitë e caktuara sistematike të Ligjit për financimin e partive politike, detajisht të paraqitura në pjesën "Dobësitë Sistematike" të këtij raporti dhe për të cilat është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e tyre.


**Të ardhurat nga Buxheti i Republikës
së Maqedonisë së Veriut**



Të ardhurat nga donacionet



Të ardhurat nga anëtarësimi



A large, bold, yellow number '6' is centered on the page. The number has a thick stroke and rounded edges. The text 'DOBĚSITĚ SISTEMORE' is printed in black, uppercase letters across the middle of the number's loop.

DOBĚSITĚ SISTEMORE

Enti Shtetëror i Revizionit kryen edhe vlerësimin e shkallës së pajtueshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore dhe jep rekomandime për ndryshimin, plotësimin dhe pajtueshmërinë e tyre.

Në këtë pjesë i theksojmë disa nga dobësitë kryesore sistemore të përcaktuara për të cilat ka nevojë për të ndërmarrë veprime nga organet kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për tejkalimin e tyre.

Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore,

Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Ligji për rezervat e mallrave,

Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në pjesën II. Organizimi dhe kompetenca e organeve të administratës shtetërore Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore nuk e rregullon formimin e Sekretariatit të Përgjithshëm si organ i administratës shtetërore. Themelimi i tij është paraparë me nenin 39 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për këtë arsye është e nevojshme harmonizimi i ligjeve të përmendura.

Është e nevojshme të harmonizohet neni 19 i Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, në lidhje me organet të cilat janë në përbërjen e Ministrisë së Financave dhe emërtimet e tyre, me ligj të veçantë: Ligji për rezervat e mallrave, Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, dhe

Ligji për ujërat

Është i nevojshëm harmonizimi i Ligjit për ujërat dhe Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore në pjesën e rregullimit të kompetencave të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe

Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në pjesën e monitorimit të gjendjeve, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së ujërave.

Ligji për buxhetin gjyqësor

Ligji për buxhetet

Harmonizimi i nenit 14 të Ligjit për buxhetin gjyqësor me nenin 29 të Ligjit për buxhetet, në lidhje me kornizën kohore, gjegjësisht afatet për hartimin dhe dorëzimin e qarkullimit buxhetor dhe kërkesave buxhetore të gjykatave.

Ligji për financimin e partive politike

Është i nevojshëm rirregullimi i nenit 14 të Ligjit për financimin e partive politike, në lidhje me miratimin e udhëzimeve më konkrete për rregullimin e mënyrës së pagesës, evidentimin dhe pagesën e anëtarësisë si burim i financimit të partive politike me qëllim të njëtrajtshmërisë në mënyrën e evidentimit të tyre në kontabilitet dhe konfirmimin e limitit të përcaktuar ligjërisht për secilin anëtar veçmas, duke pasur parasysh financimin e fushatës zgjedhore për një proces të caktuar,

Është i nevojshëm qartësimi i nenit 15 të Ligjit për financimin e partive politike, në lidhje me përcaktimin e kushteve dhe kufizimit kur partitë politike marrin donacion të pronës së patundshme si lloj i mjeteve materiale.

Kodi Zgjedhor

Të rishqyrtohen dhe qartësohen dispozitat e nenit 83 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjetet nga llogaria e rregullt e partisë politike dhe nga donacionet nga partia politike, në pjesën e limiteve individuale dhe totale të mjeteve të financuara / dhuruara nga personat fizikë dhe juridikë.

Të rirregullohet neni 76-d i Kodit Zgjedhor me përcaktimin e kriterëve të matshme në sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut të destinuara për reklamat politike me pagesë.

Të rregullohet mënyra në të cilën donatorët do të dëshmojnë / konfirmojnë se ata nuk janë «persona të lidhur», me radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) gjatë financimit ose dhënies së donacioneve për partitë politike.

Nevoja për rregullimin ligjor të dispozitave të nenit 85 të Kodit Zgjedhor, në pjesën e mënyrës së veprimit për rastet kur në Raportin e Plotë Financiar tregohen mjetet e tepërta të mbledhura në llogari për fushatën zgjedhore, si dhe detyrimet e paguara.

Ekziston nevoja për përcaktimin e dispozitave me të cilat do të rregullohet nëse mund koalicioni ose partia politike të mbështet kandidatin e pavarur - grup i zgjedhësve dhe t'i shfrytëzojë mjetet e ndara për reklamat politike me pagesë për kandidatin e pavarur - grup i zgjedhësve, nëse mund, në çfarë kushtesh dhe në çfarë mënyre dhe nëse me mbështetjen e tillë ka të drejtë të përdor mjetet që i takojnë si kandidat i pavarur.

Përcaktimi i detyrimit për dorëzimin e raportit për reklamat dhe billboardet e përdorura nga komunat

në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Qytetin e Shkupit.

Të ndërmerren aktivitete për rregullimin e mëtejshëm të Kodit Zgjedhor në pjesën e përcaktimit të organit kompetent për monitorimin dhe raportimin për prezantimin mediatik zgjedhor të mediave elektronike (portalet e internetit).

Të rishqyrtohet nevoja për plotësimin e nenit 76-e paragrafi 11 të Kodit Zgjedhor në drejtim që të parashihet vendosja e sistemit të interoperabilitetit për shkëmbimin dhe kontrollimin e të dhënave për aktivitetin e afisheve në të cilat do të përfshihen të gjitha palët e interesuara.

Kodi Zgjedhor

Ekziston nevoja për rregullimin e mënyrës së organizimit, pagimit, monitorimit dhe raportimit tek autoritetet kompetente për prezantimin në internet të bërë nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale.

Nevoja për rirregullimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë mediat elektronike për të pasur mundësi të aplikojnë për reklamat politike në KSHZ.

Përcaktimi i kriterëve të qarta dhe precize për ndarjen e mjeteve buxhetore të dedikuara për reklamat politike me pagesë në mediat elektronike (portalet e internetit).

Rishikimi i afatit të përcaktuar për pagesën e donacioneve, gjegjësisht është e nevojshme të përcaktohet që donacionet të paguhen jo më vonë se dita e përfundimit të fushatës zgjedhore.

Rregullimi i nenit 84-b, paragrafi 8 të Kodit Zgjedhor me të cilin do t'i mundësojë Ministrisë së Financave me akt nënligjor të rregullojë mënyrën e mbajtjes së librave afariste dhe përgatitjen e raportit finan-

ciar / financimet për fushatën zgjedhore, duke pasur parasysh të gjitha llojet / burimet e financimit të fushatës zgjedhore, veçanërisht kur ato jo gjithmonë shkaktojnë të hyra monetare në llogarinë e transaksionit.

Rregullimi i Kodit Zgjedhor, me çka në pjesën e gjobave dhe dispozitave të kundërvajtjes do të sigurojë gjoba edhe për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosparaqitjes së Raportit mbi hapësirën e reklamave të përdorura nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe mjeteve të cilat janë paguar dhe kërkohen në atë bazë.

Nevoja për të caktuar organ për zbatimin e trajnimeve në lidhje me detyrimet për raportimin financiar, me ç'rast do të kontribuojë për përmirësimin e transparencës gjatë kohës së informimit të publikut për financimin e fushatës zgjedhore.

Ligji për Drejtorinë Doganore

Në pajtim me nenin 67 pika 5 të Ligjit për Drejtorinë Doganore, është e nevojshme Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë akt me të cilin t'i caktoj vendet specifike të punës së nëpunësve doganorë.

Ligji doganor

Në pajtim me nenin 246-a të Ligjit doganor, ministri i Financave duhet të miratojë akt nënligjor me të cilin do të përcaktohet përmbajtja, mënyra e udhëheqjes dhe fshirja nga evidenca doganore e detyrimeve të importit dhe eksportit dhe detyrimeve dhe taksave të tjera të cilat Drejtoria Doganore i arkëton.

Ligji për Bankën Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut

Nevojat për rirregullimin e Ligjit për Bankën Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht risaktësimin e nenit 13 në drejtim të rregullimit

të së drejtës së subvencionimit të kamatës nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë huamarrjes së Bankës Zhvillimore te kreditorët e jashtëm.

Ligji për taksat komunale

Taksa komunale për përdorimin e rrugëve urbane dhe ndërurbane me automjete, është përcaktuar që të paguajnë personat juridikë të autorizuar për kryerjen e regjistrimit të automjeteve dhe të paguhet në llogarinë përkatëse të pagesës në kuadër të llogarisë së thesarit të komunës. Zgjidhja aktuale ligjore nuk e përcakton në cilat afate personat juridikë duhet të paguajnë taksën e arkëtuar në llogarinë e komunës, për të pasur detyrime për ta njoftuar komunën për numrin e automjeteve të regjistruara në varësi të kapacitetit kub dhe për shumën mujore të mjeteve të mbledhura individualisht dhe kumulativisht.

Taksa komunale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, për të cilën nuk ka ndonjë detyrim të përcaktuar nga ndërmarrja tregtare përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike e cila kryen arkëtimin e taksave nga pronarët e njehsorëve, për të informuar komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupi për numrin e tatimpaguesve sipas kategorive (numri i njehsorëve) në pajtim me numrin tarifor, si dhe për të ardhurat e arkëtuara dhe kërkesat e paarkëtuara në këtë bazë.

Ligji për tatim mbi pronë

Revizioni e tregon pasigurinë në pjesën e zbatimit të nenit 39 të Ligjit për tatim mbi pronë nga miratimi i tij në vitin 2004, në pjesën e detyrimit për të harmonizuar regjistrin e pronave të patundshme të mbajtur nga komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit me regjistrin që e udhëheq Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive e RMV-së, dhe më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzo-

hen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Drejtoria e të Ardhurave Publike. Për zbatimin e kësaj zgjidhjeje ligjore janë të nevojshme saktësime të caktuara në Ligj, si dhe lidhje softuerike të organeve kompetente.

Në Ligjin për tatim mbi pronë, janë përcaktuar kompetencat e DAP-së për kryerjen e kontrollimit mbi punën e organeve të komunave, organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të organeve të Qytetit të Shkupit, por pa përkufizuar qartë mënyrën me të cilën DAP-ja do t'i zbatojë aktivitetet e lidhura me kompetencat e marra nga komunat. Gjithashtu, nuk është paraparë rregullimi i Ligjit nëpërmjet miratimit të aktit nënligjor për të.

Ligji për zjarrfikje

Në pajtim të nenit 49 për financimin e aktiviteteve të Njësive Territoriale të Zjarrfikësve, Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë mundësi të realizojnë të ardhura shtesë nga gjobat për shkelje në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet, kontributet vullnetare dhe mjetet e tjera nga kompanitë e sigurimeve, fondacionet, personat juridikë dhe fizikë të destinuar për avancimin e mbrojtjes dhe të ardhurave nga burimet personale për shërbimet e kryera. Qyteti i Shkupit dhe komunat në RMV nuk realizojnë të ardhura për këto baza, përveç të ardhurave nga kompanitë e sigurimeve në shumën prej 2% të premive të mbledhura për sigurimin e mjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike për të cilat nuk ka njohuri për vlerën e shumës të cilat duhen të paguhen dhe as nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të qenë në gjendje të verifikojmë tërësinë dhe saktësinë e mjeteve të paguara.

Në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, zjarrfikësit profesionistë të punësuar në njësitë territoriale të zjarrfikësve, i përkasin grupit II – vendet e punës së zyrtarëve me autorizime spe-

ciale, nëngrupi 10 - zyrtarë të tjerë të autorizuar në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës.

Me Ligjin për zjarrfikje përcaktohen tre kategori të vendeve të punës, si më poshtë: kategoria A - Zjarrfikës të udhëheqësisë së lartë shpëtimtarë, kategoria B - Zjarrfikës udhëheqës shpëtimtarë, ndërsa pagat e zjarrfikësve profesionistë në përputhje me nenin 5 të Ligjit është më e lartë për 20% të pagës së punonjësve të tjerë me trajnim profesional përkatës për vendin e punës në administratën komunale. Kjo dispozitë ligjore nuk është mjaft e saktë, duke pasur parasysh që struktura e të punësuarve në komuna është shumë e ndryshme dhe varet nga disa faktorë. Për të tejkalluar gjendjet e konstatuara nevojitet zgjidhje e qartë dhe koncize ligjore për të përcaktuar pagën e zjarrfikësve profesionistë.

Ligji për Qytetin e Shkupit dhe

Ligji për sportin

Financimi i aktiviteteve në fushën e sportit dhe rekreacionit është paraparë në listën e kompetencave të komunave, në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, por jo edhe në kompetencat e komunave të Qytetit të Shkupit, të definuara në nenin 15 të Ligjit për Qytetin e Shkupit, sipas të cilit sporti nuk përfshihet në çështjet me interes publik, si kompetencë e komunave në Qytetin e Shkupit, gjegjësisht në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të njëjtë, kjo kompetencë është dhënë Qytetit të Shkupit. Në anën tjetër, në nenin 22-a të Ligjit për sport, janë përcaktuar kompetencat e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në fushën e sportit, kurse, për realizimin e tyre, këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit ose komisioni i komunës, komuna në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit përgjegjës për sport, miratojnë programe me propozim të

unioneve komunale të sportit dhe Unionit të Sportit të Qytetit të Shkupit.

Ligji për shfrytëzimin dhe disponimin me sende në pronësi shtetërore dhe me

Sende në pronësi komunale

Sipas dispozitës së nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponimin me sende në pronësi shtetërore dhe me sende në pronësi komunale, sendet e patundshmërive në pronësi të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, mund t'ua japin në shfrytëzim përkohësisht ose përgjithmonë, me ose pa kompensim, organeve shtetërore dhe personave juridikë të themeluar nga shteti, por jo edhe institucioneve ose personave juridikë të themeluar nga komuna.

Në funksion të tejkalimit të gjendjes së theksuar, mendojmë se është i nevojshëm të kryhet ndryshimi dhe plotësimi i zgjidhjes ligjore për mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm ose të përhershëm të sendeve të patundshmërive në pronësi komunale, ku do të përfshihen edhe personat juridikë të themeluar nga komuna.

Ligji për sigurim shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë të ndërmerr aktivitete për rishqyrtimin e zgjidhjeve ligjore dhe mundësive për implementimin dhe funksionimin e sistemit kombëtar të punëve materiale financiare dhe kontabilitetit në ISHP dhe sistemit qendror për evidentimin e kohës së punës.

Ligji për prokurime publike

Janë të nevojshme ndryshimet në Ligjin për prokurime publike në lidhje me kufizimin e marzhit të shitjes dhe sigurimit të shërbimeve për servisimin dhe pjesëve rezervë me çmime të cilat përputhen me çmimet e tregut, në procedurat për servisimin e pajisjeve për të cilat operatorët ekonomikë kanë pozitë monopoli / të drejtë ekskluzive.

Ligji për ujërat

Në Ligj është paraparë llogaritja e vlerës variable të kompensimit për lëshimin në ujëra, e cila duhet të përcaktohet në lejen e lëshimit në ujëra në bazë të «njësisë së dëmit», dhe llogaritjet nga personi që derdh ujërat e zeza të patrajuara në marrës. Në të vërtetë, Qeveria me propozim të ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor duhet të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së «njësisë së dëmit» në pajtim me sasinë e ujit të lëshuar, i cili lëshohet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe mënyrën e pagesës së vlerës variable të kompensimit për lëshimin në ujëra. Me revizion konstatoam se nuk është miratuar akti nënligjor i theksuar, për shkak të kësaj nuk është përcaktuar mënyra e llogaritjes së «njësisë së dëmit», në lejet e lëshimit në ujëra nuk përcaktohet vlera variable e kompensimit dhe ajo nuk llogaritet dhe arkëtohet.

Ligji për ujërat,

Ligji për ekonominë e ujërave

Në pajtim me Ligjin për ekonominë e ujërave, mbikqyrja inspektuese kryhet nga inspektorët e ekonomisë së ujërave nga aspekti i përdorimit të ujit dhe gjendja e objekteve dhe infrastrukturës së ekonomisë së ujërave në pajtim me kompetencat që rrjedhin nga Ligji për ujëra, por nuk është përcaktuar kompetenca e mbikëqyrjes inspektuese të procesit të ujitjes së sipërfaqes bujqësore si masë agroteknike. Është i nevojshëm rirregullimi i rregullativës ligjore në pjesën e kompetencave të mbikëqyrjes inspektuese të ujitjes si masë agroteknike.

Ligji për ekonominë e ujërave

Ligji për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve të ujërave

Përcaktimi i kompensimit për ujitje nuk është përfshirë si shërbim i ujit me Ligjin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve të ujërave që rregullon mënyrën e përcaktimit të çmimit të shërbimeve të ujërave edhe pse ujitja është konsumatori më i madh i ujit. Nga ana tjetër, nuk është miratuar metodologjia e paraparë me ligj për përcaktimin e tarifës së ujitjes, për këtë arsye përdoren çmimet e përcaktuara para miratimit të Ligjit për ekonominë e ujërave që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kur ujitjen të njëjtat kultura midis atyre që kryejnë aktivitet të ekonomisë së ujërave. Është i nevojshëm rishikimi dhe rirregullimi i zgjidhjeve ligjore të theksuara në pjesën e përcaktimit të mënyrës se si do të llogaritet kompensimi për ujitjen të cilën kryerësit e veprimtarisë së ekonomisë së ujërave e arkëtojnë nga përdoruesit.

Ligji për tokë bujqësore

Zbatimi i një pjese të dispozitave në Ligjin për tokë bujqësore krijon rreziqe për mosplotësimin e qëllimeve të ligjit, për këtë arsye ekziston nevoja për rishikimin dhe përmirësimin në pjesën e rregullimit të procedurave për lëshimin e tokës bujqësore të shtetit me qira me dhe pa publikim në shpallje, mundësia për përdorimin e tokës bujqësore tre vite papagesë nga personat fizikë dhe shoqëritë afariste, drejtuesit e të cilave janë më të rinj se 40 vjeç, si dhe për vendosjen e mbrojtjes juridike të shkallës së dytë për ofertuesit në të gjitha fazat e procedurave.

Ligji për material faror dhe për mbëltrim për bimët bujqësore

Ekziston nevoja për rirregullimin e Ligjit për material faror dhe për mbëltrim për bimët bujqësore në pjesën e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së kontratës për autorizimet publike.

Ligji për sigurim social,

Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale,

Dekreti për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok-dotacioneve për institucionet publike të mbrojtjes sociale - shtëpitë e pleqve

Institucionet Komunale Publike për mbrojtjen sociale - shtëpitë e pleqve financohen nëpërmjet bllok-dotacioneve ndarja e të cilave bëhet në pajtim me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Dekretin për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok-dotacioneve, por pas kësaj nuk merren parasysh kostot për mirëmbajtjen, ndërtimin dhe pajisjen e vazhdueshme të objekteve për mbrojtje sociale. Është e nevojshme Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me komunat të ndërmarrin aktivitete për rishqyrtimin dhe harmonizimin e kriterëve në bazë të të cilave ndahen mjetet buxhetore për financimin e shtëpive të pleqve.

Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë (LPSRP)

Kemi konstatuar parregullsi në ligj edhe në ligjet e tjera:

- ▶ me nenin 67 të LPSRP-së janë rregulluar kushtet me të cilat personat e papunësuar nuk mund të realizojnë kompensim me para në bazë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës që nuk janë në harmonizim të plotë me Ligjin

për marrëdhënie pune në pjesën e anulimit të kontratës së punës;

- ▶ me nenin 68 të LPSRP-së nuk është saktësuar mënyra e rregullimit të llogaritjes së shumës së KP-së gjatë punës me kohë të pjesshme të llogaritur si punë me kohë të plotë e cila si e drejtë është e paraparë edhe me nenin 66 alineja 2 të të njëjtit ligj, që kontribuon në mënyrë të ndryshme në veprim;

- ▶ me nenin 77 të LPSRP-së është rregulluar zbatimi i përfundimit të së drejtës për kompensim me para të personit të papunësuar nëse është udhëzuar nga Agjencia për të krijuar marrëdhënie pune, por nuk është saktësuar kushti nëse personi:

| "refuzon të paraqitet te punëdhënësi" i cili drejtohet në vend pune me përgatitje profesionale përkatëse ose ka deklaruar se pranon punësim edhe në shkallë më të ulët të përgatitjes profesionale;

| "refuzon të krijojë marrëdhënie pune te punëdhënësi" për të cilin punëdhënësi pranon dhe plotëson kushtet e punësimit, por edhe nëse kushtet e punësimit janë të përshtatshme për personin e papunë;

| është i angazhuar me punë për të kryer punë me kontratë në vepër dhe të përcaktojë statusin e tyre;

- ▶ me ligjin material nuk është saktësisht e rregulluar nëse bujqit individualë dhe kategoritë e tjera të personave kanë të drejtën e KP-së të cilët nuk janë të detyruar të paguajnë kontribut nga sigurimi i detyrueshëm në rast të papunësisë, ndërsa në pajtim me Ligjin për kontribut nga sigurimi i detyrueshëm social janë të detyruar të kontribuojnë për SPI dhe SSH.

- ▶ Ligji nuk përmban dispozita me të cilat do të rirregullohet e drejta e Agjencisë për të kërkuar kthimin e mjeteve (p.sh. gjatë kthimit në punë të personit të papunë me vendim gjyqësor retroaktiv), si dhe përcaktimin e afatit për kthimin e mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut / nënlogaria e Agjencisë.

Ligji për ndërtim dhe Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (LMTK)

Ekziston mos harmonizimi në përkufizimin e termit "rikonstruim" në Ligjin për ndërtim dhe LMTK. Në të vërtetë, në pajtim me Ligjin për ndërtim termi rikonstruim paraqet "kryerjen e punimeve në kuadër të përmasave ekzistuese të objektit me të cilat ndikojnë në plotësimin e kërkesave bazë për ndërtim dhe me të cilën ndryshohet pajtueshmëria e ndërtimit me projektin sipas të cilit është ndërtuar, me ndryshimin e fasadës, ndryshimin e procesit teknologjik dhe instalimin, sanimin dhe zëvendësimin e elementeve strukturore, etj., përkatësisht kryerjen e punimeve, me të cilat ndryshohet pajtueshmëria e ndërtimit me projektin sipas të cilit është ndërtuar". Ndërsa sipas LMTK-së termi "rikonstruim" është procedurë dhe metodë e restaurimit të pronës së mbrojtur që në masë të madhe është shkatërruar ose pjesët e tjera dhe të konstruksionit janë rrënuar. Për këtë arsye, më saktë për shkak të mos harmonizimit të termit rikonstruim sipas dy ligjeve, IK-ja për mbrojtje, si dhe personat e tjerë juridikë / fizikë që bartin projekte konservatore, përballen me vështirësi në nevojën për të siguruar miratimin nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për ndërtim.

Ligji për kontribut nga sigurimi i detyrueshëm social

Sistemi i përcaktimit, kontrollimit dhe arkëtimit të kontributeve nuk bazohet në integrimin dhe shkëmbimin e të dhënave të përditësuara dhe të plota ndërmjet DAP-së dhe institucioneve në sistemin e detyrueshëm të sigurimeve sociale, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Fondi i Sigurimit Shëndetësor dhe Agjencia e Punësimit sipas nenit 21 dhe 23 të ligjit. Drejtoria e të Ardhurave Publike ka detyrimin të paraqesë informacionin e dhënë ligjërisht pranë institucioneve, marrëveshjen e lidhur të ndërsjellë, por DAP-ja dorëzoi informacione vetëm për kontributet e paguara dhe për shumën e kontributeve të papaguara nga tatimpaguesit të cilët kanë dorëzuar llogari dhe kanë detyrimin për ta paguar atë, por jo për detyrimin e llogaritur për të paguar të gjitha obligacionet, siç parashikohet në përputhje me këtë ligj.



**RAPORTI
FINANCIAR I
ESHR-së DHE
RAPORTI I
REVIZORIT TË
PAVARUR**



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

До Собранието на Република Северна Македонија

Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2022, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710 заклучно со 31 декември 2022 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

Мислење

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2022 година.

Скопје, 31.05.2023

Овластен ревизор

Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија

PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Јаглика Јорданова Андријеска

Друштво за ревизија PCM
МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

Државен завод за ревизија
Финансиски извештај за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

Опис на позицијата	Образлож ение	во денари		
		Буџет 2022	Реализирано 2022	Реализирано 2021
Приходи				
Трансфери и донации	3.1.	139.875.000	133.663.705	111.147.301
Вкупно приходи		139.875.000	133.663.705	111.147.301
Расходи				
Тековни расходи				
Плати, наемнини и надоместоци	3.2.1.	102.680.000	100.721.812	93.793.726
Стоки и услуги	3.2.2.	27.075.000	23.526.749	13.368.469
Разни трансфери	3.2.3.	1.580.000	1.303.105	291.580
Вкупно тековни расходи		131.335.000	125.551.666	107.453.775
Капитални расходи				
Капитални расходи	3.3.	8.540.000	8.112.039	3.693.526
Вкупно капитални расходи		8.540.000	8.112.039	3.693.526
Вкупно расходи		139.875.000	133.663.705	111.147.301
Нето вишок на приходи - добивка по оданочување		-	-	-

Скопје, 21.02.2023

Данче Ангеловска

Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќања
Данче Ангеловска



Максим Ацевски

Главен државен ревизор

Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештај за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

Опис на позицијата	Образло- жение	во денари	
		2022	2021
Активa			
Тековни средства	4.1.		
Побарувања од купувачи	4.1.1.	218.497	218.497
Побарувања од вработените	4.1.2.	223.301	74.137
Активни временски разграничувања	4.1.3.	14.219.873	9.472.618
Залихи	4.1.4.	1.694.777	1.625.110
Вкупно тековни средства		16.356.448	11.390.362
Постојани средства	4.2.		
Нематеријални средства	4.2.1.	9.054.927	8.549.427
Материјални средства	4.2.2.	440.110.900	367.019.426
Вкупно постојани средства		449.165.827	375.568.853
Вкупна актива		465.522.275	386.959.215
Вонбилансна актива		-	-
Пасивa			
Тековни обврски	4.3.		
Краткорочни обврски спрема добавувачи	4.3.1.	1.301.645	1.163.527
Краткорочни обврски за плати и други обврски спрема вработените	4.3.2.	9.054.967	8.309.091
Пасивни временски разграничувања	4.3.3.	441.798	292.634
Вкупно тековни обврски		10.798.410	9.765.252
Долгорочни обврски	4.4.	3.863.261	-
Извори на средства	4.5.		
Извори на капитални средства		376.107.605	374.223.689
Ревалоризациона резерва		74.752.999	2.970.274
Вкупно извори на деловни средства		450.860.604	377.193.963
Вкупна пасивa		465.522.275	386.959.215
Вонбилансна пасивa		-	-

Скопје, 21.02.2023


Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќања
Данче Ангеловска


Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2022

ПРЕГЛЕД НА ПРОМЕНИ НА ИЗВОРИ НА СРЕДСТВА

О П И С	Државен јавен капитал	Останат капитал (залихи на материјали, резервни делови и ситен инвентар и хартии од вредност)	во денари
			Вкупно
Состојба 01.01.2022 година	375.568.853	1.625.110	377.193.963
Зголемување по основ на:	87.659.610	1.047.216	88.706.826
Зголемување на вредноста (капитализација)	15.827.185	1.047.216	16.874.401
По попис 2022			-
Ревалоризација	71.832.425		71.832.425
Намалување по основ на:	14.062.636	977.549	15.040.185
Амортизација	13.706.444		13.706.444
Издатници		966.747	966.747
По попис 2022	306.492	10.802	317.294
Ревалоризација	49.700		49.700
Состојба 31.12.2022 година	449.165.827	1.694.777	450.860.604



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

До Собранието на Република Северна Македонија

Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2022, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
Т+389 (0)2 3233 301
Е contact@rsm.mk
www.rsm.mk

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија – Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119 заклучно со 31 декември 2022 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

Мислење

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2022 година.

Скопје, 31.05.2023

Овластен ревизор

Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија

PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Јаглика Јорданова Андријеска



THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на PCM мрежата и тргува како PCM. PCM е трговското име кое се користи од страна на членките на PCM мрежата. Секој член на мрежата PCM е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата PCM самата не е посебно правно лице во ни една јурисдикција.

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметка на основен буџет на РСМ 631-19 за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

Опис на позицијата	Образложение	Буџет 2022	Реализирано 2022	Реализирано 2021
Приходи	3.1.			
Трансфери и донации	3.1.1.	2.970.000	2.494.120	2.516.120
Вкупно приходи		2.970.000	2.494.120	2.516.120
Расходи	3.2.			
Тековни расходи				
Стоки и услуги	3.2.1.	896.000	84.316	22.000
Вкупно тековни расходи		896.000	84.316	22.000
Капитални расходи				
Капитални расходи	3.2.2.	2.074.000	2.039.966	-
Вкупно капитални расходи		2.074.000	2.039.966	-
Вкупно расходи		2.970.000	2.124.282	22.000
Остварен вишок на приходи		-	369.838	2.494.120
Даноци, придонеси и други давачки од вишокот на приходи				
Нето вишок на приходи		-	369.838	2.494.120
Распоредување на вишокот на приходи				
Дел од нето вишокот на приходи за пренос во наредна година		-	369.838	2.494.120
Обврски за данок на добивка			-	-
Вкупно распоред на вишок на приходи		-	369.838	2.494.120

Скопје, 21.02.2023

Данче Ангеловска

Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќања
Данче Ангеловска



Максим Ацевски

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметка на основен буџет на РСМ 631-19 за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

Опис на позицијата	Образло жение	во денари	
		2022	2021
Актива			
Тековни средства	4.1.		
Парични средства	4.1.1.	369.838	2.494.120
Побарувања од купувачите во земјата	4.1.2.	9.341.850	9.341.850
Побарувања од вработените	4.1.3.	-	-
Активни временски разграничувања	4.1.4.	-	-
Вкупно тековни средства		9.711.688	11.835.970
Постојани средства	4.2.		
Нематеријални средства	4.2.1.	-	-
Материјални средства	4.2.2.	-	-
Вкупно постојани средства		-	-
Вкупна актива		9.711.688	11.835.970
Вонбилансна евиденција - актива		-	-
Пасива			
Тековни обврски	4.3.		
Краткорочни обврски спрема добавувачи	4.3.1.	-	-
Пасивни временски разграничувања	4.3.2.	9.711.688	11.835.970
Вкупно тековни обврски		9.711.688	11.835.970
Извори на средства	4.4.		
Извори на капитални средства		-	-
Ревалоризациона резерва		-	-
Вкупно извори на деловни средства		-	-
Вкупна пасива		9.711.688	11.835.970
Вонбилансна евиденција - пасива		-	-

Скопје, 21.02.2023

Данче Ангеловска

Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќања
Данче Ангеловска

Максим Ацевски

Главен државен ревизор

Максим Ацевски



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

До Собранието на Република Северна Македонија

Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на буџет на донации Проект од General Court of Audit – Saudi FISP, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2022, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективност на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на буџет на донации Проект од General Court of Audit – Saudi FISP заклучно со 31 декември 2022 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING



PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

T+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

Мислење

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2022 година.

Скопје, 31.05.2023

Овластен ревизор

Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија

PCM МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

Јаглика Јорданова Андријеска



THE POWER OF BEING UNDERSTOOD


AUDIT | TAX | CONSULTING

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Проект од General Court of Audit – Saudi FISP за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

Опис на позицијата	Образложе ние	Буџет 2022	Реализирано 2022	Реализирано 2021
Приходи				
Вкупно приходи		-	-	-
Расходи				
Вкупно расходи		-	-	-
Нереализирани средства од буџетот		-	-	-
Даноци, придонеси и други давачки од вишокот на приходи - добивка пред оданочување				
Нето вишок на приходи - добивка по оданочување		-	-	-

Скопје, 21.02.2023


Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќање
Данче Ангеловска




Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Проект од General Court of Audit – Saudi FISP за годината завршена на 31 декември 2022

БИЛАНС НА СОСТОЈБА

Опис на позицијата	Образло- жение	во денари	
		2022	2021
Актива			
Вкупна актива		-	-
Пасива			
Вкупна пасива		-	-

Скопје, 21.02.2023

Данче Ангеловска

Раководител на одделение за
буџетска контрола и плаќање
Данче Ангеловска



Максим Ацевски

Главен државен ревизор

Максим Ацевски

Shkurtesat

ESHR	Enti Shtetëror i Revizionit	MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
ISR	Institucioni Suprem i Revizionit	NPP	Ndërmarrja Publike Private
KRSH	Kryerevizori shtetëror	SÇE	Sekretariati për Çështje Evropiane
ZKRSH	Zëvendësi i kryerevizorit shtetëror	IPA	Instrumenti i Ndihmës Para-Aderuese
BE	Bashkimi Evropian	SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit	OECD	The Organisation for Economic Co-operation and Development
ISSAI	Standarde ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit	IDI	INTOSAI Development Initiative
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Revizionit	WGPD	Grupi Punues i INTOSAI për Borxhin Publik
AMS	Audit management system	WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci
WBIF	Korniza e Investimeve për Ballkain Perendimor	ZHVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional
TI	Teknologjia Informatike	MF	Ministria e Financave
NJVL	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	NPAA	Programi Nacional për Miratimin e të Drejtës së Bashkimit Evropian
ISHP	Instituti Shëndetësor Publik	SHA MEPSO	Operator i sistemit elektrotransmetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëri Aksionar për transmetimin e energjisë elektrike dhe menaxhimi i sistemit elektroenergetik.
DAP	Drejtoria e të Ardhurave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut	EE	Energji elektrike
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar	MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
BPV	Bruto prodhimi vendor	MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike	ISHMJ	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor
NPK	Ndërmarrje Publike Komunale	MBPEU	Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujit
SHA	Shoqëri Aksionare	AMFBZR	Agjencioni për Mbështetje Financiale në Bujqësi dhe zonat rurale
ZZHTI	Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale	AUV	Agjencioni për ushqim dhe veterinar
ZI	Zonaindustriale		
FIZHT	Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik		

KE	Komisioni Evropian
NJRKZ	Njësia Territoriale Zjarrfikëse
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit
SPI	Sigurimi pensional invalidor
PP	Prokurime publike
LPP	Ligji për prokurime publike
SNK	Standardet ndërkombëtare kontabël
CAAT's	Teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter
IK	Institucion Kombëtar
PP	Parti Politike
ISHP	Institucionet shëndetësore publike
IPSH	Institucionet private shëndetësore
SHA ESM	Për prodhim të energjisë elektrike ESM
KP	Kompensimi me para
QP	Qendra për punësim
SM	Sigurimi material
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
LVF	Ligji për veprimtari filmike
DMTK	Drejtoria për mbrojtje të trashëgimisë kulturore
LMTK	Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore
ASHMAAV	Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i Republikës së Maqedonisë së Veriut

KSHZ	Komisioni Shtetëror për Zgjedhje
VMRO-DPMNE (OBRM-PDBKM)	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
BDI	Bashkimi demokratik për Integrim
SET	Sistemi i elektrotransmetimit
QMK	Qendra për menaxhim me krizat
SHA	Ekonomia e Ujërave- Shoqëria aksionare në pronësi të shtetit Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë së Veriut
NP Strezhovë	Ndërmarrja publike Strezhovë, Manastir;
QEF	Qendrat elektrike fotovoltaike
BRE	Burimet e ripërtëritshme të energjisë
QTE	Qendra termoelektrike
KEX	Kombinati i energjisë së Xehetarisë



